

Konsolidimi i demokracisë në Kosovë - sfidat

Doktoranti: Xhavit Drenori

Dorëzuar:
Universitetit European të Tiranës
Shkollës Doktorale

Në përmbushje të detyrimeve të programit të Doktoratës në: Shkenca sociale, me profil: Marrëdhënie ndërkombëtare, për marrjen e gradës shkencore “Doktor”.

Udhëheqës shkencor: Prof. Dr. Petrit Nathanaili

Numri i fjalëve: 51250

Tiranë, dhjetor / 2018

Konsolidimi i demokracisë në Kosovë - sfidat

Doktoranti: Xhavit Drenori

Dorëzuar:
Universitetit European të Tiranës
Shkollës Doktorale

Në përmbushje të detyrimeve të programit të Doktoratës në: Shkenca sociale, me profil: Marrëdhënie ndërkombëtare, për marrjen e gradës shkencore “Doktor”.

Udhëheqës shkencor: Prof. Dr. Petrit Nathanaili

Numri i fjalëve: 51250

Tiranë, dhjetor / 2018

DEKLARATA E AUTORËSISË

Nën përgjegjësinë time personale deklaroj se ky studim është punë origjinale, pra i shkruar nga unë, dhe nuk përmban plagjiaturë. Studimi nuk është prezantuar asnjëherë më parë para një institucioni tjetër apo botuar si tërësi apo pjesë të tij.

Autori

ABSTRAKTI

Qëllimi i këtij studimi është që në mënyrë shkencore të ofrojë fakte rreth shkallës së cilësisë së demokracisë, respektivisht konsolidimit të saj në Republikën e Kosovës.

Përderisa demokracia si sistem politik dallohet qartë nga sistemet tjera qeverisëse, rreth definimit të saktë të konsolidimit të demokracisë, politikologët ende nuk kanë gjetur një pikë të përbashkët. Në fakt, me konsolidimin e demokracisë me të madhe ka filluar të merret shkenca tek pas të ashtuquajturës “Vala e tretë e demokratizimit” (Hunginton).

Kosova është shtet i ri dhe rreth vet proceseve të saj demokratike flitet shumë vonë, pas luftës së vitit 1999. Prandaj, edhe kufizimi i këtij studimi do të jetë procesi, sfidat dhe problemet e konsolidimit të demokracisë në Kosovë që nga vendosja e mekanizmave ndërkombëtare pas përfundimit të luftës në vitin 1999. Po ashtu, një fokus i veçantë do t’i kushtohet faktorëve qoftë ata atë brendshëm apo të jashtëm, të cilët kanë ndikuar dhe vazhdojnë të ndikojnë në procesin e konsolidimit të demokracisë në Kosovë.

Rruga nëpër të cilën ka kaluar shtetndërtimi i Kosovës pas viti 1999 karakterizohet me një konsolidim të veçantë të demokracisë për shkak të ndikimit direkt apo indirekt të faktorëve të ndryshëm.

Prandaj, përmes këtij studimi synohet të identifikohen faktorët kryesor që i kanë kontribuar ngadalësimit të demokracisë, të vlerësohet roli i shoqërisë civile si dhe roli i mekanizmave ndërkombëtarë në konsolidimin e demokracisë në Kosovë.

Fjalë kyçe: *Demokratizimi, Konsolidimi i demokracisë, Sfidat, faktorët e brendshëm dhe të jashtëm që ndikojnë në konsolidimin e demokracisë.*

ABSTRACT

The purpose of this study is to provide scientific facts about the quality of democracy assessment, respectively its consolidation in the Republic of Kosovo. While democracy as a political system is clearly distinguished from other systems of governance, politicians have not yet found a common point. In fact, with the consolidation of democracy, science is beginning to be dealt with after the so-called "Third Wave of Democratization" (Huntington).

As a new state, Kosovo used to speak about its democratic processes too late, after the war of 1999. Therefore, the limitation of this study will be the process of challenges and problems of consolidating democracy in Kosovo since the establishment of international mechanisms following the conclusions of the war in 1999. Also, a special focus will be given to the internal and external factors that have influenced and continue to influence the process of consolidating democracy in Kosovo.

The road that Kosovo passed through since 1999 to achieve its state-building is characterized by a special consolidation of democracy due to the direct or indirect impact of various factors.

Therefore, this study aims to identify key factors contributing to the slowdown in democracy, to assess the role of civil society and the role of international mechanisms in the consolidation of Democracy in Kosovo.

Key words: *Democratization, Democracy consolidation, Challenges, internal and external factors affecting the consolidation of democracy.*

Falënderime:

Një falënderim të veçantë për udhëheqësin shkencor të studimit, Prof. Dr. Petrit Nathanaili, për sugjerimet e vazhdueshme gjatë hulumtimit.

Falënderim dhe mirënjohje të thellë edhe familjes sime për mbështetjen, kurajon, për lehtësitë e mëdha që m'i ofruan, si edhe që m'i krijuan të gjitha mundësitë për ta realizuar këtë projekt.

Dedikimi:

Bashkëqytetarëve të vendit tim!

Shkurtesat

OKB:	Organizata e Kombeve të Bashkuara
NATO:	Organizata e Traktatit të Atlantikut të Veriut
SHBA:	Shtetet e Bashkuara të Amerikës
KFOR:	Forcë Ndërkombëtare për Siguri në Kosovë (pjesë e NATO-s)
UNMIK:	Misioni Ndërkombëtar i Kombeve të Bashkuara në Kosovë
BE:	Bashkimi Evropian
EULEX:	Misioni i Bashkimit Evropian në Kosovë
OSBE:	Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë
ICO:	Zyrës Ndërkombëtare Civile (Internacional Civil Office)
PSSP:	Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm të Kombeve të Bashkuara
USAID:	Agjencia e Shteteve të Bashkuara për Zhvillim Ndërkombëtar
UÇK:	Ushtria Çlirimtare e Kosovës
KGJK:	Këshilli Gjyqësor i Kosovës
KPK:	Këshilli Prokurorial i Kosovës
AKK:	Agjencia Kosovare Kundër Korrupsionit
BTI:	Indeksi i Transformacionit sipas Fondacionit "Bertelsmann"
KE:	Komuniteti Evropian
TBE:	Traktati i Bashkimit Evropian
EUSR:	Përfaqësuesi Special i Bashkimit Evropian në Kosovë
IPA:	Instrumenti për Ndihmën e Para-Anëtarësimit
KLMDNJ:	Këshilli për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive të Njeriut
IPVQ:	Institucionet e Përkohshme të Vetëqeverisjes
OJQ:	Organizata Joqeveritare
OShC:	Organizata të Shoqërisë Civile

Përmbajtja

i.	Hyrja.....	13
ii.	Pyetjet kërkimore dhe hipotezat e studimit.....	15
iii.	Përmbajtja e studimit	16
iv.	Metodologjia e studimit	17

Kapitulli I - Definimi i termeve *tranzicion, demokratizim dhe konsolidim i demokracisë*.....

19

I.1	Tranzicioni	19
I.1.1	Fazat e tranzicionit	19
I.1.1.1	Faza e liberalizimit.....	20
I.1.1.2	Faza e demokratizimit.....	22
I.1.1.3	Faza e konsolidimit të demokracisë.....	23
I.1.1.4	Sfidat kryesore me të cilat përballën shtetet gjatë tranzicionit.....	35

Kapitulli II - Kosova nën administrimin dhe mbikëqyrjen ndërkombëtare.....

40

II.1	Kosova në vitet e 90-ta.....	40
II.2	Themelet e konsolidimit të demokracisë në Kosovë pas vitit 1999.....	42
II.2.1	Shpallja e pavarësisë së Kosovës (pavarësia e mbikëqyrur ICO).....	46
II.2.1.2	Misioni i Bashkimit Evropian në Kosovë (EULEX).....	48
II.2.1.3	Përfundimi i mbikëqyrjes ndërkombëtare.....	50
II.2.1.4	Nga decentralizimi deri tek asociacioni i komunave me shumicë serbe.....	51
II.2.1.5	Influenca e Serbisë tek komuniteti serb në Republikën e Kosovës.....	54

Kapitulli III – Ndarja e pushteteve: Ekzekutivi, Legjislativi dhe Gjqësori dhe roli i tyre në konsolidimin e demokracisë në Kosovë 59

III.1.1 Sistemi legjislativ dhe parlamentarizmi.....	66
III.1.1.2 Roli i pushtetit legjislativ në konsolidimin e demokracisë në Kosovë.....	70
III.1.1.3 Roli i partive politike në konsolidimin e demokracisë në Kosovë.....	75
III.1.1.4 Zgjedhjet e lira dhe të ndershme.....	79
III.1.1.5 Pushteti ekzekutiv.....	82
III.1.1.6 Roli i pushtetit ekzekutiv në konsolidimin e demokracisë në Kosovë.....	83
III.2. (Mos) Besimi i qytetarëve në Institucionet shtetërore të Republikës së Kosovës.....	87

Kapitulli IV - Efikasitetit i sistemit Gjyqësor në Kosovë dhe roli i tij në konsolidimin e demokracisë në Kosovë..... 90

IV.1.1 Sistemi gjyqësor në Kosovë.....	90
IV.1.2 Historiku i sistemit gjyqësor në Kosovë.....	91
IV 1.3 Gjyqësori në Kosovë nga viti 1945 deri në kushtetutën e vitit 1974.....	92
IV.1.4 Rrënimi i sistemit gjyqësor në Kosovë gjatë viteve të 90-ta.....	94
IV.1.5 Ngritja e sistemit gjyqësor nga viti 1999 deri me shpalljen e pavarësisë.....	94
IV.1.6 Sistemi gjyqësor pas shpalljes së pavarësisë së Kosovës.....	96
IV.1.7 Këshilli gjyqësor dhe gjykatat në Republikën e Kosovës.....	97
IV.1.8 Gjykatat e Kosovës.....	98
IV.1.9 Këshilli Prokurorial dhe prokuroritë në Republikën e Kosovës.....	100
IV.1.10 Prokurori i shtetit.....	101
IV.1.11 Zyra e Prokurorit të Shtetit.....	102
IV.1.12 Efikasiteti i Drejtësisë në luftën kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar.....	102
IV.1.13 Efikasiteti i gjykatave në Kosovë.....	103
IV.1.14 Efikasiteti i prokurorive në Kosovë.....	108

**Kapitulli V – Institucioni i presidentit të Kosovë dhe roli i tij
në konsolidimin e demokracisë në Kosovë..... 118**

V.1 Presidenti i Republikës së Kosovës – historiku.....	118
V.2 Pozita e Presidentit parlamentar të Republikës së Kosovës.....	120
V.3 Kompetencat e Presidentit të Republikës së Kosovës.....	124
V.4 Sfidat e Institucionit të Presidentit në konsolidimin e demokracisë në Kosovë	127
V.4.1 Shkeljet kushtetuese të Presidentit dhe krizat politike.....	128
V.4.2 Fushata elektorale dhe poyita e Presidentit	131
V.4.3 Roli i Presidentit të Republikës se Kosovës karshi dialogut me Serbinë.....	132

**Kapitulli VI – Roli i mekanizmave ndërkombëtare në
konsolidimin e demokracisë në Kosovë..... 137**

VI.1. Roli i BE-së.....	137
VI.1.1 Mekanizmat para-anëtarësimit.....	138
VI.1.1.1 Kriteri politik.. ..	139
VI.1.1.2 Kriteri ekonomik.....	140
VI.1.1.3 Kriteri i përafrimit të legjislacionit Kosovar me atë të BE-së.....	141
VI.1.1.4 Marrëdhëniet BE-Kosovë.....	142
VI.1.1.5 Marrëveshja e stabilizim-asocimit.....	143
VI.1.1.6 Mbështetja financiare - instrumenti ndihmës për para-anëtarësim IPA.....	146
VI.1.1.7 Roli i organizatës për Siguri dhe Bashkëpunim Evropian (OSBE).....	148
VI.1.1.8 Organizimi dhe mbikëqyrja e zgjedhjeve.....	149
VI. 1.1.9 Promovimi dhe mbrojtja e të drejtave të njeriut dhe komuniteteve.....	151
VI.1.1.10 Demokratizimi i institucioneve.....	151
VI.1.1.11 Forcimi i sigurisë dhe rendit publik.....	153
VI.1.1.12 Roli i Kuintit.....	154

Kapitulli VII – Roli i Shoqërisë Civile dhe Mediave në konsolidimin e demokracisë në Kosovë	158
VII.1 Përkufizimi i shoqërisë civile.....	158
VII.1.1 Historiku i zhvillimit të shoqërisë civile në Kosovë.....	163
VII.1.1.1 Roli i organizatave të shoqërisë civile në konsolidim të demokracisë në Kosovë.....	165
VII.1.1.2 Historiku i zhvillimit të mediave dhe rëndësia e tyre në proceset demokratike.....	171
VII.1.1.3 Funkcioni i media në zhvillimin e demokracisë.....	176
VII.1.1.4 Roli i Mediave në konsolidimin e demokracisë në Kosovë.....	180
Rekomandimet.....	190
Përfundimet.....	192
Bibliografia.....	201
Lista e tabelave.....	213
Anekset:.....	214

i. Hyrje

“Asnjë shtet nuk ka të drejtë që të fshihet prapa sovranitetit shtetëror për të shkelur të drejtat e njeriut apo të drejtat themelore të popullit të vet”, kishte thënë Sekretari i Përgjithshëm i OKB-së, Kofi Anan, gjatë një fjalimi para Komisionit për të Drejtat e Njeriut, në Gjenevë, në prill të vitit 1999.¹

Sado që kishte shkaktuar debat të madh në Kombet e Bashkuara, ishte e pashmangshme ndërhyrja ushtarake për parandalimin e një katastrofe humanitare në Kosovë, të shkaktuar nga politika hegjemoniste e Serbisë. Kështu që më 24 mars të vitit 1999 ndërhyri Aleanca ushtarake më e fuqishme në botë, NATO, kundër forcave serbe, për t’i dhënë fund gjithashtu edhe luftës së armatosur në Kosovë.

U nevojiten plot 78 ditë bombardime mbi caqet ushtarake serbe për t’i hapur rrugë një - de fakto - protektorati ndërkombëtar për Kosovën, si fazë tranzicioni deri në gjetjen e statusit politik, të cilit i paraprinte marrëveshja ushtarake (Marrëveshja e Kumanovës), e cila përfundimisht e gjuhëzonte Millosheviqin dhe e detyron atë t’i tërheqë të gjitha forcat ushtarake dhe paramilitare nga Kosova.

Me ndërhyrjen e NATO-s rezultoi edhe Rezoluta 1244 të Kombeve të Bashkuara të 10 qershorit të vitit 1999, me ç’rast në Kosovë do të instalohej një Mision Ndërkombëtar (UNMIK) nën mandatin e Kombeve të Bashkuara, i cili do ta qeveriste Kosovën në fazën e tranzicionit, deri te gjetja e një zgjidhjeje të statusit përfundimtar politik për Kosovën.

¹ Kofi Annan “No government has the right to hide behind national sovereignty in order to violate human rights”. 07.04.1999. Për më shumë:
<http://www.un.org/press/en/1999/19990407.sgsm6949.html>. E qasur: Qershor 2016.

Këtij misioni do t'i duhej rreth një dekadë veprimi që ta ndihmonte Kosovën, së pari në rindërtimin e infrastrukturës së shkatërruar nga lufta dhe njëkohësisht në aspektin politik ta ndihmonte në themelimin e institucioneve vendore, lokale dhe qendrore, të cilat më pas, pas dështimit të shumë negociatave me Serbinë të ndërmjetësuara nga Bashkësia Ndërkombëtare, më 17 shkurt të vitit 2008, do ta shpallnin Kosovën të pavarur dhe sovranë.

Deri tek shpallja e pavarësisë, Kosova ishte një protektorat i Kombeve të Bashkuara, ku gjatë procesit të themelimit e më vonë konsolidimit të institucioneve, në asnjë sferë nuk mungoi ndikimi nga mekanizmat ndërkombëtar, veprimet e të cilëve në disa raste kane ngadalësuar apo penguar konsolidimin e demokracisë.

Meqë konsolidimi i shtetit të Kosovës do të jetë boshti i tezës së studimit, atëherë në pjesën e parë të hulumtimit fokusi do të jetë së pari në teoritë e konsolidimit të demokracisë, respektivisht konsolidimit të shtetit në përgjithësi, duke u bazuar në teoritë e shumta, ku vlen të përmendet ajo e Linz dhe Stepan, Wolfgang Merkel, Robert Dahl.

Në teoritë e transformacionit nga një regjim autoritar në demokraci, realizimi bëhet në tri faza. Faza e parë: shkatërrimi i sistemit; faza e dytë: demokratizimi; faza e tretë: konsolidimi i demokracisë, dhe saktësisht faza e tretë do të jetë edhe çështja kryesore e këtij studimi.

Për të qenë sa më të saktë në përkufizimin e konsolidimit të demokracisë në Kosovë, është shumë e nevojshme të analizohet edhe definimi i termit “demokraci e konsoliduar”.

Gjatë analizës në studimin tim, do të provoj t'i ofroj disa definime më të avancuara, si p.sh.: ato të Linz/Stepan, Robert Dahl, Wolfgang Merkel. Megjithatë, analizimi i konsolidimit të demokracisë në Kosovë do të bëhet kryesisht duke u bazuar në metodën e të ashtuquajturës Vier-Ebene-Model

(Model i katër niveleve) të politologut gjerman Wolfgang Merkel, meqë ky model i përshtatet më së miri edhe situatës dhe çështjes së Kosovës.

ii. Pyetjet kërkimore dhe hipotezat e studimit

Për ta trajtuar procesin dhe nivelin e konsolidimit të demokracisë në Kosovë janë ngritur disa pyetje shkencore, të cilave në këtë studim do të provoj t'iu jap përgjigje.

Pyetja parësore kërkimore do të jetë:

1. Cilët janë faktorët kryesor që po e ngadalësojnë konsolidimin e demokracisë në Kosovë?

Për të ardhur deri tek një përgjigje, do të analizohen faktorët kryesor që kanë ngadalësuar dhe po vazhdojnë të ngadalësojnë konsolidimin e demokracisë në Kosovë.

Pyetja e dytë kërkimore, e cila është në thelb e lidhur ngushtë me pyetjen e parë, do të jetë:

2. Cili është roli i shoqërisë civile në konsolidimin e demokracisë në Kosovë?

Dihet mirëfilli që Shoqëria Civile dhe Mediat në përgjithësi luajnë një rol të rëndësishëm në konsolidimin e demokracisë në secilin shtet. Do të provoj t'iu jap përgjigje pyetjes në lidhje me atë se çfarë roli ka luajtur dhe po luan shoqëria civile në konsolidimin e demokracisë në Kosovë?

Dhe pyetja e fundit kërkimore është:

3. Cili është roli i mekanizmave ndërkombëtar në konsolidimin e demokracisë në Kosovë, përfshirë edhe integrimin e pakicës serbe në institucionet dhe shoqërinë kosovare?

Duke pasë parasysh që në Kosovë ka prani të madhe të mekanizmave ndërkombëtar që nga viti 1999, duhet të jepet përgjigje në pyetjen rreth rolit të tyre në konsolidimin e demokracisë në Kosovë.

Nga pyetjet kërkimore më lartë, do të testohen dy hipotezat e mëposhtme:

- 1. Mosushtimi i kompetencave në mënyrë të pavarur i legjislativit, ekzekutivit dhe gjyqësorit ka ndikuar në ngadalësimin e procesit të konsolidimit të demokracisë në Kosovë.***

Pra, do të provoj të argumentoj që mosushtimi i kompetencave dhe përgjegjësiwe institucionale në mënyrë të pavarur nga tri pushtetet (legjislativi, ekzekutivi dhe gjyqësori) ndikon në ngadalësimin e procesit të konsolidimit demokratik në Kosovë.

- 2. Mosnjohja e Republikës së Kosovës si shteti i tyre nga komuniteti serb në Kosove si dhe mospengimi i ndërhyrjes destruktive të Serbisë nga mekanizmat ndërkombëtar, janë pengesë për konsolidimin e demokracisë në Kosovë.***

Do të provoj të argumentoj se shkakut që shumica e komunitetit serb në Kosovë ende nuk e njeh subjektivitetin e shtetit të Kosovës, rrjedhimisht sjell edhe influenca të politikave shtetërore të Republikës së Serbisë, e që bëhen pengesë serioze e konsolidimit të demokracisë në Kosovë.

iii. Struktura e studimit

Kjo temë është e strukturuar në shtatë kapituj.

Në kapitullin e parë trajtohen definimi i termeve të tranzicionit, fazat nëpër të cilat kalon ai, demokratizimi dhe konsolidimi i demokracisë.

Kapitulli i dytë në fokus e ka që të analizoj themelet e konsolidimit të demokracisë në Kosovë pas vitit 1999, duke prekur rolin e UNMIK, deri tek shpallja e pavarësisë. Veç kësaj, këtu analizohet edhe roli i mekanizmit mbikëqyrës të pavarësisë së Kosovës, përfundimi i mbikëqyrjes dhe vendosja e EULEX-it.

Duke marrë për bazë se ndarja e pushteteve dhe funksionimi i tyre në mënyrë të pavarur luan një rol të rëndësishëm në konsolidimin e demokracisë, kapitulli i tretë dhe i katërt trajton funksionimin e legjislativit, ekzekutivit dhe gjyqësorit në Kosovë si dhe rolin e tyre në fuqizimin e demokracisë.

Sfidat që e kanë karakterizuar funksionimin e Institucioni i Presidentit të Republikës së Kosovës dhe rolin e tij në konsolidimin e demokracisë do ta trajtojmë në kapitullin e pestë të këtij studimi.

Në procesin e shtet-ndërtimit si dhe në konsolidimin e demokracisë, kanë qenë të përfshirë edhe mekanizmat ndërkombëtarë, prandaj është e një rëndësie të veçantë që këta mekanizma të trajtohen në kapitullin e gjashtë.

Kapitulli i shtatë ka në fokus rolin e mediave dhe shoqërisë civile në konsolidimin e demokracisë në Kosovë.

iv. Metodologjia e studimit

Duke pasur parasysh që studimi është kufizuar vetëm në sfidat e konsolidimit të demokracisë në Kosovë dhe për këtë çështje janë trajtuar institucione vendore, ndërkombëtare si dhe shoqëria civile,

në studim domosdoshmërisht është nevojitur metoda analitike, gjë që shumica e të dhënave të mbledhura nga hulumtimi do të përfshijnë aspekte teorike, historike dhe statistikore.

Për qëllim të këtij studimi doktoral, kam shfrytëzuar burime të ndryshme që lidhen më këtë temë dhe që kanë ndihmuar në zhvillimin e hulumtimit.

Metodologjia e përdorur në mbledhjen e të dhënave relevante përfshinë hulumtimin e gjerë shkencor nga materiali i ndryshëm: nga studime, revista shkencore, artikuj të gazetave, raporte periodike të institucioneve kredibile ndërkombëtare (Komisioni Evropian, Freedom House, Bertelsmann Stiftung Indeks etj.), shumë nga to edhe në gjuhë të huaja, si gjermanisht dhe anglisht, ka konsistuar në punën për përgaditjen e këtij studimi.

Burimet dytësore përmes publikimeve, dokumentacionit qeveritar dhe anketimeve kanë krijuar kornizën e nevojshme për përcaktimin e kufijve të hulumtimit dhe hipotezave në lidhje me pyetjen e faktorëve kryesor që po ngadalësojnë konsolidimin e demokracisë në Kosovë.

Pra, ky studim doktoral është hulumtim analitik dhe kërkon kombinime të burimeve parësore dhe dytësore, si dhe metodat sasiore dhe cilësore. Për pjesën teorike do të përdorën kryesisht burime, si libra akademik dhe revista, ndërsa si burime të tjera sekondare të dobishme do të përfshihen raporte qeveritare dhe statistika, që do të shërbejnë si bazë për analizë, duke ofruar konkluzione të shëndosha dhe rekomandime në lidhje me pyetjen e hulumtimit. Gjithashtu, në aspektin teorik një rëndësi e veçantë do t'i jepet konceptit të politologut gjerman Wolfgang Merkel dhe gjithashtu politologëve/shkencëtarëve të tjerë që kanë trajtuar këtë fushë, duke pasur parasysh që askush në Kosovë (me dijeninë dhe hulumtimet e mia) deri me tani nuk ka shqyrtuar konsolidimin e demokracisë bazuar në konceptin e Wolfgang Merkel dhe politologëve/shkencëtarëve tjerë.

Për t'iu përgjigjur pyetjeve kërkimore me saktësi, kërkimi empirik ka qenë i nevojshëm dhe i domosdoshëm, i cili i ka paraprirë edhe një pyetësori që ka pasur për qëllim intervistimin e zyrtarëve shtetëror (deputetë) si dhe njohës të fushës nga shoqëria civile. Ky pyetësor i është bashkëngjitur studimit në aneks.

Duke pasur parasysh faktin se për demokracinë në Kosovë mund të flasim vetëm pas vitit 1999, studimi domosdoshmërisht kufizohet në kohë, përkatësisht në dy dekada, 1999 deri 2008, periudhën që Kosovën e kishte administruar administrata e Kombeve të Bashkuara në Kosovë dhe periudhën nga viti 2008, koha kur ishte shpallur pavarësia e Kosovës e deri më sot. Meqë ky studim do të analizoj funksionimin e institucioneve në mënyrë demokratike sipas metodës së **katër fushave** të politologut gjerman, Wolfgang Merkel, atëherë dekada e dytë, 2008 deri më sot, do të përbëj boshtin e studimit.

KAPITULLI I - Definimi i termeve *tranzicion, demokratizim dhe konsolidim i demokracisë*

I.1. Tranzicioni

Para se të diskutohen konceptet e ndryshme të tranzicionit dhe konsolidimit, duhet theksuar që procesi i demokracisë mund të ndahet në dy pjesë të dallueshme, pra tranzicioni dhe konsolidimi, edhe pse përkohësisht të dyja mund të mbivendosen ose edhe përkojnë me njëra-tjetrën (Gunther / Puhle /4 Diamanduros; 1995:3). Termi “tranzicion” nënkupton kalimin e një sistemi institucional

nga një regjim politik në një tjetër. O'Donnel dhe Schmitter² e definojnë tranzicionin si një fazë kalimtare nga një regjim në një tjetër (të panjohur) “something else”. Më tej, sipas këtyre autorëve, koha gjatë tranzicionit është kohë e brishtë, në të cilën rregullat apo normat e vjetra e kanë humbur vlefshmërinë dhe rregullat apo normat e reja ende nuk janë instaluar. Vetëm në raste të rralla bëhet ky kalim i sistemit politik në një demokraci të konsoliduar, në një kohë të shkurtër dhe pa pengesa. Pengesat më të mëdha elitës së re politike i dalin nga elita e vjetër, e cila me çdo kusht pengon instalimin e sistemit të ri. Autorët më tutje e definojnë tranzicionin demokratik si fazën kalimtare nga regjimi autoritar në regjim demokratik. Ky kalim, sipas tyre, bëhet në tri faza. Ato janë: *faza e liberalizimit, faza e demokratizimit dhe faza e konsolidimit të demokracisë*. Të këtij mendimi janë edhe autorët Przeworski si dhe Nolen e Thibaut.

I.1.1. Fazat e tranzicionit

Në hulumtimet e tranzicionit në shkencat politike, termi *demokraci* është shumë më pak i diskutueshëm sesa termi *demokraci e konsoliduar* si dhe rruga dhe kohëzgjatja e konsolidimit: cilat institucione politike, ekonomike dhe sociale duhet të etablohen për të konkluduar se një sistem demokratik është “stabil”?

Siç u potencua në hyrje të këtij kapitulli, autorët O'Donell dhe Schmitter tranzicionin e organizojnë në tri faza: *faza e liberalizimit, faza e demokratizimit dhe faza e konsolidimit të demokracisë*.

² Transition from Authoritarian Rule: Tentative Conclusions about Uncertain Democracies (Tranzicioni nga rregullat autoritare: konkludim tentativ rreth demokracive të pasigurta). Për më shumë: http://isites.harvard.edu/fs/docs/icb.topic925740.files/Week%206/Odonnell_Transitions.pdf. E qasur: Qershor 2016.

Para fillimit të fazës së parë, autorët e lartpërmendur e përshkruajnë edhe një mini fazë të quajtur si *para-tranzicion*. Me këtë periudhë është menduar koha më e vështirë që kalon një vend në këtë proces, duke pasur parasysh që në këtë kohë regjimi autoritar e ka arritur kulmin e shtypjes kundër elitave demokratike, madje duke përdorur edhe ushtrinë. Këtu përfshihen edhe një sërë masash tjera të regjimeve autoritare, si shtypja e fjalës së lirë dhe ndalimi i operimit të forcave opozitare. Në të shumtën e rasteve, madje, në këtë fazë është krijuar një qeverisje partiake, e cila nuk duron të ketë parti opozitare. Lëvizjet apo partitë me mendim ndryshe zakonisht operojnë fshehtas ose në ekzil.

Fillimi i përfundimit të një regjimi autoritar shënohet si koha e kalimit në fazën e liberalizimit të procesit të tranzicionit. Megjithatë, koha e saktë e kësaj faze është shumë vështirë e përcaktueshme. Prezeworski përmend sinjalet të cilat i paraprijnë rënies së regjimit autoritar, të cilat zakonisht lidhen me gjendjen e rënduar ekonomike, pastaj humbjen e legjitimitetit për shkak të trazirave të përhershme, qoftë përmes protestave apo formave të tjera të pakënaqësisë popullore si dhe presionit nga jashtë për reforma.

Tabela në vazhdim e paraqet në mënyrë pamore të gjithë procesin e tranzicionit, ku siç edhe mund të shihet, fazës së liberalizimit i paraprinë një periudhë që është identifikuar si *para-tranzicion*.
(Tabela 1.)




Tabela. 1. Paraqitja e fazave të tranzicionit bazuar në definimin e O'Donnel dhe Schmitter.³
I.1.1.1. Faza e liberalizimit

Trazirat e vazhdueshme dhe ndikimi nga jashtë e shkaktojnë më pas edhe dobësimin dhe rënien e regjimit dhe me këtë hyhet në fazën e hapave të parë të liberalizimit. Në këtë fazë, në skenë dalin haptas forcat demokratike dhe promovojnë lëvizjen e re. Është faza kur regjimi autoritar është i detyruar të hapet dhe t'i pranojë hap pas hapi ndryshimet e reja. Kjo fazë kritike e demokratizimit më pas krijon hapësirë për veprime tjera për reforma, e të cilat e përmbysin definitivisht regjimin autoritar dhe të cilat jo detyrimisht e çojnë në një demokraci të konsoliduar.

I.1.1.2. Faza e demokratizimit

Kjo fazë e tranzicionit përfshin kryesisht ndërtimin e institucioneve demokratike, institucione të cilat garantojnë një konkurrencë të barabartë politike dhe pjesëmarrje të qytetarëve. Në këtë fazë

³ O'Donnel dhe Schmitter: „Der theoretische Rahmen: Demokratie, Transition und Parteieninstitutionalisierung“ (Kornizateorike: demokracia, tranzicioni dhe institucionalizimi i partive). Springer 2016. <http://www.springer.com/gp/book/9783531185606>. E qasur: Shtator 2016.

normat e vjetra që i kishte aplikuar regjimi autoritar do të zëvendësohen me normat e reja demokratike. Kjo fazë përcjell me vete edhe një pasiguri të akterëve shoqërorë për rregullat dhe procedurat e reja të vendimmarrjes.

Kohëzgjatja e kësaj faze gjithashtu mbetet një pikë kontestuese ndërmjet politologëve. Në fakt, politologu gjerman, Wolfgang Merkel, përfundimin e kësaj faze e parasheh me aprovimin e kushtetutës së re. Vendosja e rregullave të reja demokratike (kushtetutës së re) nga akterët politikë do të thotë që ata vetë do të veprojnë në kuadër të këtyre rregullave.

I.1.1.3. Faza e konsolidimi të demokracisë

Në literaturë e hasim fillimin e kësaj faze të tranzicionit, siç edhe u cek më lart, me aprovimin e kushtetutës së re. Megjithatë, përfundimi i saj mbetet një kontest shkencor. Përderisa W. Merkel fazën e përfundimit të kësaj faze e sheh të përfunduar kur në një vend është instaluar një sistem stabil i funksionimit të demokracisë, politologë të ndryshëm kanë dhënë teoritë e tyre të cilat në mënyrë të përmbledhur do të paraqiten në vazhdim.

Politologu Guillermo O'Donnell konsolidimin e demokracisë e definon si aftësinë e regjimeve politike për t'u mbijetuar krizave.

Politologu Ellen Bos beson se për konsolidim të demokracisë mund të flitet vetëm atëherë kur kemi ndërrim të pushteteve përmes zgjedhjeve të lira dhe të ndershme. Në linjë me këtë definim e gjejmë

edhe teorinë e Huntigtonit, i cili konsolidimin e demokracisë e mbështet në faktin e ndërrimit të pushteteve në nivel kombëtar dy herë radhazi, përmes zgjedhjeve të lira dhe të ndershme.

Mirëpo, këto definime apo teori minimaliste do të kritikoheshin më vonë nga definicionet e zgjeruara rreth konsolidimit të demokracisë. Njëri nga protagonistët që kritikon këto definime të shkurtra ishte edhe pikëvrojtimi i Pridhmas, i cili dallon konsolidim pozitiv dhe negativ. Nëse vetëm elita politike vepron brenda normave të reja, të aprovuara me kushtetutë të re, atëherë kemi të bëjmë me konsolidim negativ. Në anën tjetër, konsolidimi pozitiv do të nënkuptonte veprimin brenda normave të reja jo vetëm të elitës politike, por edhe të qytetarëve, të cilët me qëndrimin e tyre e bartin dhe e legjitimojnë sistemin e ri. Ndërmjet konsolidimit pozitiv dhe negativ kanë zhvilluar teorinë e tyre Gunther, Diamand dhe Puhle, duke u mbështetur në analizimin që i kanë bërë tranzicionit në Evropën Juglindore. Sipas tyre, mund të flitet për një konsolidim të demokracisë vetëm atëherë kur të gjithë aktorët politikë i pranojnë dhe veprojnë brenda normave të vendosura nga ta, për ta zhvilluar konkurrencën politike. Ky koncept në rend të parë fokusohet vetëm në institucionet politike dhe veprimet e tyre brenda normave të reja, mirëpo nuk përfshin edhe përfshirjen e gjërë të qytetarëve në të. Në fakt, pikërisht këtu e parasheh edhe Huntigton thelbin e konsolidimit të demokracisë, meqë sipas tij, qytetarët duhet të mësohen se demokracia vetvetiu nuk i zgjidh problemet shoqërore, mirëpo me këtë sistem qeveritë edhe mund të mos votohen për mandat tjetër, meqë ato nuk i kanë përmbushur premtimet.

Në anën tjetër, sipas Linz dhe Stepan, një demokraci mund të konsiderohet e konsoliduar nëse ajo është shndërruar në “the only game in town” (e vetmja lojë në qytet). Juan Linz dhe Alfred Stepan

tranzicionin demokratik e vlerësojnë të kompletuar nëse i ka përmbushur këto kushte: Është arritur një konsensus i kënaqshëm rreth procedurave politike që do të prodhonin një qeveri të zgjedhur nga zgjedhje demokratike; Qeveria që vjen në pushtet është produkt i drejtpërdrejtë i rezultatit të zgjedhjeve të lira, pra i votës së popullit; Qeveria e zgjedhur *de facto* ka autoritetin për të gjeneruar politika të reja qeverisëse; Ekzekutivi, legjislativi dhe gjyqësori të gjeneruara nga procesi demokratik nuk e ndajnë përgjegjësinë e tyre *de jure* me organe tjera.⁴

Linz dhe Stepan i definojnë tri dimensione për përmbylljen e konsolidimit të demokracisë: *sjellja*, *qëndrueshmëria* dhe *kushtetutshmëria*.

Në aspektin e **sjelljes** – nënkuptohet një situatë e tillë kur: 1. Asnjë grup apo organizatë politike nuk harxhon burime, nuk bën ndonjë tentativë serioze për ta përmbysur regjimin demokratik apo nuk bën përpjekje për t’u shkëputur nga shteti përmes krijimit të një regjimi jodemokratik ose përmes përdorimit të mjeteve të dhunshme. 2. Qeveria e sapozgjedhur nuk ka nevojë të preokupohet se si ta shmangë rrëzimin e demokracisë.

Në aspektin e **qëndrimit** – nënkuptohet një situatë e tillë kur: 1. Edhe nëse përballen me një krizë shumë serioze, shumica e popullsisë besojnë se çdo ndryshim politik duhet të arrihet nga zbatimi i formulave dhe praktikave demokratike. 2. Pjesa më e madhe e popullsisë beson dhe i përmbahet pa lëkundje besimit se procedurat dhe institucionet demokratike janë dhe mbeten rruga e vetme e

⁴ Krahaso: Juan J. Linz and Alfred Stepan. 1996. Problems of Democratic Transition and Consolidation (Problemet e tranzicionit demokratik dhe konsolidimit). Baltimore: John Hopkins University Press, 1996. Chapter 1. (Linz/ Stephan 1996: S.3).

duhur për ta qeverisur si jetën e tyre individuale, ashtu edhe jetën e shoqërisë. 3. Mbështetja për alternativat kundër sistemit aktual demokratik është ose e vogël, ose e izoluar dhe e pandikuar nga forcat jodemokratike.

Në aspektin **kushtetues** - nënkuptohet një situatë e tillë kur individi, grupet, njerëzit dhe shoqëria:

1. E bëjnë shprehi dhe praktikë të tyre zgjidhjen e konflikteve në bazë të normave dhe ligjeve ekzistuese. 2. Pranojnë se dhunimi i normave dhe institucioneve kushtetuese përfaqësojnë veprime joefektive dhe të kushtueshme.

Më tej, Linz dhe Stepan i definojnë këta indikatorë përbërës të konsolidimit të demokracisë: Shoqëria civile (e zhvilluar apo e pazhvilluar). Me këtë kuptohet një politikë ku individët, grupet, lëvizjet e vetëorganizuara janë relativisht të pavarur në veprimtarinë e tyre nga shteti (ndikimi i qeverisë) dhe përpiqen të artikulojnë vlera, të krijojnë shoqata dhe ndërmarrin shprehje solidariteti, si dhe mbrojnë dhe avancojnë interesat e tyre; Shoqëri politike (autonome ose jo) - me Shoqëri Politike kuptohet: Një arenë në të cilën aktorët politikë organizohen në një mënyrë specifike për t'u ndeshur mes tyre politikisht, për të kërkuar nga shoqëria dhënien e së drejtës së qeverisjes dhe pasjes së pushtetit, si dhe të dhënies së autoritetit për të vendosur kontrollin e tyre mbi aparatin shtetëror; Sundimi i ligjit (praktikohet apo jo) - me Sundim të Ligjit kuptohet: Ajo frymë dhe mendësi kushtetuese, e cila karakterizohet nga qëndrimi i njëjtë në raport me kushtetutën dhe institucionet e dala prej saj, zotimin ndaj respektimit si diçka të detyrueshme të procedurave të qeverisjes, pranimin e hierarkisë së ligjeve dhe të interpretimit të tyre nga një sistem gjyqësor i pavarur; Shtet-qeverisje funksionale (burokraci efëcente apo jo) - me Qeverisje Funksionale

kuptohet: Një qeveri, aparat shtetëror dhe burokraci, të cilat janë të afta të komandojnë, rregullojnë, dhe grumbullojnë të ardhura nga qytetarët në emër të shtetit dhe për shtetin; dhe Shoqëri ekonomike (jo vetëm kapitaliste, por edhe sociale) - me Shoqëri Ekonomike kuptohet: Një set normash, praktikash, institucionesh, rregullash të hartuara dhe të pranuara mbi një bazë socio-politike, të cilat shërbejnë si ndërmjetëse në marrëdhëniet mes shtetit dhe tregut.

Për politologun amerikan, Robert Dahl, “asnjë sistem i qëndrueshëm në botën reale nuk është tërësisht i demokratizuar”, ndaj ai përdorë termin poliarki (Polyarchie) , i cili përkufizon “regjime relativisht (por jo krejtësisht) të demokratizuara”. Në këtë kontekst, kuptimi parësor i fjalës “demokraci” si “pushtet i popullit” ndryshon dukshëm nga zbatimi i vlerave të saj në sistemin politik.⁵

Poliarkitë definohej me më shumë se sa thjesht proces zgjedhor; ato përfshijnë një qytetari pak a shumë të përfshirë, si dhe të drejtën e këtyre qytetarëve qeveritarë.

Poliarkia është më shumë se garë e lirë për votë të lirë, dhe përfshinë të drejta të plota për pjesëmarrje dhe kontestim. Më tej, Dahl, në studimin "Poliarkitë", konsideron se një karakteristikë themelore e demokracisë është të qenit të hapur vazhdimisht si qeveri ndaj preferencave të qytetarëve, të konsideruar të barabartë në pikëpamje politike.⁶ Demokracia është një sistem politik që karakterizohet nga të qenit të hapur në mënyrë tërësore ose përafërsisht tërësore për të gjithë qytetarët. Pjesëmarrjen në vendimmarrje Dahl e përshkruan në tri parime, të cilat do ta mbanin lidhjen ndërmjet qeverisë dhe preferencave të qytetarëve: 1. Qytetarët duhet të kenë mundësinë të formulojnë preferencat e tyre; 2. Qytetarët duhet të kenë mundësinë e shprehjes në mënyrë

⁵ Robert A. Dahl, “Poliarkia: Pjesëmarrja dhe Opozita”, Pegi, Tiranë, 2005, faqe. 7.

⁶ Po aty. Faqe 27-28.

individuale por edhe kolektive të preferencave të tyre, por edhe të bashkëqytetarëve të tyre; dhe 3. Qeveria duhet t'i peshojë me prioritet preferencat e shprehura të qytetarëve, pavarësisht përmbajtjes dhe prejardhjes së tyre.

Për përmbushjen e këtyre kriterëve të demokracisë, Dahl parasheh si mbrojtje tetë garancione institucionale:

1. Liritë e asocimit dhe koalicionit;
2. E drejta e shprehjes së lirë të fjalës;
3. E drejta për të zgjedhur (e drejta e votës aktive);
4. E drejta për t'u zgjedhur në poste publike (e drejta e votës pasive);
5. E drejta për të kandiduar për poste politike apo për të mbështetur një elitë të caktuar;
6. E drejta e qasjes në burime alternative dhe pluraliste të informacionit (E drejta për informacion);
7. Zgjedhje të lira dhe të ndershme; dhe
8. Institucionet e ndërtuara, pra politikat qeverisëse të kenë në agjendë preferencat e qytetarëve.

Në anën tjetër, politologu gjerman, Wolfgang Merkel, pas fazave të kalimit nga sistemi autoritar në sistem demokratik dhe asaj të demokratizimit (institucionalizimit), fazën e konsolidimit të demokracisë e sheh si fazën më të vështirë, sepse ajo varet nga shumë faktorë.

I mbështetur në konceptet e konsolidimit pozitiv të demokracisë të Pridham dhe modelit të tri aspekteve të Linz dhe Stepan, W. Merkel zhvillon konceptin e tij rreth konsolidimit të demokracisë, duke bërë matjen analitike në katër nivele.⁷

Niveli I: Konsolidimi kushtetues;

Niveli II: Konsolidimi përfaqësues;

Niveli III: Konsolidimi i sjelljes; dhe

Niveli IV: Konsolidimi shoqëror.

Tabela në vazhdim (Fig. 2) e pasqyron fazën përmbyllëse të tranzicionit.





Tabela. 2. Fazat e tranzicionit, përfshirë edhe fazën përmbyllëse.

⁷ Krahaso: Gegen alle Theorie? Die Konsolidierung der Demokratie in Ostmitteleuropa (Kundër gjithë teorisë? Konsolidimi i demokracisë në evropën e mesme dhe të lindjës. Wolfgang Merkel. WZB Berlin Social Science Center. Berlin 2007. Faqe 416. Për më shumë: https://wzb.eu/sites/default/files/personen/merkel.wolfgang.289/merkel_pvs_3_48.pdf. E qasur: Mars 2016.

Në nivelin e parë, atë të konsolidimit kushtetues, Merkel i parasheh institucionet në kuptimin e ngushtë të fjalës, pra institucionet politike ose organet kushtetuese, si presidentin, qeverinë, kuvendin, gjyqësorin dhe sistemin e zgjedhjeve.⁸

Shkallën e konsolidimit të institucioneve kushtetuese (niveli i parë, sipas Merkel) e parasheh si përmbushje e tri kriterëve bazë: 1. Efijencës së institucioneve: Institucionet politike duhet të jenë në gjendje që me intensitet të shpejtë të marrin vendime politike që llogariten të një problematike të veçantë dhe këto institucione nëpërmjet tyre të arrijnë të prodhojnë stabilitet politik. 2. Transparencën institucionale: vendimet politike duhet të legjitimohen në mënyrë demokratike dhe të tillat duhet t’iu nënshtrohen kontrolleve. 3. Përfshirja institucionale: institucionet duhet ta mbështesin integrimin dhe participimin politik dhe social në vendimmarrje.⁹ (Tabela. 3).



⁸ Po aty. Faqe 416.

⁹ Po aty. Faqe 418.

Tabela. 3.¹⁰Niveli I: Konsolidimi kushtetues sipas W. Merkel për vendet e Evropës së Mesme dhe Lindore.¹¹

Niveli i dytë (konsolidimi përfaqësues) përfshinë përfaqësimin e interesave në dimensionin territorial (partitë) dhe në dimensionin funksional (grupet e interesit). Merkel në këtë nivel i identifikon katër grupe të konsolidimit, vlerat e konsolidimit të të cilave janë brenda institucioneve kushtetuese. Në grupin e parë janë shtete si: Sllovenia, Çekia, Hungaria, Kroacia dhe Estonia. Më pak të konsoliduara në këtë nivel i vlerëson shtetet si: Polonia, Sllovakia, Lituania, Shqipëria, Bullgaria dhe Rumania. Si jo të konsoliduar në këtë nivel, pra të konsolidimit përfaqësues, Merkel i vlerëson Maqedoninë, Letoninë, Serbinë dhe Malin e Zi.¹² Në grupin e fundit renditen shtete si: Bellorusia, Moldavia dhe Rusia, të cilat vlerësohen si jostabile dhe autoritare. (Tabela.4).

¹⁰ Rënditja e shteteve në tabelën 3: Estonia, Sllovenia, Polonia, Lituania; Hungaria, Çekia, Sllovakia, Kroacia, Letonia, Bullgaria, Rumania, Maqedonia, Serbi dhe Mali i Zi, Bosna dhe Herzegovina, Shqipëria, Rusia, Moldavia dhe Bellorusia.

¹¹ Po aty: Faqe 419.

¹² Ky studim është bërë në vitin 2005, kur ekzistonte ende Unioni Serbi dhe Mali i Zi. Për më shumë: https://wzb.eu/sites/default/files/personen/merkel.wolfgang.289/merkel_pvs_3_48.pdf
E qasshme: Mars 2016.




Tabela. 4.¹³ Niveli II: Konsolidimi reprezentativ sipas W. Merkel për vendet e Evropës së mesme dhe lindore.¹⁴

Niveli i tretë, konsolidimi i sjelljes, përfshin aktorët politikë joformal. Në këtë nivel të demokratizimit, Merkel trajton rrezikun e përdorimit të vetos nga një grup akterësh për t'i penguar proceset demokratike. Tabela e mëposhtme paraqet renditjen e shteteve sipas rrezikut që i kanosen në kontekst të bllokimit të proceseve nëpërmjet vetos së grupeve të caktuara politike. (Tabela. 5).

¹³ Pënditja e shteteve në tabelën 4: Hungaria, Çekia, Sllovenia, Kroacia, Estonia, Polonia, Sllovakia, Rumania, Lituania, Shqipëria, Bullgaria, Serbi dhe Mali i Zi, Maqedonia, Letonia, Bosna dhe Herzegovina, Rusia, Moldavia dhe Bellorusia.

¹⁴ Po aty. Faqe 420.




Tabela. 5.¹⁵ Niveli III: Konsolidimi i sjelljes sipas W. Merkel për vendet e Evropës së mesme dhe lindore.¹⁶

Niveli i katërt i konsolidimit, konsolidimi shoqëror, sipas Merkel, përfshin kulturën e ngulitur demokratike të qytetarëve në shtet. Tabela në vijim paraqet renditjen e shteteve të Evropës së Mesme dhe Lindore. (Tabela. 6).

¹⁵Rënditja e shteteve në tabelën 5: Hungaria, Çekia, Sllovenia, Sllovakia, Polonia, Lituania, Letonia, Kroacia, Estonia, Rumania, Maqedonia, Bullgaria, Serbia dhe Mali i Zi, Rusia, Bosna dhe Hercegovina, Shqipëria, Modavia, Bellorusia.

¹⁶Po aty. Faqe 421.




Tabela. 6.¹⁷Niveli IV: Konsolidimi qytetar sipas W. Merkel për vendet e Evropës së Mesme dhe Lindore.¹⁸

Këto katër nivele të konsolidimit janë renditur sipas kohës së ndodhjes së tyre dhe rrjedhin logjikisht njëra pas tjetrës. Me anë të këtij modeli, Merkel pohon se mund të matet rrjedha e konsolidimit të demokracisë së një vendi në mënyrë analitike. Sipas tij, demokracia është imune ndaj tendencave të destabilizimit, vetëm nëse të katër këto nivele janë konsoliduar. Për më tepër, Merkel bën dallime ndërmjet konsolidimit minimal, ku përfshin të dy nivelet e para, atë të konsolidimit kushtetues dhe përfaqësues, dhe konsolidimin maksimal, i cili i përfshin edhe dy nivelet tjera, atë të konsolidimit të sjelljes dhe atë qytetar.

¹⁷ Rënditja e shteteve në tabelën 5: Sllovenia, Çekia, Estonia, Hungaria, Kroacia, Sllovakia, Polonia, Lituania, Letonia, Bullgaria, Rumania, Shqipëria, Serbia dhe Mali i Zi, Maqedonia, Rusia, Modavia dhe Bosna e Hercegovina.

¹⁸ Po aty. Faqe 421.

II.1.1.4 Sfidat kryesore me të cilat përballen shtetet gjatë tranzicionit

Siç u pa në shtjellimet e mësipërme, përderisa tranzicioni demokratik nënkupton para së gjithash shpërbërjen e institucioneve autoritare si dhe ndërrimin e tyre me ato pro-demokratike, tek konsolidimi demokratik i institucioneve bëhet fjalë për një proces më të përbërë dhe më të gjerë, i lidhur me institucionalizimin e një sërë rregullave të reja demokratike në jetën politike, ku demokracitë e reja duhet të jenë të institucionalizuara, konsoliduara dhe legjitime. Konsolidimi paraqitet si një proces më i gjatë dhe më i përbërë sesa vet tranzicioni. Ndërtimi i rendit demokratik paraqet një fazë tjetër, mirëmbajtja e saj dhe mos rrezikimi i tij për një kohë më të gjatë paraqet një proces tjetër.¹⁹

Kur jemi tek shtetet të cilat janë përfshirë nga vala e tretë e demokratizimit, vëmendja e analistëve është e përqendruar në pyetjen se sa janë në gjendje strukturat e sapo themeluara demokratike dhe multipartiake të sigurojnë sundimin e ligjit dhe mbrojtjen e të drejtave të njeriut. Pa marrë parasysh dallimet që mund të vërehen, e përbashkët për këto shtete është se të gjitha janë duke kaluar në procesin e konsolidimit demokratik. Prosesi i konsolidimit nënkupton procesin, gjatë se këto sisteme demokratike që shpesh quhen edhe si “qasi-formale”, do të fillojnë të veprojnë bazuar në parimet dhe vlerat e demokracive liberale. Shumë shtete të cilat janë përfshirë nga procesi i tranzicionit demokratik, jo vetëm në Evropën Juglindore por edhe në Amerikën Jugore, janë treguar

¹⁹ Geoffrey Pridham. *On the cup between democratic transition and consolidation in East-Central Europe*. University of Bristol, UK. Institute for Public Affairs, Bratislava, 12 October 2000.

të suksesshme në procesin e tranzicionit, por kanë dështuar në procesin e konsolidimit demokratik.²⁰

Dallimet kryesore rreth procesit të konsolidimit demokratik në nivel akademik paraqiten në mes të ekspertëve amerikan, të cilët theksojnë më shumë rëndësinë e plotësimit të kërkesave formale të demokracisë dhe atyre evropian, siç është rasti i politologut Merkel, që përqendrohet më shumë në konsolidimin substancial demokratik. Sipas ekspertëve amerikan, konsolidimi demokratik në shtetet në tranzicion mund të arrihet brenda një dekade, kurse për ata Evropian nevojitet ndërrimi i një gjenerate të tërë apo së paku dy dekada.²¹

Konsolidimi demokratik, në essence, nënkupton institucionalizimin e sistemit të ri demokratik dhe shpërndarjen e vlerave demokratike në përpjekje për të transformuar edhe kulturën politike, gjë që varet shumë nga problemet e trashëguara historike të vendeve të tranzicionit. Tranzicioni dhe konsolidimi shihen si faza të ndryshme në procesin e demokratizimit. Megjithatë, vija ndarëse në mes tyre nuk është strikt e përcaktuar, edhe pse faza e konsolidimit që natyrisht është më e gjatë fillon të realizohet menjëherë pas procesit të tranzicionit. Për shembull, krijimi i shoqërisë civile që është një nga elementet e konsolidimit demokratik, në disa vende fillon menjëherë pas procesit të tranzicionit, edhe pse kohëzgjatja e krijimit të shoqërisë civile varet edhe nga natyra e regjimit të mëparshëm. Konsolidimi demokratik konsiderohet si proces shumë dimensional, ku elemente të

²⁰ Lidija Hristova. Democratic Consolidation of Divided Societies. New Balkans Politics. Journal of Politics. Volume 9. Skopje, Macedonia. 2005.

²¹ Geoffrey Pridham. *On the cup between democratic transition and consolidation in East-Central Europe*. University of Bristol, UK. Institute for Public Affairs, Bratislava, 12 October 2000.

ndryshme të konsolidimit paraqiten dhe zhvillohen në faza të ndryshme të procesit të demokratizimit. Në bazë të vlerësimeve teorike që u dhanë me sipër në vazhdim do të shohim hapat e parë praktik që ndërmorën disa shtete në procesin e tranzicionit dhe njëherit sfidat më të mëdha që këto shtete kaluan në këtë proces.

Ndryshimet kushtetuese dhe zgjedhjet e lira demokratike- Hapi i parë që u ndërmor nga shtetet e dala nga regjimet komuniste ishte hartimi dhe aprovimi i kushtetutës si akti më i lartë juridik i një vendi. Kushtetutat demokratike, së paku formalisht, siguruan ndarjen e pushtetit shtetëror dhe kontrollin reciprok të degëve të pushtetit. Hapi i dytë i rëndësishëm ishte pluralizmi politik, përkatësisht ekzistenca e shumë partive politike dhe organizimi i zgjedhjeve të lira demokratike të mbikëqyrura nga institucione ndërkombëtare. Shumica e këtyre shteteve në kushtetutat e tyre një kaptinë të veçantë ia kanë kushtuar respektimit dhe mbrojtjes së lirive dhe të drejtave të qytetarëve. Megjithatë, edhe pse ka kaluar më shumë se një dekadë e fillimit të procesit të tranzicionit demokratik, shumë nga elementet e lartpërmendura kanë mbetur vetëm formale dhe konsolidimi demokratik në përgjithësi mbetet një nga sfidat më të mëdha të shteteve në tranzicion.

Transformimi i sistemit ekonomik- Zëvendësimi i sistemeve ekonomike të komanduara dhe të kontrolluara nga shteti në vendet socialiste me ekonominë e tregut të lirë ka qenë një proces i gjatë dhe i vështirë, që ka pasur ndikim të madh në demokratizimin politik.²² Reformat ekonomike kanë qenë të vështira, ngase nuk ka qenë çështja në ndryshimin apo modernizimin e ekonomisë, por

²² Geoffrey Pridham. *On the Cup between democratic transition and consolidation in East-Central Europe*. University of Bristol, UK. Institute for Public Affairs, Bratislava, in Bratislava, 12-13 October 2000

transformimin e plotë të sistemit ekonomik. Me gjithë vështirësitë e mëdha, ndryshimi i sistemit ekonomik ka qenë i suksesshëm në shtetet e Evropës Juglindore, nëse marrim parasysh ndryshimin e GDP-së për kokë banori në vitin 1995 në krahasim me vitin 1989, ku filloi procesi i tranzicionit. Sidoqoftë, transformimi i ekonomisë është ndeshur me pengesa të shumta në disa shtete të Ballkanit, ku edhe elemente të tjera të konsolidimit demokratik kanë ngecur. Privatizimi i ndërmarrjeve shoqërore është shoqëruar me parregullsi të shumta nën ndikimin e korrupsionit dhe presionit të madh të grupeve të krimit të organizuar. Njëkohësisht, edhe investimet e jashtme kanë qenë të vonuara në disa vende, për shkak të mos ndryshimit të legjislacionit dhe sigurisë së brendshme të vendit. Kosova nuk është përjashtim sa i përket parregullsive gjate procesit të privatizimit të ndërmarrjeve shoqërore që janë shoqëruar edhe me raste korruptive.²³

Zhvillimi i shoqërisë civile paraqet një nga sfidat më të rëndësishme në konsolidimin demokratik të shteteve të tranzicion, duke marrë parasysh dëmet e mëdha që janë trashëguar nga sistemi komunist në këtë drejtim. Në vendet ku format e komunizmit ka qenë më e butë, krijimi i shoqërisë civile ka qenë më i lehtë, por në vende të tjera ku komunizmi ka qenë i hekurt, si në Shqipëri apo Rumani, procesi i krijimit të shoqërisë civile ka qenë mjaft i vështirë. Një element i rëndësishëm, që ka ndihmuar procesin e krijimit të shoqërisë civile, ka qenë interesimi i madh i të rinjve për arsimim dhe hapja e Universiteteve ndaj botës perëndimore. Shkalla e interesimit për arsimim, si një nga çështjet prioritare në sistemet komuniste, ka vazhduar edhe pas procesit të tranzicionit dhe ka pasur ndikim të theksuar në shpërndarjen e vlerave demokratike.

²³ Grup autoresh, Privatizimi dhe post-privatizimi në Kosovë “Nje gote gjysme bosh apo gjysme e plote” Raport studimor: Shtator 2008.
<http://www.riinvestinstitute.org/uploads/files/2016/October/17/shqip1476702103.pdf>. Faqe 27.
E qasur: Janar 2018.

Shtetësia dhe identitetet kombëtare- kanë paraqitur vështirësi të mëdha në bashkëjetesën e komuniteteve të ndryshme brenda shteteve të Evropës Juglindore, e sidomos në territorin e Ish-Jugosllavisë dhe Bashkimit Sovjetik, reformat politiko-ekonomike rezultuan me ringjalljen e lëvizjeve nacionaliste dhe tendencave për pavarësimin e Republikave të këtyre federatave të brishta. Problemi i themelimit të shteteve etnike dhe respektimit të komuniteteve minoritare në shtetet e sapokrijuara, mbetet një nga sfidat kryesore në shtetet e përfshira nga vala e tretë e demokratizimit. Supozohet se pas pavarësimit të Malit të Zi dhe Kosovës, do të përfundojë vala e krijimit të shteteve kombëtare dhe do të shënojë përfundimin e konflikteve etnike në regjion, por megjithatë respektimi dhe mbrojtja e të drejtave të pakicave kombëtare mbetet çështje shumë e ndjeshme dhe problem permanent për të gjitha vendet e regjionit.

Nga ky shtjellim sado i përgjithësuar, vërehet se shtetet në tranzicion po përpiqen të bëjnë progres të dukshëm në procesin e konsolidimit demokratik, sidomos në themelimin dhe mbajtjen e institucioneve shtetërore demokratike, transformimit të sistemit ekonomik, zhvillimit të shoqërisë civile dhe zgjidhjen e problemeve etnike. Sidoqoftë, krijimi i një sistemi të depolitizuar dhe të fuqishëm gjyqësor, lufta kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar, respektimi dhe mbrojtja e të drejtave të minoriteteve, vazhdojnë të jenë sfida të vendeve në tranzicion.

Ky studim, do të bëjë përpjekje t'i analizoj të gjitha konceptet teorike të politologut gjerman, W. Merkel dhe politologëve të tjerë të referuar në këtë studim, të cilët kanë studiuar aspekte teorike mbi hapat e konsolidimeve demokratike në shtete të ndryshme, me qëllim analizimi i sistemit

qeverisë në Kosovë, në mënyrë që të matet rrjedha e konsolidimit të demokracisë në Kosovë. Gjatë shtjellimit do të analizohen me kujdes të gjithë hapat e ndërmarra nga shteti i Kosovës në procesin e konsolidimit të demokracisë në Kosovë, për të ardhur deri te gjetja e faktorëve kryesor që kanë ngadalësuar procesin e konsolidimit të demokracisë në Kosovë. Gjithashtu, studimi do të provoj të analizoj punën e shoqërisë civile dhe mekanizmave ndërkombëtar, në mënyrë që të vlerësohet se a kanë bërë mjaftueshëm këto institucione në procesin e konsolidimit të demokracisë në Kosovë.

KAPITULLI II - Kosova nën administrimin dhe mbikëqyrjen ndërkombëtare

II.1 Kosova në vitet e 90-ta

Me përfundimin e Luftës së Ftohtë dhe me rënien e Murit të Berlinit, filloi një kapitull i ri për Evropën, në veçanti për atë Lindore. Të gjitha shtetet, të cilat ishin pjesë e Bashkimit Sovjetik, fituan pavarësinë e tyre dhe shprehen gatishmërinë dhe vullnetin e tyre për t'u bërë pjesë e Evropës Perëndimore, demokratike dhe të lirë. Në fokus ishte përhapja e demokracisë dhe vendosja e sundimit të ligjit, si dhe garantimi dhe mbrojtja e të drejtave dhe lirive të njeriut e të pakicave kombëtare. Impaktit të këtyre ndryshimeve nuk arriti që t'iu shmangej as Jugosllavia. Brenda Jugosllavisë, Sllovenia qëndronte në krye të përpjekjeve të reformave, ku edhe Republikat tjera, përfshirë edhe Kosovën filluan të ndjekin kursin, i cili do t'i shpiente deri tek pavarësia.²⁴

²⁴ Bekim Podrimqaku: Die Westbalkanländer auf dem Weg in die EU, Hamburg 2013, faqe. 12.

Ky kurs u kundërshtua nga Beogradi, i cili me çdo kusht dëshironte që të drejtat që u janë dhënë Republikave dhe Krahinave në kuadër të Jugosllavisë t'i minimizonte. Ky qëndrim i Beogradit që Republikat t'i fuste nën një administrim qendror dhe revokimi i autonomisë së dy krahinave (Kosovës dhe Vojvodinës), prodhoi një situatë të tensionuar dhe në një afat të shkurtër nxori gjendjen jashtë kontrollit.

Në qershor të vitit 1991, Sllovenia dhe Kroacia shpallën pavarësinë e tyre, ku më pas të njëjtën e bënë edhe Maqedonia dhe Bosnja e Hercegovina.²⁵ Si kundërpërgjigje ndaj këtyre veprimeve, Beogradi ndërmori masa ushtarake për parandalimin e shpërbërjes së këtyre republikave, ku si pasojë, fillon konflikti në territorin e Jugosllavisë, i cili u përmbyll me ndërhyrjen e NATO-s dhe marrëveshjen e Dayton-it në vitin 1995. Nga kjo marrëveshje, zgjidhja e problemit të Kosovës u përjashtua, duke u cilësuar si problem i brendshëm i Serbisë. Kjo marrëveshje përfundoi luftën në Bosnjë e Hercegovinë dhe Kroaci, por nuk përmbylli procesin e zhbërjes së Jugosllavisë, sepse mbeti pa u zgjidhur edhe një ndër çështjet me të ndërlikuara, ajo e Kosovës. Shqiptaret e Kosovës, që përbënin mbi 91%²⁶ të popullsisë së Kosovës, kërkonin që t'u respektohet dhe lejohet e drejta e vetëvendosjes, me qëllim që të shpërbëhet Kosova nga Serbia, ashtu siç e bënë edhe Republikat tjera. Qëndrimi i Beogradit kur ishte në pyetje Kosova, ishte i palëkundur dhe refuzonte në mënyrë kategorike krijimin e shtetit të Kosovës. Shqiptarët e Kosovës këtë e konsideruan si shpallje të luftës nga ana e Serbisë, ku dhe rezultoi me konflikt të hapur në mes ushtrisë së Serbisë dhe Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (UÇK).

²⁵ Po aty. S. 15.

²⁶ Sipas Agjencisë së Statistikave të Republikës së Kosovës.

Për ta shmangur luftën në Kosovë, Bashkimi Evropian, NATO dhe OKB-ja shterrën të gjitha mundësitë diplomatike në përpjekjen e tyre për ta gjetur një zgjidhje të pranueshme edhe për shumicën shqiptare në Kosovë, por në anën tjetër, Beogradi refuzoi çdo zgjidhje që do t'i garantonte Kosovës të drejtën e vetëvendosjes për ta krijuar shtetin e pavarur. Veprimet brutale të ushtrisë serbe ndaj shqiptarëve të Kosovës e detyruan NATO-në në vitin 1999 që pa mandatin e OKB-së, të nis bombardimet kundër Serbisë, me qëllim që t'i detyronte forcat serbe që të tërhiqeshin nga Kosova dhe të parandalonte një katastrofë humanitare.

Pas 72 ditëve të fushatës ajrore të NATO-s kundër forcave serbe, përfshirë edhe infrastrukturën vitale në Serbi, me 9 qershor 1999, në Kumanovë të Maqedonisë u nënshkrua marrëveshja ushtarake në mes Serbisë dhe NATO-s për tërheqjen e trupave serbe pa asnjë kusht nga Kosova.²⁷

II. 2. Themelet e konsolidimit të demokracisë pas vitit 1999 (Kosova nën administrimin e UNMIK-ut)

Me ndërhyrjen e NATO-së në Kosovë, Këshilli i Sigurimit i Kombeve të Bashkuara më 12 qershor 1999, miratoi Rezolutën 1244, e cila Kosovën e vuri nën një protektorat ndërkombëtar si dhe mandatoi një mision paqeruajtës për të ngritur Administratën e Përkohshme të Kombeve të Bashkuara në Kosovë (UNMIK), i cili u mbështet nga OSBE dhe BE si dhe u plotësua nga NATO Kosovo Force (KFOR).²⁸

²⁷ Annegret Bendiek: Der Konflikt im ehemaligen Jugoslawien und die Europäische Integration, Wiesbaden, 2004, faqe. 70.

²⁸ Ines Lietzke: Konflikt Regelung durch Europäisierung, Wiesbaden, 2106, faqe. 112

Bazuar në rezolutën 1244 të Këshillit të Sigurimit, UNMIK ishte mandatuar“(…)

...to establish an international civil presence in Kosovo in order to provide an interim administration for Kosovo (...), and which will provide transitional administration while establishing and overseeing the development of provisional democratic self-governing institutions to ensure conditions for a peaceful and normal life for all inhabitants of Kosovo.”²⁹

KFOR-i, si componentë ushtarake e misionit që ishte, ishte përgjegjës për ruajtjen e armëpushimit, monitorimin e tërheqjes së trupave jugosllave dhe monitorimin e procesit të demilitarizimit të UÇK-së si dhe për sigurinë e brendshme të Kosovës.

Në anën tjetër, Administrimi dhe struktura e UNMIK-ut mbështetej në katër shtylla. Në shtyllën e parë bënin pjesë drejtësia dhe sundimi i ligjit, në të dytën administrata civile, në të tretën demokratizimi dhe ndërtimi i institucioneve demokratike dhe në të katërtën rindërtimi dhe zhvillimi.

Duke marrë për bazë se në Kosovë çdo gjë duhej të fillonte nga zero, UNMIK ishte para disa sfidave komplekse, të cilat ishin vështirë për t’u tejkaluar, sepse institucionet kryesore si policia, drejtësia si dhe institucionet shtetërore nuk mund të thuhet që ekzistojnë.³⁰

Sa i përket themelimit të institucioneve të Kosovës në kuadër të këtij misioni, OSBE-ja ishte përgjegjëse për ndërtimin e Institucioneve shtetërore, në të cilat do të integroheshin edhe pakicat.

²⁹ RESOLUTION 1244 (1999) Adopted by the Security Council at its 4011th meeting, on 10 June 1999 (Rezoluta 1244 „...për të krijuar një prani ndërkombëtare civile në Kosovë për të siguruar një administrim të përkohshëm për Kosovën (...) dhe që do të sigurojë administrimin e përkohshëm gjatë krijimit dhe mbikëqyrjes së zhvillimit të institucioneve të përkohshme demokratike të vetëqeverisjes për të siguruar kushte për një jetë paqësore dhe normale për të gjithë banorët e Kosovës.”).

³⁰ Bekim Podrimqaku: Die Westbalkanländer auf dem Weg in die EU, Hamburg 2013, faqe.106.

Kosova si një vend postkonfliktual me një ndarje të thellë etnike (Pakica Serbe dhe Shumica Shqiptare) paraqiti një sfidë të madhe për Kombet e Bashkuara në procesin e ndërtimit të institucioneve demokratike dhe konsolidimin e tyre. Pra, antagonizmat etno-nacional vazhduan të jenë si ndër faktorët që kanë penguar konsolidimin e demokracisë, edhe pas shpalljes së pavarësisë së Kosovës. Nga kjo del se transformimi demokratik i shoqërive të dala nga lufta, në veçanti i atyre që karakterizohen me ndarje të thella etnike, është shumë më kompleks se sa transformimi i sistemeve autokratike.³¹

UNMIK-u, jo vetëm që ishte ngarkuar për themelimin në mënyrë graduale të institucioneve të Kosovës, por atij iu kishin dhënë edhe kompetenca ekzekutive, të cilat kishin ndikim në të tri shtyllat e kryesore të demokracisë: legjislativi, ekzekutivi si dhe mbikëqyrja ndaj gjyqësorit. Këto kompetenca, të cilat ishin të rezervuara për UNMIK-un, ngadalësuan konsolidimin e demokracisë në Kosovë sepse Përfaqësuesi Special në krye të UNMIK-ut jo vetëm që ishte instanca e fundit e normave juridike të dala nga institucionet e Kosovës, por kishte kompetencë edhe për të shkarkuar nga detyra çfarëdo zyrtari nga administrata civile.³² Duke u bazuar në atë se demokracia i ka themelet e veta tek legjitimiteti të cilin ia jep populli bartësve të institucioneve, nëpërmjet zgjedhjeve të lira dhe demokratike, e bënë të qartë se fuqia ekzekutive e Përfaqësuesit të Lartë të UNMIK-ut vështirësonte ndërtimin e demokracisë dhe konsolidimin e saj. Bazuar në këtë, mund të themi se Institucionet e Kosovës, të cilat ishin ndërtuar nga bashkësia ndërkombëtare as nuk mund

³¹ Bruno Schoch: Demokratisierung im ungeklärten Staat? Das UN-Protektorat im Kosovo – eine Bilanz, në: https://www.hsfk.de/fileadmin/HSFK/hsfk_downloads/reoport1310.pdf. E qasur: Shkurt 2018.

³² Markus Wagner: Das erste Jahr der UNMIK, in: http://www.dgvr.de/fileadmin/publications/PDFs/Zeitschrift_VN/VN_2000/Heft_4_2000/04_Beitrag_Wagner_VN_4-00.pdf. E qasur: Shkurt 2018.

të merrnin vendime dhe as të ndërmerrnin masa të caktuara, sepse ishin tejet të kufizuara, ku si pasojë e mosbartjes së kompetencave nga UNMIK-u tek vendoret, e bënte gjendjen edhe më tej jo stabile, ku dhe gjenerohej një ambient jo i përshtatshëm për të përshpejtuar ritmin e transformimit-konsolidimit të demokracisë.³³

Faktori tjetër që ndikoi në pengimin e transformimit dhe konsolidimit të institucioneve të Kosovës nën administrimin e UNMIK-ut, ishte edhe paqartësia lidhur me statusin final të Kosovës. Mosdefinimi i statusit përfundimtar apo mungesa e një strategjie, e cila do ta definonte dhe përmyllte procesin e statusit të Kosovës, vetëm sa i kontribonte tendosjes së gjendjes dhe situatës së sigurisë në përgjithësi. Duke parë këtë si rrezik potencial për destabilizimin e vendit, Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm të Kombeve të Bashkuara, Michael Steiner, doli me një strategji “Standardet para Statusit”, nëpërmjet të cilës u definuan kriteret për zhvillimin politik dhe shoqëror, të cilat duhet të përmbusheshin para hapjes së bisedimeve për statusin përfundimtar.³⁴

Sidoqoftë, standardet para statusit nuk ndryshuan gjendjen, por vetëm morën kohë në bartjen e kompetencave nga ndërkombëtarët tek vendorët. Këtë më së miri e dëshmon edhe raporti i bërë për Këshillin e Sigurimit të OKB-së, në tetor të vitit 2005 nga Kai Eide (Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm të Kombeve të Bashkuara), i cili nëpërmjet këtij raporti propozoi që, edhe pse nuk janë arritur akoma standardet, duhet të hapet kapitulli për definimin e statusit

³³ Bekim Podrimqaku: Die Westbalkanländer auf dem Weg in die EU, Hamburg 2013, faqe. 107.

³⁴ Vedran Džihic und Helmut Kramer: Der Kosovo nach der Unabhängigkeit, në: <http://library.fes.de/pdf-files/id/ipa/05695.pdf>. E qasur: Shkurt 2018.

përfundimtar për Kosovën. Pas këtij propozimi nga Eide, Sekretari i Përgjithshëm dhe Këshilli i Sigurimit i Kombeve të Bashkuara vendosen që të dërgojnë ish-presidentin finlandez, Martti Ahtisaari, si i dërguar për statusin final të Kosovës.³⁵

Ahtisaari, në kuadër të mandatit që iu kishte dhënë për të propozuar një dokument gjithëpërfshirës për të përmbyllur statusin e Kosovës, bëri një propozim që parasheh Pavarësinë e Kosovës edhe pse fjala “Pavarësi” nuk përmendej askund në planin e tij (Ahtisaari-Plan). Bazuar në këtë plan, udhëheqësia e Kosovës shpalli Kosovën shtet të pavarur dhe sovran me 17 shkurt 2008, përmes deklaratës së lexuar në Kuvendin e Kosovës.

II 2.1. Shpallja e pavarësisë (Pavarësia e mbikëqyrur ICO)

Me shpalljen e pavarësisë së Kosovës, për vendin filloi një kapitull i ri. Përgjegjësitë që deri para shpalljes së pavarësisë ishin në duart e ndërkombëtarëve, do të duhej të barten tek vendorët. Pra, këta të fundit ishin bartës të implementimit të Planit të Ahtisaarit, përfshirë edhe konsolidimin e institucioneve demokratike, ashtu siç ishte paraparë në këtë plan. Neni 143 i Kushtetutës së Republikës së Kosovës i obligon institucionet vendore të “(...) veprojnë në pajtim me të gjitha detyrimet e Republikës së Kosovës, sipas Propozimit Gjithëpërfshirës për Zgjidhjen e Statusit të Kosovës (...) ato do t’i ndërmarrin të gjitha veprimet e nevojshme për zbatimin e tyre.”³⁶

³⁵ Po aty.

³⁶ Kushtetuta e Republikës së Kosovës.

Sidoqoftë, Plani i Ahtisaarit e parashihte një mbikëqyrje të tranzicionit pas shpalljes së pavarësisë, ndryshe e quajtur Pavarësia e Mbikëqyrur, që i bie se institucionet e Republikës së Kosovës do të mbikëqyren dhe nëse është nevoja edhe të mbështeten në zbatimin e Planit të Ahtisaarit nga një mekanizëm ndërkombëtarë i quajtur ICO.³⁷ Fuqinë e këtij mekanizmi e thotë shprehimisht edhe neni 147 i Kushtetutës e Republikës së Kosovës, si në vijim: “Autoriteti Përfundimtar i Përfaqësuesit Ndërkombëtarë Civil, Pavarësisht dispozitave të tjera të kësaj Kushtetute, Përfaqësuesi Ndërkombëtarë Civil, në pajtim me Propozimin Gjithëpërfshirës për Zgjidhjen e Statusit të Kosovës, (...) është autoriteti përfundimtar në Kosovë lidhur me interpretimin e aspekteve civile të Propozimit Gjithëpërfshirës. Asnjë autoritet i Republikës së Kosovës nuk ka juridiksion të rishikojë, të pakësojë ose në ndonjë mënyrë të kufizojë mandatin, kompetencat dhe detyrimet e përcaktuara në nenin 146 dhe në këtë nen.”³⁸

Sipas kësaj, *ICO* ishte autoriteti i fundit, pra kishte kompetencë që t’i shkarkonte edhe politikanët e korruptuar të nivelit të lartë. Në praktikë, një rast i tillë nuk është evidentuar asnjëherë në Kosovë, edhe pse korrupsioni ka qenë dhe vazhdon të jetë një nga sfidat me të mëdha për Republikën e Kosovës në tranzicion dhe konsolidimin e demokracisë.

II.2.1.2 Misioni i Bashkimit Evropian në Kosovë “EULEX”

EULEX konsiderohet si misioni më i madh civil në historinë e Bashkimit Evropian jashtë territorit të saj, i cili ishte dërguar në Republikën e Kosovës për të mbështetur institucionet kosovare, si:

³⁷ International civilian office.

³⁸ Kushtetuta e Republikës së Kosovës.

gjyqësorin dhe policinë "në ndërtimin e një sistemi të pavarur multietnik të drejtësisë, një polici dhe administratë shumë-etnike" dhe të sigurojë që "këto institucione të jenë të lira nga ndërhyrja politike".³⁹

Sipas kësaj, institucionet e Republikës së Kosovës në procesin e konsolidimit të tyre do të vazhdojnë që të mbikëqyren dhe asistohen nga ky mision.

Dërgimi i këtij Misioni nga Bashkimi Evropian jep për të kuptuar se shteti i sapo krijuar nuk ishte në gjendje akoma që të ketë qasjen e duhur në procesin e konsolidimit të institucioneve demokratike dhe të pavarura. Atij (EULEX-it), iu rezervuan edhe disa kompetenca ku, nëse është e nevojshme, "në konsultim me autoritetet kryesore civile ndërkombëtare në Kosovë, ajo mund të tërheqë ose të zhvlerësojë vendimet e autoriteteve kosovare"⁴⁰ Me vet faktin se Republika e Kosovës është sistem parlamentar, që do të thotë se të gjitha institucionet dalin nga legjitimiteti i këtij institucioni me të lartë (Kuvendi), i cili legjitimitetin e merr nga zgjedhjet e lira dhe demokratike, dhënia e kompetencave tek një mekanizëm siç është rasti i EULEX-it është në kundërshtim me parimet e demokracisë dhe konsolidimit të saj. Mbështetja, rekomandimet kanë qenë dhe janë më së të nevojshme në rastin e Kosovës drejt rrugës së transformimit dhe konsolidimit të demokracisë, por jo edhe rezervimi i kompetencave siç i jepen EULEX-it, sepse kjo e zbehë pavarësinë e shtetit. Veç kësaj, ky mision ka dështuar në arritjen e objektivave dhe për më tepër, ka ngadalësuar konsolidimin e demokracisë, sepse nuk ka marrë për bazë zotësinë vendore

³⁹ Ziel und Aufgaben der Eulex-Mission, në: <https://derstandard.at/3227911/Ziel-und-Aufgaben-der-EULEX-Mission>.E qasur: Shkurt 2018.

⁴⁰ Po aty.

(local ownership) në fushën juridike dhe nuk ka shkëmbyer njohuri dhe ekspertiza të nivelit lokal me gjyqtarë dhe prokuror vendor.⁴¹

EULEX po ashtu iu është ekspozuar kritikave publike për mos kryerjen e detyrave, të cilat u janë besuar. Në disa raste, për mosefikasitetin e tij në fushën e gjyqësorit, EULEX-it i janë adresuar edhe kritika për korrupsion brenda për brenda këtij misioni. Në vjeshtën e vitit 2014, ish-prokurorja britanike, Maria Bamieh, që kishte punuar në kuadër të këtij misioni, u deklarua se një gjyqtar italian dhe një kolege e saj çeke janë korruptuar, ku si rezultat i kësaj parlamentarët evropian dhe Human Rights Watch, kërkuan që të bëhet një hetim i zgjeruar lidhur me këtë rast.⁴²

Detyra tjetër e EULEX është edhe krijimi i një sistemi të pavarur dhe multietnik, pra integrimi i pakicave në institucionet e Kosovës dhe njohja nga ana e tyre e Kosovës së pavarur si shtet të tyre. Një integrim i tillë, sidomos i pakicës serbe, deri më sot nuk është arritur sa duhet, sepse ata akoma vazhdojnë që të politizohen dhe instrumentalizohen nga Beogradi, për të pasur një çasje destruktive në raport me shtetin e Kosovës, edhe pse ata (pakicat serbe) jetojnë në Kosovë. Mosintegrimi i pakicave nacionale apo mosgatishmëria e tyre për t'u integruar në shtetin ku ata jetojnë, paraqet një sfidë të madhe në procesin e konsolidimit të demokracisë, sepse “(...), integrimi i pakicave nacionale në institucione janë bazë vendimtare për tranzicionin e suksesshëm në demokraci (...)

⁴¹ Nicasia Picciano: The European Union State-Building in Kosovo, në: <https://www.verlagdrkovac.de/978-3-8300-8664-2.htm>. E qasur: Shkurt 2018.

⁴² Andreas Ernst: EU versagt in Kosovo, në: <https://www.nzz.ch/international/europa/die-eu-mission-in-kosovo-auf-verlorenem-posten-1.18519077>. E qasur: Shkurt 2018.

vetëm nëse çështjet e unitetit kombëtar janë zgjidhur si dhe është vendosur territori shtetëror, transformimi në demokraci mund të jetë i suksesshëm.”⁴³

Republika e Kosovës, po ashtu, akoma nuk ka arritur që të shtrijë juridiksionin e saj në tërë territorin. Këtu është me rëndësi të përmendet sidomos veriu i Kosovës, ku në atë pjesë institucionet e Kosovës janë tejet të kufizuara për të vepruar, sepse ky lokacion vazhdon që të kontrollohet nga Beogradi.⁴⁴

II.2.1.3. Përfundimi i mbikëqyrjes ndërkombëtare - akt simbolik

Me datën 07.09.2012, Republika e Kosovës bëri ndryshimet e nevojshme kushtetuese për t’i hapur rrugë përmbylljes së pavarësisë së mbikëqyrur, kurse shefi i ICO-së, Pieter Feith, para Grupit Drejtues Ndërkombëtar (International Steering Group), shpalosi qëndrimin e tij lidhur me përmbylljen e pavarësisë së mbikëqyrur, ku sipas tij Plani i Ahtisaarit është zbatuar në mënyrë substanciale, nëpërmjet të cilit është krijuar një shtet modern me një demokraci multietnike, pra sipas tij, janë krijuar komunat me shumicë serbe dhe është bërë ligji i cili garanton trashëgiminë kulturore serbe.⁴⁵

⁴³ Sipas Stahl Bernhard: Nationalismus und Demokratie: Wohingehet das Kosovo? në: Olaf Leiß, Martin Roth, Christian Gesellmann (Hrsg.), faqe 365.

⁴⁴ Andreas Ernst: Neue Sheriffs für Kosovos wilden Norden, <https://www.nzz.ch/international/kopie-von-neue-sheriffs-fuer-kosovos-wilden-norden-ld.1354978>. E qasur: Shkurt 2018.

⁴⁵ Der Kosovo erlangt volle souveränität, në: <https://derstandard.at/1339639540031/Lenkungsrat-Der-Kosovo-erlangt-voellige-Souveraenitaet>. E qasur: Shkurt 2018.

Sidoqoftë, kjo nuk ishte e mjaftueshme për të garantuar një shtet ligjor, në të cilin do të mundësohej një funksionim i pavarur i institucioneve dhe një kulturë politiko-institucionale, prandaj edhe përfundimi i mbikëqyrjes së pavarësisë, më shumë mund të konsiderohet si një akt simbolik sepse Kosova akoma iu ekspozojë dukurive negative, si: krimet të organizuar, nepotizmit, korrupsionit, papunësisë së lartë dhe ekonomisë së dobët.

Duke marrë në konsideratë së Republika e Kosovës, për të luftuar këto dukuri nuk ka bërë progresin e mjaftueshëm dhe akoma nuk është duke bërë sa duhet në minimizimin e tyre, mekanizmat ndërkombëtarë, nëse jo de jure, de facto vazhdojnë të mbikëqyrin funksionimin e institucioneve dhe çasjen e lidershit ndaj tyre. Edhe studiuesi Mappes Niediek⁴⁶ përfundimin e pavarësisë se mbikëqyrur e vlerëson si një akt formal, sepse sipas tij, Kosova mund të mbijetojë vetëm me ndihmë masive ekonomike dhe natyrisht kjo dhënie formale e sovranitetit është e një rëndësie të vogël, sepse ai është tejte i kufizuar në aspektin politik dhe atë ekonomik.⁴⁷ Veç kësaj, Kosova akoma ka nevojë për mbështetjen e KFOR-it dhe NATO-s, sepse ky mekanizëm është jetik për sigurinë e territorit të saj.

II.2.1.4. Nga decentralizimi deri tek Asociacioni i Komunave me shumicë serbe

Lufta në Kosovë nuk shkatërroi vetëm infrastrukturën, por la pas një hendek në mes serbëve dhe shqiptarëve, i cili akoma paraqitet si një ndër sfidat më komplekse në konsolidimin e institucioneve.

⁴⁶ Është një gazetar gjerman dhe autor i specializuar për Evropën Juglindore.

⁴⁷ Sipas Cani Bahri: Souverän genug für die Unabhängigkeit?
në: <http://www.dw.com/de/souver%C3%A4n-genug-f%C3%BCr-die-unabh%C3%A4ngigkeit/a-16229639>. E qasur: Shkurt 2018.

Gjate administrimit të UNMIK-ut, serbët e Kosovës u koncentruan nëpër enklavat e tyre, duke kundërshtuar në mënyrë permanente çdo zgjidhje të statusit të Kosovës që do të shpiente deri te pavarësia. Ata, po ashtu, refuzonin që të bëhen pjesë integrale e shoqërisë kosovare me arsyetimin se shteti, të cilin ata e njohin dhe i besojnë, është ai i Serbisë.

Enklavat e banuara me serb e krijuan një lidhje direkte me Beogradin, nëpërmjet të cilës u financuan,⁴⁸ politizuan dhe instrumentalizuan dhe në këtë mënyrë u forcuan deri në atë shkallë sa që edhe morën formën e strukturave paralele. E tëra kjo ndodhi nën administrimin e UNMIK-ut, i cili edhe pse ishte në dijeni për influencën e Beogradit, nuk ndërmori asnjë masë.

Ky ishte një nga gabimet që nuk duhej ta lëshonte ky mission, sepse forcimi i strukturave paralele pengonte konsolidimin e institucioneve të Kosovës, si dhe funksionimin e tyre në territorin e saj. Shumica e popullsisë shqiptare si dhe lidërsia e tyre forcimin e strukturave paralele serbe e vlerësonin si dobësi të UNMIK-ut, që nuk ishte në gjendje për të ndërmarrë hapa konkret në parandalimin e aktiviteteve të strukturave paralele si dhe influencën e Beogradit ndaj tyre.⁴⁹

Ky lëshim nga bashkësia ndërkombëtare edhe sot vazhdon të jetë pengesë në konsolidimin e demokracisë si dhe në sistemin politik në Republikën e Kosovës. Me synimin që të shuhen strukturat paralele serbe dhe që serbëve të Kosovës t’iu hapen dyert integruese në shoqërinë kosovare që të ndihen më të sigurt, erdhi edhe ideja për decentralizimin e komunave, përfshirë edhe krijimin e atyre të rejave në enklavat ku shtrihen dhe popullohen me serb.

⁴⁸ Stephan Osvath: Serbische Parallelwelt im Kosovo, në:
http://www.deutschlandfunk.de/serbische-parallelwelt-im-kosovo.795.de.html?dram:article_id=245002. E qasur: Shkurt 2018.

⁴⁹ Kramer und Džihic: die Kosovo-Bilanz, Wien 2005, faqe 85.

Decentralizimi nuk ishte një projekt që do të testohet për herë të parë në Kosovë por ai kishte ndodhur edhe në vendet tjera të Evropës, përfshirë edhe shtetet që tanimë janë anëtarë të BE-së. “Në shumë vende të Evropës ekzistojnë forma të ndryshme të decentralizimit, të cilat janë karakterizuar nga faktorët historik apo etniko-kulturor, por gjithashtu ka edhe nga proceset e modernizimit të strukturave shtetërore.”⁵⁰

Në vitin 2003, komisioni i decentralizimit që ishte në kuadër të Këshilli të Evropës, i propozoi UNMIK-ut dhe institucioneve kosovare një plan gjithëpërfshirës për decentralizim, ku “në vitin 2005, administrata e UNMIK-ut filloi pilot-projektin për krijimin e komunave të reja. Fillimisht u krijuan pilot-njësitë komunale në Junik (me shumicë të popullatës shqiptare), Mamushë (me shumicë të popullatës turke) dhe Han të Elezit (me shumicë të popullatës shqiptare). Këto tri pilot-njësi komunale u shndërruan në komuna me kompetenca të plota pas zgjedhjeve lokale të vitit 2009. Po më 2009-ten, u krijuan edhe katër komuna të reja, të parapara me Propozimin Gjithëpërfshirës për Zgjidhjen e Statusit Final të Kosovës: Parteshi, Klllokoti, Graçanica dhe Ranillugu (që të katërta me shumicë të popullatës serbe).”⁵¹

Për ta realizuar këtë, përfaqësuesit politikë dhe përfaqësuesit e misionit të BE-së u përpoqen të bindin serbët që të marrin pjesë në decentralizimin e administratës locale, sepse kjo duhet t'i japë shumicës së komunave serbe autonomi të plotë në fushat e arsimit, kujdesit shëndetësor, kulturës

⁵⁰ Sipas Kaltrina Shala: Der Dezentralisierungsprozess im Kosovo, faqe 38.

⁵¹ Themelimi i Komunave të reja në Kosovë, analizë politikash, në:
http://www.institutigap.org/documents/24767_KomunateReja.pdf. E qasur: Shkurt 2018.

dhe regjistrimit të kompanive.⁵² Veç kësaj, decentralizimi sipas aktorëve ndërkombëtarë kishte poashtu për qëllim që të kontribuonte në ndërtimin e një shoqërie multietnike në Republikën e Kosovës. Mirëpo, ky proces vlerësohej si kompleks dhe problematik, sepse ndërtimin e një shoqërie multietnike në vazhdimësi e pengonin dhe e pengojnë strukturat paralele serbe të financuara dhe influencuara nga Beogradi.⁵³

II. 2.1.5. Influenca e Serbisë tek komuniteti serb në Republikën e Kosovës

Decentralizimi, i cili është realizuar në baza etnike ka ngadalësuar dhe vazhdon ta ngadalësojë integrimin e komunitetit serb në shoqërinë dhe institucionet kosovare, si dhe ka ndikuar ritmin e konsolidimit të demokracisë në Republikën e Kosovës. Ai nuk do të duhej të realizohej në këtë mënyrë, sepse në rastin e Kosovës hendeku i marrëdhënieve në mes shqiptarëve dhe serbëve të Kosovës vetëm sa është theksuar. Po ashtu, edhe rikthimi i besimit në mes këtyre dy grupeve (shumicës shqiptare dhe pakicës serbe) është bërë edhe më kompleks.

Kjo mënyrë e decentralizimit në njërën anë ka lehtësuar çasjen e Beogradit në komunat serbe, e sidomos në atë të veriut, ku institucionet e Kosovës janë tejet të kufizuara në aktivitetet e tyre, kurse në anën tjetër ka penguar përpjekjet e institucioneve të Kosovës në integrimin e serbeve në shoqërinë kosovare. Si rrjedhojë e kësaj, “Qeveria e Kosovës ushtron vetëm sovranitet formal mbi

⁵² Kosovo-Regierung um Dezentralisierung bemüht, në:
<http://www.dw.com/de/kosovo-regierung-um-dezentralisierung-bem%C3%BCht/a-4059074>.
E qasur: Shkurt 2018.

⁵³ Po aty, faqe 86.

veriun e vendit të saj (...) ajo nuk është në gjendje të zbatojë vendimet e saj në mënyrë autoritative, me përdorimin e forcës në të gjitha pjesët e territorit saj të pretenduar.”⁵⁴

Në kuadër të bisedimeve për normalizimin e marrëdhënieve me Serbinë, u propozua ideja për krijimin e asociacionit për katër komunat serbe, ku dhe "është arritur pajtimi që të shpërbëhen strukturat policore dhe të inteligjences të Serbisë në Kosovë dhe që të transformohen strukturat e tjera, të krijohet Asociacioni i komunave ekzistuese me shumicë serbe në Kosovë, dhe që në katër komunat në veri të Kosovës të mbahen zgjedhjet për asamblетë komunale dhe për kryetarët e komunave, si dhe të funksionalizohet sistemi i drejtësisë dhe i gjykatave.”⁵⁵

Edhe pse në Kosovë ekziston një asociacion për të gjitha komunat në Republikën e Kosovës, më datën 25 gusht 2015, në Bruksel u nënshkrua Marrëveshja midis Qeverisë së Kosovës dhe asaj të Serbisë, për krijimin e Bashkimit të Komunave Serbe të Kosovës. Kjo marrëveshje u kundërshtua fuqishëm nga opozita, ku pas protestave dhe kundërshtive të madha, nga Presidentja e Republikës së Kosovës kjo marrëveshje është dërguar në Gjykatën Kushtetuese të Kosovës⁵⁶ për t’u interpretuar nëse është në përputhje me Kushtetutën e Republikës së Kosovës.

⁵⁴ Michael Ehrke: Serbien: Zwischen Kosovo und der EU, në: <http://library.fes.de/pdf-files/id-moe/08918.pdf>. E qasur: Shkurt 2018.

⁵⁵ Thaçi: "Katër komuna serbe në veri do të kenë asociacionin e tyre" <http://www.dw.com/sq/tha%C3%A7i-kat%C3%ABr-komuna-serbe-n%C3%AB-veri-do-t%C3%AB-ken%C3%AB-asociacionin-e-tyre/a-16629207>. E qasur: Shkurt 2018.

⁵⁶ Thaçi: "Katër komuna serbe në veri do të kenë asociacionin e tyre" <http://www.dw.com/sq/tha%C3%A7i-kat%C3%ABr-komuna-serbe-n%C3%AB-veri-do-t%C3%AB-ken%C3%AB-asociacionin-e-tyre/a-16629207>. E qasur: Shkurt 2018.

Gjykata Kushtetuese “(...) gjeti se shumë elemente të marrëveshjes nuk ishin në pajtim me Kushtetutën e Kosovës.”⁵⁷

Nëpërmjet krijimit të asociacionit të komunave serbe “është një mekanizëm që do e pengonte konsolidimin e demokracisë, sepse ky asociacion do t’i lejoj Beogradit që edhe më tej të vazhdoj t’i influencoj serbet e Kosovës si dhe të manipuloj prezencën e tyre në institucionet e Kosovës”⁵⁸, sepse marrëveshja për krijimin e këtij asociacioni për komunat serbe do t’i jepte hapësirë Serbisë (...) t’i ofrojë Asociacionit mbështetje financiare dhe teknike në mënyrë transparente (...).”⁵⁹

E tëra kjo që u tha me lartë konfirmon influencën ilegale të Serbisë tek komuniteti serb, të cilën në bisedimet me Kosovën mundohet me çdo kusht që nëpërmjet marrëveshjeve të tilla edhe ta legalizoj këtë influencë. Veç kësaj “dimensioni historik” i këtij ndikimi politik të Serbisë e bën atë tepër të ndjeshëm në shoqërinë kosovare, duke e shndërruar edhe në arsye të përplasjes dhe grindjeve të brendshme grupore e partiake.”⁶⁰

Një legalizim i çasjes së Serbisë të serbët e Kosovës do të vazhdojë edhe më tej që të pengojë konsolidimin e demokracisë në Kosovë, sepse Serbia do të vazhdojë që të dizajnojë politika destruktive në raport me Kosovën dhe këto politika me së miri mund t’i zbatojë nëpërmjet serbëve të Kosovës.

⁵⁷ European Centre for Minority Issues Kosovo: Asociacioni/Bashksia e komunave me shumicë Serbe. E qasur: Shkurt 2016.

⁵⁸ Andreas Ernst : In Kosovo spielen Fakten keine Rolle mehr, në: <https://www.nzz.ch/international/sturz-der-regierung-in-pristina-kosovo-droht-sich-international-zu-isolieren-ld.1292506>. E qasur: Shkurt 2018.

⁵⁹ Po aty.

⁶⁰ Dukagjin Gorani, intervistë nëpërmjet pyetësorit.

Si **përfundim**, mund të konkludojmë se demokracinë në Kosovë e kanë penguar shumë faktorë, duke u nisur nga antagonizmat ndëretnike (Pakica Serbe dhe Shumica Shqiptare) që paraqiti një sfidë të madhe edhe për Kombet e Bashkuara në procesin e ndërtimit të institucioneve demokratike dhe konsolidimit të tyre.

Dhënia e kompetencave ekzekutive, të cilat ishin rezervuara për UNMIK, ngadalësuan konsolidimin e demokracisë në Kosovë, sepse UNMIK-u ishte instanca e fundit e normave juridike të dala nga institucionet e Kosovës.

Sipas kësaj, Institucionet e Kosovës ishin tejet të kufizuara. Praktika e dhënies së kompetencave vazhdoi edhe pas pavarësisë, ku në kuadër të Planit të Ahtisaarit nga kompetencat ekzekutive kaluan tek ICO dhe krahas këtij mekanizmi u dërgua edhe Misioni i Bashkimit Evropian në Kosovë “EULEX”, sepse Kosova nuk ishte në gjendje akoma që të ketë qasjen e duhur në procesin e konsolidimit të institucioneve demokratike dhe të pavarura.

Edhe EULEX mund të tërheqë ose të zhvlerësojë vendimet e autoriteteve kosovare.

Edhe ky mision nuk arriti që të përmbushë detyrat të cilat iu kishin dhënë, ku ndër to ishte dhe integrimi i pakicës serbe në shoqërinë kosovare dhe mosintegrimi apo mosgatishmëria e tyre për t’u integruar në institucionet e Kosovës vazhdon të paraqesë një sfidë të madhe në procesin e konsolidimit të demokracisë.

Mekanizmat ndërkombëtarë lejuan që enklavat e banuara me serb në Kosovë të krijojnë një lidhje direkte me Beogradin, që iu jepte hapësirë për të manipuluar dhe në të njëjtën kohë për të penguar konsolidimin e institucioneve të Kosovës, si dhe shtrirjen e juridiksionit në tërë territorin e saj. Veç

kësaj, forcimi i strukturave paralele (serbe) në Kosovë ka qenë dhe vazhdon të jetë pengesë për konsolidimin e një shoqërie multietnike në Kosovë.

Në këtë kapitull, po ashtu u pa se përfundimi i mbikëqyrjes së pavarësisë ishte një akt simbolik, sepse Kosova nuk ishte në gjendje për të garantuar një shtet ligjor, në të cilin do të garantonte një funksionim të pavarur institucionesh dhe një kulturë politiko-institucionale.

Faktori tjetër që është nxjerrë gjatë trajtimit të këtij kapitulli, i cili e vështirëson konsolidimin e demokracisë, është edhe krijimi i Asociacionit të Komunave me shumicë serbe, sepse ky asociacion do t'i mbajë dyert e hapura për Beogradin, që edhe më tej ta përdorë këtë mekanizëm për t'i instrumentalizuar serbet e Kosovës dhe kështu nëpërmjet tyre t'i pengojë insitucionet e Kosovës në proceset e vendimmarrjes, siç është ky i fundit bllokimi i formimit të Ushtrisë së Kosovës (Forcave të Armatosura të Kosovës), veprim ky që është në kundërshtim të parimeve të demokracisë, sepse pakica serbe prej 5% po vendosë për 95 % të popullsisë së Kosovës.

Në këtë kontekst, që nga vendosja e UNMIK-ut, OSBE-së, ICO-së, EULEX-it e deri te inkuadrimi direkt si aktor kryesor i BE-së, tolerimi i çasjes së Beogradit, nëpërmjet serbëve të Kosovës, me qëllim që ta pengojë funksionimin e shtetit të Kosovës, si dhe ta pengojë konsolidimin e demokracisë, ka qenë një gabim që është shndërruar në barrë për Kosovën dhe që në çdo fushë është duke e penguar shtetin e Kosovës.

Faktorëve që kanë ndikuar në ngadalësimin e konsolidimit të demokracisë në Kosovë iu shtohet edhe pjesëmarrja mjaft e ulët e qytetarëve në proceset demokratike, gjë që si rrjedhojë e saj ka rënë gjithnjë e më shumë besimi i qytetarëve në institucionet shtetërore. Si pasojë, është krijuar një klimë e pasigurisë socio-ekonomike ndër qytetarë dhe një pjesë e madhe e tyre e shohin largimin

nga Kosova si alternativë. Rasti i ikjes masive në fund të vitit 2014 dhe fillimvitin 2015 dëshmoi se edhe rrugët ilegale për migrim do të shfrytëzoheshin nga shumë qytetarë të Kosovës vetëm e vetëm për të gjetur një shtet që ofron kushte më të mira socio-ekonomike. Humbja e besimit në shtetin që i mbron qytetarët e saj dhe klasën politike, e cila i shërben së pari një shtrese të caktuar klientele dhe e cila nuk krijon kushte për jetë të dinjitetshme, ishin nxitje për shumë migrantë ilegal, që e kishin dhënë si arsye për azil në shtetet perëndimore. Kjo kishte ndikuar që shumë skeptik të zhvillimeve pozitive në Kosovë të shfrytëzonin këtë arsye si argument për të ngadalësuar proceset për Kosovën, sidomos procesin e liberalizimit të vizave.


KAPITULLI III - Ndarja e pushteteve: Ekzekutivi, Legjislativi dhe Gjyqësori dhe roli i tyre në konsolidimin e demokracisë në Kosovë

Në demokraci, një ndër elemente më primare të qeverisjes është ndarja e pushteteve. Ndarja e pushteteve siguron një qeverisje më efektive, e cila në vete ka më shumë pavarësi në hallkat apo degët e qeverisjes, që pamundësojnë kontrollin ose ushtrimin e ndikimit në vendimmarrje nga një degë ndaj tjetrës degë të qeverisjes, e që janë tri: legjislativi, ekzekutivi dhe gjyqësori.

Nëse shikohet aspekti kronologjik dhe përmbajtësor, mund të konstatohet se kërkesat lidhur me ndarjen e përgjegjësisë dhe autonominë e organeve të qeverisjeve u paraqiten me qëllim për ta luftuar pushtetin absolut të njëres nga degët e qeverisjes.

Diskutimi lidhur me ndarjen e pushteteve fillon qysh në Greqinë e lashtë dhe nënkuptonte ndarjen dhe pavarësinë mes pushteteve.”⁶¹ Kjo tendencë, në atë kohë nuk gjeti mbështetje, në mungesë të kulturës politike dhe mungesës së pushtetit demokratik; më vonë, e sidomos pas shekullit të XVII dhe XVIII, vjen në shprehje si rezultat i zotërimit të borgjezisë. Ndërsa, me kalimin e kohës, u bë legalizimi i ndarjes së pushteteve përmes akteve më të larta normative, mirëpo edhe sot nuk kemi një ndarje strikte të pushteteve në vendet ku është zhvilluar demokracia.⁶²

Ndarja e pushteteve, përveç pavarësisë së hallkave të qeverisjes, prodhon edhe një kontroll reciprok mes tri hallkave të pushtetit gjë që jep mundësinë e ushtrimit të veprimtarisë së pavarur për secilën degë të qeverisjes, ndërsa krijon efekte pozitive midis njësive që kanë pushtet.



Nëse nisemi nga parimi i ndarjes së pushteteve trupat e tri degëve të qeverisjes (ekzekutivi, legjislativi dhe gjyqësori) do te funksionojnë më mënyrë të pavarur dhe do ti japin përgjegjësi njëri-tjetrit dhe qytetarëve të vendit. Shumë herë ky parim njihet dhe si mekanizëm i kontrollit dhe balancit.

Tabela. 7. Funksionimi i Ndarjes së Pushteteve

⁶¹ Marrë nga ueb-faqja www.dadalos.org/ rubrika Demokracia. E qasur: Shkurt 2018.

⁶² Hon Dean Wells, Current challenges for the Doctrine of the Separation of Powers – The Ghost in the Machinery of Government file:///C:/Users/Kujtim.bytyqi/Downloads/195-1-380-1-10-20120622.pdf faqe 114-116. E qasur: Shkurt 2018.

Ndarja e pushteteve sot është prezente në të gjitha vendet ku aplikohet sistemi demokratik. Autori Mayer paraqet përshkrime mbi funksionimin e pushteteve në disa vende në librin e tij te quajtur “Politikat Krahase”, i cili përgjatë përshkrimit të strukturave dhe proceseve politike në Britaninë e Madhe, kemi ndarje të pushteteve ndërmjet Kurorës, Qeverisë, Parlamentit, ndërsa në Gjermani në mes Kuvendit Federal, Këshillit Federal, Kryetarit me pushtet të kufizuar, Kancelarit Federal me pushtet të madh ekzekutiv, dhe Gjykatës Kushtetuese Federative.⁶³ Në rastin e SHBA-ve, „më e drejtë do të ishte të thuhej se sistemi kushtetues bazohet më shumë në idenë e kontrollit dhe të ekuilibrit sesa në konceptin e pastër të ndarjes së pushteteve“⁶⁴. Kështu që, në realitet mund të thuhet se ka një ndarje të pastër të pushteteve mes tri degëve të qeverisjes.

Në vazhdim do të paraqesim ndarjen e pushtetit në Kosovë, në periudhën e krijimit të institucioneve vendore para dhe pas shpalljes së Pavarësisë në vitin 2008.

Nëse flasim për periudhën e tranzicionit në Kosovë, gjatë administrimit të UNMIK-ut në Kosovë nuk kishim të bënim me parimin e ndarjes së pushtetit, për arsye se i tërë pushteti ishte në duart e administratës ndërkombëtare, e cila drejtohej nga Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm (PSSP). Kjo formë e qeverisjes së vendit përmes administratës ndërkombëtare, e cila kishte rolin kryesor, mund të themi se promovoj parimin e unitetit të pushtetit në duart e një organi, i cili ishte legjitimuar përmes Rezolutes 1244/99. Pushteti i rezervuar i PSSP-së, kishte fuqi të madhe vendimmarrëse me karakter absolut, ndërsa filozofia me të cilën arsyetohej veprimi qëndronte në atë se pushteti gradualisht do të kalonte në duart e vendorëve. Kjo, natyrisht, mund të vërtetohet që edhe tranzicioni dhe gjithashtu konsolidimi i demokracisë në Kosovë ishte shumë i ngadalshëm në

⁶³ Lawrence C. Mayer, „Politikat Krahase“, SOROS dhe Ora, Tiranë, 2003, f. 30-218.

⁶⁴ Luan Omari, „Shteti i së Drejtës“, Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Tiranë, 2002, f. 77.

kohën kur kishim të instaluar Administratën e UNMIK-ut, shkaku i pushtetit të rezervuar që kishte Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm në Kosovë.

Rrjedhimisht, nga muaji maj i vitit 2001, kemi miratimin e Kornizës Kushtetutës e cila ofroi mundësinë e formimit të institucioneve në njërën anë, ndërsa në anën tjetër, mundësoi një ndarje të pushteteve në tri hallka ndërmjet institucioneve vendore. Kurse, sa i përket autoritetit të PSSP-së, ai mbeti i paprekur dhe se i tërë sistemi politik në raste kur vlerësohet sipas kapitullit XII-të të kornizës kushtetuese, ishte nën kontrollin e PSSP-së. Ai prodhonte pushtet absolut në tri shtyllat e qeverisjes vendore, duke zbehur autoritetin e organeve të cilat kishin dalë nga vota e popullit. Kur themi se PSSP-ja, kishte një autoritet absolut, kjo vërtetohet me faktin se, në disa raste, kur institucionet vendore merrnin vendime, ato vendime shfuqizoheshin nga PSSP-ja. Rasti i këtillë i aplikimit të pushtetit të PSSP-së, ishte me degën legjislative ku disa herë Kuvendi i Kosovës, filloi hapat për nisma legjislative, por u pengua nga pushteti i rezervuar i Kryeadministratorit (PSSP-së). I tillë ishte edhe rasti me Komisionin kushtetues & legjislativ të Kuvendit të Kosovës kur iu ndalua nisma për ndryshimin e Kornizës Kushtetuese.”⁶⁵ Edhe përkundër kësaj, Kosova para shpalljes së Pavarësisë së saj në vitin 2008, kishte një ndarje formale mes tri hallkave të pushtetit si;

- Parlamentit- si organit legjislativ i quajtur KUVENDI me karakter bikameral, i cili është institucioni më i lartë legjislativ .
- Kryetari i Kosovës- që përfaqëson unitetin e popullit dhe garanton funksionimin demokratik të Institucioneve.
- Qeveria – organi që ushtron pushtet ekzekutiv dhe zbaton ligjet e miratuara nga Kuvendi.

⁶⁵ Arsim Bajrami, „ Seanca mësimore nga kursi Shteti Ligjor”, 2006.

- Gjyqësori- i cili administrohet nga gjykatat, të cilat punojnë në kudër të ligjeve të zbatueshme në vend.



Tabela. 8. Ndarja e Pushteteve. Struktura e shpërndarjes së pushteteve në Kosovë gjatë Administrimit ndërkombëtar deri ne vitin 2008.

Duke u mbështetur në Kornizën Kushtetuese, kreu 9.1 i saj përcaktonte fushëveprimin e Kuvendit të Kosovës si „ institucion më i lartë përfaqësues dhe ligjvënës i vetëqeverisjes së përkohshme“⁶⁶, i cili përfaqësonte degën legjislative të qeverisjes, duke përcaktuar përbërjen, zgjedhjen, mandatin, përgjegjësitë dhe procedurat vendimmarrëse.

Kuvendi është organi më i lartë i organeve vendore, i cili, sikur edhe organet e tilla në vendet tjera, ushtron funksionin legjislativ, zgjedhor dhe monitorues. Duke u mbështetur ne kornizën kushtetuese deri në vitin 2008, Kuvendi i Kosovës kishte këto përgjegjësi :

- Miratimin e ligjeve, rregulloret e brendshme, shqyrtimin e marrëveshjeve ndërkombëtare.
- Zgjedhjen e Kryesisë së Kuvendit, Kryetarit, Kabinetit Qeveritar ose edhe refuzimin e tyre.

⁶⁶ Korniza Kushtetuese për Vetëqeverisje të Përkohshme të Kosovës,
https://www.kuvendikosoves.org/common/docs/FrameworkPocket_ALB_Dec2002.pdf.
 E qasur: Shkurt 2018.

- Vendimin për mocionin ndaj Qeverisë.
- Miratimin e rregulloreve të punës së Kuvendit dhe komisioneve të tij.
- Përgjegjësitë e bashkëpunimit me institucionet tjera.

Mirëpo, siç u tha edhe më lartë, ky organ kishte kufizime të cilat dalin nga autoriteti i administratës ndërkombëtare përmes rregulloreve dhe nënshkrimit të ligjeve të Kuvendit. Për dalim nga vendet tjera, ku këto kompetenca mund të rrjedhin nga legjislativi, Presidenti apo nga Kryetari i Kuvendit në Kosovë, këto kufizime ishin pjesë e kompetencave të administratës ndërkombëtare në Kosovë, se paku deri në vitin 2008.

Pushteti Ekzekutiv-sipas kornizës kushtetuese. ishte pushtet ku Qeveria ushtronte pushtetin ekzekutiv, e cila ka funksion në zbatimin e ligjeve të miratuara nga Kuvendi.

Pushteti Juridik- Sistemi gjyqësor në Kosovë ishte i organizuar, që nga Gjykata Supreme, ajo e Qarkut dhe gjykatat komunale, ku administrimi i tyre bëhej në përputhje me ligjin e zbatueshëm. Kjo përbënte një ndarje të kompetencave në mes tri degëve të qeverisjes, mirëpo vlen të theksohet se edhe përkundër kësaj ndarjeje, në të gjitha degët e qeverisjes në Kosovë administrata ndërkombëtare dhe përfaqësuesi special i saj ka pasur super autoritet mbi këto institucione,, pasi që vendi qeverisej nga misioni i OKB-së, deri në shpalljen e Pavarësisë së Kosovës në vitin 2008.

Pas shpalljes së Pavarësisë së Kosovës në vitin 2008, dhe rrjedhimisht miratimit të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, përmes së cilës përsëri është saktësuar ndarja e pushteteve në legjislativ, ekzekutiv dhe gjyqësor. Megjithatë, siç theksohet edhe më në kapitujt më lartë, mbikëqyrja

ndërkombëtare ka vazhduar edhe pas shpalljes së Pavarësisë së Kosovës, deri në vitin 2012, përmes “Zyrës Ndërkombëtare Civile” (Internacional Civil Office) - ICO.

Pra, pas shpalljes së Pavarësisë së Kosovës, lirisht mund të flitet për ndarje të mirëfilltë të pushteteve. Mirëpo, problemi kryesor me të cilin këto tri degë janë ballafaquar ishte ndërhyrja apo interferimi i punës së tri degëve ndaj njëra-tjetrës. Sidomos, mund të theksohet ndërhyrja e ekzekutivit në punën e legjislativit dhe gjyqësorit. Në anën tjetër, Kuvendi i Republikës së Kosovës ka qenë i kritikuar për moskryerjen e njërës prej punëve të tij të rëndësishme, atë të kontrollit apo monitorimit të punës së ekzekutivit. Komisionet parlamentare kanë qenë të injoruar nga ekzekutivi, me çka ato shpesh kanë humbur efektin e punës së tyre.⁶⁷

Prandaj, ne vazhdim do të flitet për organizimin e tri pushteteve në Kosovë, me theks të veçantë, për periudhën pas shpalljes së pavarësisë së Kosovës dhe miratimit të Kushtetutës së Republikës së Kosovës nga viti 2008 dhe efikasitetin e këtyre tri pushteteve në kryerjen e detyrave të dhëna me kushtetutë. Ky vlerësim i efikasitetit të këtyre tri hallkave të pushtetit do të jap edhe disa përgjigje përkitazi me rolin e këtyre tri pushteteve në zhvillimin dhe konsolidimin e demokracisë në Kosovë.

Funksionimi i këtyre shtyllave është i një rëndësie të veçantë sepse “mosfunksionimi i këtyre shtyllave kryesore të një sistemi shtetëror e informalizon jetën shoqërore dhe publike; shkakton humbje të besimit dhe anashkalim të institucioneve të shtetit. Në shumë aspekte, diç e këtillë ka ndodhur në Kosovë: sa më pak funksionojnë legjislativi, ekzekutivi dhe gjyqësori – aq më shpesh

⁶⁷ BTI 2016, Raporti i Shtetit: Kosovë, faqe 11: https://www.bti-project.org/fileadmin/files/BTI/Downloads/Reports/2016/pdf/BTI_2016_Kosovo.pdf.
E qasur: Gusht 2017.

zgjidhjet për problemet e qytetarit/shoqërisë tentohen të gjenden përtej tyre, në sferën private, në kodet popullore joinstitucionale dhe joshtetërore.”⁶⁸

III.1.1. Sistemi legjislativ dhe Parlamentarizmi

Në kuptimin e përgjithshëm, me Parlamentarizëm kuptojmë një sistem përfaqësues, në të cilin parlamenti si organ qendror i zgjedhur nga populli i një vendi të caktuar, luan rolin kryesor në procesin e vendimmarrjes. Gjeneza e parlamentit si institucion politik është e lidhur ngushtë me paraqitjen e parlamentarizmit si formë e qeverisjes shtetërore, e bazuar në rolin dominues të parlamentit. Paraqitja dhe zhvillimi i parlamentarizmit si lëvizje politike është e lidhur ngushtë me reformat emancipuese të ndërmarra nga borgjezia si klasë e re, veçanërisht gjatë periudhës së absolutizmit, në ballafaqimin e saj me klasën feudale.⁶⁹

Në mendimin përparimtar të kohës që përfaqësonte interesat e klasës së re borgjeze, theksohej me forcë se, vetëm populli mund dhe duhej të bëhej bartës i vërtetë i pushtetit më të lartë në shtet, përmes zgjedhjes së përfaqësuesve të vet në parlament. Në të vërtetë, procesi i implementimit të deklarimeve fillestare të borgjezisë zgjati mjaft shumë. Realisht dhe praktikisht, e drejta për t’u zgjedhur, për një kohë të gjatë, iu njoh vetëm një numri mjaft të kufizuar të shtetasve dhe për gëzimin e kësaj të drejte ishin vënë kritere të ndryshme kufizuese, si p.sh., pasuria, prona, ngjyra, titulli, gjinia-seksi etj.⁷⁰

⁶⁸ Dukagjin Gorani, interviste nëpërmjet pyetësorit.

⁶⁹ Xhezair Zaganjori. 2002. Demokracia dhe Shteti i së Drejtës. Tiranë: „Luarasi”. Faqe 139.

⁷⁰ Arsim Bajrami. 2002, Teoria dhe Praktika Parlamentare. Shkup: Flaka. Faqe 95;

Heqja e këtyre kufizimeve dhe të tjera të ngjashme, është bërë gradualisht dhe për një kohë mjaft të gjatë, përmes reformave progresive demokratike të shoqërisë. Vetëm përmes reformave të tilla dhe lidhjes e kushtëzimit të zgjedhjes së parlamentit mbi parimet themelore të demokracisë, ndër të cilat më të rëndësishmet janë:

- garantimi i zgjedhjeve të përgjithshme të lira,
- të barabarta,
- të drejtpërdrejta dhe
- të fshehta.

Vetëm me plotësimin e këtyre kushteve mund të flitet për parlamentin si bartës të vërtetë të sovranitetit të popullit dhe të pushtetit më të lartë shtetëror. Në këtë mënyrë, realizohet edhe vetë thelbi i demokracisë, e cila kërkon pushtet shtetëror që buron nga populli dhe kontrollohet prej popullit.

Në shtetet demokratike me sistem parlamentar, parlamentet, në përgjithësi, duhet t'i realizojnë katër detyra themelore:

1. T'i diskutojnë dhe t'i miratojnë ligjet,
2. Të diskutojnë dhe të gjejnë zgjidhje për çështjet me rëndësi të veçantë për shtetin dhe shoqërinë,
3. Të miratojnë buxhetin e shtetit dhe

4. Të kontrollojnë punën dhe veprimtarinë e qeverisë dhe të administratës shtetërore në përgjithësi.⁷¹

Në sistemet parlamentare të qeverisjes, parlamenti është një kuvend-organ i përfaqësuesve të zgjedhur që miraton ligje dhe që i jep të drejtën qeverisë të caktojë dhe të vjeli taksa e tatime. Krahas rolit ligjvënës, ai zgjedhë nga radhët e veta personelin e qeverisë, sikur në rastin e sistemit legjislativ në Republikën e Kosovës, duke shkrirë funksionet ligjvënëse dhe ekzekutive në sistemin e qeverisjes parlamentare.⁷²

Kryetari i qeverisë, i zgjedhur nga grupi i shumicës në parlament (partisë politike apo koalicionit që ka fituar shumicën e vendeve në parlament), është i detyruar të japë llogari para parlamentit së bashku me qeverinë-kabinetin e tij, duke pranuar parimet e përgjegjësisë kolektive dhe individuale, përkatësisht të qeverisë dhe të ministrave.⁷³

Shtetet me funksionim të efektshëm të sistemit ligjvënës fillimisht u ballafaquan me zgjidhjen e dy „krizave” të mëdha:

1. „Krizës së pjesëmarrjes”, pra, pjesëmarrjes së qytetarëve në qeverisje përmes përfaqësuesve të vet, që do të thotë edhe fitore të demokracisë përfaqësuese,
2. „Krizës së shpërndarjes”, pra, shpërndarjes së vlerave materiale dhe shpirtërore, që do të thotë fillimi i realizimit të marrjes së përgjegjësisë nga qeveritë në drejtimin e ekonomisë

⁷¹ Arsim Bajrami. 2005. Demokracia Parlamentare-Aspekte krahasuese. Prishtinë: „Flaka”, Shkup. Faqe 93.

⁷² Xhezair Zaganjori,. 2002. Demokracia dhe Shteti i së Drejtës. Tiranë: „Luarasi”. Faqe 139-140.

⁷³ Mc Lean, Iain. 2001. Fjalor Politik-Oxford. Tiranë: Shtëpia e librit & Komunikimit. Faqe 408.

dhe të sigurimit të përfitimeve materiale të mirëqenies së qytetarëve, të cilat u integruan në shtetet e mirëqenies sociale.⁷⁴

Ndër tiparet dhe veçoritë kryesore të funksionimit të mirëfilltë të një sistemi legjislativ të një vendi demokratik janë:

- qeveria del nga parlamenti, ajo zgjidhet dhe kontrollohet nga parlamenti. Politikisht, kjo është e domosdoshme, kurse juridikisht, kjo është e mundshme të realizohet në praktikë;
- përmes votës së mosbesimit (me shumicën e votave), parlamenti mund ta rrëzojë- ndërrojë qeverinë në çdo kohë;
- pushteti ekzekutiv, ka të drejtë që në raste të caktuara të inicojë shpërndarjen e parlamentit;
- partia kryesore që ka shumicën në parlament dhe praktikisht edhe qeverisjen e vendit, është pothuajse nën kontrollin e plotë të kryetarit të qeverisë.

Është për t'u theksuar se, përgjithësisht, këto vlerësohen si tiparet apo veçoritë kryesore që e karakterizojnë sistemin parlamentar të qeverisjes. Megjithatë, nga tërësia e këtyre tipareve, veçanërisht në sistemin parlamentar të qeverisjes, me të drejtë mund të veçohet si tipari më i rëndësishëm e drejta parlamentare për ta rrëzuar-ndërruar qeverinë.⁷⁵

Përveç kësaj, mundësia e rrëzimit-ndërrimit të qeverisë nga ana e parlamentit (mocioni i mosbesimit) si dhe mundësia e shpërndarjes së parlamentit nga pushteti ekzekutiv, e bëjnë të

⁷⁴ Filo, Llambro dhe Haxhi Ferati. 2004. Socialdemokracia Europiane dhe Rruga e Tretë-Vështrim historik. Tiranë. Faqe 16; Filo, Llambro dhe Juliana Marko. 2006. Historia e Kohëve moderne-Për Shkenca Politike dhe Sociale. Tiranë: UFO. Faqe 6-7.

⁷⁵ Xhezair Zaganjori,. 2002. Demokracia dhe Shteti i së Drejtës. Tiranë: „Luarasi”. Faqe 142-143.

mundur që në sistemet parlamentare të qeverisjes, të këtë një bashkëpunim mjaft të ngushtë mes shumicës parlamentare (të cilin e përbën një parti ose një koalicion i partive) dhe qeverisë, praktikisht, mes kryetarit të qeverisë dhe anëtarëve të partisë apo koalicionit që e përbëjnë shumicën.

Funksionet e mësipërme, përgjithësisht, më tepër kanë karakter teorik- formal. Për çdo rast konkret, krahas normave kushtetuese është e nevojshme të merren parasysh edhe faktorë tjerë të rëndësishëm si: tradita, përvoja, kultura politike, raporti i forcave politike, karakteri i personalitetit të kryetarit të qeverisë, raportet e tyre brenda partisë ose partive që kanë pushtetin politik në vend etj.⁷⁶

III.1.1.2 Roli i pushtetit legjislativ në konsolidimin e demokracisë në Kosovë

Pushteti legjislativ në Kosovë garantohet me Kushtetutën e Republikës së Kosovës që në kapitullin e saj të katërt (IV) flet për parimet e përgjithshme, strukturën, kompetencat, mandatin, imunitetin dhe kompetencat tjera.

Kuvendi i Kosovës është institucion ligjvënës i Republikës së Kosovës i zgjedhur drejtpërdrejt nga populli. Ai përbëhet nga 120 deputetë.⁷⁷ Ndër të tjera, Kuvendi miraton ligje, vendos të ndryshojë Kushtetutën (me 2/3 e të gjithë deputetëve të tij, duke përfshirë 2/3 e të gjithë deputetëve që mbajnë vendet e rezervuara dhe të garantuara), miraton buxhetin e Republikës së Kosovës, ratifikon

⁷⁶ Po aty. Faqe 143-144.

⁷⁷ Kushtetuta e Republikës së Kosovës Kapitulli IV, <https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=3702>. E qasur: Shkurt 2018.

traktatet ndërkombëtare, zgjedh dhe shkarkon Kryetarin dhe nënkryetarët e Kuvendit, zgjedh dhe mund të shkarkojë Presidentin e Kosovës, zgjedh Qeverinë dhe shpreh mosbesimin mbi të, mbikëqyrë punën e Qeverisë, mbikëqyrë politikën e jashtme dhe të sigurisë, jep pëlqimin për dekretin e Presidentit mbi shpalljen e Gjendjes së Jashtëzakonshme, etj. Deputetët e Kuvendit të Kosovës nuk mund të ushtrojnë asnjë funksion ekzekutiv.⁷⁸

Sidoqoftë, Kuvendi i Kosovës që nga viti 2008 vlerësohet për një performancë shumë të dobët⁷⁹ e që vazhdon edhe në ditët e sotme. Kuvendi i Kosovës në shumë raste ka qenë i ndikuar drejtpërdrejtë nga pushteti ekzekutiv. (...) Legjislativi në Kosovë është peng i vullneteve politike të grupeve partiake në Kuvendin e Republikës. Vonesat dhe pengesat që shkaktohen në funksionimin e tij janë kryekëput të ndërlidhura me interesat e grupeve politike – e që janë interesa të natyrës ekonomike, ligjore/juridike dhe – jo rrallëherë – edhe të natyrës ideologjike.⁸⁰

Ndërsa, edhe e ashtuquajtura “kontrolli dhe balanca” ndërmjet këtyre dy pushteteve ka qenë për t’u dëshiruar. Pjesëmarrja e përfaqësuesve të ekzekutivit në ftesat që komisionet parlamentare iu kanë bërë atyre në bazë të mandatit dhe ligjit, ka qenë e paktë dhe shpeshherë e papërgjegjshme në përgjigjet e tyre. Kuvendi i Kosovës, në shumë raste, ka shkuar në zgjedhje të parakohshme, pastaj edhe konstituimi i Kuvendit të ri, pas zgjedhjeve ka qenë sfidues dhe i zgjatur me disa muaj. Kjo e ka bërë Kuvendin e Kosovës njërin nga organet shtetërore, të cilit në shumë raste i është bërë e pamundur kryerja e funksionit të tij me sukses.

⁷⁸ Po aty.

⁷⁹ Albert Krasniqi, intervistë nëpërmjet pyetësorit.

⁸⁰ Dukagjin Gorani, intervistë nëpërmjet pyetësorit.

Kuvendi i Kosovës, ndër të tjera, njihet edhe si organ i cili ka miratuar jashtëzakonisht pak ligje, sidomos në legjislaturat e fundit të tij⁸¹. Në vitin 2017 vetëm katër ligje Kuvendi arriti t'i miratojë në sesionin vjeshtor, për gati 5 muaj prej konstituimit të tij.⁸² Në përgjithësi në legjislaturën e parafundit vetëm 4 për qind të agjendës legjislative është përmbushur.⁸³ Rrjedhimisht, disa nga defektet që e kanë përcjellur legjislativin në Kosovë ndër vite janë: miratimi i pakët i ligjeve, fërkimet e ashpra të partive politike parlamentare për tema të nxehta, si: Asociacioni i komunave me shumicë serbe dhe Demarkacioni me Malin e Zi, që ka sjellë edhe deri tek përdorimi i gazit lotsjellës në Kuvend nga ana e deputetëve të opozitës. Pastaj, mosgatishmërinë e qeverisë që të jenë pjesëmarrës në seancat e Kuvendit në interpelanca dhe debate të rëndësishme shtetërore.

Në procesin e vendimmarrjeve të rëndësishme nacionale, Kuvendi i Kosovës akoma vazhdon të pengohet në mënyrë jo demokratike nga partitë politike, sepse “skena partiake në Kosovë ende nuk ka evoluuar në nivel të sekularizmit institucional, duke qenë në gjendje të bëjë ndarjen mes interesit nacional, grupor dhe individual. Në fazën e saj të hershme në të cilën ndodhet, logjika legjislative dhe shtetërore e Kosovës funksionon ngjashëm me monarkitë e pazhvilluara parlamentare të shekujve 19 – apo të shoqërive post-koloniale (Afrikë/Azi) të shekullit 20. Ajo karakterizohet me paraliza të vazhdueshme institucionale dhe grindje të pandalshme parlamentare meqë ende nuk është e vetëdijshme që të bëjë ndarjen e interesit nacional prej atij partiak, si dhe (...) grupet politike në legjislativ janë të bindura se vetëm agjenda e tyre është agjenda nacionale.”⁸⁴

⁸¹ Albert Krasniqi, intervistë nëpërmjet pyetësorit.

⁸² Gazeta elektronike Bota Sot, <http://www.botasot.info/aktuale-lajme/813291/kuvendi-sarriti-ta-permbush-rolin-e-tij/>. E qasur: Shkurt 2018.

⁸³ Po aty.

⁸⁴ Dukagjin Gorani, interviste nëpërmjet pyetësorit.

Po ashtu, Kuvendi i Kosovës, jo rrallë herë është ballafaquar me probleme edhe gjatë organizimit të zgjedhjeve lokale, sepse deputetet e shihnin me të arsyeshme që të merren me zgjedhje se sa të vijnë në Kuvend dhe të kryejnë punët kushtetuese që ata i kanë. Në përgjithësi, konsiderohet se përgjegjësia e madhe e mospunës së Kuvendit ishte shkaku i Qeverisë dhe koalicionit qeverisës, sepse ata ishin determinues të punës së Kuvendit. Sa i përket legjislaturës së fundit, situata është edhe më zhgënjyese, sepse Kuvendi i Kosovës që nga konstituimi e deri më tash ka arritur të miratojë vetëm pesë ligje, prej të cilave tri marrëveshje ndërkombëtare me karakter financiar dhe dy projektligje që janë plotësim-ndryshim i Ligjit për Buxhetin e vitit të kaluar, si dhe buxheti për vitin 2018.⁸⁵

Në përgjithësi, mund të nxirret përfundimi që Kuvendi i Republikës së Kosovës nuk ka arritur t'i përmbushë obligimet e tij që i takojnë me Kushtetutën e Kosovës, e sidomos funksionin e saj kryesor e që është miratimi i ligjeve.

Mosfunksionimi efikas i punës së Kuvendit të Kosovës vë në pikëpyetje njërin nga elementet kryesore të konsolidimit demokratik të një shteti. Kuvendi buron nga populli përmes zgjedhjeve të lira dhe demokratike. Sidoqoftë, pushteti legjislativ në Kosovë ka qenë jo aq efikas ndër vite, sa që shpeshherë ka vënë në pikëpyetje edhe ekzistencën e vet shtetit, e mos të flasim për kryerjen e detyrave të tij, përmes së cilës do ta përmirësonte edhe imazhin shtetëror jashtë vendit dhe konsolidimin e mirëfilltë të demokracisë.

⁸⁵ Gazeta elektronike "GAzeta Zeri" <http://www.arbresh.info/lajmet/kuvendi-performance-te-dobet/>. E qasur: Shkurt 2018.

Tentimi i fundit i disa deputetëve të Republikës së Kosovës për ta shfuqizuar Gjykatën Speciale është rasti më konkret që tregon ndikimin e madh që pushteti ekzekutiv ka ndaj legjislativit. Për më tepër, vazhdimi i kësaj ideje solli një reagim të ashpër të bashkësisë ndërkombëtare, e sidomos ambasadave të shteteve mike në Kosovë.⁸⁶ Kjo gjendje, në përgjithësi, solli pasiguri edhe në vet ekzistencën e shtetit dhe konsolidimit të demokracisë në Kosovë. Për më tepër, kjo gjendje ndikoi edhe tek besimi i qytetarëve ndaj pushtetit shtetëror në përgjithësi. Nuk ka fare dyshim që dy pushtetet: legjislativi dhe ekzekutivi ende nuk e kanë kaluar provimin e mosndikimit në punët e njeri-tjetrit. Presionet e vazhdueshme që ia bëjnë njëra-tjetrës, në vazhdimësi kanë krijuar kriza të përsëritura dhe kanë vënë në dyshim serioz konstatimin që shteti i Kosovës është ende në fazën e hershme të konsolidimit të demokracisë. Për më keq, shpeshëherë pa ndërhyrjen ndërkombëtare, si në rastin e tentimit të shfuqizimit të Gjykatës Speciale, Kosova brenda një nate mund ta humbiste krejt çka kishte, e mos të flasim për konsolidim stabil të institucioneve demokratike. Nuk ka dyshim që konsolidimi i mirëfilltë demokratik i një shteti kërkon maturi sa i përket marrjes së vendimeve. Marrëveshjet ndërkombëtare duhet respektuar, sidomos pasi ato janë miratuar njëherë në Kuvend. Ekziston një pajtim i përgjithshëm që shteti i Kosovës, me rastin e tentimit të fundit të shfuqizimit të Gjykatës Speciale, sidoqoftë ka humbur besimin e botës demokratike dhe ka vënë në pikëpyetje rrugën e saj të konsolidimit demokratik, sidomos rolin e pushtetit legjislativ në këtë aspekt. Edhe çështja e ratifikimit të Marrëveshjes së shënjitimit të vijës kufitare ndërmjet Kosovës dhe Malit të Zi, që është zvarritur 3 vite, ka vënë në pikëpyetje punën e Kuvendit të Kosovës dhe deputetëve në përgjithësi.

⁸⁶ Gazeta elektronike "Koha jone" <http://www.kohajone.com/2018/01/05/quint-i-kategorik-kunder-shfuqizimit-te-gjykates-speciale/>. E qasur: Shkurt 2018.

Si përfundim, mund të themi që pushteti legjislativ në Kosovë ka përjetuar dhe po përjeton kriza të thella të funksionimit të saj, e që rrjedhimisht afekton drejtpërdrejtë konsolidimin e demokracisë në Kosovë.

III.1.1.3 Roli i Partive Politike në konsolidimin e demokracisë në Kosovë

Një demokraci pa parti politike është një ngjarje shumë kaotike, ku nuk mund të flitet për një shtet demokratik e lëre më për konsolidimin e saj, pra një demokraci e përbërë parlamentare nuk mund të realizohet pa partitë funksionale.⁸⁷

Prandaj, nuk ka dyshim që partitë politike luajnë një rol të rëndësishëm në konsolidimin e demokracisë. Autori Bingham Powell ka dhënë argumente që një sistem i fortë i partive politike është thelbësor për një demokraci të fortë. Partitë politike influencojnë edhe pjesëmarrjen e qytetarëve në garat elektorale. Dinamika e sistemit partiak dhe partitë politike në përgjithësi kanë mundësinë që edhe të shuajnë probleme edhe trazira, por munden edhe t'i ndezin ato, kur nuk ka konsensus. Strategjitë dhe angazhimet e liderëve të partive politike mund të jenë kritike për mbështetjen e sistemit demokratik në kohën e krizës dhe trazirave.⁸⁸

Një tjetër autor, Leonardo Morlino konsideron që konsolidimi i demokracisë nëpërmjet partive ofron zgjerim të strukturave të partisë dhe sistemit partiak në përgjithësi, e cila pastaj është në

⁸⁷ Gerhard Walres/ Karsten Grabow (Hrsg.): Parteien und Demokratie, in: https://www.kas.de/c/document_library/get_file?uuid=5639c0e9-031c-55f7-fe66-ccb660ac4ac&groupId=252038. E qasur: Nëntor.2018.

⁸⁸ Powell Bingham, Contemporary Democracies: Participation, Stability and Violence (Demokraci Bashkëkohore: Stabilitet dhe Dhunë), Cambridge, Mass., Harvard University Press, 1982, Faqe. 7

gjendje të kontrollojë dhe të integrojë të gjitha format e pjesëmarrjes.⁸⁹ Prandaj, në përgjithësi është e pranueshme që partitë politike krijojnë hapësirë për zhvillimin e participimit dhe vendosjen e një sistemi të ri në shoqëritë demokratike. Sidoqoftë, penetrimi i partive politike në struktura vendimmarrëse të ndryshme varet nga faktorë të ndryshëm, pra varësisht nga numri i partive politike të angazhuara në një sistem, lloji i sistemit partiak dhe nga marrëdhënia ndërmjet legjislativit dhe ekzekutivit.⁹⁰

Pra, partitë politike janë makineri e zhvillimit të demokracive. Autori Rustow sheh tre elemente të cilët e theksojnë rolin e partive politike në konsolidimin e një shteti demokratik. E para, politikanët dhe qytetarët mësojnë nga zgjedhjet e suksesshme të disa çështjeve për të vendosur besimin e tyre në rregullat e reja dhe për t'i përdorur ato për çështje të reja. E dyta, përvojat me teknikat demokratike dhe rekrutimin konkurrues, konfirmon politikanët në praktikat dhe bindjet e tyre demokratike. Dhe, e treta, popullsia hyn në strukturën e re duke u lidhur efektivisht me organizimin partiak të një shteti.⁹¹

Në përgjithësi, partitë politike kanë luajtur dhe luajnë një rol shumë të rëndësishëm në funksionimin dhe konsolidimin demokratik të një shteti. Zhvillimi i partive politike është masë mbrojtëse e pluralizmit politik, duke penguar shfaqjen e alternativave të tjera, siç janë sundimi ushtarak apo politika burokratike. Pra, duhet pasur gjithmonë parasysh rolin e tyre, sidomos në periudhën e

⁸⁹ Leonardo Morlino , Democratic Consolidation (Konsolidimi Demokratik), Oxford University Press, 1998, Fq. 25.

⁹⁰ Po aty, Faqe 26.

⁹¹ Dankward Rustow , Transitions to Democracy Towards a Dynamic Model, Columbia University Press, 1970, Faqe 358.

tranzicionit, nga ndryshimi i regjimeve autoritare në regjimet demokratike, konkretisht konsolidimin e demokracive liberale.⁹²

Sa i përket partive politike në Kosovë, ato janë ballafaquar me shumë probleme që së pari kanë penguar zhvillimin normal të tyre, e pastaj edhe dobësuar rolin e tyre në konsolidimin e demokracisë në Kosovë. Që nga viti 1999 e deri më sot, partitë politike në Kosovë ende kanë probleme me definimin apo profilizimin e qartë të programeve të tyre partiake, konkretisht me profilizimin e ideologjive politike që ato përkrahin dhe përqafojnë.⁹³ Dhjetë vite pas shpalljes së Pavarësisë së Kosovës, shteti ende përballet me mungesë të demokracisë së mirëfilltë në sistemin partiak të tij. Problemi kryesor qëndron në atë se mekanizmat për garantimin e respektimit të legjislacionit lidhur me funksionimin e partive politike nuk janë të fuqizuara deri në atë masë sa të jenë në gjendje t'i mbikëqyrin në mënyrë të efektshme veprimet dhe veprimtaritë e partive politike, dhe t'i sanksionojnë ato kur bëjnë shkelje të ligjeve. Kjo është ajo që mundëson zhvillimin e praktikave jodemokratike brenda partive politike kosovare.

Gjithashtu, një faktor shqetësues në skenën e partive politike në Kosovë është edhe fuqia e madhe që një anëtar apo lider partiak ka ndaj partisë në përgjithësi. Lideri partiak dhe njerëzit rreth tij kanë më tepër fuqi se që iu takon me statut, dhe këta mjaft shpesh marrin vendime duke i anashkaluar të gjitha organet e partisë së tyre. Gjithashtu, liderët partiak kanë kushtëzuar anëtarët e partisë konkretisht deputetet nga radhët e asaj partie, që të votojnë apo mbështesin qëndrimet e liderëve politik të tyre, e që bie në kundërshtim me zhvillimin e demokracisë së brendshme partiake. Kjo

⁹² Geoffrey Pridham, *Securing Democracy Political Parties and Democratic Consolidation in Southern Europe*, Routledge Sigurimi i Demokracisë Partitë Politike dhe Konsolidimin Demokratik në Evropën Jugore), New York, 2003, Faqe 57.

⁹³ Albert Krasniqi & Krenar Shala, 2012, *Fuqizimi i shtetësisë së Kosovës nëpërmjet demokratizimit të partive politike*. Faqe 9-10.

gjendje sjell deri tek vendimmarrja joformale, e që është një pengesë tejet serioze për demokratizimin e partive politike dhe në përgjithësi konsolidimin demokratik partiak në Kosovë. Demokracia brendapartiake përballet me një varg problemesh serioze. Partitë politike në Kosovë nuk e kanë të zhvilluar kulturën e lejimit të debateve dhe kundërshtimeve brendapartiake. Si pasojë, anëtarët e pakënaqur me partitë e tyre politike, shumë më shpesh e braktisin partinë dhe i bashkëngjiten ndonjë partie tjetër, apo, edhe krijojnë parti të reja. Gara për liderë partiak gati asnjëherë nuk ka qenë serioze dhe konkurruese. Në shumicën e rasteve, liderët nuk kanë konkurrencë në zgjedhjet e brendshme, duke i lejuar që të ushtrojnë presione të ndryshme joformale gjatë zgjedhjeve. Partitë politike në Kosovë njërin nga problemet që ende e kanë, është edhe regjionalizimi. Shumica e partive politike, konkretisht liderët e tyre që vijnë nga regjionet e caktuara në Kosovë, përkrahën më shumë në atë pjesë të Kosovës, ku për pasojë krijojnë parti regjionale dhe vota asimetrike.

Po ashtu, është me rëndësi këtu të ceket së partitë politike dhe liderët e tyre në Kosovë akoma nuk kanë arritë që të krijojnë një linjë ndarëse në mes interesit personal partiak si dhe atij shtetëror. Ky qëndrim apo sjellje e partive vështirëson konsolidimin e insitucioneve, e sidomos pas zgjedhjeve, si dhe e bën të pamundur që të mbrohen dhe jetësohen interesat e shtetit. Moslënia anash e interesave të ngushta si dhe viktimizimi i atyre kolektive, në një mënyrë apo në tjetrën, e zbeh funksionimin e shtetit si dhe e zbehë rolin e tij, qoftë në politikat/diplomacinë rajonale apo edhe në atë ndërkombëtare.

Gjithashtu, për një kohë të gjatë, partitë politike garuese në zgjedhjet qendrore apo locale, kanë pasur problem me pranimin e rezultateve të zgjedhjeve, e kjo për shkak të dyshimeve të shumta për vjedhje të votave, ku si pasojë ka pasur shumë ankesa në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve dhe si

rezultat përsëritjen e votimeve në disa vendvotime dhe qendra të votimit. Ndër problemet e shumta që ballafaqohen sot partitë politike në Kosovë janë edhe mostransparenca e tyre gjatë raportimit të financave të tyre gjatë fushatave zgjedhore. Mungesa e transparencës për financimin e partive politike ka krijuar me të drejtë dyshime për korrupsion dhe keqpërdorime, sepse partitë fituese të zgjedhjeve kanë favorizuar financuesit e tyre duke i shpërblyer me tenderë të ndryshëm nga shteti.⁹⁴

Në përgjithësi, mund të themi që partitë politike në Kosovë ende përballen me probleme të theksuara sa i përket konsolidimit të demokracisë së brendshme, e që është njëra nga parimet kryesore të zhvillimit normal të një partie politike në demokraci. Mostransparenca e deklarimit të financave të tyre, mungesa e kulturës së lejimit të debatit të brendshëm, fuqia e madhe që ka lideri, zgjedhjet e brendshme jodemokratike dhe regjionalizmi, janë vetëm disa nga problemet me të cilat përballen sot partitë politike në Kosovë, të cilat rrjedhimisht e vënë në dyshim rolin e tyre në konsolidimin e demokracisë në Kosovë.

III.1.1.4 Zgjedhjet e lira dhe të ndershme

Zgjedhjet e lira bëjnë pjesë ndër shtyllat kryesore të demokracisë, sepse vetëm nëpërmjet tyre mund të konsolidohen institucionet, legjitimiteti i të cilave po ashtu burimin e ka tek demosia. Prandaj, cënueshmëria e zgjedhjeve, në çfarëdo mënyre që mund të jetë, kategorizohet si goditje ndaj demokracisë.

⁹⁴ Gazeta elektronike "Telegrafi" <https://telegrafi.com/kush-financon-partite-fiton-tender/> E qasur: Shkurt 2018.

Kosova është Republikë Parlamentare, ku votuesit zgjedhin anëtarët e parlamentit (deputetët) drejtpërdrejtë, përmes votimit të fshehtë, çdo katër vite. Vendet në Kuvend ndahen midis të gjitha partive, koalicioneve, nismave qytetare dhe kandidatëve të pavarur, në përpjesëtim me numrin e votave të vlefshme, të fituara prej tyre në zgjedhjet për Kuvend.

Në zgjedhjet parlamentare të viteve 2001 dhe 2004, votimi për deputetë është bërë me sistem proporcional me lista të mbyllura. Ky sistem me përfaqësim proporcional dhe lista të mbyllura, i ka shërbyer qëllimit të vet në mandatin e parë, duke lejuar që partitë politike të konsolidohen në periudhën menjëherë pas luftës, mirëpo ky ishte vendim i gabueshëm për mandatin e dytë, meqë Kosovës i duhej të hynte në një fazë të re të zhvillimit demokratik.⁹⁵ Një hap i madh demokratik pasoi në vitin 2007, kur zgjedhjet parlamentare u zhvilluan me lista të hapura, dhe zgjedhësit mund të votonin deri në 10 kandidatë. Parregullsitë që u shfaqën gjatë këtyre zgjedhjeve pjesërisht iu mveshën zgjedhjes së dhjetë kandidatëve në një fletëvotim. Numri i madh i kandidatëve për t'u votuar krijoi konfuzion në mesin e votuesve dhe e rriti numrin e fletëvotimeve të pavlefshme.⁹⁶

Ndryshimet e fundit në sistemin zgjedhor u bënë në vitin 2010. Në përpjekje për t'i zvogëluar parregullsitë gjatë votimit, numri i kandidatëve që mund të votoheshin u zvogëlua nga dhjetë në

⁹⁵ Dugolli, Malazogu "Voting trends and electoral behavior in Kosovo 2000-2004. KIPRED 2006, faqe 5.

⁹⁶ Grup Autoresh, Sistemi zgjedhor dhe partiak në Kosovë – Perspektiva e zhvillimit të demokracisë brendapartiake 2012 http://www.rpp-westernbalkans.net/en/research/Projects-and-Networks-of-Excellence-completed/Governance/Balkan-Electoral-Comparative-Study/mainColumnParagraphs/00/text_files/file2/Kosovo_Nacionalna_studija_ALB.pdf Faqe 48. E qasur: Shkurt 2018.

pesë. Pragë zgjedhor për parti, koalicionë dhe kandidatë të pavarur është 5% e votave të përgjithshme, ndërkohë që për partitë që përfaqësojnë pakicat kombëtare nuk ka prag zgjedhor.⁹⁷

Ligji për Zgjedhjet e Përgjithshme përcakton dispozitat e përgjithshme të sistemit zgjedhor në Kosovë dhe ky e definon tërë vendin si një zonë e vetme zgjedhore, me shumë kandidatë, nga të cilët njëqind deputetë futen në parlament përmes përfaqësimit proporcional me lista të hapura, dhe 20 vende shtesë janë të rezervuara për deputetët e pakicave kombëtare.

Sidoqoftë, gjatë raundeve të ndryshme të zgjedhjeve në Kosovë ka pasur shumë parregullsi dhe probleme. Njëri nga problemet më të shpeshta sa i përket fushatave parazgjedhore të partive politike është ai që partitë në pushtet këtë e shfrytëzojnë për promovimin e tyre gjatë fushatës. Kësisoj, gjatë zgjedhjeve, qeveritë e ndryshme në Kosovë merrnin vendime që targetonin kategori të ndryshme të popullsisë me qëllim të marrjes së votave të tyre për partinë në pushtet. Kjo, jo vetëm që pati implikime të mëdha dhe të dëmshme për buxhetin e shtetit, por edhe e dëmtoi jashtëzakonisht shumë garën e drejtë zgjedhore midis partisë në pushtet dhe subjekteve të tjera politike të Kosovës. Procesi zgjedhor në Kosovë në fillimet e saja është përcjellë në vazhdimësi me parregullsi të shumta e që ishin: vjedhja dhe manipulimi i votave, shkelja e privatësisë së votës, votimi familjar, presion dhe frikësim të vëzhguesve vendor.⁹⁸

Rrjedhimisht, qytetari i Kosovës, e ka humbur bindjen se në Kosovë nuk keqpërdoret vota, kjo u manifestua në zgjedhjet e mëparshme duke manipuluar me vota, për këtë arsye çdo herë e më shumë zvogëlohet numri i qytetarëve që dalin në zgjedhje. Sidoqoftë, mund të themi që në vitet e

⁹⁷ Po aty faqe 48.

⁹⁸ Gazeta elektronike "Telegrafi" <https://telegrafi.com/parregullsite-ne-zgjedhje-demtuan-demokracine-kosove/>. E qasur: Shkurt 2018.

fundit, sidomos në zgjedhjet e vitit 2013, zgjedhjeve të fundit qendrore të vitit 2017 dhe atyre lokale, gjithashtu në vitin 2017, ka pasur përmirësime të jashtëzakonshme sa i përket mënjanimi të shkeljeve dhe parregullsive. Prandaj, në raportet ndërkombëtare në përgjithësi organizmi i zgjedhjeve në Kosovë cilësohet si zgjedhje të lira dhe të ndershme.⁹⁹

III.1.1.5 Pushteti ekzekutiv

Qeveria, sikur edhe shefi i shtetit, është organ i pushtetit ekzekutiv. Qeveria sot paraqet organ shtetëror të pushtetit ekzekutiv, të cilën e përbejnë funksionarët më të lartë shtetëror (ministrat), që gjenden në krye të një resori shtetëror.¹⁰⁰ Ndërsa, ligjet miratohen nga parlamenti, rregullimet janë zakonisht të nevojshme për t'i implementuar ligjet. Ligjet janë relativisht të përgjithshme në paraqitje dhe kanë nevojë për rregulla të tjera, që sigurojnë zbatimin e tyre. Pushteti ekzekutiv ngarkohet me hartimin e këtyre rregullave, sepse ministrat apo agjencitë administrative zakonisht kanë ekspertizën e nevojshme.

Qeveria e Kosovës, ushtron pushtetin ekzekutiv dhe përbëhet nga Kryeministri, zëvendëskryeministri(at), dhe ministrat. Ajo zbaton ligjet e miratuara nga Kuvendi, propozon dhe zbaton politikën e brendshme dhe të jashtme, promovon zhvillimin ekonomik, propozon projektligje në Kuvend, nxjerrë akte juridike të nevojshme për zbatimin e ligjeve, propozon

⁹⁹ Bashkimi Evropian, Misioni për vëzhgimin e zgjedhjeve- Raporti përfundimtar –Zgjedhjet parlamentare në Kosovë 2017. https://eeas.europa.eu/sites/eeas/files/final_report_eom_kosovo_june_2017_albanian.pdf . E qasur: Shkurt 2018.

¹⁰⁰ Arsim Bajrami, “Demokracia Parlamentare”(aspekte krahasuese) botim i katërt Prishtinë 2005, faqe.151-153.

buxhetin, etj.¹⁰¹ Qeveria e Republikës së Kosovës i nënshtrohet kontrollit parlamentar.¹⁰² Për më tepër, mandati i kontrollit parlamentar të Kuvendit të Kosovës nuk kufizohet vetëm në mbikëqyrjen e punës së Qeverisë, por ai përfshinë edhe institucionet tjera publike, të cilat, në bazë të Kushtetutës dhe ligjeve i raportojnë Kuvendit të Kosovës.

III.1.1.6 Roli i pushtetit ekzekutiv në konsolidimin e demokracisë në Kosovë

Thelbi i ndarjes së pushteteve për sferën parlamentare dhe qeveritare nuk qëndron në nivelin e kontrollit ligjor të "ekzekutivit" (që është kryesisht juridiksioni i gjykatave), por në nivelin e kontrollit politik. Për këtë vlen: Vetëm fuqia politike kundërvepruese mund të parandalojë shpërdorimin e pushtetit nga ana e shumicës përkatëse të qeverisë. Si e tillë vetëm opozita vjen në konsideratë që t'i kundërvihet pozitës.¹⁰³ Pra një opozitë mirë e konsoliduar dhe konstruktive ndikon direkt në cilësinë e një pozite, si dhe në zbatimin e politikave të premtuara gjatë fushatave elektorale. Në Republikën e Kosovës, deri më tani nuk ka pasur një opozitë, e cila ka pasur një forcë, që do të luante një rol të rëndësishëm në mbikëqyrjen e qeverisë si dhe të frenonte atë në raste të caktuara, e sidomos kur kemi të bëjmë me interesat vitale të shtetit. Veç kësaj, raportet në mes pozitës dhe opozitës kanë qenë të një dimensioni të rivalitetit të egër dhe aspak civilizues.

¹⁰¹ Kushtetuta e Republikës së Kosovës, <https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=3702>. E qasur: Shkurt 2018.

¹⁰² Kushtetuta e Republikës së Kosovës, Neni 4, pika dhe 1 dhe 4, gjendet në: <http://www.kushtetutakosoves.info/repository/docs/Kushtetuta.e.Republikes.se.Kosoves.pdf>. E qasur: Shkurt 2018.

¹⁰³ Gewaltenteilung zwischen Legislative und Exekutive?, ne: <http://www.bpb.de/apuz/25526/gewaltenteilung-zwischen-legislative-und-exekutive?p=all>, qasur me 10.11.2018.

Kur flitet për rolin e pushtetit ekzekutiv në konsolidimin e demokracisë në Kosovë, janë dy probleme që në vazhdimësi e preokupojnë skenën politike në Kosovë. Problemi i parë lidhet me punën e ekzekutivit dhe dobësitë e legjislativit në mbikëqyrjen e ekzekutivit. Rrjedhimisht, ekziston një nivel shumë i ulët i mbikëqyrjes së qeverisë nga ana e Kuvendit të Kosovës. Siç e kemi përmendur edhe më lartë, anëtarët e qeverisë ende nuk arrijnë të marrin pjesë në seancat plenare parlamentare apo mbledhjet përkatëse të komisioneve parlamentare. Kontrolli dhe mbikëqyrja parlamentare ndaj ekzekutivit, ushtrohet përmes instrumenteve demokratike të mbikëqyrjes. Kjo më së shpeshti bëhet përmes pyetjeve parlamentare, interpelancave, nëpërmjet shqyrtimit të raporteve të qeverive mbi punën e tyre, duke ngritur komisione të posaçme për të organizuar vizita në terren me qëllim kontrollit në praktikë të masave të caktuara të qeverisë, komisioneve hetimore, mocioneve të votëbesimit etj. Sidoqoftë, praktika e deritanishme ka dëshmuar se Kuvendi i Kosovës nuk ka qenë shumë efektiv në ushtrimin e funksionit mbikëqyrës. Një nga problemet ishte edhe koalicionet qeverisëse mjaft të fuqishme që në vazhdimësi kanë zbehur fuqinë dhe mekanizmat e mbikëqyrjes parlamentare ndaj qeverisë nga ana e Kuvendit të Kosovës.¹⁰⁴ Rasti i freskët ishte edhe debati parlamentar për ambientin dhe ndotjen e madhe që po ndodh në kryeqytetin e Prishtinës, ku shumica e anëtarëve të ekzekutivit nuk ishin fare të pranishëm në seancë. Kjo tregon që kur ekzekutivi nuk ka ndonjë interes të caktuar për temën në fjalë, ajo me mosprezencën e saj në debate parlamentare, nënvlerëson temën dhe ndikon tek deputetët që mos të marrin ndonjë iniciativë që bie ndesh me interesat e qeverisë.

¹⁰⁴ NEW MANDATE, NEW OPPORTUNITIES Evaluation of the work of the Assembly of Kosovo and recommendations for further development. Botuar më 2008, faqe, 16.

Edhe vlerësimet ndërkombëtare përmes raporteve të tyre kanë konstatuar se mbikëqyrja e degës ekzekutive nga Kuvendi duhet përforcuar. “Përfaqësuesit e Qeverisë nuk ndjekin seancat plenare në baza të rregullta. Gjithashtu, kërkesat nga Kuvendi për raporte me shkrim nga qeveria nuk plotësohen në masë të mjaftueshme”¹⁰⁵

Kontrolli i dobët parlamentar, nga njëra anë dhe nga ana tjetër tendencat e fuqishme nga ekzekutivi i vendit për ta shndërruar me çdo kusht Kuvendin e Kosovës në legjitimues të vendimeve të saja, ka bërë që Kuvendi i Kosovës edhe pas përfundimit të mbikëqyrjes ndërkombëtare të pavarësisë, të mos arrijë të fuqizohet, bazuar në kompetencat kushtetuese. Ndikimi i qeverisë në punën e Kuvendit ka qenë evident, shkak i numrave të deputeteve të koalicionit të pushtetit. Edhe në rastet kur Kuvendi ka votuar diçka që Qeveria e ka vlerësuar si jo të drejtë, pastaj Qeveria ka ndikuar tek deputetët që ata ta ndryshojnë qëndrimin. Shembull i tillë ishte në seancën e 7 dhjetorit 2011, në të cilën Kuvendi miratoi mocionin e Lëvizjes “Vetëvendosje” lidhur me masat e reciprocitetit me Serbinë¹⁰⁶ dhe vetëm një muaj më vonë, më 20 janar 2012, me kërkesë të grupit parlamentar të PDK-së, miratohet një kundërmocion për të njëjtën çështje.

Prandaj, më shumë ka pasur kontroll të ekzekutivit ndaj legjislativit sesa anasjelltas. Pushteti ekzekutiv në vazhdimësi ka kontrolluar punën e Kuvendit. Nga përfaqësuesit e opozitës dhe

¹⁰⁵ Raporti i Progresit i Komisionit Evropian 2011, gjendet në linkun e më poshtëm:
http://www.eeas.europa.eu/delegations/kosovo/documents/eu_kosovo/20111018_progress_report_sq.pdf. E qasur: Shkurt 2018.

¹⁰⁶ Transkripti nga seanca plenare 07.12.2011, gjendet në:
http://www.assemblykosova.org/common/docs/proc/proc_s_2011_12_07_10_3884_al.pdf. E qasur: Shkurt 2018.

monitoruesit e punës së Kuvendit thuhet se, në vend që Kuvendi ta kontrollonte Qeverinë, në Kosovë po ndodhë e kundërta”.¹⁰⁷

Gjithashtu, hezitimi i ministrave të kabinetit qeveritar për t’iu përgjigjur pyetjeve parlamentare të deputetëve, prania e rrallë e tyre në seanca plenare, mospërgjigja ndaj ftesave të komisioneve parlamentare për të raportuar në mbledhjet e tyre, janë raste të cilat dëshmojnë qartë për pamundësi të ushtrimit të kompetencave kushtetuese të mbikëqyrjes së ekzekutivit nga ana e legjislativit. Kjo paaftësi në procesin e ndarjes së pushteteve ka treguar dhe po tregon që pushteti ekzekutiv në Kosovë nuk kontrollohet në masën e duhur nga Kuvendi i Kosovës ku si pasojë, pushteti ekzekutiv merr fuqinë e pushtetit edhe sa i përket kontrollit të punës së gjyqësorit e që është problemi i dytë që trajtohet në këtë nën-kapitull.

Pra, pushteti ekzekutiv në Kosovë vazhdimisht kritikohet për ndërhyrjen e vazhdueshme ndaj pushtetit gjyqësor. Qeveria e Republikës së Kosovës në vazhdimësi cenon punën e gjyqësorit në Kosovë.

Reformat në gjyqësor ende kanë mbetur peng i politikës. Si pasojë e kësaj, sistemi gjyqësor vazhdon të përballet me numrin e vogël të gjyqtareve, çka edhe shkakton mosefikasitet në punë dhe grumbullim të lëndëve, të cilat nuk po zgjidhen. Pushteti ekzekutiv dhe legjislativ asnjëherë nuk ka pasur vullnet të krijoj kushte për punë të pavarur të gjyqësorit. Ekzekutivi, pushtetin gjyqësor me qellim e ka lënë në gjendje të keqe, në mënyrë që të mbetet i varur nga politika.

¹⁰⁷ Gazeta elektronike “Telegrafi” <https://telegrafi.com/qeveria-kontrollon-kuvendin/>. E qasur: Shkurt 2018.

Si përfundim mund të themi që pushteti ekzekutiv në Kosovë është më i fuqishëm sesa parashihet të jetë në një shtet normal demokratik. Për më tepër, ky pushtet përveç që ka mbikëqyrje të kufizuar nga legjislativi, ai përkundrazi e kontrollon punën e tij dhe gjithashtu ndikon punën e pavarur të gjyqësorit, për të cilin më gjerësisht do të flitet në kapitullin në vijim.

III.2 (Mos) Besimi i qytetarëve në Institucionet shtetërore të Republikës së Kosovës

Besimi i qytetarëve në institucionet shtetërore është një ndër shtyllat kryesore të demokracisë sepse “çdo demokraci nga ajo se qytetarët një minimum besojnë në institucionet shtetërore. Në një demokraci përfaqësuese një ditë bëhet problem nëse votuesit në parim hasin në mosbesim.”¹⁰⁸ Mos besimi e vë po ashtu në pikëpyetje ekzistencën e funksionimit të një sistemi institucional (...) ai “ në teorinë bashkëkohore politike shihet si një kërkesë qendrore e demokracisë. Kështu e koncepton, **teoria e sistemit**, sipas David Easton, besimin si një dimension të mbështetjes së përhapur, duke e bërë atë një përcaktues të rëndësishëm të qëndrueshmërisë së sistemeve politike.”¹⁰⁹

Shkaktari kryesor që rrënon besimin në mes votueseve/qytetarëve është mos funksionalizimi i tri pushteteve të pavarura (Kuvendi, Ekzekutive dhe Gjyqësori). Influenca në vazhdimësi e çfarëdo lloj natyre nëpër këto shtylla, e cila e ka pasur për qellim pengimin e punës së tyre në përputhje me mandatin kushtetues godet çdo sferë të politikave (ekonomike sociale) të një shoqërie. Rënia graduale e besimit në institucionet dhe shtetin e Kosovës ka filluar pas shpalljes së pavarësisë, sepse

¹⁰⁸ Laurenz Ennser: Das Vertrauen in politische Institutionen ist gesunken, in: <https://derstandard.at/2000042333910/Das-Vertrauen-in-die-politischen-Institutionen-ist-stark-gesunken>. E qasur: Nëntor 2018.

¹⁰⁹ Gary S. Schaal: Vertrauen, Verfassung und Demokratie, fq. 17.

mënyra e të funksionuarit të këtyre institucioneve deri me tani nuk ka qenë në favor të politikave dhe nevojave të qytetarit të Kosovës. Besimi i qytetarëve në përfaqësuesit e tyre ka qenë prej kohësh në rënie dhe votuesi vështirë se e ka njohur apo njeh kandidatin e tij dhe bindjet e tij. Mosbesimit në institucione i ka paraprirë edhe votimi gjatë mbajtjes së zgjedhjeve jo sipas arsyeshmërisë, por sipas regjioneve, rretheve familjare dhe inercionit të emocioneve. Kjo mënyrë e votimit akoma vazhdon të jetë prezente në Kosovë, gjë që ka ndikuar dhe vazhdon të ndikojë në konsolidimin e institucioneve.

Si rezultat i kësaj, qytetaret e Kosovës nuk e shohin me vendin e tyre mundësi prandaj synimin e kanë që të ikin (jashtë vendit). Ky synim i qytetareve është dëshmuar në muajt e fundit të vitit 2014 dhe fillimvitit 2015, ku shteti i Kosovës në këtë periudhë kohore do të përballej me një fenomen të veçantë në historinë më të re të funksionimit si shtet i pavarur dhe sovran, atë të ikjes masive të qytetarëve të saj drejt vendeve të Bashkimit Evropian për të kërkuar një jetë më të mirë.¹¹⁰ Për arsye socio-ekonomike, pra në kërkim të një jete më të dinjitetshme, në mënyrë ilegale, Kosovën e kishin lëshuar rreth 75,000 qytetarë të saj, shumica nga ta shtruan kërkesë për azil në shtetet perëndimore. Kjo ikje masive i zuri në befasi institucionet e shtetit të Kosovës, por edhe vendet nikoqire të këtij fluksi kaq të madh, duke shkaktuar një problematikë të re dhe serioze edhe në procesin e përmbushjes së kriterëve për liberalizimin e vizave për Kosovën, meqë nga kjo kohë do të shtohet edhe kriteri i uljes së migrimit ilegal të qytetarëve në shtetet e zonës Shengen, si kriter shtesë për liberalizimin e vizave për Kosovën.

¹¹⁰ Organizata jo-qeveritare “Iniciative për Veprime Sociale “Studimi mbi migrimet e Kosovarëve gjatë 2014-2015”; për më shumë: <http://04online.info/wp-content/uploads/2015/03/Studim-mbi-Migrimet-2014-15.pdf>. E qasur: prill 2015.

Përtej saj, analizim i mirëfilltë i arsyes së ikjes masive nxori se përveç arsyes apo shkaqeve ekonomike, arsyeja e dytë e braktisjes së vendit të tyre ishte edhe zhgënjimi apo mosbesimi në institucione të Republikës së Kosovës.¹¹¹

Tabela në vazhdim pasqyron të gjitha edhe arsyet tjera që quan në braktisje të vendit nga shumë qytetarë të Kosovës në vitet 2014-2015.




Figura 1. Arsyet se përse kosovarët emigrojnë drejt vendeve të BE-së.¹¹²

¹¹¹ Po aty. E qasur: Prill 2015.

¹¹² Po aty. E qasur: Prill 2015.

Njëri ndër institucionet shtetërore me kredibilitetin më të ulët apo besueshmërinë më të ulët tek qytetarët e Kosovës, pa dyshim mbetet sistemi i drejtësisë. Sipas Indeksit të Performancës së Institucioneve të Sundimit të Ligjit në Kosovë për vitin 2018 del se 72.4% e të anketuarve për zgjedhin gjykatat si institucionet më të prekura nga ndikimi politik.¹¹³ Duke u nisur nga ky fakt, në këtë studim një kapitull i tërë do t'i kushtohet funksionimit të sistemit të drejtësisë në Kosovë dhe ndikimit të tij në konsolidimin e demokracisë në Kosovë.

KAPITULLI IV - Efikasiteti i sistemit Gjyqësor në Kosovë dhe roli i tij në konsolidimin e demokracisë në Kosovë

Duke marrë për bazë se funksionimi i sistemit gjyqësor në mënyrë profesionale dhe të pavarur luan një rol tejet të rëndësishëm në konsolidimin e Demokracisë, në këtë kapitull do të trajtohet në detaje sistemi gjyqësor në Kosovë, duke filluar nga historiku i gjyqësorit në Kosovë, ngritja e sistemit gjyqësor nga viti 1999 deri me shpalljen e pavarësisë në vitin 2008 si dhe funksionimi i tij pas shpalljes së pavarësisë së Kosovës e deri me tani, me theks të veçantë efikasiteti i gjykatave dhe prokurorive në përmbushjen e misionit të tyre.

IV.1.1 Sistemi gjyqësor në Kosovë

Pushteti gjyqësor konsiderohet si pushteti i tretë shtetëror i cili ushtrohet nga gjykatat. Ndarja e pushteteve përcaktohet edhe përmes Kushtetutës së Republikës së Kosovës. Ndërsa, struktura organizative, kompetencat dhe funksionimi i gjykatave rregullohen më ligje të posaçme.

¹¹³ Indeksi i Performancës së Institucioneve të Sundimit të Ligjit në Kosovë BOTIMI I KATËRT.
Raport nga Grupi për Studime Juridike dhe Politike. Për më shumë:
<http://www.legalpoliticalstudies.org/wp-content/uploads/2018/10/rolpik4-web.pdf> . E qasur:
Tetor 2018.

Me kushtetutë, pra, përcaktohen parimet bazë të funksionimit të gjyqësorit në tërësi, të cilat sigurojnë pavarësinë e gjyqësorit¹¹⁴. Kësisoj, ndër parimet më të rëndësishme është së pari pavarësia e gjykatave, që nënkupton pavarësinë e gjyqësisë nga legjislativi dhe ekzekutivi. Një parim tjetër është “depolitizimi” i gjykatave, që nënkupton që gjykatësit nuk do të ushtrojnë ndonjë funksion tjetër publik, duke siguruar kështu pavarësi në ushtrimin e funksionit të tij. Zgjedhja e gjyqtarëve me afate të gjata është një nga parimet tjera me rëndësi, që nënkupton se gjyqtarët zgjidhen për periudha më të gjata kohore, duke marrë garanci se do të jenë të pavarur nga ndryshimet politike. Pastaj, financimi i pavarur paraqet një garanci të funksionit të gjyqësisë së pavarur dhe parimet tjera.

Duke pasur parasysh vlerësimet e shumta që janë dhënë efikasitetit të sistemit gjyqësor në Kosovë para vitit 2008, edhe në ditët e sotme konsiderohet që gjyqësori del të jetë njëra ndër fushat me defektet më të mëdha dhe që ndikon direkt edhe në përparimet në fushat tjera.¹¹⁵ Sistemi gjyqësor në Kosovë shumicën e parimeve të lartpërmendura nuk i ka të pavarura prandaj në këtë kapitull do të trajtohet sistemi gjyqësor në Kosovë, me theks të veçantë efikasiteti i tij në trajtimin e lëndëve kundër korrupsionit.

IV.1.2 Historiku i gjyqësorit në Kosovë

Zhvillimet historike në lidhje me Kosovën dhe përreth saj, në etapa të ndryshme kohore, i kanë imponuar edhe specifikat e organizimit të pushteteve në Kosovë, varësisht nga karakteristikat e

¹¹⁴ Arsim Bajrami. Draftimi i Kushtetutës. Manual për hartuesit e Kushtetutës dhe ligjeve. Prishtinë 200, f. 197.

¹¹⁵ Raporti i progresit të Komisionit Evropian; BTI-së; Freedom House.

autoriteteve që kanë sunduar territorin e Kosovës gjatë historisë.¹¹⁶ Megjithatë, nga koha e organizimit politiko-ushtarak të Lidhjes së Prizrenit (1878) e gjerë në përfundimin e Luftës së Dytë Botërore, në Kosovë nuk mund të flitet për ndonjë organizim të sistemit gjyqësor në nivel të institucioneve vendore. Në veçanti, populli shqiptar, edhe pse nën sundimin e të huajve, sidomos në krahinat malore ku nuk mund të shtrihej pushteti i administratorëve të huaj (pushtuesve), marrëdhëniet politiko-shoqërore, pronësore, penale etj, i rregullonte përmes aplikimit të së drejtës zakonore, dhe kontestet gjyqësore i ka zgjidhur nëpërmjet pleqësive. Në mungesë të pushtetit qendror, pleqësia ishte organ gjyqësor, i cili merrej me gjykimin e çështjeve penale, civile, dhe çështjeve tjera.

IV.1.3 Gjyqësori në Kosovë nga vitit 1945 deri në Kushtetutën e vitit 1974

Fillet e gjyqësisë në Kosovë pas Luftës së Dytë Botërore paraqiten në korrikun e vitit 1945, kur zgjedhet organi më i lartë gjyqësor i Krahinës së Kosovës me emrin Gjykata Popullore e Krahinës. Për shkak të zhvillimeve politike të kohës, vetëm pas një muaji, me vendim të Kuvendit të Serbisë kjo gjykatë do ta humbë karakterin e gjykatës së instancës më të lartë në krahinë, duke u shndërruar në gjykatë me kompetenca të gjykatës së qarkut, derisa funksionin e instancës më të lartë gjyqësore të Krahinës e ka kryer Gjykata Supreme e Serbisë. Kjo e sanksionuar me Ligjin mbi Rregullimin e Gjykatave Popullore, që u nxor nga Kuvendi i Përkohshëm Popullor i Jugosllavisë me 25 gusht të vitit 1945.

¹¹⁶ Gjykata supreme; historiku i sistemit gjyqësor në Kosovë; për më shumë:
<http://www.gjyqesori-rks.org/sq/courts/page/index/56>. E qasur: Shtator 2016.

Me ndryshimet në Kushtetutën e vitit 1963, në Republikën Socialiste Federative të Jugosllavisë (RSFJ) fillon të aplikohet sistemi unik gjyqësor, që në përbërje kishte: gjykatat e kompetencës së përgjithshme, që në atë kohë ishin Gjykatat Komunale, Gjykatat e Qarkut, Gjykatat Supreme të Republikave, Gjykata Supreme Federative dhe Gjykatat e Specializuara. Ky koncept i ndërtimit të gjyqësorit ka imponuar nevojën që në Krahinat Autonome të formohen degët e Gjykatës Supreme të Serbisë, që u aplikua edhe në Krahinën e Kosovës. Gjatë kësaj periudhe, gjyqtarët e degëve gjyqësore kanë qenë të zgjedhur dhe shkarkuar nga Kuvendi i Krahinës, (ku kanë funksionuar 17 Gjykata Komunale dhe 3 Gjykata të Qarkut), përveç degës së Gjykatës Supreme të Serbisë në Krahinën Autonome të Kosovës.

Më vonë, me ndryshimet kushtetuese që pasuan nga viti 1968 deri 1972, Krahinat Autonome në lëmin e gjyqësisë gati njëjtësohen me Republikat. Gjatë kësaj periudhe Kosova nxjerr Ligjin Kushtetues (24 shkurt 1969), i cili rregullon pozitën e Gjykatës Supreme të Kosovës si gjykatë me të drejta dhe detyra të njëjta me ato të Republikave, e cila ushtron funksionin në mënyrë ligjore në tërë territorin e Kosovës. E më pas, me ndryshimet kushtetuese të vitit 1971, përkatësisht në amendamentin 2 për Ligjin Kushtetues të KSAK, Krahina i rregullon me ligjet e veta edhe gjykatat, arbitrazhin, Këshillat e Pajtimit, Prokurorinë Publike, Avokaturën Publike etj.

Në vitin 1972 formohet Gjykata Kushtetuese e Kosovës si dhe Gjykata e Lartë Ekonomike me seli në Prishtinë, dhe përfundimisht konkretizohet me avancimin e pozitës me ndryshimet kushtetuese të vitit 1974 në rang të përafërt me njësitë tjera federale, duke iu mundësuar që të ushtrojnë pushtetin legjislativ, ekzekutiv dhe gjyqësor. Funksioni gjyqësor, sipas Kushtetutës së vitit 1974 ushtrohej nga gjykatat e rregullta dhe gjykatat vetëqeverisëse. Gjykatat e rregullta përbëheshin nga gjykatat

komunale dhe gjykatat e qarkut, kurse si gjykatë e rregullt e instancës më të lartë paraqitet Gjykata Supreme e Kosovës, në të cilën janë zgjidhur në mënyrë meritore çështjet e ndryshme civile, penale, ekonomike dhe administrative. Themelimi, kompetenca, përbërja dhe organizimi i gjykatave të rregullta në Kosovë u rregullua me Ligjin mbi Gjykatat e Rregullta të Kosovës të vitit 1978.

IV.1.4 Rrënimi i sistemit gjyqësor në Kosovë gjatë viteve të 90-ta

Fillimi i sulmeve ndaj pozitës Kushtetuese të Kosovës nga ana e Republikës së Serbisë, që pasoi pas ngjarjeve të vitit 1981, arriti kulminacionin me amendamentet që u përgatitën në Kushtetutën e Serbisë në vitin 1989. Këto amendamente shkaktuan rrënimin e plotë të Autonomisë së Kosovës, pezulluan pushtetin e autoriteteve legjitime në Kosovë, u bë ndërprerja e punës së Kuvendit, Këshillit Ekzekutiv të Kosovës, u morën kompetencat organeve gjyqësore dhe të sigurisë së pushtetit të Kosovës, të cilat u transferuan në Republikën e Serbisë. Me këto veprime, pasoi edhe marrja e kompetencave të administratës së judikaturës. Kështu, me vendimin e Kuvendit të Serbisë bëhet shkarkimi i gjyqtarëve shqiptarë, të cilët zëvendësohen me gjyqtarë serbë dhe në të njejtën kohë bëhet ndërprerja e organizimit të provimit të judikaturës, duke pamundësuar kuadro të reja që t'i nënshtrohen provimit të judikaturës dhe profesionalizmit në këtë fushë.

IV.1.5 Ngritja e sistemit gjyqësor nga viti 1999 deri me shpalljen e pavarësisë në vitin 2008

Gjendja e menjëhershme e pasluftës në Kosovë, në fushën e gjyqësorit, rezultoi me një shkatërrim të gjerë në ndërtimin dhe funksionimin e institucioneve, në infrastrukturë, teknologji dhe kuadro të kualifikuara, me shumë lëndë të pazgjidhura ndër vite, shkatërrim të dosjeve gjyqësore dhe dokumentacionit të rëndësishëm, problemet e sigurisë në rritje dhe me një gjyqësor ende jofunksional.

Kështu, me fillimin e instalimit të administratës së Kombeve të Bashkuara në Kosovë (UNMIK), si një çështje me prioritet u ndërmorën hapat fillestar për rindërtim të një sistemi gjyqësor multi-etnik, të bazuar në parimet demokratike. Si hap të parë, UNMIK lëshoi tri dekrete emergjente: një për themelimin e Këshillit të Përbashkët Konsultativ mbi Emërimet e Përkohshme Gjyqësore, një për anëtarët e saj dhe e treta për emërimin e katër prokurorëve, dy gjyqtarëve hetues dhe një panel prej tre gjyqtarësh. Ky sistem u njoh si "Sistemi emergjent gjyqësor" i iniciuar më 30 qershor 1999 me hapjen e Gjykatës së Qarkut në Prishtinë, e ndjekur nga hapja e gjykatave në Prizren, Pejë, Gjiilan dhe Mitrovicë dhe e mbështetur nga gjykatat mobile, me 36 gjyqtar, e cila deri në fund të vitit 1999 sistemi emergjent i drejtësisë arriti të emëronte 301 gjyqtarë.

Në mars 2000, UNMIK themeloi Departamentin Administrativ të Drejtësisë, përgjegjës për menaxhimin e përgjithshëm të çështjeve që kishin të bëjnë me sistemin gjyqësor. Në prill të vitit 2001, gjithnjë duke shkuar në avancim të strukturave udhëheqëse gjyqësore, UNMIK-u themeloi Këshillin Gjyqësor dhe Prokurorial të Kosovës (KGJPK), i cili zëvendësoi Komisionin Këshillues Gjyqësor që kishte pushuar së funksionuari në Dhjetor të vitit 2000. KGJPK-ja kishte për detyrë të bënte thirrje për aplikime nga ana e profesionistëve të drejtësisë për të shërbyer në postet e

gjyqtarëve, prokurorëve dhe gjyqtarëve porotë; shqyrtonte aplikacionet e tyre dhe jepte rekomandime për emërimin e tyre tek administrata e OKB-së në Kosovë.

Në maj të vitit 2001, UNMIK-u, përmes autorizimeve të Përfaqësuesit Special të Sekretarit të Përgjithshëm (PSSP), nxori Kornizën Kushtetuese për Vetëqeverisje të Përkohshme në Kosovë (Korniza Kushtetuese), e cila parashihte krijimin e institucioneve të përkohshme Vetëqeverisëse (IPVQ) që përbëheshin nga Kuvendi i Kosovës, Presidenti i Kosovës, Qeveria, Gjykatat dhe organet tjera dhe institucionet e përcaktuara në kuadër të saj. Korniza Kushtetuese përcaktoi që sistemi gjyqësor të jetë i përbërë nga Gjykata Supreme, Gjykatat e Qarkut, Gjykatat Komunale dhe Gjykatat për Kundërvajtje. Si rezultat i këtyre zhvillimeve, deri në fund të vitit 2003, në gjykatat e Kosovës ishin të emëruar dhe punonin gjithsej 316 gjyqtarë, përfshirë këtu edhe 14 gjyqtarë ndërkombëtarë, përfshirja e të cilëve u rregullua me Rregulloren e PSSP-së nr. 2000/6.

Në Dhjetor të vitit 2005, administrata e UNMIK-ut themeloi Këshillin Gjyqësor të Kosovës (KGjK) duke operuar nën autoritetin e PSSP-së dhe duke trashëguar Këshillin Gjyqësor dhe Prokurorial të Kosovës. KGjK përbëhej nga 11 anëtarë, prej të cilëve 7 ishin gjyqtarë (duke përfshirë 2 gjyqtarë ndërkombëtarë). Gjyqtarët përfshinin Kryetarin e Gjykatës Supreme, që njëkohësisht ushtronte detyrën e Kryetarit të KGJK-së, 2 gjyqtarë nga Gjykata Supreme dhe 4 gjyqtarë tjerë që përfaqësonin gjykatat tjera.

IV.1.6 Sistemi gjyqësor pas shpalljes së pavarësisë së Kosovës. Organizimi i sistemit gjyqësor në Kosovë sipas Kushtetutës së Republikës së Kosovës

Pas shpalljes së pavarësisë së Kosovës në shkurt të vitit 2008, dhe me miratimin e Kushtetutës së Kosovës, organizimit të sistemit të drejtësisë i kushtohet një kapitull i veçantë (VII) ku nga neni

102-108 janë të sanksionuara parimet e përgjithshme të sistemit gjyqësor, organizimi, juridiksioni, përfshirë këtu Këshillin Gjyqësor të Kosovës si organ përgjegjës, i cili siguron pavarësinë dhe paaësinë e sistemit gjyqësor, derisa rregullimin strukturor të gjykatave e ka lënë të vendoset me Ligj të veçantë.¹¹⁷

Si rrjedhojë, në korrik të vitit 2010 aprovohet Ligji për Gjykata Nr. 03/L-199, i cili përcakton sistemin e gjykatave të Republikës së Kosovës të përbërë nga: Gjykatat Themelore, Gjykata e Apelit dhe Gjykata Supreme. Pjesë e sistemit gjyqësor të Republikës së Kosovës janë edhe Gjyqtarët e EULEX-it, funksioni dhe kompetenca e të cilëve është e përcaktuar sipas Ligjit Nr.03/L-053. Fillimi i zbatimit të Ligjit për Gjykatat, që nis me operacionalizimin e plotë në janar të vitit 2013, paraqet fillimin e një periudhe të re në procesin e reformimit dhe strukturimit të gjyqësorit të Kosovës, në një sistem më bashkëkohorë dhe më efikas në ndarjen e shërbimeve për qytetarë të Kosovës.

IV.1.7 Këshilli Gjyqësor dhe Gjykatat në Republikën e Kosovës

Organizimin dhe funksionimin e Këshillit Gjyqësor të Kosovës e rregullon Ligji për Këshillin Gjyqësor të Kosovës.¹¹⁸ Këshilli është plotësisht i pavarur në kryerjen e funksioneve të veta me qëllim të sigurimit të një sistemi të drejtësisë së pavarur, të drejtë, apolitik, të çashtë, profesional dhe të paanshtë, i cili pasqyron natyrën shumë etnike të Republikës së Kosovës dhe zbaton

¹¹⁷ Kushtetuta e Republikës së Kosovës: <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=3702>. E qasur: Shkurt 2018.

¹¹⁸ Ligji për Këshillin Gjyqësor të Kosovës. Për më shumë: <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2713>. E qasur: Tetor 2016.

Kushtetutën si dhe parimet e pranuar ndërkombëtarisht për të drejtat e njeriut dhe barazinë gjinore. Këtë pavarësi e siguron neni 3 i kreut të dytë të këtij ligji. Aty ku janë përcaktuar Kompetencat, përgjegjësitë dhe përbërja e Këshillit.¹¹⁹ Këshilli ka rolin fundamental për sigurimin e pavarësisë dhe paanësisë së sistemit gjyqësor. Në këtë kuadër, funksionet e Këshillit përfshijnë procedurat për rekrutim, emërim, riemërim, transferim, disiplinë, vlerësim, ngritje në detyrë dhe trajnim të gjyqtarëve dhe gjyqtarëve porotë; në menaxhim dhe administrim të gjykatave, si dhe në zhvillimin dhe mbikëqyrjen e buxhetit të gjyqësorit. Duke u bazuar në Kushtetutë, mandati i anëtarëve të Këshillit është mandat pesë vjeçar (5). Këshilli sipas Kushtetutës i ka gjithsej 13 anëtarë: tetë (8) anëtarë zgjedhën nga Kuvendi i Republikës së Kosovës, ndërsa pesë (5) anëtarë zgjedhën drejtpërdrejt nga gjyqësori.¹²⁰ Këshilli punën e vet e organizon edhe përmes Komisioneve të përhershme apo të përkohshme. Në kuadër të Këshillit është Sekretariati që ndihmon Këshillin në zbatimin e rregullave dhe politikave të Këshillit lidhur me menaxhimin, buxhetin dhe administrimin e gjykatave. Në kuadër të Këshillit veprojnë edhe Njësia për Shqyrtimin e Performancës Gjyqësore (NjShPGj) dhe Zyra e Prokurorit Disiplinor (ZPD).

IV.1.8 Gjykatat e Kosovës

Organizimin, funksionimin dhe juridiksionin e gjykatave në Republikën e Kosovës e rregullon Ligji mbi Gjykatat.¹²¹ Sistemi i gjykatave i Republikës së Kosovës përbëhet nga: Gjykatat Themelore,

¹¹⁹ Po aty. Faqe 2.

¹²⁰ Po aty. Faqe 3 dhe 4.

¹²¹ Ligji për Gjykatat. Për më shumë: <http://www.kuvendikosoves.org/common/docs/ligjet/2010-199-alb.pdf> E qasur: Tetor 2016.

Gjykata e Apelit dhe Gjykata Supreme.¹²² Gjykatat Themelore janë gjykata të shkallës së parë në territorin e Republikës së Kosovës. Me ligjin mbi Gjykatat janë themeluar 7 Gjykata Themelore. Gjykata Themelore e Prishtinës me seli në Prishtinë themelohet për territorin e Komunës së Prishtinës, Fushë Kosovës, Obiliqit, Lipjanit, Podujevës, Gllogovcit dhe të Graçanicës. Gjykata Themelore e Gjilanit me seli në Gjilan themelohet për territorin e Komunës së Gjilanit, Kamenicës, Novobërdës, Ranillugut, Parteshit, Vitisë, Klllokotit dhe Vërbocit. Gjykata Themelore e Prizrenit me seli në Prizren themelohet për territorin e Komunës së Prizrenit, Dragashit, Suharekës dhe Mamushës. Gjykata Themelore në Gjakovë me seli në Gjakovë themelohet për territorin e Komunës së Gjakovës, Malishevës, dhe Rahovecit. Gjykata Themelore e Pejës me seli në Pejë themelohet për territorin e Komunës së Pejës, Deçanit, Junikut, Istogut dhe Klinës. Gjykata Themelore e Ferizajit me seli në Ferizaj themelohet për territorin e Komunës së Ferizajit, Kaçanikut, Shtimes, Shtërpçës dhe Hanit të Elezit. Gjykata Themelore e Mitrovicës me seli në Mitrovicë themelohet për territorin e Komunës së Mitrovicës Jug dhe Mitrovicës Veri, Leposaviqit, Zubin Potokut, Zveçanit, Skenderajit dhe Vushtrrisë.

¹²² Po aty. Faqe 4.




Tabela. 21. Organogrami i Gjykatave në Kosovë.¹²³

IV.1.9 Këshilli Prokurorial dhe Prokuroritë në Republikën e Kosovës

Organizimin dhe kompetencat e Këshillit Prokurorial të Kosovës janë të rregulluara me Ligjin për Këshillin Prokurorial të Kosovës,¹²⁴ përderisa organizimin dhe kompetencat e Prokurorive në Republikën e Kosovës e rregullon Ligji për Prokurorin e Shtetit.¹²⁵

¹²³ Raporti statistikor i Gjykatave 2016. Për më shumë: <http://www.gjyqesori-rks.org/sq/kjc/report/list/1>. E qasur: Janar 2017.

¹²⁴ Ligji për Këshillin Prokurorial. Për më shumë: <http://www.kuvendikosoves.org/common/docs/ligjet/2010-224-alb.pdf>. E qasur: Tetor 2016.

¹²⁵ Ligji për Prokurorin e Shtetit. Për më shumë: <http://www.kuvendikosoves.org/common/docs/ligjet/2010-225-alb.pdf>. E qasur: Tetor 2016.

Këshilli Prokurorial i Kosovës është institucion plotësisht i pavarur në kryerjen e funksioneve të tij, në pajtim me ligjin. Këshilli Prokurorial i Kosovës siguron çasje të barabartë në drejtësi për të gjithë personat në Kosovë. Këshilli Prokurorial i Kosovës siguron që Prokurori i Shtetit të jetë i pavarur, profesional, i paanshëm dhe pasqyron natyrën shumetnike të Kosovës dhe parimet e barazisë gjinore. Këshilli Prokurorial i Kosovës do të rekrutojë, propozojë, avancojë, transferojë, disiplinojë prokurorët në mënyrën e rregulluar me ligj. Këshilli do t'i japë përparësi emërimit për prokurorë të anëtarëve të komuniteteve të nënpërfaqësuar në mënyrën e përcaktuar me ligj. Të gjithë kandidatët duhet t'i plotësojnë kriteret e përcaktuara me ligj. Përbërja e Këshillit Prokurorial të Kosovës, si dhe dispozitat për emërimin, shkarkimin, mandatin, strukturën organizative dhe rregullat e procedurës, rregullohen me ligj.

IV.1.10 Prokurori i Shtetit

Prokurori i Shtetit është institucion i pavarur, me autoritet dhe me përgjegjësi për ndjekjen penale të personave të akuzuar për ndonjë vepër penale ose për ndonjë vepër tjetër, sikurse është rregulluar me ligj. Prokurori i Shtetit është institucion i paanshëm, dhe vepron në bazë të Kushtetutës dhe të ligjit. Organizimi, kompetencat dhe detyrat e Prokurorit të Shtetit rregullohen me ligj. Prokurori i Shtetit pasqyron përbërjen shumetnike të Republikës së Kosovës dhe respekton parimet e barazisë gjinore. Mandati fillestar për prokuror është trevjeçar. Në rast të riemërimit, mandati është i përhershëm deri në moshën e pensionimit, sikurse është përcaktuar me ligj, përveç nëse shkarkohet në pajtim me ligjin.

Struktura organizative e Prokurorit të Shtetit është e organizuar në këtë mënyrë: Zyra e Kryeprokurorit të Shtetit si instanca më e lartë e Prokurorit të Shtetit, me kompetencë në tërë territorin e Republikës së Kosovës. Prokuroria e Apelit si shkallë e dytë me kompetencë në tërë territorin e Republikës së Kosovës dhe e cila përbëhet nga Departamenti i Përgjithshëm dhe Departamenti për Krime të Rënda. Prokuroria Speciale e Republikës së Kosovës si organ prokurorial i specializuar, me juridiksion në tërë territorin e Republikës së Kosovës. Shtatë Prokuroritë Themelore të përbëra nga Departamentet e Përgjithshme, nga Departamentet për të Mitur dhe nga Departamentet për Krime të Rënda.

IV.1.11 Zyra e Kryeprokurorit të Shtetit

Zyra e Kryeprokurorit të Shtetit udhëhiqet nga Kryeprokurori i Shtetit, i cili emërohet nga Presidenti i Republikës së Kosovës, pas propozimit të Këshilli Prokurorial të Kosovës.¹²⁶ Në kuadër të Zyrës së Kryeprokurorit të Shtetit përveç Kryeprokurorit të Shtetit, vepron edhe Zëvendës-Kryeprokurori i Shtetit dhe pesë (5) prokurorë që merren me lëndët e shkallës së trete.

IV.1.12 Efikasiteti i organeve të drejtësisë në Kosovë në luftën kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar.

¹²⁶ Ueb faqja e Këshillit Prokurorial të Kosovës, për më shumë: <http://kpk-rks.org/prokurorit/87/prokurori-i-shtetit/87>. E qasur: Gusht 2016.

Sa i përket luftës kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar, në vazhdim do të sjellim të dhëna vetëm në këtë fushë duke pasur parasysh që luftimi i korrupsionit dhe krimit të organizuar në Kosovë vazhdon të mbetet njëra ndër sfidat kryesore në rrugën e gjatë të konsolidimit të demokracisë në Kosovë.

Mosefikasiteti i institucioneve gjegjëse për luftimin e këtyre dukurive negative po ndikon direkt edhe në qëndrueshmërinë dhe zhvillimin më të hovshëm të sferave tjera të shtetit, si ekonomia dhe mirëqenia sociale. Kjo për faktin se zyrtarë të caktuar duke qenë të paprekshëm nga ligji, vazhdojnë të abuzojnë me pozitat zyrtare në institucione të ndryshme.

IV.1.13 Efikasiteti i Gjykatave në Kosovë

Përveç numrit të madh të lëndëve të pazgjidhura ndër vite, gjyqësorin në Kosovë e karakterizojnë edhe joprofesionalizmi, politizimi, mungesa e transparencës dhe parashkrimi i lëndëve.

Nëse i referohemi raporteve vjetore 2015 dhe 2016 të gjyqësorit në Kosovë, shohim se edhe gjatë kësaj periudhe ka pasur një efikasitet jo të kënaqshëm të trajtimit të lëndëve¹²⁷, sado që lufta kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar është edhe njëri ndër kriteret kryesore të liberalizimit të vizave.¹²⁸

¹²⁷ Raporti statistikor i Gjykatave 2016. Për më shumë: <http://www.gjyqesori-rks.org/sq/kjc/report/list/1>. E qasur: Janar 2017.

¹²⁸ Kriteret për liberalizimin e vizave. Për më shumë: <https://mapl.rks-gov.net/getattachment/f07e2b7f-7607-4bf2-9b16-25297ac8a310/Udhezues-per-Liberalizimin-e-Vizave.aspx>. E qasur: Janar 2017.

Raporti statistikor për punën e gjykatave për vitin 2016 i publikuar në web-faqen e Këshillit Gjyqësor të Kosovës¹²⁹, pasqyron punën e gjykatave veç e veç për secilën gjykatë, degë dhe për secilin nivel të gjykatës, duke përfshirë Gjykatën Supreme, Dhomat e Veçanta të Gjykatës Supreme, Gjykatën e Apelit dhe 7 Gjykatat Themelore, mirëpo duke lënë jashtë raportit të dhënat për Gjykatën Themelore në Mitrovicë, degët në Leposaviq dhe Zubin Potok për shkak të mosfunksionimit të tyre.

Nëse analizohet gjendja kadrovike, si njëra ndër sfidat që po e përcjellin mosefikasitetin e gjykatave, del që në Gjykatën Supreme 14 gjyqtarë kanë zgjedhur lëndë gjatë vitit 2016 me 17 shërbyes civil si staf mbështetës. Në Dhomën e Posaçme lëndë kanë zgjedhur 13 gjyqtarë me 24 shërbyes civil si staf mbështetës. Në Gjykatën e Apelit 34 gjyqtarë dhe 67 shërbyes civil si staf mbështetës dhe në Gjykatat Themelore 261 gjyqtarë dhe 1333 shërbyes civil si staf mbështetës. Në total i bie që në Gjykatat e lartshënuara lëndë kanë zgjidhur 322 gjyqtarë, të mbështetur nga 1441 shërbyes civil si staf mbështetës.

Në anën tjetër, tek gjendja e lëndëve shohim që ka pasur një numër të konsiderueshëm të lëndëve të trashëguara si të pazgjidhura.

Bazuar në të dhënat e raportit statistikor të Gjykatave për vitin 2016, del që sfiduese mbetet ende çështja e ngarkesës së gjyqtarëve me lëndë. Në raport paraqitet fakti se një gjyqtar në Gjykatën Supreme ka qenë i ngarkuar me lëndë të reja 6,9 për një muaj, përderisa efektshmëria e tij/saj ka qenë 89% ose 6,1 lëndë të zgjidhura. Performancë të mirë në raport paraqitet për gjyqtarët e

¹²⁹ Këshilli Gjyqësor i Kosovës, për më shumë: <http://www.gjyqesori-rks.org/sq/kjc/report/list/1>. E qasur: Janar 2017

Dhomave të Posaçme, të cilët për një muaj ishin të ngarkuar mesatarisht me 12,2 lëndë, prej të cilave i ka zgjidhur të gjitha, madje kanë zgjidhur edhe lëndë të vjetra. Efektshmëria e tyre për një muaj ishte 130% ose 15,8 lëndë të zgjidhura. Në anën tjetër Gjykata e Apelit ka treguar performancë më të dobët nga të gjitha, ku për një muaj një gjyqtar ka qenë i ngarkuar me 30,2 lëndë, prej të cilave ka zgjidhur 26,1 ose 86%. Gjykatat Themelore kanë treguar një efikasitet më të madh për vitin 2016, ku nga 26,6 lëndët për një muaj për gjyqtar kanë zgjidhur të gjitha prej tyre dhe njëkohësisht kanë zgjidhur edhe lëndë të vjetra. Pra raporti i lëndë të pranuar për një muaj dhe zgjidhja e tyre ka qenë 26,6 të pranua dhe 35,1 të zgjidhura që në përqindje i bie 132%. Në raport, përveç efikasitetit të secilës Gjykatë për vitin 2016, nuk janë specifikuar lëndët, pra lëndët kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar, si objekt i studimit tonë nuk janë paraqitur.

Të dhënat janë përfshirë në një raport të Institutit Demokratik të Kosovës, të cilët kanë monitoruar rastet kundër korrupsion për vitet e kaluara.¹³⁰ Monitorimi nga ky Institut kishte ndodhur prej 1 korrikut 2015 deri më 30 shtator 2016. Ishin monitoruar 1382 seanca gjyqësore, ku ishin përfshirë 977 raste të korrupsionit me 2500 persona. Në fokus të këtij raporti janë rastet e korrupsionit të monitoruara në gjashtëmujorin e parë të vitit 2016, ku janë monitoruar 749 seanca gjyqësore, ku përfshihen 564 raste të korrupsionit me 1386 persona.¹³¹ Gjatë monitorimit nga ky Institut ishin gjetur parregullsi në shumë raste, duke përfshirë mosrespektimin e afateve ligjore në trajtimin e rasteve të korrupsionit në të gjitha hallkat e sistemit të drejtësisë, si zvarritjet në polici, prokurori

¹³⁰ Raporti i Institutit Demokratik të Kosovës: “RETORIKA NË LUFTIMIN E KORRUPSIONIT
Raport i monitorimit të trajtimit të rasteve të korrupsionit në sistemin e drejtësisë në Kosovë”.
Për më shumë: <http://kli-ks.org/wp-content/uploads/2016/10/1.-Retorika-ne-luftimin-e-korrupsionit-27.10.2016.pdf> . E qasur: Janar 2017.

¹³¹ Po aty. Faqe 9.

dhe gjykata. Nga 749 seanca të monitoruara, 590 prej tyre janë mbajtur, ndërkaq si pasojë e mosplotësimit të kushteve ligjore për mbajtjen e seancave 159 prej tyre janë shtyrë.

Arsyet e shtyerjes janë të ndryshme, duke filluar prej mungesës së të pandehurve, mosdorëzimit të shkresave të lëndës nga Prokuroria, mungesës së prokurorëve, trupit gjykues, avokatëve, palëve të dëmtuara dhe kërkesave të palëve në procedurë.¹³² IKD gjatë monitorimit të rasteve të korrupsionit në Prokurori dhe Gjukata ka vërejtur në praktikë fenomenin e zvarritjes së dërgimit të aktakuzave nga prokurorët në Gjukata. IKD ka identifikuar shtatë (7) raste të korrupsionit ku prokurorët kanë ngritur aktakuzat, ndërsa janë vonuar prej 13 deri në 400 ditë për t'i dorëzuar të njëjtat në Gjykatë. IKD vlerëson se kjo më së paku përbën neglizhencë të prokurorëve, e cila duhet të hetohet nga mekanizmat e llogaridhënies. Derisa, politikat e KGJK-së obligojnë gjykatësit të trajtojnë me prioritet lëndët e korrupsionit, në praktikë kjo nuk po respektohet. Në këtë periudhë raportuese, nga 17 aktakuzat e ngritura për veprat penale të korrupsionit, 8 raste janë trajtuar nga gjykatat, ndërsa 9 raste janë në pritje. Në këto raste caktimi i seancave nuk është bërë në përputhje me obligimet ligjore, por vazhdimisht janë shkelur afatet ligjore. Prej 749 seancave gjyqësore të monitoruara nga IKD, ku përfshihen 269 raste të korrupsionit, të cilat janë analizuar për këtë periudhë raportuese, Gjykatat kanë shpallur 93 aktgjykime për rastet e korrupsionit. Pothuajse në secilën fazë të procedurës penale, nuk respektohen afatet ligjore të përcaktuara në Kodin e Procedurës Penale.

Koha më e shkurtër e trajtimit të rastit të korrupsionit nga koha e paraqitjes së kallëzimit penal deri në shpallje të aktgjykimit është 68 ditë, përderisa rasti që ka marr më së shumti kohë deri në

¹³² Po aty. Faqe 9.

shpallje të aktgjykimit është 4257 ditë apo mbi 11 vjet e gjysmë. Ndërsa, kohëzgjatja prej ngritjes së aktakuzës deri në shpalljen e aktgjykimit, në rastin më të mirë të monitoruar, ka marrë kohë 27 ditë, ndërsa rasti që ka marrë më së shumti kohë është në 3816 ditë apo mbi 10 vjet. Profili i 630 personave të akuzuar në këto 269 raste të korrupsionit të monitoruara nga IKD gjatë kësaj periudhe është kryesisht i ulët dhe i mesëm dhe një numër i kufizuar i personave të akuzuar i takon profilin të lartë. 398 persona i takojnë profilin të ulët, 208 persona i takojnë profilin të mesëm dhe 24 persona i takojnë profilin të lartë. IKD gjatë monitorimit të 93 aktgjykimeve të shpallura në shkallë të parë nga Gjykatat, vlerëson se politika e dënimeve në rastet e korrupsionit është e butë. Gjykatësit kanë shqiptuar 93 aktgjykime ndaj 160 personave të akuzuar. Prej tyre gjykatësit kanë dënuar me burg efektiv 25 persona (apo 15.62%) ndaj 28 personave kanë shqiptuar dënime me kusht (apo 17.5%), ndaj 12 personave kanë shqiptuar dënime me gjobë (apo 7.5%), ndërsa kanë liruar 95 persona (apo 59.37%) me aktgjykim lirues, refuzues dhe për shkak të parashkrimit. Prej këtyre rasteve ku janë shpallur aktgjykimet, janë përfshirë të gjitha profilet ku 93 persona i takojnë profilin të ulët, 61 persona profilin të mesëm dhe 6 persona i takojnë të profilin të lartë. Prej 6 personave të profilin të lartë, 4 prej tyre janë liruar, ndërsa 2 janë dënuar me nga 3 muaj burgim efektiv. Edhe në rastin e gjykatave, përqindja e personave ndaj të cilëve shqiptohen aktgjykime liruese kalon 59.37%. Kjo është dëshmi se kualiteti i ndjekjes penale është shumë i ultë. IKD vazhdimisht në raportet e saj ka raportuar se një shkallë kaq e lartë e hedhjes së kallëzimeve penale dhe e aktakuzave, në praktikë dëshmon më shumë persekutimin sesa luftimin apo ndëshkimin e kryerësve të veprave penale të korrupsionit. Më tej në këtë raport thuhet se janë pikërisht këto rezultate të dobëta në ndjekje dhe gjykim të korrupsionit, kanë ndikuar në humbjen e besimit të qytetarëve në sistemin e drejtësisë. Sipas Pulsit Publik të UNDP-së, rezulton se kënaqshmëria e qytetarëve me punën e sistemit

gjqësor dhe prokurorial në muajin prill 2016 ka shënuar pothuajse rënien më të madhe të të gjitha kohërave, duke rënë në 18.4% për gjyqësorin dhe 16.9% për prokuroritë.¹³³

IV.1.14 Efikasiteti i Prokurorive në Kosovë

Performancën e prokurorive të Kosovës më së miri mund ta dëshmojmë me rastet e trajtuara kundër-korrupsion dhe krim të organizuar, me lëndët e përpunuara dhe proceduara në gjykata për vitet 2013, 2014 dhe 2015.

Raporti në mes kallëzimeve penale në punë dhe të proceduara në sistemin prokurorial në përgjithësi jep se nga 2074 kallëzime penale në punë në vitin 2014, prokuroritë kanë proceduar 900 apo 43.39% të kallëzimeve penale. Nga 2158 kallëzime penale në punë në vitin 2015, prokuroritë kanë proceduar 828 apo 38.37% të kallëzimeve penale. Këtu hynë këto grupe të veprave penale:

- Grupi i veprave penale të Armëve, të përfshira në mekanizmin përcjellës;
- Grupi i veprave penale të Drogave, të përfshira në mekanizmin përcjellës;
- Grupi i veprave penale të Kontrabandimit me emigrantë, të përfshira në mekanizmin përcjellës;
- Grupi i veprave penale të Krimit të organizuar, të përfshira në mekanizmin përcjellës;
- Grupi i veprave penale të Korrupsionit, të përfshira në mekanizmin përcjellës;
- Grupi i veprave penale të Shpërlarjes së parasë, të përfshira në mekanizmin përcjellës;

¹³³ Po aty. Faqe 10.

- Grupi i veprave penale të Trafikimit me qenie njerëzore, të përfshira në mekanizmin përcjellës;
- Grupi i veprave penale të Krimeve ekonomike, të përfshira në mekanizmin përcjellës;
- Grupi i veprave penale të Nxitjes së urrejtjes, të përfshira në mekanizmin përcjellës.¹³⁴

Megjithatë në studimin tonë do të trajtojmë vetëm grupet e veprave penale të korrupsionit si dhe ato të krimit të organizuar.

Raporti në mes kallëzimeve penale në punë dhe të proceduara gjatë vitit 2014 ka qenë i tillë: nga 2074 kallëzime penale në punë, prokuroritë kanë proceduar 900 apo 43.39% të kallëzimeve penale. Nga 2158 kallëzime penale në punë në vitin 2015, prokuroritë kanë proceduar 828 apo 38.37% të kallëzimeve penale.¹³⁵ Nga 47 kallëzime penale në punë kundër krimit të organizuar gjatë vitit 2014 ishin proceduar vetëm 8 prej tyre, që në përqindje i bie rreth 17%. Efikasitet edhe më i dobët ishte treguar në vitin 2015, ku nga 55 kallëzime penale të kësaj fushe ishin proceduar vetëm 8, apo në përqindje 14%.

Efikasitet më i lartë ishte shënuar në trajtimin e lëndëve kundër korrupsion. Nga 976 kallëzime penale në punë kundër korrupsionit në vitin 2014 ishin proceduar 444 ose shprehur në përqindje

¹³⁴ Performanca e Prokurorive. Raport analitik tre vjeçar(2013 – 2014 – 2015). Për më shumë:
http://www.psh-ks.net/repository/docs/PERFORMANCA_E_PROKURORIVE_2013,_2014,_2015.pdf. E qasur: Shtator 2016.

¹³⁵ Po aty, Faqe 7.

rreth 45%.Ndërsa në vitin 2015 kjo performancë kishtë rënie të lehtë, ku nga 950 kallëzime në punë të kësaj natyre, ishin proceduar 412 prej tyre, ose në përqindje 43%.¹³⁶

Në krahasim me Raportin në mes kallëzimeve penale në punë dhe të proceduara, **Raporti në mes kallëzimeve penale të pranuara dhe atyre të proceduara** për vitet 2014 dhe 2015 paraqitet më efikas. Nga 1159 kallëzime penale të pranuara në vitin 2014, prokuroritë kanë proceduar 900 apo 77.65% të kallëzimeve penale. Nga 950 kallëzime penale të pranuara në vitin 2015, prokuroritë kanë proceduar 828 apo 87.16% të kallëzimeve penale.

Ndërkohë që nga 22 kallëzime penale të pranuara kundër krimit të organizuar, në vitin 2014 janë proceduar 8 prej tyre ose shprehur në përqindje 36%. Në vitin 2015 është treguar një performancë dukshëm më e rritur, ku nga 14 lëndë të pranuara ishin proceduar 8 prej tyre ose 57%.

Në lëndët kundër-korrupsion raporti në mes të kallëzimeve penale të pranuara dhe të proceduara ka qenë dukshëm më efikas. Nga 503 kallëzimet penale të pranuara në vitin 2014, 444 nga to ishin proceduar, shprehur në përqindje 88%. Në vitin 2015 kjo performancë ishte ngritur në 100%, ku nga 412 kallëzime penale ishin proceduar 412.

Raporti në mes rasteve për persona në punë dhe të proceduara për vitet 2014 dhe 2015 ka qenë si vijon: nga 4860 persona në punë në vitin 2014, prokuroritë kanë proceduar 1941 persona apo 39.94%.Nga 5025 persona në punë në vitin 2015, prokuroritë kanë proceduar 1783 persona apo 35.48%.

¹³⁶ Po aty, faqe 5.

Në lëndët kundër krimit të organizuar raporti tregon se nga 388 persona në punë në vitin 2014 prokuroritë kanë proceduar 125 persona apo rreth 32% . Në vitin 2015 ky raport ka qenë, nga 467 persona në punë, prokuroritë kanë proceduar 113 persona apo rreth 24% .

Ndërsa në lëndët kundër korrupsion tregon se nga 2569 persona në punë në vitin 2014 prokuroritë kanë proceduar 1011 persona apo rreth 39% . Në vitin 2015 ky raport ka qenë, nga 2559 persona në punë, prokuroritë kanë proceduar 919 persona apo rreth 36% .

Raporti në mes rasteve të pranuar për persona dhe të proceduara për vitin 2014 na tregon se nga 2249 persona të pranuar, prokuroritë kanë proceduar 1941 persona apo 86.31%. Nga 1869 persona të pranuar në vitin 2015, prokuroritë kanë proceduar 1783 persona apo 95.40%.

Në lëndët kundër krimit të organizuar raporti nxjerr në pah se nga 165 persona, prokuroritë kanë proceduar 125 persona në vitin 2014 apo rreth 76% , ndërsa për vitin 2015 ky raport ka qenë i tillë që nga 156 persona, prokuroritë kanë proceduar 113 persona apo rreth 72%.

Në lëndët e korrupsionit, raporti ka qenë shumë më efikas. Kështu që nga 1011 persona, prokuroritë kanë proceduar 1011 persona në vitin 2014 apo rreth 100% , ndërsa për vitin 2015 ky raport ka qenë i tillë që nga 860 persona, prokuroritë kanë proceduar 919 persona apo rreth 107%.

Kur jemi të **mënyra e procedimit të rasteve për persona**, gjatë vitit 2014 Prokuroritë kanë proceduar rastet e 1981 personave, prej të cilave: për 303 persona (apo 15%) janë hedhur kallëzimet penale; për 424 persona (apo 22%) janë pushuar hetimet; rastet e 4 personave i kanë zgjidhur në mënyrë tjetër dhe për 1250 persona (apo 63%) janë ngritur aktakuza. Gjatë vitit 2015 Prokuroritë kanë proceduar rastet e 1805 personave, prej të cilave: për 235 persona (apo 13%) janë hedhur

kallëzimet penale; për 401 persona (apo 22%) janë pushuar hetimet; rastet e 10 personave janë zgjidhur në mënyrë tjetër dhe për 1159 persona (apo 64%) janë ngritur aktakuza.

Nga shtatë Prokuroritë themelore dhe Prokuroria Speciale e Republikës së Kosovës, Prokuroria Themelore në Gjilan me 87% për vitet 2013,2014 dhe 2015, kishte performancën mesatare më të lartë në procedimin e kallëzimeve penale, në raport me kallëzimet penale në punë.¹³⁷ Nga kjo Prokurori janë proceduar 333 kallëzime penale nga 382 kallëzime penale në punë.

Performancën më të ulët në procedim të kallëzimeve penale për vitet 2013, 2014 dhe 2015, pas Prokurorisë Speciale të Republikës së Kosovës me 27.06%, ose nga 558 kallëzime penale në punë ishin proceduar vetëm 151 kallëzime penale, Prokuroria Themelore në Prishtinë ka shënuar një performancë të ulët. Nga kjo Prokurori janë proceduar 646 kallëzime penale nga 2382 kallëzime penale në punë ose shprehur në përqindje 27.12%. Më pas pasojnë Prokuroritë Themelore në Mitrovicë me 31%, ajo në Ferizaj me 53%, në Pejë me 59%, në Prizren me 60% dhe në Gjakovë me 61%.

Në anën tjetër, performanca e prokurorive në procedimin e kallëzimeve penale në raport me kallëzimet e pranuar, është dukshëm më e lartë. Në trajtim efikas të lëndëve prapë prinë Prokuroria Themelore në Gjilan me 99% në procedim të kallëzimeve penale në raport me kallëzimet penale të pranuar. Më pas për nga efikasiteti renditën prokuroritë themelore në Prizren me 92%, më pas pasohet nga Prokuroria Speciale e Republikës së Kosovës me 87%. E katërta për nga efikasiteti i kallëzimeve penale të proceduara në raport me kallëzimet penale të pranuar, renditet Prokuroria Themelore në Gjakovë me 86%, e ndjekur nga Prokuroria Themelore në Pejë me 85%, ajo në

¹³⁷ Po aty. Faqe 34.

Ferizaj me 81%, në Mitrovicë më 73% dhe fare në fund të listës për nga efikasiteti renditet Prokuroria Themelore në Prishtinë e cila gjatë viteve 2013,2014 dhe 2015 nga 1079 kallëzime të pranuar, ka proceduar vetëm 646 kallëzime penale apo shprehur në përqindje 60%.

Në anën tjetër, raporti ndërmjet rasteve me kallëzime penale në punë, kallëzimeve penale të pranuar dhe kallëzimeve penale të proceduara, del që Prokuroria Themelore në Prishtinë renditet e para. Ajo gjatë viteve 2013, 2014 dhe 2015 ka pasur 2382 kallëzime penale në punë, e ndjekur nga Prokuroria Themelore në Prizren me 684, ajo në Mitrovicë me 664, më pas Prokuroria Speciale me 558, Prokuroria Themelore në Pejë më 445, ajo në Ferizaj me 436, në Gjilan me 382 dhe Prokuroria Themelore në Gjakovë me 260 kallëzime penale në punë.¹³⁸

Gjatë viteve 2013, 2014 dhe 2015, Prokuroria Themelore në Prishtinë kishte pranuar 1079 kallëzime penale, e ndjekur nga Prokuroria Themelore në Prizren me 448, ajo në Gjilan me 336, në Pejë me 310, në Ferizaj me 286, në Mitrovicë 282, në Gjakovë 184 dhe fare në fund të listës Prokuroria Speciale me 174 kallëzime të pranuar.

Nga lëndët e sipërpërmendura, gjatë viteve 2013, 2014 dhe 2015, Prokuroria Themelore në Prishtinë kishte proceduar 646 kallëzime penale, ajo në Prizren 413, në Gjilan 333, në Pejë 226, në Ferizaj 234, në Mitrovicë 206, në Gjakovë 160 dhe në Prokuroria Speciale me 151 kallëzime penale të proceduara.

¹³⁸ Po aty. Faqe 38.

Është më rëndësi të prezentohet edhe fakti i performancës individuale të prokurorëve, të cilët për vitet e lartshënuara kanë proceduar kallëzime penale. Në këtë listë prinë Prokuroria Themelore në Ferizaj dhe listën e përmbyllë Prokuroria Speciale.¹³⁹

Në bazë të numrit të kallëzimeve penale të proceduara në raport me numrin e prokurorëve, rezulton se prokuroritë përgjatë viteve kanë performuar si në vazhdim:

Prokurori në Prokurorinë Themelore në Ferizaj, mesatarisht çdo vit ka proceduar 29.32 kallëzime penale; Prokurori në Prokurorinë Themelore në Gjakovë, mesatarisht çdo vit ka proceduar 26.66 kallëzime penale; Prokurori në Prokurorinë Themelore në Prizren, mesatarisht çdo vit ka proceduar 25.82 kallëzime penale; Prokurori në Prokurorinë Themelore në Pejë, mesatarisht çdo vit ka proceduar 24.22 kallëzime penale; Prokurori në Prokurorinë Themelore në Gjiilan, mesatarisht çdo vit ka proceduar 20.82 kallëzime penale; Prokurori në Prokurorinë Themelore në Mitrovicë, mesatarisht çdo vit ka proceduar 20.62 kallëzime penale; Prokurori në Prokurorinë Themelore në Prishtinë, mesatarisht çdo vit ka proceduar 17.94 kallëzime penale; dhe Prokurori në PSRK, mesatarisht çdo vit ka proceduar 4.87 kallëzime penale.

Për vitin 2016, Këshilli Prokurorial në raportin e punës së prokurorive për periudhën janar-shtator nxjerr se vetëm 50 përqind e kallëzimeve penale përfunduan në aktakuzë.¹⁴⁰

Për periudhën janar-shtator 2016 nga prokuroritë ishin trajtuar 996 kallëzime penale dhe vetëm 50% e tyre kishin përfunduar në ngritje të aktakuzës. Në anën tjetër sipas këtij raporti del se në vitin 2016 ishin trashëguar 2105 lëndë të trashëguara. Për periudhën e janar-shtator 2016 prokuroritë

¹³⁹ Po aty. Faqe 40.

¹⁴⁰ Artikulli në gazetën Koha Ditore i datës 14. Janar.2017 me titull "Këshilli Prokurorial paraqiti raportin e punës së prokurorive për periudhën janar-shtator 2016". Faqe 5.

kanë pranuar 1111 lëndë prej 1778 persona. Nga ky numër ishin trajtuar 996 dhe nga bashkuar me numrin e lëndëve të trashëguara, prokuroritë kanë 2220 lënda të patrajtuara.

Kjo i bie që në fund të vitit 2016 kishim shtim të numrit të lëndëve të patrajtuara për 115 në krahasim me vitin paraprak.

Numri më i madh i kallëzimeve penale ishte dorëzuar nga Policia e Kosovës me 812 kallëzime penale, më pas nga Agjencia Kundër Korrupsion (AKK) 65 kallëzime penale, ndërsa nga Doganat dhe nga vetë qytetarë ishin dorëzuar afro 50 kallëzime penale.

Raporti nxjerr më pas në pah se 29% e kallëzimeve të dorëzuara nga institucionet dhe personat privat, ishin hedhur poshtë, 0.9% kishin pasur bashkim të procedurave, 0.5% transferim në shtetet tjera, 19 % pushim të hetimeve dhe 52% kanë përfunduar në ngritje të aktakuzës.

Për më tepër, raporti paraqet edhe të dhënat në raport me gjykatat, ku për periudhën janar-shtator gjykatat kishin marrë 406 vendime lidhur me aktet akuzuese për persona të caktuar. Nga 52% e aktakuzave, gjykatat kishin hedhur poshtë 0,9% të tyre. 61% nga to janë shpallur fajtorë, 16% ishin liruar nga aktakuza dhe 14% ju ishin refuzuar aktet akuzuese.

Në raport më pas prezantohen të dhëna edhe për natyrën e lëndëve. Nga 354 kallëzime penale të dorëzuara në periudhën janar-shtator gjatë viti 2016 nga to janë trajtuar 333 sosh duke mbetur vetëm 11 lënda të patrajtuara. Gjatë prezantimit të këtij raporti, vetë Kryeprokurori kishte shprehur pakënaqësinë e tij rreth efikasitetit të prokurorive për periudhën e lartshënuar. Ai mëtej kishte thënë se kemi shumë lëndë kur prokurorët i kanë pushuar hetimet ose janë tërhequr nga aktakuza.

Statistikat tregojnë se situata nuk është e kënaqshme. Numri i madh i kallëzimeve penale që janë hedhur poshtë duhet të shikohen se a janë të bazuara, për të parë nëse më vonë prokurorët mund të ngrejnë aktakuzë apo jo me kallëzimet penale paushalle, për të dëmtuar njerëz.¹⁴¹

Në anën tjetër, Raporti vjetor i Policisë së Kosovës për vitin 2016 në kuadër të luftës kundër krimeve ekonomike dhe korrupsionit, kishte hetuar 616 raste, ngritur 416 kallëzime penale ndaj 777 personave, kishte arrestuar 139 persona, ishin realizuar 19 operacione, 319 bastisje, si dhe kishte goditur 14 grupe të organizuara kriminale.¹⁴²

Si përfundim mund të konkludojmë, bazuar edhe në faktet e rëndësishme dhe raportet e lartpërmendura në këtë kapitull, se gjyqësori, si pushtet i tretë, del me ngecjet më të mëdha në përmbushjen e misionit të tij.

Nga të gjitha faktet e nxjerra dhe në bazë të të dhënave që u përmenden në raportet e cituara, mund të konkludojmë se edhe në këtë nivel të konsolidimit, Kosovën e përcjellin defekte të mëdha, dhe si e tillë mbetet ende larg përmbushjes së kriterëve në këtë fushë.

Thuajse të gjitha raportet e cituara në këtë studim, për defekt më të madh në zhvillimin e demokracisë në Kosovë kishin emërues të përbashkët defektet në gjyqësor. Madje, Raporti i progresit i Komisionit Evropian për Kosovën e nxori funksionimin e gjyqësorit në Kosovë në një fazë të hershme.

¹⁴¹ Po aty. Faqe 5.

¹⁴² Raport vjetor i Policinë së Kosovës 2016. Për më shumë:
http://www.kosovopolic.com/repository/docs/Raporti_vjetor_i_pun%C3%ABs_s%C3%AB_Policis%C3%AB_s%C3%AB_Kosov%C3%ABs_2016_-_SHQIP.pdf. E qasur: Janar 2017.

Gjyqësori në përgjithësi në Kosovë, përfshirë Këshillin Gjyqësor të Kosovës dhe Këshillin Prokurorial të Kosovës, vazhdon të përballet me mungesë të efikasitetit, llogaridhënies dhe integritet në ushtrimin e përgjegjësisë kushtetuese dhe ligjore. Ndikimi politik, korrupsioni, neglizhenca e joprofesionalizmi po vazhdojnë të karakterizojnë gjyqësorin në Kosovë dhe si i tillë ky sistem sot konsiderohet si jokredibil dhe jotransparent. Kësaj shtate i ka ndihmuar mungesa e përkrahjes politike për të krijuar një sistem gjyqësor të pavarur. Në anën tjetër, asnjëherë nuk ka munguar vullneti politik i secilës qeveri që ta mbajë nën kontroll çdo segment të sistemit.

Në analizat që u bënë raporteve të cituara, u veçua sidomos efikasiteti tepër i ulët i luftës kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar.

Sado që në letër është top prioritet i institucioneve të Kosovës lufta kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar, është ky edhe njëri ndër kriteret bazë për liberalizimin e vizave, gjatë analizimit të fakteve u pa se në praktikë kjo gjë nuk po ndodhë, ose bëhet me hapa tepër të ngadaltë, sidomos nga Këshilli Prokurorial i Kosovës.

Përveç mosefikasitetit të sjelljes para drejtësisë të zyrtarëve të lartë shtetërorë që kishin abuzuar me pozitën zyrtare, gjyqësorin në vitet e fundit e kishte karakterizuar edhe me gjyqtarë të përfshirë në afera korruptive, madje në nivele të larta të sistemit.

Pra, politizimi i gjyqësorit në Kosovë po vazhdon të prodhojë neglizhencë në ndjekje të lëndëve, duke lejuar që shumë prej tyre të parashkruhen dhe keqbërësit të jenë të lirë të përsërisin veprat korruptive.

“Gjykatësit dhe prokurorët e Kosovës sot kanë shumë probleme profesionale. Por, mbi të gjitha, ata kanë një frikë të pakuptueshme për të zbatuar ligjin, për ç’gjë ata e kanë pushtetin e pakontestueshëm. Ata janë kapluar nga një psikozë e pashpjegueshme kolektive se mos po krijojnë

përshtypje në opinion se janë të korruptuar apo të ndikuar politikisht. Dhe, duke iu ruajtur etiketimeve të tilla, ata po bëjnë kompromis me ligjin” shkruan gazetarja Valbona Mehmeti në një artikull të publikuar në dhjetor të vitit 2016 në të përditshmen “Koha Ditore”.¹⁴³ Ajo më tej e citon një prokuror, i cili ishte shprehur para gjykatësit kështu: “ E di që i dyshuari nuk e ka kryer veprën penale që i ngarkohet, por nuk mund ta jap pëlqimin për t’ia ndërprerë paraburgimin, se nuk dua me rreziku vetën e vendin tim të punës për të shkruajtur gazetatat përse nuk e keni dënu”.

Më pas, gazetarja vazhdon të përmbledh edhe njëherë gjyqësorin në Kosovë me këto fjali: “Ndonëse nuk mund të arsyetohet, frika e gjykatësve për imazhin e tyre publik nuk është e pabazë. Qytetarët kanë humbur besimin në ta, kjo për fajin e gjykatësve. Ndarja e drejtësisë selektive, joprofesionalizmi, mostransparenca, ndikimi nga politika, dënimet e ulëta për kriminelët dhe të korruptuarit madje edhe bashkëpunimi me krimin dhe përfshirja e vet gjyqësorit në korrupsion, është imazhi i gjyqësorit të sotëm”.

V. Institucioni i Presidentit të Republikës së Kosovës në roli i tij në konsolidimin e demokracisë

V.1 Presidenti i Republikës së Kosovës - historiku

Në kohën e Kushtetutës së vitit 1974, brenda autonomisë politiko-territoriale që gëzonte Kosova në kuadër të ish-federatës jugosllave, ajo kishte modelin e presidencës kolegjiale në formë të Kryesisë së Kosovës. Ky organ u suprimua në vitin 1990, pas suprimimit kundër-kushtetues të Autonomisë së Kosovës nga Serbia në fund të vitit 1989. Me amendamentin e Kushtetutës së Republikës së

¹⁴³ Gazeta KOHA DITORE, artikull i publikuar në dhjetor të vitit 2016, autore: Valbona Mehmeti.

Kosovës, të miratuar në Kaçanik me 7 shtator 1990, për herë të parë u aplikua modeli i presidentit të zgjedhur drejtpërdrejt. Në sajë të këtyre amendamenteve në zgjedhjet presidenciale, Dr. Ibrahim Rugova u zgjodh President i parë i Kosovës, për t'u rizgjedhur edhe njëherë në të njëjtin funksion në vitin 1996.¹⁴⁴

Pas përfundimit të luftës dhe vendosjes së Kosovës nën administrimin ndërkombëtar, mbi bazën e Rezolutës 1244 të KS të OKB-së, Kosova miratoi Kornizën Kushtetuese për Vetëqeverisjen e Përkohshme. Sipas kësaj Kornize, Presidenti i Kosovës zgjidhej nga Kuvendi pas një votim në tri rrethe. Në dy rrrathët e parë kërkohej 2/3 e votave, kurse në rrethin e tretë shumica e thjeshtë e votave të të gjithë deputetëve të Kuvendit të Kosovës.¹⁴⁵ Ky mekanizëm zgjedhor recikloi në vazhdimësi kriza parlamentare, sepse zgjedhja e presidentit u bë një shkas i krizave të thella politike. Kështu, në vitin 2001 Dr. Rugova u zgjodh President i Kosovës pas dështimeve në dy rradhët e votimit dhe pas një marrëveshjeje politike për koalicionin gjithëpërfshirës me të cilën, Dr. Rugova si udhëheqës i LDK-së si parti fituese, u detyrua që mandatin për udhëheqjen e qeverisë t'ia besojë PDK-së si parti e dytë, përkatësisht Dr. Bajram Rexhepit, i cili u emërua si Kryeministër. E njëjta krizë recikloi edhe në vitin 2004, kur përsëri në shkëmbim të postit të Presidentit Dr Rugova ia besoi udhëheqjen e qeverisë AAK-së, gjegjësisht z. Ramush Haradinajt. Edhe pas zgjedhjeve të vitit 2007 Dr. Fatmir Sejdiu u zgjodh President i Kosovës vetëm pas arritjes së marrëveshjes për koalicionin qeverisës midis PDK si parti fituese dhe LDK-së si parti e dytë, me z. Hashim Thaçi Kryeministër.

¹⁴⁴ Faqja zyrtare e Presidentit të Republikës së Kosovës <https://www.president-ksgov.net/sq/presidentet-e-kosoves> (qasur me 16.10.2018)

¹⁴⁵ Faqja zyrtare e Kuvendit të Republikës së Kosovës, Korniza Kushtetuese për vetëqeverisje të përkohshme në Kosovë; https://www.kuvendikosoves.org/common/docs/FrameworkPocket_ALB_Dec2002.pdf. E qasur: Tetor 2018.

Modeli parlamentar i zgjedhjes së Presidentit ishte burim i vazhdueshëm i krizave parlamentare dhe ai pati për pasojë denigrimin institucional dhe kushtetues të Presidentit në tri aspekte kryesore:

- E para, zgjedhja e Presidentit kushtëzohej me zgjedhjen e qeverisë dhe me arritjen e kompromiseve politike, të cilat ulnin nivelin e legjitimitetit demokratik të presidentit dhe shkaktonin jo rrallë edhe marrëveshje joparimore, që ndikonin në autoritetin dhe kredibilitetin institucional të Presidentit.

- E dyta, një president parlamentar, i varur dhe i kontrolluar nga parlamenti, e shndërronin Presidentin në llogaridhënës (nëpunës) të parlamentit dhe ndikonte në fuqinë e tij kushtetuese, duke i pamundësuar ushtrimin e lidershit kushtetues, përkatësisht rolit kushtetues si kreu i shtetit dhe element/faktor i unitetit dhe kohezionit kushtetues të vendit.

- E treta, një zgjedhje parlamentare e Presidentit si praktikë e shteteve paskomuniste dhe atyre të dala nga diktaturat, gjithnjë e me shumë po braktiset dhe po zëvendësohet me zgjedhjen popullore të presidentit.

Në Evropën Juglindore vetëm Kosova, Shqipëria dhe Greqia kanë ruajtur këtë model, kurse shumica e shteteve të reja dhe atyre në tranzicion kanë zgjedhur drejtpërdrejt presidentin.

V.2 Pozita e Presidentit parlamentar të Republikës së Kosovës

Kushtetuta e Republikës së Kosovës proklamon Republikën e Kosovës si një shtet me rregulla të qarta të demokracisë parlamentare. Bazuar në këtë parim, Republika e Kosovës është shtet në të cilin respektohen rregullat e lojës, të cilat vlejnë për vendet e demokracive parlamentare në përgjithësi. Pa marrë parasysh që në demokracinë që aplikohet në Republikën e Kosovës vlejnë rregullat e parlamentarizmit, kushtetuta nuk e ka përcaktuar që parlamenti të ketë rol dominant në

përcaktimin e këtyre rregullave, përkundrazi kjo është bërë në mënyrë mjaft të balancuar, pa krijuar dallime se cili mund të jetë organi më i lartë, që përcakton rregullat e demokracisë parlamentare.

Kushtetuta e Republikës së Kosovës, qysh në nenin e parë të saj, në mënyrë të qartë jetëson parimin e demokracisë kushtetuese, ku në mesin e qartësimeve të ndryshme, thuhet që Republika e Kosovës, është shtet demokratik. Praktikisht, parimi i demokracisë parlamentare mund të vërehet më së shumti në rolin e parlamentit, i cili faktikisht përbën institucionin më aktiv kushtetues. Kjo mund të justifikohet për faktin që Kushtetuta e Republikës së Kosovës, përcakton një qeveri e cila është bartëse e pushtetit ekzekutiv, por i nënshtrohet rregullave parlamentare. Në të njëjtën mënyrë mund të themi edhe për presidentin, derisa të mos ndryshojë diçka në këtë drejtim. Dominimi i parlamentit në sistemin kushtetues të Republikës së Kosovës, e bën të theksuar rolin e tij në parim më të fuqishëm, të proklamuar, dhe rritë tej mase rolin dhe rëndësinë e tij. Ndarja dhe kontrolli i pushteteve, përbën një ndër parimet kryesore të demokracisë. Ky parim aplikohet ku më shumë e ku më pak. Ndarja e pushteteve nënkupton njëherit edhe kontrollin reciprok ndërmjet tyre. Kur flasim për ndarjen dhe kontrollin e pushteteve mund të theksojmë se ky parim në disa shtete proklamohet si i ngurtë, kurse në disa shtete të tjera është më fleksibil. Shembull tipik i ndarjes dhe kontrollit të ngurtë të pushteteve janë Shtetet e Bashkuara të Amerikës, ku të tria pushtetet i kanë mekanizmat e tyre të kontrollit.

Në Republikën e Kosovës, ndarja e pushteteve bëhet në këtë mënyrë: Pushteti legjislativ, bartës i të cilit është parlamenti, apo Kuvendi i Republikës së Kosovës; Pushteti ekzekutiv, bartës i të cilit është Qeveria e Republikës së Kosovës; Pushteti gjyqësor, bartës të të cilit janë Gjykatat e Republikës së Kosovës. Kjo mënyrë e ndarjes së pushteteve, ka përjashtuar nga kjo ndarje presidentin e Republikës së Kosovës dhe Gjykatën Kushtetuese, të cilat nuk janë pjesë e ndarjes së

pushteteve, por më shumë janë mekanizma të balancit në mes të këtyre pushteteve. Sa i përket kontrollit të pushteteve ndërmjet vete, kushtetuta e Republikës së Kosovës është mjaft fleksibile në këtë drejtim për arsye se nuk përcakton ndonjë mekanizëm strikt të kontrollit reciprok të të trija pushteteve, përveçse kjo vlen në mënyrë selektive, kur është fjala për kontrollin parlamentar të qeverisë. Në lidhje me kontrollin e pushteteve, kushtetuta më shumë përdorë mekanizmat e jashtëm, siç janë institucioni i Presidentit dhe ai i Gjykatës Kushtetuese, që përkujdesen për të krijuar një balancë kushtetues ndërmjet forcave të pushteteve.

Megjithatë, mund të thuhet se Kushtetuta e Republikës së Kosovës, ka respektuar dhe aplikuar mjaft qartë parimin e ndarjes së pushteteve, si një ndër parimet më të vjetra të zhvillimit të demokracisë, pavarësisht që sa i përket kontrollit reciprok në mes të bartësve, ka aplikuar mënyrën e butë të kontrollit, dhe kështu kështu e ka bartur më shumë jashtë këtij rrethi vicioz, sesa e ka lënë të zhvillohet brendapërbrenda tri pushteteve ndërmjet vete. Parimi kushtetues i ndarjes dhe kontrollit të pushteteve është parim i qartë i prezymimit të demokracisë, parim i cili është standard dhe rregull në të gjitha sistemet kushtetuese në mbarë globin. Ky parim ka dëshmuar se garanton funksionim të institucioneve dhe njëherit edhe pavarësinë e tyre nga njëri-tjetri, deri në një shkallë të caktuar. Pavarësia e pushtetit garanton efektivitet dhe efikasitet të pushteteve, por kjo e kombinuar me kontroll reciprok ndërmjet tyre. Kushtetuta e Republikës së Kosovës nuk përcakton shprehimisht formën e qeverisjes në Kosovë, ajo nuk atribuon shprehimisht Kosovën si një republikë të pastër parlamentare. Përkundrazi bazuar në raportim mes pushteteve, fuqinë kushtetuese të Presidentit të Republikës së Kosovës, mund të nxirret përfundimi se Kosova ka një sistem të përzier të qeverisjes, që është i ngjashëm me sistemet gjysmë-presidenciale. Një konkluzion i këtillë mbështetet në dy fakte kryesore: e para, fuqinë ekzekutive të Presidentit në disa fusha dhe rolin e Presidentit në

politikën e jashtme. Në këtë kontekst reforma aktuale që synon zgjedhjen e drejtpërdrejtë të presidentit nga qytetarët e forcon orientimin e Kosovës drejt sistemit gjysmë-presidencial. Në ngjarjet aktuale ku Presidenti aktual z. Hashim Thaqi ka marrë primatin për udhëheqjen e dialogut, shihen qartë kompetencat e tij të zgjeruara në politikën e jashtme. Dhe, e dyta, rolin e Parlamentit në sistemin kushtetues të Republikës së Kosovës, në raport të ndarjes së pushteteve, për faktin që si në shumicën e Republikave parlamentare, në Republikën e Kosovës Parlamenti nuk përcaktohet si organi më i lartë në shtet. Kjo nënkupton që kemi një ndarje të pushteteve, pa theksuar shprehimisht se njëri apo tjetri organ është organi më i lartë shtetëror.

Lidhur me sistemin e qeverisjes kushtetuta në nenin 4. përcakton se “Kosova është Republikë demokratike, e bazuar në parimin e ndarjes së pushteteve dhe kontrollit e balancimit në mes tyre, sikurse është përcaktuar me këtë Kushtetutë”. Më tej përcakton tri pushtetet klasike të ndarjes së pushteteve, si vijon:

- Kuvendi i Republikës së Kosovës ushtron pushtetin legjislativ.
- Presidenti i Republikës së Kosovës përfaqëson unitetin e popullit.
- Presidenti i Republikës së Kosovës është përfaqësues legjitim i vendit brenda dhe jashtë dhe garantues i funksionimit demokratik të institucioneve të Republikës së Kosovës, në pajtim me këtë Kushtetutë.
- Qeveria e Republikës së Kosovës është përgjegjëse për zbatimin e ligjeve e politikave shtetërore dhe i nënshtrohet kontrollit parlamentar.
- Pushteti gjyqësor është unik, i pavarur dhe ushtrohet nga gjykatat.
- Gjykata Kushtetuese është organ i pavarur i mbrojtjes së kushtetutshmërisë dhe bën interpretimin përfundimtar të Kushtetutës.

Republika e Kosovës ka institucionet e veta për mbrojtjen e rendit kushtetues dhe të integritetit territorial, rendit dhe qetësisë publike, të cilat funksionojnë nën autoritetin kushtetues të institucioneve demokratike të Republikës së Kosovës¹⁴⁶. Sa i përket kompetencave të Presidentit të Republikës së Kosovës, më gjerësisht do të flasim në kapitullin vijues.

V.3 Kompetencat e Presidentit të Republikës së Kosovës

Meqenëse Kosova është republikë parlamentare, sipas parimit të ndarjes së pushtetit, Presidenti është kreu i shtetit dhe përfaqëson unitetin e popullit, kurse Kryeministri është kreu i Qeverisë. Aktualisht, Kushtetuta përcakton 30 kompetenca për Presidentin¹⁴⁷, për shumicën nga të cilat duhet të zhvilloj ‘konsultime të detyrueshme’ me Kryeministrin apo institucionet tjera. Në thelb, kompetencat e Presidentit për emërimë janë kryesisht të kufizuara në miratimin e emërimeve të propozuara, që bëhen nga organet tjera. Presidenti ka një rol të vogël zyrtar në agjendën legislative, përveç vetos që mund të ushtrohet një herë ndaj një ligji të propozuar. Ndonëse Presidenti ka pushtetin për të udhëhequr politikën e jashtme, ai megjithatë duhet ta bëjë këtë në bashkëpunim me Ministrin e Punëve të Jashtme. Përderisa Presidenti është Komandant Suprem i Forcave të Armatosura, Kryeministri kryeson Këshillin e Sigurisë së Kosovës, që ka përgjegjësinë për hartimin e politikave të sigurisë.

Mbase, kompetencat më të gjëra që i ka Presidenti janë ato për shpalljen e gjendjes së jashtëzakonshme, ku në këtë rast Presidenti bëhet kryesues i Këshillit të Sigurisë së Kosovës, por Kuvendi përfundimisht mund të imponoj kufizime ndaj atyre kompetencave. Kushtetuta, me qëllim detyron Presidentin që të punoj ngushtë me Kryeministrin; pra Presidenti ka pushtet relativisht të

¹⁴⁶ Kushtetuta e Republikës së Kosovës, neni 4, paragrafët, 1,2,3,4,5,6.

¹⁴⁷ Kushtetuta e Republikës së Kosovës, Neni 84.

kufizuar për të vepruar në mënyrë të pavarur nga Qeveria¹⁴⁸. Kompetencat e Presidentit shtrihen në fushën e politikës së jashtme, mbrojtjes, sigurisë, gjyqësorit, legjislativit dhe komuniteteve. Më poshtë janë të paraqitura kompetencat e Presidentit, të përcaktuara sipas Kushtetutës, dhe të ndara sipas fushës dhe propozimeve nga institucionet tjera:

- Përfaqëson Republikën e Kosovës brenda dhe jashtë;
- Komandant Suprem i Forcave të Sigurisë të Kosovës;
- Cakton mandatarin për formimin e Qeverisë, pas propozimit të partisë politike ose të koalicionit, që përbën shumicën e Kuvendit;
- Emëron dhe shkarkon Kryetarin e Gjykatës Supreme të Kosovës, me propozimin e Këshillit Gjyqësor të Kosovës;
- Emëron dhe shkarkon gjyqtarët e Republikës së Kosovës, me propozimin e Këshillit Gjyqësor të Kosovës;
- Emëron dhe shkarkon Kryeprokurorin e Shtetit të Republikës së Kosovës, me propozimin e Këshillit Prokurorial të Kosovës;
- Emëron dhe shkarkon prokurorët e Republikës së Kosovës, me propozimin të Këshillit Prokurorial të Kosovës;
- Emëron gjyqtarët për Gjykatën Kushtetuese, me propozimin e Kuvendit;
- Emëron Komandantin e Forcave të Sigurisë të Kosovës, pas rekomandimit të Kryeministrit;
- Së bashku me Kryeministrin, emëron Drejtorin, Zëvendësdrejtorin dhe Inspektorin e Përgjithshëm të Agjencisë së Kosovës për Inteligjencë;

¹⁴⁸ Gjykatësi John R. Tuhheim, Memorandum #5 drejtuar Komisionit për Reformën Kushtetuese, 9 korrik 2011

- Emëron Kryetarin e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve; -Emëron Guvernatorin e Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës i cili shërben edhe si Drejtor Menaxhues dhe emëron anëtarët e tjerë të Bordit të Bankës-Emëron Kryetarin e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve;
- Emëron Guvernatorin e Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës i cili shërben edhe si Drejtor Menaxhues dhe emëron anëtarët e tjerë të Bordit të Bankës;
- Emëron dhe shkarkon shefat e misioneve diplomatike të Republikës së Kosovës, me propozimin e Qeverisë;
- Udhëheq politikën e jashtme të vendit;
- Ka të drejtën e kthimit për rishqyrtim të ligjeve të miratuara, nëse konsideron se janë të dëmshme për interesat legjitime të Republikës së Kosovës ose të një a më shumë komuniteteve të saj. Të drejtën e rikthimit të një ligji mund ta shfrytëzojë vetëm një herë;
- Vendors për shpalljen e Gjendjes së Jashtëzakonshme, në konsultim me Kryeministrin;
- Mund të kërkojë mbledhje të Këshillit të Sigurisë të Kosovës dhe i kryeson ato në kohën e Gjendjes së Jashtëzakonshme;
- Vendors për formimin e misioneve diplomatike e konsullare të Republikës së Kosovës, në bazë të konsultimit me Kryeministrin;
- Jep medalje, mirënjohje dhe çmime, në pajtim me ligjin;
- Shpall falje individuale, në pajtim me ligjin;

- Së paku një herë në vit i drejtohet Kuvendit të Kosovës përkitazi me fushëveprimtarinë e tij/saj.
- Garanton funksionimin kushtetues të institucioneve të përcaktuara me këtë Kushtetutë;
- Shpall zgjedhjet për Kuvendin e Kosovës dhe thërret mbledhjen e parë të tij;
- Nxjerr dekrete në pajtim me këtë Kushtetutë;
- Shpall ligjet e miratuara nga Kuvendi i Republikës së Kosovës;
- Nënshkruan marrëveshjet ndërkombëtare në pajtim me këtë Kushtetutë;
- Propozon amendamente për këtë Kushtetutë;
- Mund të referojë çështje kushtetuese në Gjykatën Kushtetuese;
- Pranon letrat kredenciale të shefave të misioneve diplomatike të akredituar në Republikën e Kosovës;
- Udhëheq Këshillin Konsultativ për Komunitete.¹⁴⁹

V.4 Sfidat e Institucionit të Presidentit të Republikës së Kosovës në konsolidimin e demokracisë në Kosovë

Që nga shpallja e pavarësisë së Kosovës, institucioni presidencial është ballafaquar me sfida, duke filluar nga ato të procesit të zgjedhjes së Presidentit sipas nenit 86 të Kushtetutës së Kosovës e deri tek shkeljet kushtetuese, të cila po ashtu janë konfirmuar nga interpretimet e caktuar të Gjykatës Kushtetuese të Kosovës, si mekanizëm mbrojtës i kushtetutshmërisë në Republikën e Kosovës.

¹⁴⁹ Kushtetuta e Republikës së Kosovës: Kapitulli V Presidenti i Republikës së Kosovës. E qasur: Tetor 2018.

Ishin po këto dy shkelje, nga bartësit e pushtetit në të cilin përfshiheshin dy presidentë të Republikës së Kosovës.

Duke marr për bazë së Kosova si shteti i ri me një demokraci të re, edhe pozita e Presidentit në vazhdimësi ka reflektuar vështirësitë e konsolidimit të demokracisë në Kosovë, ku për këtë do merren në vijim disa shembuj, nëpërmjet të cilëve do të konfirmohet se Presidentët e zgjedhur nuk kanë arritur të shkëputën nga petku i partive politike, pjesë e të cilave edhe kanë qenë. Kjo shpesh ka rënduar apo më mirë të thuhet ka komplikuar procesin e zgjedhjes së Presidentit, si rezultat i mungesës së kulturës politike dhe rivalitetit tejet destruktiv në mes partive politike, të cilat pozitën e Presidentit edhe e kanë shikuar në mënyrë subjektive.

V.4.1 Shkeljet kushtetuese të pozitës së Presidentit të Republikës së Kosovës dhe krizat politike

Shkeljet kushtetuese, të cilat kanë ndodhur, i kanë paraprirë edhe krizave dhe bllokadave politike dhe duke e dërguar vendin në zgjedhje të parakohshme, ku si tërësi kanë penguar apo vënë në pikëpyetje konsolidimin e demokracisë.

Një kërkesë e iniciuar nga deputetët e Kuvendit të Kosovës në vitin 2010, ndaj Presidentit të atëhershëm z. Fatmir Sejdiu, bëri që Gjkata Kushtetuese të kualifikojë shkeljen serioze të nenit 88 pika 2 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nga ana e ish-Presidentit¹⁵⁰. Në këtë aktgjykim thuhet si vijon —”ka shkelje serioze të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, respektivisht nenit 88.2, të kushtetutës, nga shkëlqesia e tij, z. Fatmir Sejdiu, duke mbajtur njëkohësisht postin e

¹⁵⁰ Aktgjykimi i Gjykatës Kushtetuese, lënda nr.kl 47/10, datë 28.Shtator 2010.

Presidentit të Republikës së Kosovës, si dhe postin e partisë politike, Lidhja Demokratike e Kosovës”. Pra, sipas neni 88 pika 2, “pas zgjedhjes së Presidentit nuk mund të ushtrojë asnjë funksion në parti politike”¹⁵¹

Pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit, z. Sejdiu pati dhënë dorëheqje nga posti i Presidentit të Republikës së Kosovës, dhe për një kohë ishte krijuar vakum institucional. Nga kjo situatë, edhe zgjedhjet e parakohshme u bënë të pashmangshme.

Pas mbajtjes së zgjedhjeve të reja qendrore në vitin 2010 dhe 2011, nga të cilat dolën institucionet demokratike, pozita e Presidentit, përjetoi goditjen tjetër serioze të përballjes me praktikën dhe situatat e mundshme që mund t’i sjellë ajo. Rasti tjetër, po ashtu i iniciuar nga një grup deputetësh pranë Gjykatës Kushtetuese, që kontestonte vendimin e Kuvendit të Kosovës për zgjedhjen e Presidentit, doli të jetë shkelje e radhës serioze e Kushtetutës. Kësaj here u kontestuan procedurat e zgjedhjes së Presidentit të Republikës së Kosovës, në vazhden e kompletimit të institucioneve të dala nga zgjedhjet. Aktvendimi i Kuvendit të Kosovës nr.04.v.04, zgjedhjen e Presidentit të Kosovës e shpalli që ishte jokushtetuese, për faktin që ishte në kundërshtim me kërkesat e nenit 86 të Kushtetutës dhe parimet demokratike të mishëruara aty¹⁵². Që të dyja këto raste, që u cilësuan si shkelje të Kushtetutës, paraqitën një krizë politike, e para përfundoj me zgjedhje, ndërsa e dyta, me një konsensus politik në mes të tri partive politike, në mënyrë që të shmangeshin zgjedhjet e parakohshme, për shkak të dështimit në kompletimin e institucioneve, përkatësisht zgjedhjen e Presidentit¹⁵³.

¹⁵¹ Shiko Kushtetuta e Republikës së Kosovës

¹⁵² Aktgjykimi i Gjykatës Kushtetuese, nr.Ko, 29/11, 30, mars 2011.

¹⁵³ Kriza politike e krijuar pas shpalljes jo kushtetues të vendimit të Kuvendit të Kosovës, për

Për me tepër, u krijua një krizë politike që prodhoi vendime politike për zgjedhjen e Presidentit të ardhshëm të Republikës së Kosovës, përmes të ashtuquajturit “zarf”, i mbështetur edhe nga Ambasada Amerikane. Prandaj, me konsensus tripartiak, për President të Republikës së Kosovës u zgjodh znj. Atifete Jahjaga. Përmes dy shkeljeve të lartpërmendura kushtetuese dhe zgjedhjes me konsensus të Presidentes Jahjaga, u vu në pikëpyetje roli i Presidentit të Republikës së Kosovës, sidomos karshi mandatit të unitetit të popullit. Njëherit, kjo formë e zgjedhjes së Presidentit përbën një mënyrë **sui generis** të zgjedhjes, vetëm për të shmangur krizën më të thellë politike që mund të ishte krijuar. Këtu shihet qartë se partitë politike, e sidomos ato më të mëdha, duke u pozicionuar sipas interesave, qoftë personale apo partiake, ka imponuar ndërhyrjen e mekanizmave të jashtëm për ta shmangur një bllokadë të pafund dhe zhvlerësimin e pozitës së Presidentit. Ky veprim, respektivisht imponim për ndërhyrja nga jashtë, ishte shkelje kushtetuese, e cila shprehimisht thotë zgjedhjen e Presidentit, si dhe ishte një pengesë e procesit të konsolidimit dhe forcimit të demokracisë. Emërimi i znj. Jahjaga si Presidente e Republikës së Kosovës përjashtoi çdo normë demokratike dhe vullnetin e popullit, sepse ky emërim nuk e kishte burimin nga institucioni, i cili merr legjitimitetin e popullit.

Në kuadër të marrëveshjes, partitë rivale politike gjithashtu ishin marrë vesh që menjëherë ta fillojnë një proces të ndryshimit të Kushtetutës dhe legjislacionit zgjedhor, duke ndryshuar formën e zgjedhjes së Presidentit të vendit, pra që ai të zgjidhet nga vota e drejtpërdrejtë e qytetarëve. Përkundër që kanë kaluar disa vite që kur janë themeluar komisione të veçanta në adresimin e

zgjedhjen e Presidentit, për të dalë nga kriza e krijuar dhe për të shmangur zgjedhjet e parakohshme, presidenti i Republikës së Kosovës u zgjodh me një konsensus të gjerë politik, në kuadër të një marrëveshje, e nënshkruar nga liderët e tri partive politike në Kosovë PDK-LDK-AKR.

këtyre çështjeve, puna e tyre pa asnjë kuptim logjik dhe praktikë, ka mbetur peng i tekeve personale dhe politike të lidërshit politik në vend. Kjo shton gjasat që situatave të kaluara të zgjedhjes së Presidentit, në këtë formë të prodhoj edhe kriza të tjera politike.

Në përgjithësi, pra zgjedhja e Presidentit të Republikës së Kosovës në votim në Kuvendin e Republikës së Kosovës, përveç që ka prodhuar kriza të vazhdueshme politike të paraqitura më sipër, seriozisht ka dëmtuar dhe po dëmton edhe kredibilitetin e kësaj pozite të unitetit dhe gjithashtu dëmton konsolidimin normal të demokracisë në vend.

V.4.2 Fushatat elektorale dhe pozita e Presidentit

“Në momentin që jam zgjedhur President, për mua ka përfunduar çdo autoritet sa u përket partive politike në Kosovë (...).” kështu ishte shprehur Presidenti Thaçi, i cili kishte synimin që të dërgonte një mesazh se kompetencat e dala nga Kushtetuta e Republikës së Kosovës për pozitën e Presidentit do respektohen përfshirë këtu edhe mospërzierja në aktivitetet e çfarëdolloj partie politike. Megjithatë, ai nuk arriti t’i përmbahet premtimit të tij të dhënë, duke u kyçur në aktivitete që kishin për qëllim që gjatë fushatës elektorale, ta ndihmonte partinë, të cilës i përkiste. Ai vazhdoi të bëjë fushatë elektorale “(...) dhe duhet pranuar se Presidenti Thaçi, në sytë elektoratit, vazhdon që më shumë të shihet si person politik, se sa si person i kufizuar në përfaqësimin e unitetit të popullit të Republikës së Kosovës.”¹⁵⁴ Pjesëmarrja nëpër takime me qytetarët në kohën e fushatës elektorale

¹⁵⁴ Bajraktari Gresa: Presidenti Thaci shek Kushtetuten, I del ne ndihme PDK-se, ne: <http://www.botasot.info/politika-lajme/710068/presidenti-thaci-shkel-kushtetuten-i-del-ne-ndihme-pdk-se/>, qershor 2017. E qasur: Tetor 2018.

nga ana e Presidentit Thaçi është një argument që pozita e Presidentit të Republikës së Kosovës akoma nuk ka fituar një kulturë që të respektoj Kushtetutën e Republikës së Kosovës.

V.4.3 Roli i Presidentit të Republikës së Kosovës karshi dialogut me Serbinë

Ndarja e pushteteve sot më tepër ka një kuptim të ndarjes së përgjegjësi kushtetuese në ushtrimin e autorizimeve, të cilat u ngarkohen degëve të veçanta të pushtetit. Mirëpo, e veçanta e sistemeve parlamentare është ekzistimi i Presidentit, si kreu i shtetit, krahas një qeverie e cila është e ngarkuar me detyra ekzekutive.

Për t'u kuptuar pozita e kreut të shtetit në sistemin parlamentar duhet t'u referohemi interpretimeve kushtetuese bashkëkohore. Mirëpo, para se të shpjegojmë domethënien bashkëkohore të rolit që ka Presidenti në sistemet parlamentare, duhet të theksojmë se sistemi parlamentar i qeverisjes (në një republikë, jo në monarki) u shfaq në Gjermani në vitin 1919. Sipas Kushtetutës së Vajmarit, presidenti zgjidhej drejtpërdrejt nga populli dhe ishte menduar si një zëvendësues i monarkut, i cili përmes zgjedhjes së drejtpërdrejtë do të mund të vendoste një ekuilibër mes ekzekutivit dhe legjislativit. Me theks të veçantë, kufizimin e autoritetit të parlamentit. Zgjedhja e drejtpërdrejtë e kishte fuqizuar edhe rolin dhe pozicionin e tij kushtetues.

Mirëpo, ky model i qeverisjes ishte treguar i pasuksesshëm, sepse me kalimin e kohës Presidenti kishte ndërtuar një autoritet diktatorial karshi Parlamentit, sidomos duke u bazuar në kompetencat e tij kushtetutëdhënëse. Me kalimin e kohës, u anashkalua tërësisht roli i parlamentit si organ legjislativ dhe u zëvendësua me akte presidenciale, të cilat në raste të caktuara kishin rang

kushtetues. E drejta për ta shpërndarë parlamentin u kthye në mekanizëm të kalkulimeve personale të Presidentit dhe sa herë që kishte mospajtime e ushtronte këtë të drejtë.

Gjykatat Kushtetuese, bashkëkohore në vendimet e tyre, kanë konstatuar se presidenti i shtetit në një sistem parlamentar nuk duhet të shikohet si pjesë e cilitdo prej pushteteve. Ai është kreu i shtetit dhe nuk është i ngarkuar me detyra ekzekutive ose legjislative, pavarësisht që ka rol ceremonial në këto procese. Mirëpo, ai është i zhveshur nga kompetenca vetanake. Atij i takon e drejta të informohet nga ekzekutivi për politikën e brendshme dhe të jashtme dhe i shpall ligjet. Pavarësisht që ai nënshkruan marrëveshjet ndërkombëtare, presidenti i shtetit në sistemet parlamentare nuk e shpreh vullnetin e tij (as si person, as si institucion), por ai vepron në bazë të autorizimeve të ekzekutivit ose legjislativit. Nëse ka dilema për kushtetutshmërinë e një akti, atëherë ai i drejtohet Gjykatës Kushtetuese, për dallim nga kompetencat që kishte në fillim të shek. XX, kur i njëjti e drejta e kontrollit material kushtetues, sot një e drejtë e tillë nuk i njihet.

Presidenti ka funksion reprezentativ (brenda dhe jashtë), por nuk është reprezentues i vullnetit të tërësisë. Ai mund të konsiderohet si përfaqësues i tërësisë, ngjashëm sikurse një i autorizuar në proceset juridike civile ose penale, i cili ndërmerr veprime në emër dhe për një person tjetër. Dallimi në mes të termeve reprezentim dhe përfaqësim në të drejtën kushtetuese më së lehti sqarohet me një analogji në mes të termeve sundim dhe qeverisje. Pavarësisht që tingëllojnë të njëjta, ato esencialisht kanë kuptime të ndryshme.

Elaborimet e mësipërme vetëm sa e kanë krijuar një pasqyrë më të qartë rreth mitit që kanë krijuar ata që janë afër Presidentit të Kosovës se ai ka kompetencë që buron nga Kushtetuta për të

udhëhequr bisedimet me Serbinë. Doktrina dhe praktika kushtetuese i ka sqaruar sipas metodave të interpretimit kushtetues rolet, funksionet dhe pozicionet e organeve kushtetuese në të gjitha aspektet.

Nuk ka dyshim se vetëm Kuvendi si tërësi, ka autorizime për të shprehur vullnetin politik të tërësisë. Pavarësisht të metave që janë shfaqur në praktikën parlamentare të Kosovës, nuk mund të mohohet pozicioni juridik dhe doktrinar i Kuvendit si reprezentues i vetëm i popullsisë. Obligimi i ratifikimit të marrëveshjeve ndërkombëtare që kanë të bëjnë me paqen, territorin, aleancat ose edhe integritetin në bashkësinë ndërkombëtare nga ana e Parlamentit, na kujtojnë vitin 1791, kur për të parën herë në Francë u kufizua pushteti i kreut të shtetit. Kësisoj, me të drejtë konstitucionalistët konstatojnë se pikërisht ratifikimi i marrëveshjeve të karakterit të tillë e shpërfaqin dominimin e Parlamentit si reprezentues, ndërsa kreun e shtetit si një përfaqësues, i cili, si thotë Schmitt, formalisht i shkëmben ose dorëzon certifikatën ose notën e ratifikimit të një marrëveshjeje ndërkombëtare.

Për më tepër, Presidenti i Shtetit nuk ka mekanizëm për të garantuar ratifikimin e një marrëveshjeje ndërkombëtare, pavarësisht që atë e zgjedh Kuvendi, për shkak se është i zhveshur nga kompetencat ekzekutive. Historia kushtetuese ka regjistruar raste kur parlamentet kanë hezituuar ta ratifikojnë një marrëveshje ndërkombëtare, por edhe raste kur qeveritë që kanë ardhur më pas kanë refuzuar të marrin përsipër obligimet ndaj shteteve të tjera, të cilat kanë qenë rezultat i marrëveshjeve ndërkombëtare të lidhura nga paraardhësit e tyre. Prandaj, pozicioni kushtetues i Presidentit të Republikës së Kosovës duhet të shikohet në kuadër të tërë sistemit kushtetues. Normat kushtetuese nuk guxojnë dhe nuk mund të lexohen si të shkoqitura. Pavarësisht deklaratave të Presidencës së

Kosovës ose të Shefit të Grupit Parlamentar të ish-partisë së presidentit se Kushtetuta e mandaton dhe atë për të udhëhequr dialogun me Serbinë, është fakt se veprimet e tij në Bruksel janë tejkalim i kompetencave kushtetuese dhe cenim i rendit kushtetues. Presidenti nuk e ka përkrahjen e Kuvendit të Republikës së Kosovës për ta udhëhequr këtë dialog.

Në anën tjetër, Kosova ende nuk ka një konsensus të të gjithë spektrit politik për dialogun, ndërsa qeveria aktuale nuk është e gatshme dhe nuk ka ndonjë vullnet të udhëheq këtë dialog sikurse qeveritë e kaluara. I gjithë procesi i dialogut ndërmjet Kosovës dhe Serbisë është karakterizuar me mungesë llogaridhënie nga përfaqësuesit e Republikës së Kosovës. Si një dialog i elitave, nuk është konsideruar si një proces i mirëfilltë llogaridhënës, i cili zhvillohet nga poshtë-lartë dhe garanton gjithëpërfshirje dhe transparencë.¹⁵⁵ Duke qenë një dialog pa konsensus, Presidenti i Republikës së Kosovës praktikisht ka fituar terrenin që të dal më i fuqishëm nga të gjitha institucionet tjera shtetërore, pra Kuvendin dhe Qeverinë. Ai si i vetëm po udhëheq një dialog i cili në fund të procesit nuk mund të kalojë pa pasoja dhe marrëveshje të dhimbshme për të dyja palët siç thotë edhe ai vet. Pra, roli që po luan Presidenti i Republikës së Kosovës karshi dialogut me Serbinë tregon edhe njëherë se pozita e Presidentit si individ është më i fuqishëm se institucionalizimi, gjë që “veprimet e tij janë jokushtetuese dhe rrjedhimisht ai është duke shkelur Kushtetutën, meqë nuk është në mandatin e Presidentit dhe as që ka kapacitetet e duhura për një dialog të tillë.”¹⁵⁶

¹⁵⁵ Shih Bieber, F. (2015). “The Serbia-Kosovo Agreements: An EU Success Story?” Review of Central and East European law 40 (2015) 285-319, dhe Beha, A. (2015). Disputes over the 15-points agreement on normalization of relations between Kosovo and Serbia. Nationalist papers 43(1), 102-12. E qasur: Tetor 2018.

¹⁵⁶ Rushiti Natyra: Presidenti po e shkel Kushtetutën, 05 Korrik 2017, në: <http://zeri.info/aktuale151483/presidenti-po-e-shkel-kushtetuten/>. E qasur: Tetor 2018.

Pra, çasja e tij karshi dialogut si dhe marrëdhëniet e tij me Kuvendin e Republikës së Kosovës janë në kundërshtim me normat kushtetuese, ku si rezultat i kësaj veprimet e tij, respektivisht pozicionimi i fuqishëm i pozitës së Presidentit, vë në pikëpyetje konsolidimin e mirëfilltë të institucioneve demokratike dhe vet zhvillimin e demokracisë në Kosovë.

Si **përfundim**, duke u bazuar në analizën dhe në argumentet që u cekën në këtë kapitull, vijmë në përfundim se pozita e Presidentit në Republikën e Kosovës, që nga themelimi i saj, u është ekspozuar sfidave dhe parregullsive të ndryshme, ku si pasojë është vënë në pikëpyetje kredibiliteti i kësaj pozite. Mënyra se si janë zgjedhur presidentët deri më tani ka qenë jo në frymën e demokracisë, sepse ata ose janë votuar me vështirësi nga Kuvendi ose janë zgjedhur në mënyrë jo të rregullt, duke përjashtuar çdo normë demokratike dhe kushtetuese, siç është rasti i ish-Presidentes, znj. Jahjaga.

Faktori tjetër që ka nxitur debat lidhur me shkeljet kushtetuese nga ana e presidentëve, është edhe përfshirja apo të qenit nën petkun e partive pjesë e të cilave kanë qene apo edhe vazhdojnë të jenë. Poashtu, veprimet jashtëkushtetuese të pozitës së Presidentit, siç kemi rastin e dialogut me Serbinë, e ka bërë edhe më të komplikuar dhe tejet të debatueshëm pozicionin e Presidentit karshi dialogut, sepse Presidenti nuk është mandatuar nga Kuvendi për të negociuar me Serbinë. Një vet-emërim/mandatim në krye të dialogut del përtej kompetencave presidenciale, të cilat i thotë shprehimisht Kushtetuta e Republikës së Kosovës.

Me vet faktin që Republika e Kosovës nuk është vend/sistem Presidencial por Parlamentar, është në mandatin e Kuvendit të Kosovës që të mandatojë subjektin, i cili do të dialogonte me Serbinë.

Të gjitha këto janë argumente që mënyra se si janë zgjedhur presidentët e Republikës së Kosovës si dhe mënyra se si udhëheqin me këtë pozitë, e ka penguar dhe mund të vazhdoj ta pengoj konsolidimin e demokracisë në Kosovë.

KAPITULLI VI – Roli i mekanizmave ndërkombëtarë në konsolidimin e demokracisë në Kosovë

VI.1. Roli i BE-së

Me rënien e Murit të Berlinit, Komuniteti Evropian e kishte parashikuar së të gjitha shtetet që ishin nën influencën e Bashkimit Sovjetik do shprehin gatishmërinë që të behën pjesë e kësaj organizate. Për këtë, KE/BE filloi që të hartoj mekanizma, të cilët do t'i paraprijnë anëtarësimit të shteteve të Evropës Qendrore dhe asaj Lindore. Një ndër mekanizmat e parë ishte Marrëveshja e Stabilizim-Asocimit, nëpërmjet së cilës KE/BE filloi që t'i vëj themelet e bashkëpunimit me vendet e Evropës Qendrore dhe Lindore, i cili bashkëpunim do t'i paraprijë parapërgatitjes për tu bërë anëtare të plota të BE-së.

Në vitin 1991 KE/BE ka përfunduar Marrëveshjen e Stabilizim-Asocimit me Poloninë, Çekosllovakinë dhe Hungarinë. Në vitin 1993 rezultojë po e njëjta marrëveshje me Rumaninë, Bullgarinë, me Çekinë dhe Sllovakinë si shtete të ndara si dhe në vitin 2005-2006 me shtetet baltike, përfshirë këtu edhe Slloveninë.¹⁵⁷

¹⁵⁷ Andreas Polkowski: Die mittel- und osteuropäischen Länder auf dem Weg in die EU, në:

Duke e ditur se shtetet asociuese të lartcekura kishin dalur nga një sistem krejtësisht tjetër organizativ dhe shtetëror, patjetër iu desh që të kalojnë nëpër një proces të transformimit, në kuadër të të cilit duhet t’i përmbushnin disa kushte që i kishte vënë BE-ja.

Si rrjedhojë e kësaj, Këshilli Evropian në vitin 1993¹⁵⁸ në Samitin e Kopenhagës formuloi disa kritere, ndryshe të quajtura edhe Kriteret e Kopenhagës, të cilat duhet të plotësohen nga vendet potenciale për t’u bërë anëtarë e BE-së.

VI.1.1 Mekanizmat e para-anëtarësimit - Kriteret e Kopenhagës

Bashkimi Evropian si organizatë e hapur për shtetet që shtrihen në Kontinentin e Evropës dhe” (...) që respekton vlerat demokratike të BE-së, mund të aplikojnë për anëtarësim në Bashkim. Përveç kësaj, vendi duhet të ketë institucione të qëndrueshme që garantojnë demokracinë dhe sundimin e ligjit, të ketë një ekonomi funksionale të tregut dhe aftësinë për të marrë dhe përmbushur detyrimet e anëtarësimit në BE.”¹⁵⁹

Pra, sipas kësaj “çdo shtet Evropian, i cili respekton vlerat e përmendura në nenin 2 të (TBE-së) dhe është i angazhuar për nxitjen e tyre , mund të kërkojë të bëhet anëtar i Bashkimit.”¹⁶⁰

file:///C:/Users/bekim.podrimqaku/Downloads/111-116-Polkowski.pdf, faqe 111. E qasur: Mars 2018

¹⁵⁸ Die wichtigsten Etappen des Aufbaus der Europäischen Union, në: <http://de.strasbourg-europe.eu/die-wichtigsten-etappen-des-aufbaus-der-europaischen-union,3375,de.html>. E qasur: Mars 2018.

¹⁵⁹ Westbalkan: Die Zukunft der EU-Erweiterung, në: <http://www.europarl.europa.eu/news/de/headlines/world/20180126STO94113/westbalkan-die-zukunft-der-eu-erweiterung>. E qasur: Mars 2018.

¹⁶⁰ Neni 49 I TBE-së

Sipas këtij neni (2) “Bashkimi ka në themele vlerat e respektimit të dinjitetit të njeriut, lirisë, demokracisë, barazisë, shtetit të së drejtës dhe respektimit të të drejtave të njeriut, duke përfshirë të drejtat e personave që u përkasin pakicave.”¹⁶¹

Siç u cek në kapitullin e mësipërm, si kusht për anëtarësimin e anëtarëve të rinj, duhet që të përmbushen kriteret e përcaktuara nga BE, përfshirë këtu edhe ato të Kopenhagës.

Kriteret e Kopenhagës në kuadër të procesit të transferimit edhe të shteteve të Ballkanit Perëndimor, kanë për qëllim që këtyre shteteve në rrugëtimin e tyre për tu bërë anëtare të BE-së, në një mënyrë edhe t’iu imponohet ndërtimi i institucioneve stabile, demokratike si dhe konsolidimi i demokracisë.

BE nuk do të thotë se vetëm paraqet kushtet, por ajo ofron edhe “shpërblimet” për rezultatet që arrihen nga shtetet përkatëse. Në rast se shtetet kandidate neglizhojnë në përmbushjen e kriterëve, BE ka edhe mekanizmin sanksionues.

VI.1.1.1 Kriteri Politik

Kriteri Politik ka për qëllim që shtetet potenciale për t’u bërë anëtare të BE-së, së pari duhet të ndërtojnë institucione stabile dhe të qëndrueshme, të cilat do të garantojnë rend demokratik dhe kushtetues, respektimin e drejtave të njeriut, respektimin e drejtave dhe mbrojtjen e pakicave.

Ky kriter është i një rëndësie të veçantë për shtetet që kanë dalë nga sistemet totalitare, apo që janë krijuar, sepse përgjatë procesit të plotësimit të këtij kriteri, ato formojnë institucione stabile dhe demokratike, të cilat i paraprijnë konsolidimit të demokracisë.

¹⁶¹ Neni 2 i TBE-së.

Pra, këtu shihet se Bashkimi Evropian, nëpërmjet këtij kriteri i kushtëzon shtetet që aspirojnë këtë organizatë, që paraprakisht të ndërtojnë një shtet ligjor me institucione të qëndrueshme, ku puna dhe pavarësia e të cilave garantohet me Kushtetutë. Ky kushtëzim në një farë mënyre ka ndihmuar shtetet në tranzicion në konsolidimin e demokracisë.

Duke marrë për bazë se edhe Kosova ka perspektivën në Bashkimin Evropian, si dhe aspirojnë që të bëhet pjesë e saj, ajo është e vetëdijshme se përmbushja e kriterit politik nuk ka alternativë tjetër, pra, medoemos duhet të përmbushet. Gjatë plotësimit të këtyre kriterëve, në të njëjtën kohë do zhvillohet edhe konsolidimi i demokracisë.

VI.1.1.2 Kriteri Ekonomik

Kriteri ekonomik bën pjesë po ashtu në mekanizmat e paraantarësimit në Bashkimin Evropian, të cilin duhet ta përmbushin shtetet që janë në rrugën e integritimeve evropiane. Me plotësimin e këtij kriteri, shtetet kandidate arrijnë nivelin e një ekonomie të tregut funksional, të cilat do të kenë aftësinë për t'i përballuar presionit të konkurrencës së tregut të brendshëm të Bashkimit Evropian.

Sa i përket kriterëve ekonomike, Republika e Kosovës si shtet i ri, vazhdon që të mos ketë ekonomi të qëndrueshme dhe stabile si rezultat i prodhimit të ulët, papunësisë së lartë, ekonomisë informale e deficitit të lartë tregtar.

Sipas kësaj, ekonomia e Republikës së Kosovës është në një fazë të hershme të zhvillimit të një ekonomie të tregut funksional. Këtë vlerësim e thotë në mënyrë eksplicite edhe raporti i progresit i komisionit Evropian.¹⁶²

VI.1.1.3 Kriteri i përafrimit të legjislacionit Kosovar me atë të BE-së

Një rol qendror në procesin e integritetit të një shteti në Bashkimin Evropian e luan edhe marrja e detyrimeve ligjore (Acquis Communautaire), që dalin nga kjo organizatë si dhe implementimi i tyre.

Harmonizimi, respektivisht përafrimi i legjislacionit të shtetit aspirant me atë të Bashkimit Evropian, është një nga mekanizmat që imponon këto shtete së paku të ndërtojnë një bazë ligjore , e cila është në shërbim të konsolidimit të demokracisë. Me vetë faktin që për shtetin aspirant/kandidat çdo vit bëhet raporti i progresit, në bazë të tij Bashkimi Evropian vlerëson se sa është bërë progres në realizimin e kriterëve që iu janë vënë shteteve kandidate. Në rastin e Republikës së Kosovës këta mekanizma, sikur edhe të vendet e tjera, kanë ndikuar në bërjen e një legjislacioni që reflekton vlerat e Bashkimit Evropian, por mbetet që ato edhe më tej të zbatohen në praktikë.

Për Republikën e Kosovës përafrimi i legjislacionit me atë të BE-së nuk ka paraqitur sfida dhe as nuk paraqet, por implementimi është zhvilluar dhe vazhdon me një ritëm të ngadaltë. Sipas raportit

¹⁶² Shiko Raportin e Progresit për Kosovën të Kom. Evropian 2018.

të Progresit 2018, Kosova ka vazhduar në “përafrimin e legjislacionit por implementimi në disa fusha është i dobët (...)”¹⁶³

Përafrimi i legjislacionit si dhe implementimi i tij së pari është jetik për konsolidimin e demokracisë dhe pastaj për integrimin e Republikës së Kosovës në BE.

VI.1.1.4 Marrëdhëniet BE – Kosovë

Që nga hyrja në fuqi e Rezolutës 1244 të Këshillit të Sigurimit në vitin 1999, BE-ja është përfshirë në mënyrë të drejtpërdrejtë në procesin e ndërtimit të paqes në Kosovë. Ajo fillimisht ishte përgjegjëse për rindërtimin ekonomik dhe ndihmën financiare, pra BE-ja mbante barrën financiare për rindërtimin e Kosovës dhe ishte shumë e suksesshme në ndihmën për zhvillimin dhe ndërtimin e infrastrukturës si dhe në zhvillimin ekonomik.¹⁶⁴

Pra, edhe pse Kosova deri në vitin 2008 nuk ishte shpallur shtet i pavarur, “(...) prej vitit 1999, Bashkimi Evropian ka luajtur një rol udhëheqës në përpjekjet ndërkombëtare për ndërtimin e një të ardhmeje të re për Kosovën. Kosova ka një perspektivë të qartë në Evropë, si pjesë e rajonit më të gjërë të Ballkanit Perëndimor.”¹⁶⁵

Politikat në raport me Kosovën, Bashkimi Evropian i zhvillon nëpërmjet “(...) përfaqësuesit të saj special (EUSR) dhe misionit të politikës së sigurisë dhe mbrojtjes së Evropës (ESDP) (...) edhe

¹⁶³ Shiko Raportin e Progresit për Kosovën të Kom. Evropian 2018.

¹⁶⁴ Shkelzen Hasani: Die Rolle der EU im Friedenskonsolidierungsprozess im Kosovo, 2011.

¹⁶⁵ Marrëdhëniet politike, në https://eeas.europa.eu/delegations/kosovo_sq/7641/Kosova%20dhe%20BE-ja. E qasur: Prill 2018.

nëpërmjet ambasadave dhe zyrave ndërlidhëse të shteteve.”¹⁶⁶ Po ashtu, Zyra e Bashkimit Evropian në Republikën e Kosovës (...) luan një rol thelbësor në zbatimin e agjendës së BE-së në terren, veçanërisht në promovimin e standardeve evropiane, (...) ajo garanton dialog të përhershëm politik dhe teknik ndërmjet institucioneve të Kosovës dhe të BE-së.”¹⁶⁷

Pas shpalljes së Pavarësisë, Bashkimi Evropian, me ftesën që i është bërë nga shteti i Kosovës, dërgoi edhe një ndër misionet më të mëdha civile, i cili do ta luante rolin e një mekanizmi që do jepte mbështetje, “(...) ndihmës për autoritetet kosovare në sferën e sundimit të ligjit, veçanërisht në polici, në sistemin gjyqësor dhe në dogana.”

Ky mission, edhe pse ishte i ngarkuar të monitoroj, këshilloj institucionet përkatëse të Republikës së Kosovës, nuk ka treguar edhe aq sukses në forcimin e konsolidimit të demokracisë, respektivisht në forcimin e ushtrimit të kompetencave nga ana e gjyqësorit pa u ndikuar nga politika.

Për prezencën e mospavarësisë së sistemit gjyqësor flet edhe raporti i Komisionit Evropian për Kosovën 2018. Sipas këtij raporti, (...) *The judiciary is still vulnerable to undue political influence and rule of law institutions need sustained efforts to build up their capacities. The administration of justice remains slow and inefficient.*¹⁶⁸

VI.1.1.5 Marrëveshja e Stabilizim-Asocimit

Mekanizmi i radhës nëpërmjet të cilit Bashkimi Evropian ka thelluar marrëdhëniet me Republikën e Kosovës është edhe Marrëveshja e Stabilizim-Asocimit. Kjo marrëveshje është e një rëndësie të

¹⁶⁶ Po aty.

¹⁶⁷ Po aty.

¹⁶⁸ Commission Staff Working document, Kosovo 2018 Report, Strasbourg, 17.4.2018
SWD(2018) 156 final.

veçantë për Kosovën, sepse është një ndër marrëveshjet e para kontraktuale me Bashkimin Evropian, e cila karakterizohet me thellimin e bashkëpunimit në mes Kosovës dhe Bashkimit Evropian. Kjo marrëveshje, e cila hyri në fuqi në Prill 2016 u cilësua si arritje, nga përfaqësuesja e lartë e Bashkimit Evropian, Federica Mogherini, ku sipas saj “Marrëveshja e Stabilizim-Asocimit e hap një kapitull të ri në marrëdhëniet midis BE-së dhe Kosovës. Ky është një kontribut i rëndësishëm për stabilitetin dhe prosperitetin në Kosovë¹⁶⁹ (...)”

Për të shkuar procesi mirë drejt Marrëveshjes së Stabilizim-Asocimit, Bashkimi Evropian praktikon tri faza:

Në fazën e parë BE ofron hapjen e tregjeve dhe ndihmën financiare si dhe atë politike, ndërsa si kompensim kërkon hapa serioz drejt reformave politike dhe ekonomike sipas Kriteve të Kopenhagës.

Faza e dytë fokusohet në Negocimin dhe implementimin e Marrëveshjes së Stabilizim-Asocimit. Në këtë fazë, Bashkimi Evropian, përmes një hapësire të tregut të lirë me BE-në i lejon ekonomitë e shteteve përkatëse të fillojnë të integrohen në ekonomitë e Bashkimit Evropian. Këtë BE-ja e ka realizuar nëpërmjet preferencave autonome tregtare, të cilat mund të vlerësohen si instrument bazë për të rregulluar marrëdhëniet në mes Kosovës dhe BE-së.¹⁷⁰ Kosova ishte pjesë e këtyre preferencave deri në vitin 2010, ku për shkak të mospërgjegjësisë së institucioneve të Kosovës, BE-ja suspendoi preferencat tregtare për Kosovën, sepse “(...) Komisioni Evropian u është drejtuar me

¹⁶⁹ Stabilisierungs- und Assoziierungsabkommen (SAA) zwischen der Europäischen Union und dem Kosovo unterzeichnet, ne: <http://www.consilium.europa.eu/de/press/press-releases/2015/10/27/kosovo-eu-stabilisation-association-agreement/>. E qasur : Maj 2017.

¹⁷⁰ Këshilli i Bashkimit Evropian, në: https://www.parlament.gv.at/PAKT/EU/XXV/EU/14/61/EU_146145/imfname_10726021.pdf. E qasur: Prill 2017.

shkrim në shtator-tetor të vitit 2010 Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë, që ta bëjë një analizë se sa është aspekti kuantitativ i pranisë së produkteve kosovare në tregun evropian. Për fat të keq, një përgjigje e tillë nuk ka ardhur nga MTI-ja dhe për këtë arsye ka ardhur deri te pezullimi i pranisë së produkteve kosovare në tregun evropian.”¹⁷¹

Në vitin 2011 Parlamenti Evropian dhe Këshilli Evropian miratuan rregulloren e ndryshuar dhe plotësuar (BE Nr. 1336/2011¹⁷²), ku nëpërmes të cilës ripërtërihet e drejta e tregtisë së lirë e BE-së me Kosovën. Sipas kësaj rregulloreje, deri në fund të vitit 2015 produktet me origjinë nga Kosova mund të eksportoheshin në tregun e BE-së pa paguar tarifa doganore si dhe pa pasur kufizime sasiore.

Faza e tretë koncentrohet në mbështetje nëpërmjet të cilës Kosovës i është vënë në dispozicion një ndihmë e madhe, ashtu që ato të përmbushin obligimet e fazës së parë dhe të dytë.

Qëllimi i Marrëveshjes së Stabilizim-Asocimit është që të mbështesë përpjekjet e Kosovës në përmirësimin e demokracisë dhe sundimit të ligjit, të kontribuojë në stabilitetin politik, ekonomik dhe institucional në Kosovë si dhe stabilitetin e rajonit, të krijojë një kuadër të përshtatshëm për dialog politik, që do ta mundësonte zhvillimin e marrëdhënieve politike më të afërta midis palëve, të mbështesë përpjekjet e Kosovës për përmirësimin e bashkëpunimit ekonomik dhe ndërkombëtarë, përfshirë edhe përafrimin e legjislacionit nacional me atë të BE-së, të mbështesë përpjekjet e Kosovës për ta bërë kalimin në një sistem funksional të ekonomisë së tregut si dhe për ta finalizuar atë, të nxisë marrëdhënie të balancuara ekonomike midis BE-së dhe Kosovës dhe

¹⁷¹ Sipas Kryetarit të Odës Ekonomike të Kosovës, Safet Gëxhaliu 14 prill 2011.

¹⁷² Verordnung (EU) Nr. 1336/2011 des Europäischen Parlaments und des Rates vom 13. Dezember 2011 zur Änderung der Verordnung (EG) Nr. 1215/2009 des Rates zur Einführung besonderer Handelsmaßnahmen für die am Stabilisierungs- und Assoziierungsprozess der Europäischen Union teilnehmenden oder damit verbundenen Länder und Gebiete.

kështu gradualisht për të krijuar një zonë të tregtisë së lirë, si dhe të promovoj bashkëpunimin rajonal në të gjitha fushat që mbulohen nga kjo marrëveshje.¹⁷³

VI.1.1.6 Mbështetja financiare - Instrumenti ndihmës për para-anëtarësim IPA

Në kuadër të politikave të zgjerimit, Bashkimi Evropian ka hartuar edhe instrumentet para-antarësuese, me qëllim që të mbështeten shtetet të cilat janë në rrugën drejt integriteteve evropiane.

Duke marrë për bazë se edhe shtetet e Ballkanit Perëndimor, sikur ato që ishin nën influencën e Bashkimit Sovjetik, kishin trashëguar një sistem të ndryshëm nga ai që ishin të organizuara Shtetet e Bashkimit Evropian, ka qenë e domosdoshme që ky sistem t'i nënshtrohet procesit të transformimit dhe përafrimit me atë të BE-së. Në kuadër të transformimit të këtyre shteteve, instrumentet para-antarësuese kanë luajtur dhe luajnë një rol tejet të rëndësishëm, sepse pa këto instrumente mbështetëse shtetet kandidate nuk do kishin qenë në gjendje për t'u mbështetur në forcat vetanake, në mënyrë që të përshpejtojnë transformimin, konsolidimin e demokracisë si dhe integritet e tyre në BE për shkak të implikimeve buxhetore.

Këto instrumente, jo vetëm që kanë karakter mbështetës për shtete kandidate, por përmes tyre, Bashkimi Evropian edhe ushtron presion ndaj tyre nëse këto shtete stopojnë apo neglizhojnë në përmbushjen e kritereve.

Në kuadër të këtyre instrumenteve para-antarësuese bën pjesë edhe Instrumenti IPA për të cilin kuadri ligjor është krijuar nëpërmjet Rregullores së Këshillit të Ministrave të BE-së Nr. (EG)

¹⁷³ Shiko: Stabilisierungs- und Assoziierungsabkommen zwischen der Europäischen Union und der Europäischen Atomgemeinschaft einerseits und dem Kosovo* andererseits, Brüssel, den 2. Oktober 2015.

1085/2006 si dhe dispozitat përkatëse për zbatimin e Rregullorës (EG) 718/2007 të Komisionit Evropian.¹⁷⁴

Ky instrument zëvendësoi instrumentet financiare të para-anëtarësimit 2000-06 PHARE, ISPA, SAPARD, dhe instrumentin financiar për Ballkanin Perëndimor CARDS dhe tani ai vë në dispozicion ndihmën financiare për shtetet në procesin e integritimeve evropiane nëpërmjet pesë komponentëve:

1. ndihmën për tranzicion dhe ndërtimin e institucioneve,
2. bashkëpunimin ndërkufitar,
3. zhvillimin rajonal,
4. zhvillimin e resurseve njerëzore, dhe
5. zhvillimin rural

Përfitues nga ky program i IPA-s është edhe Republika e Kosovës e që menaxhohet nga zyra ndërlidhëse e Komisionit Evropian. Deri në vitin 2020, për Kosovën janë alokuar 645.5 milion¹⁷⁵ euro, me qëllim që ta mbështesë Republikën e Kosovës në Reformimin e shërbimit civil, përmirësimin e besueshmërisë, transparencës, llogaridhënies; ofrimin më efikas të shërbimeve publike; themelimin/forcimin e institucioneve demokratike, forcimin e demokracisë ekzistuese (qeverisja vendore, Kuvendi, organet e pavarura mbikëqyrëse). Veç kësaj, në kuadër të këtij programi, Kosova mbështetet në forcimin e sundimit të ligjit; luftës kundër korrupsionit dhe krimit

¹⁷⁴ Shiko rregullorën NR. EG1085/2006

¹⁷⁵ European Neighbourhood Policy And Enlargement Negotiations, në:
https://ec.europa.eu/neighbourhood-enlargement/instruments/funding-by-country/kosovo_en.
E qasur: Prill 2018.

të organizuar; zbatimin e ligjit për të drejtat e njeriut, dhe mbrojtjen e përfshirjen e grupeve minoritare.¹⁷⁶

Ky program e ngërthen në vete edhe mbështetjen e “hartimit dhe zbatimit të politikave të konkurrencës; ofrimin e shërbimeve publike që plotësojnë nevojat e sektorit privat si dhe përmirësimin e funksionimit të tregut të punës; ngritja e standardeve të arsimit; nxitja e zhvillimit të aftësive; ristrukturimin e sistemit të mirëqenies sociale (...)”.¹⁷⁷

Të gjitha këto fusha që u përmendën me lart natyrisht që janë komponente të konsolidimit të demokracisë.

VI.1.1.7 Roli i Organizatës për Siguri dhe Bashkëpunim Evropian (OSBE)

Sikur që akterët tjerë ndërkombëtarë që kanë qenë të përfshirë në aktivitetet që nga përfundimi i luftës në Kosovës në vitin 1999 edhe OSBE, si një ndër aktoret kryesorë, ka luajtur dhe vazhdon të luan një rol të veçantë në procesin e ndërtimit të institucioneve demokratike si dhe forcimin e tyre në mënyrë që të veprojnë sipas mandatit që ua garantojnë ligjet dhe kështu të shkohet drejt konsolidimit edhe të demokracisë.

Në vitin 1999 Këshilli¹⁷⁸ i Përhershëm i OSBE-së nxori Vendimin Nr. 305, në bazë të të cilit iu hap rruga që të dërgohet misioni në kuadër të OSBE-së.¹⁷⁹ Ky vendim ishte derivat edhe i Rezolutës 1244 të Këshillit të Sigurimit, që ishte nxjerr për Kosovën në vitin 1999.

¹⁷⁶ Po aty.

¹⁷⁷ Po aty.

¹⁷⁸ Organ i OSBE-së

¹⁷⁹ OSZE, Ständiger Rat , Beschluss Nr. 305, PC.DEC/305

“Mandati kryesor i Misionit është marrja e rolit udhëheqës në të gjitha çështjet që kanë të bëjnë me ndërtimin e institucioneve dhe të demokracisë, si dhe të drejtat e njeriut në Kosovë. Misioni e përqendron punën e vet, mes tjerash, në fushën e mbrojtjes dhe promovimit të të drejtave të njeriut dhe të komuniteteve; barazinë gjinore dhe pjesëmarrjen qytetare; aftësimin e personelit gjyqësor, Policisë së Kosovës dhe administratës publike; si dhe në ofrimin e mbështetjes në çështje të zgjedhjeve.”¹⁸⁰

OSBE jo vetëm që ishte fokusuar në ndërtimin e institucioneve, por edhe në qëndrueshmërinë e tyre, duke bërë kështu përpjeke për ta ndërtuar një kulturë demokratike, përfshirë këtu etabilimin e partitive politike në ndërtimin dhe zhvillimin e një shoqërie civile.

VI.1.1.8 Organizimi dhe mbikëqyrja e zgjedhjeve

Që nga viti 1999 OSBE ka mbështetur dhe promovuar mbarëvajtjen e zgjedhjeve në Kosovë. Kosova, si një vend i dalë nga lufta dhe pastaj si shtet i ri dhe i pavarur, nuk ka pasur rastin që të trashëgojë një traditë të organizimit të zgjedhjeve, sepse një sistem demokratik deri në vitin 1999 nuk bënte pjesë. Si rezultat i kësaj, misioni i OSBE-së në Kosovë ka qenë më se i domosdoshëm për t’i mbështetur themelet e sistemit zgjedhor. Ajo ka luajtur një rol të veçantë në krijimin e një kulture zgjedhore, edhe pse ky proces është karakterizuar me probleme dhe sfida të shumta.

Prej vitit 1999 deri më tani në Kosovë, OSBE ka ndihmuar në përgatitjen si dhe ka ofruar monitorimin e shtatë palë zgjedhjeve parlamentare. Organizimi dhe mbikëqyrja e zgjedhjeve, të cilat ishin një nga sfidat dhe pikat më të dobëta të konsolidimit të demokracisë, sepse ato

¹⁸⁰ Mandatit i OSBE-së, në: <https://www.osce.org/sq/mission-in-kosovo/mandate>.E qasur: Mars 2018.

karakterizoheshin me manipulime enorme si dhe aspak demokratike. Zgjedhjet e lira, të drejta dhe demokratike janë determinues si dhe iu paraprijnë institucioneve të pavarura dhe funksionale.

Tjetra sfidë që ka përcjellë realizimin e zgjedhjeve ka qenë dhe vazhdon ta përcjellë jogatishmëria e komunitetit serb që të merr pjesë në këtë proces demokratik, duke u thirrur në atë se ata nuk e njohin shtetin e Kosovës.

Edhe pse OSBE kishte një angazhim të madh në zhvillimin e një kulture të qëndrueshme në mbarëvajtjen e zgjedhjeve, akoma mbetet sfidë organizimi i zgjedhjeve, sidomos në pjesën veriore të Kosovës si rezultat i influencës së Serbisë ndaj komunitetit serb në Kosovë. Kjo influencë godet rendë konsolidimin e demokracisë në tërë territorin e Kosovës, sepse ajo ka për qëllim ta vëj në pikëpyetje funksionim e shtetit dhe institucioneve të Kosovës.

Veç kësaj, Serbia sa herë që mban zgjedhjet e veta nacionale, ato i organizon edhe në territorin e Republikës së Kosovës, kuptohet aty ku është komuniteti serb.¹⁸¹

Këtu ia vlen të ceket se Misioni i OSBE-së, përfaqësuesit e tij, kanë qenë prezent në qendrat e votimit, të cilët pas mbylljes së kutive të votimit, i transportojnë në Vranjë dhe Rashkë¹⁸² për numërim. Kjo nxjerr në pah se asistimi nga ana e OSBE-së i zgjedhjeve nacionale të Serbisë në territorin e Kosovës ka qenë në disfavor të konsolidimit të demokracisë.

Pika tjetër e cila mund të nxirret si faktor që është barrë në konsolidimin e demokracisë është edhe sistemi zgjedhor në Kosovë, i cili përbëhet vetëm prej një zone zgjedhore, ku si i tillë nuk garanton një përfaqësim të denjë për qytetaret. Për këtë arsye, OSBE do duhej ta mbështesë reformimin e sistemit zgjedhor dhe kështu të realizohet “krijimi i zonave zgjedhore në Kosovë. (...) arsyet e

¹⁸¹ Zgjedhjet parlamentare të Republikës së Serbisë, 24 prill 2016.

¹⁸² Qytete në Serbi.

krijimit të zonave elektorale që janë listuar (...) janë: - përfaqësimi më i mirë i gjithë Kosovës në Kuvend; - forcimi i lidhjes në mes të një anëtarit të zgjedhur dhe elektoratit; - dobësimi i hierarkisë partiake dhe nxitja e demokratizimit të partive.”¹⁸³

VI.1.1.9 Promovimi dhe mbrojtja e të drejtave të njeriut dhe komuniteteve

Republika e Kosovës ka një kuadër ligjor të avancuar lidhur me të drejtat e njeriut e sidomos në të drejtat e pakicave. I gjithë ky legjislacion është hartuar në përputhje me normat ndërkombëtare, të cilat Kushtetuta e Kosovës në mënyrë eksplicite pranon zbatimin e tyre me automatizëm.¹⁸⁴

Përgjatë procesit të draftimit të ligjeve për mbrojtjen e drejtave të njeriut dhe të pakicave, Misioni i OSBE-së e ka pasur një përfaqësim profesional në grupet e caktuara punuese.

Ajo edhe sot vazhdon të bëjë monitorimin e implementimit, ku dhe harton raporte vjetore. Ky monitorim ka pasur efekt pozitiv, sepse ka nxitur implementimin e të drejtave të njeriut dhe pakicave.

VI.1.1.10 Demokratizimi i institucioneve

Misioni i OSBE-së në kuadër të mandatit të tij një nga aktivitetet e tij është edhe forcimi i institucioneve demokratike, të cilave kushtetuta dhe ligjet e Republikës së Kosovës ua garanton pavarësinë e tyre, transparencën, si dhe llogaridhënien. Duke e marrë për bazë së në Kosovë

¹⁸³ Shiko në: <http://d4d-ks.org/assets/ElRekomandimet-mbi-Sistemin-Zgjedhor-Forumi-Reforma-Shqip.pdf>. E qasur: Maj 2018.

¹⁸⁴ Shiko Kushtetutën e Kosovës, neni 22.

institucionet u themeluan nga zero, ato kaluan nëpër një proces me sfida, ku mbështetja e jashtme ishte më se e nevojshme, përfshirë këtu funksionim në bazë të ligjit si dhe bashkëpunimin ndër-institucional.

Në këtë rast, Misioni i OSBE-së ka ndihmuar në zhvillimin e një praktike bashkëpunimi në mes Qeverisë dhe Kuvendit të Kosovës. Nëpërmjet këtij bashkëpunimi nxitet respektimi i Kuvendit si dhe gatishmëria e qeverisë në llogaridhënie para këtij institucioni më të lartë demokratik, siç është kuvendi. Kjo ka qenë e nevojshme, sepse shpesh janë identifikuar raste që ekzekutivi iu ka shmangur bashkëpunimit me legjislativin. Mosrespektimi i mandatit të Kuvendit nga ekzekutivi është një sinjal që konsolidimi i demokracisë në institucionet e Kosovës akoma nuk është i nivelit të duhur.

Për anashkalimin që i është bërë Kuvendit të Kosovës nga ekzekutivi flet edhe analisti Ardian Arifaj, ku sipas tij, “Kuvendi i ri duhet të jetë kualitativ edhe në kompetencat e veta, duhet ta ngritë veten në një institucion të mirëfilltë, përtej të cilit nuk mund të shkohet. Pra, të mos lejojë që qeveria, siç ka ndodhur në të kaluarën, ta anashkalojë apo injorojë Kuvendin e Kosovës në vendimmarrjen e vet, por Kuvendi ta tregojë fuqinë e vet, ta imponojë veten si institucioni më i lartë në Kosovë”.¹⁸⁵

Shtylla e tretë e pushtetit në Kosovë (gjyqësori) që nga themelimi, është edhe nën monitorimin e OSBE-së, i cili ka mbështetur dhe ofruar rekomandime konkrete për përmirësimin e funksionimit të këtij pushteti, pavarësia e të cilit është jetike në konsolidimin e demokracisë. Pjesë e fuqizimit të sistemit gjyqësor është edhe krijimi i institutit gjyqësor të Kosovës, i cili është themeluar pikërisht

¹⁸⁵ Për një Kuvend që s'hesht, ne :<https://www.evropaelire.org/a/2316232.html>. E qasur: Maj 2018.

nga OSBE, e që ka për qëllim krijimin dhe zhvillimin e trajnimeve,¹⁸⁶ të cilat iu ofrohen gjyqtarëve dhe prokurorëve për t'i bërë ata sa më profesional dhe të pavarur në punë. Programet edukative dhe përgatitore janë realizuar brenda dhe jashtë Kosovës për personelin e sistemit gjyqësor.¹⁸⁷

Misioni i OSBE-së nuk ka qenë i koncentruar vetëm në nivelin qendror, por edhe në atë lokal. Në nivelin lokal vazhdon të monitoroj punën dhe funksionimin e institucioneve lokale në disa fusha, përfshirë këtu transparencën llogaridhënien para qytetarëve.

VI.1.1.11 Forcimi i sigurisë dhe rendit publik

Hartimi i politikave të sigurisë si dhe forcimi i institucioneve të sigurisë është një nga aktivitetet të cilat kanë qenë dhe vazhdojnë të jenë si prioritet për Misionin e OSBE-së, sepse siguria publike paraqet një ndër fushat e rëndësishme që duhet të jetë e qëndrueshme dhe stabile.

Në kuadër të zhvillimit të politikave që kanë për qëllim ofrimin e sigurisë për shoqërinë kosovare, OSBE ka mbështetur institucionet përkatëse për të draftuar apo rishkruar strategjitë si dhe planet e veprimit, të cilat kanë për objektiv luftimin e krimit të organizuar, luftimin e terrorizmit, luftimin e ekstremizmit të dhunshëm si dhe luftimin e sulmeve kibernetike.

Edhe pse ky mision ka vënë në dispozicion mbështetje permanente për institucionet e sigurisë, akoma shteti i Kosovës iu ekspozohet dukurive negative, siç është korrupsioni, krimi organizuar e

¹⁸⁶ Instituti i Gjyqësorit të Kosovës, në: <https://www.osce.org/sq/kosovo/16357?download=true> E qasur: Prill 2018.

¹⁸⁷ Po aty.

narkotiket. Këtë e thotë në mënyrë eksplicite edhe raporti i fundit i Komisionit Evropian për Kosovën.¹⁸⁸

Duke u bazuar në tërë këtë, ka fakte që Misioni i OSBE-së ka pasur dhe vazhdon të këtë një rol të rëndësishëm në mbështetjen e ndërtimit të institucioneve demokratike dhe konsolidimit të tyre që nga përfundimi i luftës së Kosovës në vitin 1999. Për më tepër, akoma këto institucione nuk funksionojnë tërësisht në mënyrë të pavarur. Këtu është me rëndësi të cekën se si tri pushtetet (gjyqësori, legjislativi dhe ekzekutivi), akoma nuk zhvillojnë veprimtarinë e tyre në mënyrë të pavarur.¹⁸⁹ Mospavarësia e plotë e tyre është një dëshmi se konsolidimi i demokracisë në Kosovë akoma nuk ka arritur shkallën e duhur. Prandaj, misioni i OSBE-së akoma është i koncentruar në mbështetjen e demokratizimit të këtyre tri pushteteve jetike për një demokraci të mirëfilltë.

VI.1.1.12 Roli i Kuintit

Në procesin e shtetndërtimit të Kosovës, shtetet e Kuintit¹⁹⁰ kanë luajtur një rol të veçantë. Institucionet e Republikës së Kosovës si rezultat i veprimeve diletante dhe jodemokratike të partive politike, janë sjellë në situata jo të mira e në disa raste edhe janë bllokuar.

Rivaliteti në vazhdimësi destruktiv dhe aspak demokratik i partive politike ka ngadalësuar procesin e konsolidimit të demokracisë dhe si rezultat i këtyre veprimeve shtetet e Kuintit kanë ndjekur praktikën e ushtrimit të presionit ndaj partive, me qëllim që të heqin dorë nga politikat e tyre jo të favorshme për Kosovën, për institucionet dhe qytetarët e saj. Këtu kemi raste kur ambasadorët e shteteve të Kuintit kanë qenë tej mase të frustruar me veprimet që i kanë ndërmarrë deputetet e

¹⁸⁸ Shiko raportin e Kom. Evropian për Kosovën 2018.

¹⁸⁹ Po aty.

¹⁹⁰ Vendet e Kuintit janë: SHBA, Britania e Madhe, Franca, Gjermania dhe Italia.

institucionit me të lartë demokratik, Kuvendit. Ata nuk lejonin formimin e institucioneve, siç e kemi rastin e zgjedhjeve parlamentare në vitin 2016, kur një pjesë e opozitës përdorte gazin lotsjellës në Kuvend. Lidhur me këtë rast, ndër ambasadoret e shteteve të Kuintit që reagoi ashpër ishte edhe ai i SHBA-së, ku sipas tij “njerëzit që kanë gjuajtur gaz lotsjellës në Kuvend dhe koktej molotovi në rrugë, nuk i bëjnë nder askujt. Vazhdojmë të mendojmë që përdorimi i dhunës për arritjen e qëllimeve politike është i papranueshëm”¹⁹¹

Po ashtu, shtetet e Kuintit, në të mirë të forcimit të demokracisë në Kosovë, kanë dhënë edhe deklarata të përbashkëta nëpërmjet të cilave kanë kërkuar që të respektohen parimet e demokracisë në formimin e qeverisë, sepse sipas tyre “(...) qytetarët e Kosovës i zgjedhin përfaqësuesit e tyre. Vetëm këta përfaqësues janë përgjegjës për formimin e qeverisë së re, sipas ligjeve dhe kushtetutës së Kosovës.”¹⁹²

Rasti tjetër që shteteve të Kuintit iu desh që edhe të kërcënonin leadershipin kosovar me dëmtimin e marrëdhënieve me këto shtete partnere, ishte nëse ata vazhdojnë që të procedojnë më tej Ligjin për shfuqizimin e Gjykatës Speciale. Veç kësaj, një iniciativë të tillë e konsideronin si goditje ndaj sundimit të ligjit si dhe, sipas shteteve të Kuintit, “nuk ka asnjë arsye për të penguar punën e Dhomave të Specializuara dhe ftojmë secilin kryesues të institucioneve, udhëheqës të partive apo deputet, të heqë dorë nga çdo tentim për të shfuqizuar apo rinegociuar çfarëdo pjese të Ligjit për

¹⁹¹ Shiko në: <http://archive.koha.net/?id=27&l=100586>. E qasur: Prill 2018.

¹⁹² Qëndrimi i shteteve të Kuintit në formimin e qeverisë, në: <http://fax.al/read/news/10811429/15390764/quinti-te-zgjedhurit-e-popullit-pergjegjes-per-krijimin-e-qeverise>. E qasur: Mars 2018.

Dhomat e Specializuara. Një veprim i tillë vë në pikëpyetje përkushtimin e Kosovës për sundimin e ligjit dhe rrezikon të gjitha arritjet e Kosovës.”¹⁹³

Politikat dhe mbështetja e këtyre shteteve nuk është e fokusuar vetëm në Parlamentin dhe ekzekutivin, por edhe në institucionet tjera, përfshirë këtu edhe sistemin gjyqësor të Republikës së Kosovës.

Këto janë disa nga faktet që për shtetet e Kuintit, forcimi i shtetit ligjor në Kosovë në vazhdimësi ka qenë dhe vazhdon të jetë prioritet. Ata vazhdojnë të luajnë rolin e mbikëqyrësit në raport me vendimet diletante dhe të dëmshme për demokracinë në Kosovë, të cilat ndërmerren nga lidershipi kosovar, duke i vënë interesat personale mbi ato nacionale.

Po ashtu, mund të thuhet se pa një qasje të shteteve të Kuintit, të cilat shpesh u detyruan të përdorin edhe masa të forta diplomatike karshi lidershipit kosovar, demokracia dhe konsolidimi i saj do të ishte edhe më i brishtë.

Si përfundim mund të konkludojmë se, duke e marrë për bazë që mekanizmat ndërkombëtar të vendosur në Republikën e Kosovës kanë qenë pjesë e procesit të ndërtimit të institucioneve, së pari atyre kalimtare, pastaj edhe procesit të shtetndërtimit si dhe pjesë e procesit të forcimit të funksionimit të shtetit të pavarur të Kosovës, influenca e tyre gjatë këtyre proceseve nuk ka munguar.

Bashkimi Evropian, një ndër aktorët kryesor, nëpërmjet mekanizmave të vet kushtëzues si dhe atyre financiar, ka ndihmuar në procesin e konsolidimit të demokracisë në Kosovë. Pra, BE-ja për çdo

¹⁹³ QUINT-i kategorik kundër shfuqizimit të Gjykatës Speciale, në:
<http://www.dw.com/sq/quint-i-kategorik-kund%C3%ABr-shfuqizimit-t%C3%AB-gjykat%C3%ABs-speciale/a-42035399>. E qasur: Maj 2018.

hap që është bërë nga ana e Kosovës për të plotësuar Kriteret e Kopenhagës si dhe kriteret e tjera specifike që iu kanë vënë Kosovës, ka reaguar nëpërmjet mekanizmave stimulues/mbështetës. Kjo çasje e BE-së natyrisht se do vazhdojë edhe më tutje, e cila do të luaj rolin e mekanizmit shtytës në favor të konsolidimit të Demokracisë.

Një ndër faktorët e jashtëm që po e pengon konsolidimin e demokracisë është edhe politika destruktive e Serbisë karshi minoriteti serb në Kosovë si dhe përzierja e saj në punët e brendshme të Kosovës. Prandaj, në këtë rast, BE-ja nuk ka treguar sukses për ta penguar këtë influencë dhe për këtë ajo duhet të përdor karshi Serbisë politika shtrënguese, me qëllim që ta detyrojë Serbinë që të heq dorë nga këto politika. Deri më tani BE nuk ka treguar seriozitet edhe aq të madh në këtë drejtim. Ajo po vazhdon që të ndjek politika të dyfishta.

Po ashtu, OSBE-ja në forcimin e institucioneve dhe forcimin e demokracisë dhe shtetit ligjor si dhe për ta ndërtuar një kulturë demokratike dhe të qëndrueshme përfshirë konsolidimin e partitve politike, sjellja demokratike e të cilave ka një rol kyç në konsolidimin e demokracisë, ka dhënë një kontribut të çmueshëm. OSBE nuk ka lenë anash as përpjekjet për ta ndërtuar dhe zhvilluar një shoqëri të qëndrueshme civile.

Veç kësaj, nga ky kapitull rezulton se OSBE ka pasur një rol me peshë, duke qënë përgjegjës edhe për organizmin dhe monitorimin e zgjedhjeve pas luftës në Kosovë dhe duke monitoruar të gjitha proceset zgjedhore të cilat janë mbajtur deri më tani në Kosovë.

Edhe pse OSBE ka luajtur rolin e një aktori kyç në ndërtimin e institucioneve demokratike si dhe në funksionimin e tyre në mënyrë të pavarur, ajo ka bërë edhe veprime, të cilat nuk ishin në favor te

konsolidimit të demokracisë. Këtu është për t'u cekur asistenca e ofruar nga OSBE për zgjedhjet parlamentare të Serbisë, që janë mbajtur edhe në Kosovë nëpër komunat serbe.

Ky kapitull po ashtu ka nxjerrë në pah se sa i domosdoshëm ka qenë dhe është çasja e shteteve të Kuintit në raport me forcimin e institucioneve të Kosovës.

Në këtë kapitull janë marrë shembuj të mjaftueshëm, të cilët konfirmojnë rolin e Kuintit në mbrojtjen e demokracisë, duke përdorur edhe presion, si rezultat i veprimeve të partive politike, veprime këto që e vëjnë në pikëpyetje së pari funksionim e institucioneve, e pastaj edhe konsolidimin e demokracisë në Kosovë. Sipas kësaj, Kosova si demokraci e re akoma ka nevojë për akterët, siç janë Shtetet e Kuintit.

KAPITULLI VII - Roli i Shoqërisë Civile në konsolidimin e demokracisë në Kosovë

VII.1. Përkufizimi i shoqërisë civile

Shoqëria civile ka një histori të gjatë veprimi, e cila ka kaluar në disa faza të rëndësishme. Ajo, në fakt, është përballur me shumë vështirësi dhe natyrisht gjatë periudhave historike ka pasur edhe ndryshime, si në strukturën organizative, po ashtu edhe në veprimtarinë e saj. Megjithatë, qëllimi fundamental i shoqërisë civile ka qenë që të ngreh zërin e saj karshi padrejtësive që janë bërë sidomos nga shteti.

Gjatë periudhave historike, shoqëria civile ka pasur një rol me rëndësi, që sidomos ishte një goditje e fortë për komunizmin, çka më së miri lidhet me mendimin e babait të “racios” Makiavellit, i cili dikur theksonte se “shteti lindor do të shkatërrohej me një të fryrë të vetme, vetëm po të goditej në qendër”, e këtë më së miri e pasqyroi shoqëria civile e cila e goditi po aty.

Prandaj, rrjedhimisht, shoqëria civile konsiderohet si njëra prej shtyllave të vet demokracisë, madje dallimi prej sistemit monist-komunist dhe demokracisë qëndron edhe tek shoqëria civile. Edhe pse në parim, shoqëria civile mund të themi se ka prejardhje prej Adam Fergusonit, megjithatë, kur përmendet fjala shoqëri civile, ajo nënkupton çdo lloj organizimi që është joshitetëror, por gjithashtu zgjon konotacionin e shoqërisë ku sundon presioni i opinionit publik dhe rendi ligjor. Po ashtu, ka argumente të ndryshme dhe të shumta se shoqëria civile i ka rrënjët tek doktrina Hegeliane, por edhe më herët sidomos tek Greqia antike.

Ernest Gellner, shoqërinë civile e përkufizon si një grumbull i institucioneve të ndryshme joqeveritare, i cili është mjaft i fuqishëm që ta balancojë shtetin.¹⁹⁴ Shoqëria civile, pra thjesht konsiderohet aktiviteti shoqëror i njerëzve jashtë familjes, shoqërisë, dhe vendeve të tyre të punës, dhe që nuk ka qëllime fitimprurëse apo synime për të marrë pushtetin. Ajo pra nënkupton vullnetin e përbashkët të njerëzve që t’i ndjekin interesat apo dëshirat e tyre.¹⁹⁵ Roli i tyre është shkëmbimi i informacionit, arritja e qëllimeve kolektive, formulimi i kërkesave të tyre drejtuar shtetit,

¹⁹⁴ Ernest Gellner. (2002) Konditat e Lirisë: shoqëria civile dhe rivalet e saj. Pejë: Dukagjini. Faqe, 37.

¹⁹⁵ John D. Clark, (2003) Worlds Apart: Civil Society and the Battle for Ethical Globalization. USA: Kumarian Press. Page: 92.

përmirësimi dhe funksionimi i shtetit si dhe mbajtja e zyrtarëve përgjegjës ndaj obligimeve të tyre shtetërore. Shoqëria civile, pra, qëndron mes sferës private dhe shtetit.¹⁹⁶

Sidoqoftë, përkufizimi i shoqërisë civile ka qenë gjithmonë një sfidë gjatë periudhave historike, sepse koncepti është përdorur rrallë në diskurse para fundviteve të tetëdhjeta dhe, rrjedhimisht, njerëzit kanë qenë shumë të pafamiljarizuar me nocionin e shoqërisë civile. Mënyra më e mirë për t'i dhënë një përkufizim konceptit të shoqërisë civile është që së pari të kuptohet që shoqëria civile është si "një sektor i tretë", e ndarë nga qeveria dhe çështjet private. Pra, shoqëria civile i referohet asaj që mund të quhet "pushtet i katërt se bashku me median", sidoqoftë më tepër se mediat, shoqëria civile ka të bëjë edhe me asociacionet profesionale, grupet fetare, sindikatat dhe organizatat e qytetarëve për avokim, që përfaqësojnë zërat e sektorëve të ndryshëm të shoqërisë dhe e pasurojnë pjesëmarrjen e qytetarëve në demokraci.

Pavarësisht që më lart u dhanë disa koncepte në lidhje me përkufizimin e termit të shoqërisë civile, prapë se prapë mbetet shumë e vështirë të përkufizohet shoqëria civile, sepse për shembull shumica e gazetave dhe e stacioneve televizive në ShBA udhëhiqen si biznese fitimprurëse, prandaj a duhet edhe ato të llogariten si shoqëri civile, apo vetëm të shihen si pjesë e botës komerciale?¹⁹⁷

Problemi i dytë, i ndërlidhur me konceptin e shoqërisë civile, është se ky është një term strikt objektiv dhe përshkrues i cili parashtrohet pyetjen se sa është shoqëria civile e përkushtuar për demokraci dhe trajtimin e barabartë të të gjithë qytetarëve para ligjit?

¹⁹⁶ Larry Diamond. (1997) Civil Society and the Development of Democracy. Estudio/Working Paper. Page: 7.

¹⁹⁷ Në bazë të Tokvillit, Demokracia në Amerikë (Nju Jork: Westvaco, 1999), Putnam, Robert D., Robert Leonardi dhe Raffaella Nanetti, Vënia e demokracisë në veprim: Traditat qytetare në Italinë moderne (Princeton, NJ: shtypi i universitetit Princeton, 1993); Putnam, Robert D., Bowling Alone: Kolapsi dhe ringjallja e komunitetit amerikan (Nju Jork: Simon & Schuster, 2000).

Sidoqoftë, ka përkufizime të ndryshme që janë dhënë nga institucione e ndryshme botërore ku ndër më të pranuarat janë përkufizimi nga Kombet e Bashkuara, ku “shoqëria civile i referohet shoqatave të qytetarëve (jashtë familjeve, miqve dhe bizneseve të tyre) të krijuara vullnetarisht për avancimin e interesave, ideve dhe ideologjive të tyre”.¹⁹⁸

Pra, shoqëria civile përkufizohet si sfera jashtë familjes, shtetit e tregut, dhe përjashton bizneset fitimprurëse, ndonëse shoqatat mund të jenë pjesë e saj. Këto organizata, të cilat krijohen vullnetarisht, përfshijnë shoqatat, sindikatat, organizatat jofitimprurëse me bazë komunitare, institucionet e besimit dhe kulteve, organizatat bamirëse, fondacionet dhe lëvizjet me karakter social. Megjithatë, ende nuk ka ndonjë përcaktim të saktë se kush duhet të quhet saktësisht shoqëri civile, kufijtë dhe roli i tyre në një shoqëri të vërtetë demokratike.¹⁹⁹

Sa i përket marrëdhënies në mes të shoqërisë civile dhe qeverisë, teoria liberale e shoqërisë civile e sheh atë si kundërpeshë natyrore ndaj depërtimit të shtetit në jetën private të individëve. Studiuesit sikur Xhon Lok (John Locke) dhe Xhon Stjuart Mill (John Stuart Mill) e panë rolin e shtetit si të kufizuar dhe të shoqërisë të fuqishëm, duke supozuar se shteti do të jetë më i fortë nëse shoqëria civile është e dobët. Një pikëvështrim tjetër sheh shoqërinë civile dhe shtetin si mbështetëse të njëra tjetrës. Aleksis de Tokvill (Alexis de Tocqueville), aristokrat frëng, ishte i impresionuar me numrin aq të vogël të amerikanëve në qytet, që do të organizoheshin për të zgjidhur problemet e komunitetit. Robert Putnam azhurnoi teorinë e Tokvillit, duke thënë se shoqëria civile përgatitë individët me sjelljet e bashkëpunimit dhe zgjidhje të problemeve, e me këtë përmirëson qeverisjen.

¹⁹⁸ Civil Society International, Çka është shoqëria civile? www.civilsoc.org. E qasur: Mars 2018.

¹⁹⁹ <http://www.un.org/reform/civilsociety/panel.shtml>. E qasur: Mars 2018.

Kur donatorët ndërkombëtarë investuan shumë resurse në ndërtimin e shoqërisë civile në Kosovë dhe pjesën tjetër të Evropës Lindore, ata përcollën teorinë e Putnamit se shoqëria më e fortë civile do të rezultojë në shtet të fuqishëm. Vet Putnami ishte skeptik lidhur me ndërtimin e shpejtë të shoqërisë civile nga më lart, pasi që u deshën shekuj për Italinë Veriore gjersa zhvilloi një shoqëri të fortë civile.²⁰⁰

Sa i përket shoqërisë civile dhe partive politike, mund të themi lirisht se ato ndërlidhen dhe bëjnë aktivitete të ngjashme në masë mjaft të madhe. Në shumë vende, ekziston nevoja serioze që të bëhet një dallim më i qartë mes këtyre të dyjave. Për shembull, në disa vende të Evropës dhe të Amerikës Latine, partitë politike janë duke u ballafaquar që të ruajnë bazën e tyre votuese, kështu që ato funksionojnë në mënyrë tradicionale në konkurrencë me shoqërinë civile. Shumë parti politike në Evropën Perëndimore kanë themeluar OJQ-të e veta për t'i plotësuar më tej agjendat e veta. Në anën tjetër, në disa vende, sikurse në Tailandë dhe në Filipine, ligjet parashohin përfaqësimin e OJQ-ve në parlamente, ku edhe OJQ-të propozojnë kandidat për poste qeveritare. Një tjetër shembull sa i përket marrëdhënies në mes shoqërisë civile dhe politikës është prezent edhe në Evropën Juglindore, sepse shumë politikan të tanishëm janë ish-udhëheqës të OJQ-ve dhe shumë udhëheqës të OJQ-ve janë ish-politikanë, që nuk janë rizgjedhur dhe kanë dëshiruar të mbesin publikisht aktiv dhe të pranishëm.

Sidoqoftë, ajo që i dallon grupet e shoqërisë civile nga partitë politike, është qëllimi për kontrollin e pushtetit. OJQ-të janë të interesuara me një veprim në fushën publike dhe i adresohen shtetit pa

²⁰⁰ USAID, Civil Society Groups and Political Parties: Supporting Constructive Relationships, Office of Democracy and Governance Occasional Papers Series no. PN-ACU-631 (Washington, DC: USAID, 2004).

kërkuar kontroll mbi shtetin. Nga ana tjetër, qëllimi i partive politike është fitorja në zgjedhje dhe ushtrimi i pushtetit.

VII.1.1. Historiku i zhvillimit të shoqërisë civile në Kosovë

Historia e shoqërisë civile në Kosovë është pjesë e një historie më të gjerë të Evropës Lindore gjatë rënies së komunizmit, por gjithashtu ka qenë e formësuar nga rrethanat e veçanta të Kosovës dhe nga shkatërrimi i Jugosllavisë. Kur Kosovës iu hoq autonomia në vitin 1989, shoqëria civile u bë pjesë e rezistencës dhe bashkëpunonte nga afër me qeverinë paralele, që u formua si akt i kundërshtimit të Beogradit dhe që ofronte shërbime alternative në fushën e shëndetësisë, të mirëqenies sociale dhe të arsimit. Pra, shoqëria civile e Kosovës ka lindur në erën e represionit dhe të kundërshtive. Organizatat e para të shoqërisë civile në Kosovë datojnë nga fundi i viteve '80 dhe fillimi i viteve '90, pra konkretisht pas rënies së komunizmit. Në rastin e Kosovës gjatë viteve 90, për shkak të shtypjes politike në atë kohë, shoqëria civile është zhvilluar si pjesë e rëndësishme e një sistemi paralel dhe i rezistencës civile ndaj regjimit serb, dhe kishte trajtuar kryesisht çështjet që kanë të bëjnë me të drejtat e njeriut dhe mbijetesës së popullsisë.

Pra, mbrojtja e të drejtave të njeriut dhe çështjet tjera humanitare, kanë qenë fushatë më të rëndësishme të aktiviteteve të shoqërisë civile në atë kohë. Në krahasim me kohën e tanishme, organizatat kryesore të shoqërisë civile në atë kohë ishin kryesisht organizata bamirëse dhe humanitare, si rasti i organizatës "Nëna Terezë" – e cila merrej kryesisht me ofrimin e ndihmës mjekësore dhe humanitare, me një anëtarësi shumë të madhe vullnetarësh, e shpërndarë në të gjithë Kosovën.

Sa i përket fushës së të drejtave të njeriut, Këshilli për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive të Njeriut ishte organizata që monitoronte shkeljet e të drejtave të njeriut, duke kontribuar drejtpërdrejtë në informimin e komunitetit ndërkombëtar për shtypjen sistematike të popullsisë shqiptare nga regjimi serb.

Në përgjithësi, zhvillimi i shoqërisë civile në Kosovë u bë në katër faza.

Faza e parë filloi në vitin 1989 kur dy organizata, Këshilli për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive të Njeriut (KLMDNJ) dhe Shoqata Bamirëse “Nëna Tereze” u themeluan dhe mekanizmat tjerë politik krijuan një sistem parallel, si kundërshtim i regjimit të Millosheviqit. Pothuajse të gjitha OJQ-të në atë kohë merreshin me mbrojtjen e të drejtave të njeriut ose aktivitete humanitare dhe të gjitha i kundërviheshin regjimit.

Faza e dytë filloi në vitin 1995, me paraqitjen e organizatave hulumtuese, siç janë Riinvest dhe Aksioni i Kosovës për Iniciativa Qytetare, në mes tjerash. Gjerë në fund të vitit 1998, në Kosovë ekzistonte vetëm një numër i vogël i organizatave, por të shquara për suksesin dhe efikasitetin në fushëveprimin e aktiviteteve të tyre.

Faza e tretë, pas konfliktit, në zhvillimin e OJQ-ve në Kosovë gjithashtu quhet edhe “faza emergjente” dallohet me krijimin e një tregu të madh donatorësh me rreth 500 donatorë në vitin 1999, sipas disa llogaritjeve.

Faza e katërt dhe aktuale njihet si “faza e kërpudhave” për shkak të shpejtësisë së paraqitjes së organizatave.

Rrjedhimisht, menjëherë pas përfundimit të luftës dhe konkretisht krijimit të Misionit të Kombeve të Bashkuara në Kosovë (UNMIK) dhe Institucioneve të Përkohshme të Vetëqeverisjes (IPVQ) në vitin 1999, organizatat e shoqërisë civile në Kosovë u shumëfishuan, sidomos për nevojat e mëdha,

për ndihmë emergjente dhe rindërtim, si dhe për pajtim ndëretnik. Rrjedhimisht, këtu fillon edhe një etape e re e zhvillimit të shoqërisë civile në Kosovë, e adaptuar në një realitet të ri.

Pasi që edhe Bashkësia Ndërkombëtare zbarkoi në Kosovë me një fuqi të madhe financiare dhe teknike, e ardhur si nevojë e dhënies së fondeve ndërkombëtare për Kosovën e pasluftës, kjo solli edhe rritjen drastike të numrit të Organizatave të Shoqërisë Civile në Kosovë. Sidoqoftë, kjo situatë ka krijuar edhe themelimin e shumë OJQ-vë pasive ku ende ekziston një numër i madh i tyre, e që nuk zhvillojnë asnjë aktivitet të caktuar. Nga më tepër se 7.000 OJQ të regjistruara, deri në vitin 2013, më pak se 10% vlerësohet të jenë ende aktive ose pjesërisht aktive.²⁰¹

Momentalisht, Organizatat e Shoqërisë Civile në Kosovë janë shumë aktive, ku në vazhdimësi fuqizojnë kapacitetet e tyre njerëzore dhe financiare, por shkak që shumica e financave të tyre vijnë nga donatorët ndërkombëtar, ende përballen me sfida të mëdha. Në përgjithësi, ndryshimet e fundit, duke filluar nga rënia e komunizmit e deri të zbulimi i internetit, kanë krijuar tokë të pëlleshme për zhvillimin e shoqërisë civile në Kosovë dhe në mbarë botën.

VII.1.1.1 Roli i Organizatave të Shoqërisë Civile në konsolidim të Demokracisë në Kosovë

Termi ose koncepti i shoqërisë civile ka një traditë të gjatë. Angazhimi bazohet në vetorganizimin social të qytetarëve. Shoqëria civile shihet se ka një lidhje të ngushtë midis kapacitetit të shoqërisë për vetorganizim dhe qëndrueshmërisë së kushtetutës së saj demokratike. Më tutje, shoqëria civile mund të shihet në tri dimensione të ndryshme. Nga këndvështrimi normativ, shoqëria civile barazohet me një komunitet demokratik dhe një shoqëri të drejtë. Perspektiva e përhershme i

²⁰¹ Ueb faqja e Ministrisë së Administratës Publike: <https://map.rks-gov.net/Departments/DOJQ.aspx>. E qasur: Mars 2018.

referohet një lloj të caktuar veprimi shoqëror. Qëndrimi i përqendruar në aktorë fokusohet në individë dhe organizata konkrete që janë vetë-organizuar.²⁰² Zhvillimi i shoqërisë civile është varur dhe vazhdon të varet nga sistemet politike, në të cilat edhe veprojnë. Natyrisht, në sistemet e avancuara demokratike si dhe në shoqëritë e zhvilluara, shoqëria civile ka arritur kulminacionin e zhvillimit organizativ si dhe atij profesional, saqë është e përfshirë në politikëbërje deri në zbatueshmërinë e saj. Këtu nuk përjashtohet fakti se falë presionit të tyre karshi qeverive, t'i detyroj ato që të ndërrojnë qëndrimet apo politikat e tyre për raste të caktuara. Në ditët e sotme edhe "(...) teknologjitë e informacionit kanë mundësuar që shoqëria civile të jetë kujdestari i vërtetë i demokracisë në mbarë botën dhe shtypësit nuk mund të fshihen më pas kufijve të tyre (...) një shoqëri civile e fortë që lidhet përtej kufinjëve, falë mjeteve moderne të komunikimit, nuk do të lejon asnjë keqpërdorim (...)." ²⁰³ pa e ngritur dhe e trajtuar. Pra, shoqëria civile sot konsiderohet një ndër faktorët kryesor të forcimit demokratik të një vendi. Ata që preken nga një vendim politik, duhet të shprehin mendimin e tyre dhe ky është një parim demokratik. Momentalisht në Kosovë ekzistojnë dhe janë të regjistruara mbi 8,500 Organizata të Shoqërisë Civile, ndërsa numri i atyre aktive llogaritet të jetë rreth 1,500. Shumica e sektorit përbëhet nga OShC të vogla, si në kuptim të fondeve ashtu edhe të stafit.²⁰⁴

²⁰² Zivilgesellschaft - Ein Leitbild, ne: <http://www.bpb.de/politik/grundfragen/deutsche-verhaeltnisse-eine-sozialkunde/138712/zivilgesellschaft>, qasur me 20.11.2018.

²⁰³ Kofi Annan, ne: <https://www.admin.ch/gov/de/start/dokumentation/medienmitteilungen.msg-id-13289.html>, qasur me 10.11.2018.

²⁰⁴ Taulant Hoxha, INDEX-I Kosovar i Shoqërisë civile 2016, Fondacioni Kosovar për Shoqëri civile. (KCSF); file:///Shoqeria%20Civile/05_11_2016_3646225_Indexi_Kosovar_i_Shoqerise_Civile_2016_KCSF.PDF. E qasur: Prill 2018.

Shoqëria civile në aspektin e përgjithshëm shoqëror duhet të jete konstruktive me faktin se ngre zërin kundër shumë dukurive dhe të metave që mund të bëj shteti, kështu që edhe në Kosovë shoqëria civile në vazhdimësi ka bërë përpjekje që zëri i saj të ngrihet lartë dhe t'i denoncojnë shkeljet ligjore të bëra nga vet mekanizmat shtetëror. Shoqëria civile ka pasur rol me rëndësi në shoqërinë kosovare, sidomos lidhur me ndërtimin e demokracisë dhe të vet shtetit ligjor. Shumë organizata joqeveritare në Kosovë, kanë ngritur zërin lidhur me shumë çështje, si: korrupsionin, nepotizmin, krimin e organizuar, llogaridhënien e politikanëve para qytetarëve, presionin e politikës ndaj medias e shumë çështje tjera të rëndësishme. Ky fakt, në realitet tregon se roli i shoqërisë civile ka qenë i konsiderueshëm, por edhe konstruktiv në rrjedhën e gjërave në vend, prandaj shoqëria civile vazhdon të mbetet faktor kyç në ndërtimin e shtetit dhe kapaciteteve shtetërore.

Sidoqoftë, shoqëria civile e Kosovës ka pasur dhe ka ndikim të kufizuar në çështjet që janë brenga kryesore të qytetarëve, siç janë zhvillimi ekonomik dhe sundimi i ligjit. Përkundër ndikimit të perceptuar, fushat ku shoqëria civile shihet të jetë më aktive janë transparenca dhe llogaridhënia si dhe sundimi i ligjit. Një ndikim tjetër ka edhe në fushën e demokratizimit. Shoqëria civile ka një komunikim të mirë me institucionet publike relevante për punën e saj, por kjo nuk përkthehet në çasje të mjaftueshme në informata dhe përfshirje në konsultimet publike për procesin e politikëbërjes. Prapë se prapë, shoqëria civile në Kosovë plotëson një numër rolesh me rritjen e pjekurisë së institucioneve ekonomike dhe politike të Kosovës, duke filluar nga roli i monitoruesit, duke vazhduar me dhënien e kontributit në hartimin e politikave e deri te ofrimi i shërbimeve sociale. Organizatat e Shoqërisë Civile (OShC) po ashtu kanë shumë vlera në dhënien e kontributit drejt rrugëtimit të Kosovës në integrimet evropiane.

Problemet kryesore me të cilat ballafaqohet shoqëria civile në Kosove janë të vepruarit në një ambient të pafavorshëm. Varfëria e madhe në Kosovë, ku niveli i papunësisë mbetet i lartë. Kushtet e rënda socio-ekonomike kanë rezultuar në një valë të gjerë migrimi gjatë viteve 2014 dhe 2015. Perceptimet mbi nivelin e korrupsionit dhe sundimit të ligjit nuk janë aspak të kënaqshme.

Përkundër përfundimit të mbikëqyrjes së pavarësisë së Kosovës, vendi mbetet nikoqir dhe subjekt i organizatave të huaja politike, gjyqësore dhe ushtarake. Polarizimi i spektrit politik ka bllokuar punën e Kuvendit të Kosovës për një pjesë të madhe të dy viteve të fundit. Me nënshkrimin e Marrëveshjes për Stabilizim dhe Asocim me BE-në, Kosova ka shënuar marrëdhënien e parë kontraktuale me BE-në. Megjithatë, progresi në reformat për anëtarësim në BE mbetet i kufizuar. Partitë politike, të varura nga liderët, e të cilave u mungon transparenca, nuk japin shumë shpresë për progres. Kënaqshmëria me drejtimin politik të vendit është në rënie, sikurse edhe besimi ndaj institucioneve kryesore në Kosovë. Përkundër kësaj, gatishmëria e qytetarëve për t'iu bashkuar protestave publike është në rënie, ndërsa niveli i besimit ndërpersonal mbetet i ulët.²⁰⁵

Sipas raportit të progresit të Komisionit Evropian për Kosovën, zhvillimi i organizatave të shoqërisë civile ka përparuar shumë pak. Të kuptuarit publik i rolit të shoqërisë civile mbetet i ulët, ndërsa është po ashtu brengosëse që shoqëria civile i nënshtrohet presioneve politike dhe kërcënimeve nëse aktivitetet e saj nuk përputhen me qëndrimet e autoriteteve. Në fund të raportit thuhet që Qeveria, Kuvendi dhe Komunitet duhet të bashkëpunojnë në mënyrë më efektive me shoqërinë

²⁰⁵ Po aty faqe 8.

civile.²⁰⁶ Nganjëherë, marrëdhëniet e Organizatave të Shoqërisë Civile (OShC) me qeverinë dhe me bizneset po marrin formën e kundërshtarëve.

Por, cilado që të jetë detyra dhe cilido që të jetë roli, sukcesi i tyre do të varet në profesionalizmin e rritur dhe në një bazë të rezultateve më të qëndrueshme, si dhe në një ndjenjë më të fortë për atë se kush janë dhe se çka dëshirojnë të arrijnë. Ndikimi i shoqërisë civile në politikat publike ka potencial të jetë thelbësor. Ajo mund të kontribuojë në cilëndo prej pesë fazave të politkëbërjes: përcaktimin e agjendës, formulimin e politikave, vendimmarrjet, zbatimin dhe vlerësimin. Një nga instrumentet më të fuqishme për futjen e ndonjë çështjeje në agjendën publike dhe ndikimi në debatet pasuese janë mediat. Grupet e ekspertëve dhe OShC-të e tjera po ashtu mund të kenë ndikim mbi qeverinë në mënyrë të drejtpërdrejtë apo përmes partive politike, me të cilat ato nganjëherë janë të ndërlidhura. Në Kosovë, rruga më e mirë për të pasur ndikim mbi qeverinë është nganjëherë përmes ndonjë organizate ndërkombëtare apo agjencie të OKB-së. Në fazën e zbatimit, OShC-të shpesh mund të luajnë një rol për zbatimin e shërbimeve të autorizuar nga qeveria. Në këtë rast, roli i tyre është kyç në vlerësimin e rezultateve të politikave.

Sidoqoftë, përparimet që ka Kosova dhe roli i shoqërisë civile në vendin tonë, vërejmë se mbetet ende e dobët përballë rëndësisë së madhe që ka kjo shoqëri për plotësimin e hapësirave mes politikës, qeverisë dhe qytetarëve të saj. Kontributi i shoqërisë civile dhe i qytetarëve është dhe mbetet esencial dhe tejet i rëndësishëm për përshpejtimin e reformave të domosdoshme që shpesh bëhen atraktive për zhvillimin ekonomik dhe mirëqenien e vetë shoqërisë dhe e qytetarëve të saj.

²⁰⁶ Raporti i progresit i KE për Kosovën 2011, faqe 17. Shih: http://www.eeas.europa.eu/delegations/kosovo/documents/eu_kosovo/20111018_progress_report_sq.pdf. E qasur: Prill 2018.

Ngjarjet e ndryshme dhe reagimi i qytetarëve lidhur me shkeljet e ndryshme janë shumë të rëndësishme. Reagimi, pra, dëshmon maturi dhe përgjegjësi për atë që ndodh në një shtet, sepse përgjegjësi për fatet e një populli e më gjerë nuk mban vetëm qeveria dhe shteti, por edhe vetë shoqëria dhe qytetarët e saj. Sigurisht që në një shoqëri të vërtetë demokratike reagimi duhet të jetë i përhershëm, madje dhe për probleme më të vogla, sepse në vende perëndimore shoqëria civile është e ndjeshme edhe për probleme fare të parëndësishme. Në Francë për shembull, shoqëria civile e detyroi parlamentin të mblidhen në mesnatë, që të miratonin një ligj që peshku të tregtohet i ngordhur dhe jo i gjallë, e paramendojeni se çfare realizmi do te kishte për probleme më të mëdha që prekin interesa publike se çfarë ndodh.

Në përgjithësi, shoqëria civile në Kosovë nuk duhet të jenë pjelle e interesave financiare dhe të partive politike, por ajo duhet të luajë një rol të rëndësishëm në zhvillimet sociale, ekonomike, politike në vend, nëpërmjet ndërtimit të konsensusit publik, nxitjes së pjesëmarrjes së publikut në hartimin dhe zbatimin e reformave aq të domosdoshme për vendin tonë.

Shoqëria civile në Kosovë, duket se është larg detyrës si kundër-balancues i shtetit. Një pjesë e konsiderueshme e fajit, u takon vetë autoriteteve shtetërore, të cilat në njërin anë po e anashkalojnë sektorin e shoqërisë civile, e në anën tjetër thirren si administratorë të demokracisë. Si rrjedhojë e kësaj, ndikimi i tyre në proceset politike është i paefektshëm. Gjithashtu, ndikimi i shoqërisë civile në proceset sociale dhe politike ka rezultuar të jetë i ulët.

Po ashtu, mungesa e njohurive të qytetarëve për rolin të cilin e ka një shoqëri civile në demokraci, bënë që angazhimi qytetar në Kosovë të jetë në nivel të ulët. Prandaj, organizatat e shoqërisë civile

nuk duhet vetëm të thirren në emër të qytetarëve, por duhet të jenë edhe më afër tyre, duke i përfaqësuar denjësisht interesat e tyre qytetare.

VII.1.1.2 Historiku i zhvillimit të mediave dhe roli e rëndësia e tyre në proceset demokratike

Mediat janë faktori kryesor nëpërmjet të cilave transmetohen, interpretohen e analizohen mesazhet, qëndrimet e idetë politike, platformat dhe programet e ndryshme.²⁰⁷ Mjetet informative kanë një zhvillim të vjetër, sidomos shtypi dhe një ndikim të madh në rrjedhat historike të shoqërisë dhe shtetit. Ato kanë ndikuar në forma të bindshme duke marrë pjesë në këto rrjedha dhe kanë dhënë një kontribut të pazëvendësueshëm në lëmin e informimit, të arsimit, të përhapjes së kulturave, jo vetëm duke e ndryshuar mendjen njerëzore.

Me kalimin e kohës politika dhe mjetet informative të varura njëra me tjetrën, na kanë shërbyer si urë lidhëse mes publikut dhe politikës. Sistemet mediale në vështrim të parë kanë sjellur lëvizje të reja dhe me interes në atë që konsiderohet interes individual dhe më gjerë. Vëmendja lidhur me politikën dhe pjesëmarrjen në të theksohen e ritheksohen si mundësi që, përmes teknologjive të përsosura të përçohen ide, informacione, aktualitete nga më të ndryshmet. Gazetat, televizioni, interneti dhe mjete të ndryshme digjitale janë gjithnjë e më shumë duke u përfshirë në “Revolucionarizimin” e medias.

Një super-teknologji mediale vazhdon të zhvillohet me tempo të shpejtë përballë njeriut. Duke e nuhatur interesin e saj, media ka arritur po ashtu të shtrijë pushtetin e vet atje ku dikur ishte e

²⁰⁷ Anthony Giddens / Sociology / shtëpia botuese Qabej Tiranë 1997 faq. 421.

paimagjinueshme. Sundimtarët absolut, kanë penguar në formë cenzure lirinë e mendimit, dhe të shtypit. Shpeshëhere, mediat janë përdorur edhe nga pushteti për t'u propaganduar populli. Shekulli i XX ka fokusuar zhvillimin e një ndërmarrje të gjerë mediale. Sot, kjo industri elektro-digjitale, është bërë forca e vërtetë dhe më ndikim të fuqishëm në gjithë botën. Trendet e njerëzimit, konceptet demokratike, të drejtat e njeriut, sundimi ose pushteti kanë krijuar multikompanitë mediale që nuk mund të merreshin me mend dikur. Më nuk është vetëm iluzioni fakti se bota është bërë më e njohur dhe më e afërt, pranë nesh, nisur nga zhvillimi teknologjik i mjeteve të informimit. Qindra e mijëra programe televizive, digjitale, shpërndahen anekënd botës, si rezultat i teknologjisë informative. Përfundimisht, mediat janë mundësia më e mirë e kontributit, qoftë individual, qoftë e organizimeve të caktuara institucionale e politike, për proceset e caktuara politike. Fuqia mediatike është transparenca më e madhe e qëndrimit, idesë a mendimit politik. Gjithashtu mediat janë mundësia e veçantë e komunikimit me opinionin institucional mekanizmin e caktuar, janë mundësia e veçantë e prezentimit të kualiteteve, potencialit dhe vlerave të natyrës së tillë. Pra, mediat janë mundësi reale e kyçjes dhe pjesëmarrjes në politikë.

Mediat duan që vazhdimisht të jenë të pavarura, por e kanë të vështirë dhe politika “bëhet se qendron larg mediave”. Por, nuk është kështu! Shtypi, radiot, televizioni, interneti dhe format e tjera komunikative shërbejnë për të përhapur informacion në publik. Të destinuara me qëllime të qarta informative dhe komunikuese, ato luajnë role të caktuara si në zhvillimin e shoqërisë, poashtu edhe në krijimin e subkulturave, të opinioneve, të proceseve me të cilat pranohet politika e rritjes së sasisë dhe cilësisë mediale. Në Kosovë sot ka me qindra media të shkruara, elektronike dhe kanale

televizive.²⁰⁸ Kjo domethënë se periudha transitive dhe fryma demokratike e politikës dhe institucioneve demokratike kanë ndikuar që hapësira jonë të ndikohet me të madhe nga llojllojshmëria e sistemit informativ, e mjeteve të ndryshme informative. Por, ka edhe shumë paradokse në mungesë të ligjshmërive, në anën tjetër edhe në mungesë të një tradite më të gjatë të përhapjes dhe zhvillimit të fjalës së lirë, të zhvillimit të kodit moral dhe etik, informativ. Duke qenë kështu, ne vërejmë që medialiteti përbën një sferë private dhe ekonomike, padyshim edhe një sferë institucionale e shtetërore, demokratike dhe publike. Depërtimi i politikës në media, pjesëmarrja e saj në forma dhe mënyra të hapura e të fshehta, është e pakontestueshme. Liria e mendimit dhe e shprehjes është një e drejtë e sanksionuar me kushtetutë, ndërsa gjithnjë e më shumë gjejmë relacione të ndërlidhura në mes politikës dhe medias, në mes të cilave lëvizë qytetari.

Kur thuhet se media dhe politika janë të lidhura ngushtë, se ato ndërvarën nga njëra-tjetra, ideja trajtohet në një fushë të pastër mes dy partnerëve. Shpesh harrohet se mes tyre nuk ka hapësira bosh: politikanët janë të interesuar të ndikojnë publikun e gjerë përmes medias. Media përpiqet të reflektojë, pasqyroj punën e qeverisë. Ne nuk mund të kalojmë në shtjellim të politikës pa e kuptuar atë se çka është shtypi dhe media. Shtypi dhe media janë institucione informative, që i drejtohen publikut të gjerë dhe paraqesin institucionet me ndikim, që me përmbajtjen e tyre krijojnë opinione dhe ndihmojnë zhvillimin e shoqërisë dhe të sistemit politik, e më gjerë.²⁰⁹ Shumë studiues kanë vërejtur se detyra kryesore e mediave, veç informimit, është edhe të kontrolluarit e politikës – qeverisë. Por, ky relacion është i ngatërruar sepse forca politike (funksionarët, partitë) me

²⁰⁸ Komisioni i Pavarur për Media, <http://www.kpm-ks.org/?faqe=90&gjuha=1>.
E qasur: Maj 2018.

²⁰⁹ Joshua S. Goldstein /Marrëdhëniet Ndërkombëtare /Kapitulli 10 Integrimi / Fuqia e Informacionit faq.430-433.

mundësitë që ua jep pushteti shtrijnë ndikimin deri të përgjegjësitë e mediave, duke i korruptuar, duke i ofruar hapësirë interesi dhe nganjëherë duke i kërcënuar.

Lidhja e interesit bëhet e dyanshme. Shumë herë harrohet detyra e mediave dhe ajo keqpërdoret, mirëpo mendojmë që duke qenë një rol i fuqishëm i mediave në publik, vështirë edhe zbatohet ky rol. Sado që është preferuar dhe preferohet liria e gjithanshme informative, gjenden modele për t'u nxirë dhe penguar liria publike mediale. Ka rëndësi në disa raste që shteti ndalon (sekrete me rëndësi shtetërore), botimin apo publikimin e ndonjë informate²¹⁰. Pushtetit i duhet për qëllime të veta të arrijë afër mediave. Duke i kontrolluar ato, pushteti arrihet më lehtë dhe materializohet e ruhet më lehtë. Përhapja e medias, shtrirja, pastaj teknologjia radio-difuzive, elektronike e ka arritur në masë të madhe rolin e saj, por nuk ka mbetur prapa që politika të influencoj rolin e vet në sistemin medial. Prandaj, mesazhi medial është i veshur edhe me “petkun politik”, sepse kjo është mënyrë shumë e sofistikuar, por edhe praktike që politika të përçojë rolin e vet në masat e gjëra, të individët, grupet e ndryshme për të ruajtur jo vetëm ndikimin, por më shumë të korrë suksesin e vet. Është një botë komplekse në mes të politikës dhe mediave sepse, thotë Zanchini “në shoqëritë e sotme, qeverive u duhet që çdo ditë të marrin vendime lidhur me problemet e ndërlikuara nga pikëpamja teorike dhe praktike.”²¹¹ Edhe qytetarit i duhet të ketë informacion, sepse ai ka në të shumtën e rasteve informacion jothelbësor për interesat dhe votën e tij. Logjike është të kuptohet që bashkëpunimi dhe kyçjet e dyanshme mundësohen në mënyrë reale, përmes një sistemi dhe teknologjie përparimtare.

²¹⁰ IAIN McLEAN Fjalori Politik i Oxfordit (Oxford University Press 1996.) Mjetët e Informacionit faq.367-368.

²¹¹ G. Zanchini, Teledemokracia (Botim i Institutit Shqiptar të Medias) faq. 58. / Tiranë 2001.

Qeveritë e vendeve të ndryshme, i kanë kushtuar vëmendje zhvillimit të mediave. Ish-nënpresidenti amerikan Al Gore, ishte nismëtar i “Autostradave elektronike”, nismëtari i krijimit të flukseve informative me qëllim që qytetarët të mund t’i shfrytëzojnë informacionet me teknike të thjeshtë informative dhe pa diskriminime elektronike.²¹² Iniciativat e tilla si në SHBA, ndikojnë që qytetarit t’i mundësohet të shoh nga afër sferat qeverisëse, shqyrtimin e pozitës së tij në raport me qeverisjen dhe pushtetin, t’i ofrohet mundësia për njohje dhe debat, ndikim mbi pushtetin dhe ligjin. Gjithashtu kjo mundëson shansin për të reaguar në politikë, për të kërkuar dhe testuar aftësitë e politikanëve sidomos, në fushata dhe zgjedhje. Mundësia televizive edhe e formave tjera të shprehjes dhe informimit, pavarësisht nga koha dhe hapësira, mundëson që mendimi sa më bashkëkohor të krijoj rregullin dhe rezultatin pozitiv edhe për nivelet sa më pozitive të demokracisë. Sidoqoftë, mediat sot ballafaqohen edhe me fenomenin e “lajmeve të rreme”, që kanë pasur ndikim të madh në zgjedhjet presidenciale në ShBA, ku studimet tregojnë që këto lajme kanë ndihmuar Presidentin Trump t’i fitoj zgjedhjet presidenciale në vitin 2016.²¹³ Pra, sot lajmet e rreme mund të luajnë një ndikim negativ në informimin jo të drejtë të qytetareve karshi zhvillimeve të ndryshme vendore dhe ndërkombëtare.

Prapë se prapë, mbetet jetik fakti se pjesëmarrja në politikë është e rëndësishme dhe praktike që të bëhet përmes mediave. Roli i medias dhe anasjelltas, përbën mundësinë kruciale që pjesëmarrja në politikë të bëhet e atillë që të mundësoj konsolidimin sa më të madh të demokracisë së një vendi. Vetëm duke i njohur dhe plotësuar dëshirat e qytetarit pa dallim ideologjik, racial, nacional

²¹² Giorgio Zanchini, Teledemokracia (Botim i Institutit Shqiptar të Medias) faq. 34. / Tiranë 2001.

²¹³ The Washington Post: https://www.washingtonpost.com/news/the-fix/wp/2018/04/03/a-new-study-suggests-fake-news-might-have-won-donald-trump-the-2016-election/?noredirect=on&utm_term=.d24f5653fcd7. E qasur: Maj 2018.

mundësohet një shpërndarje e mirë e vlerave politike. Politika ka interes që të ndikoj për mundësitë e veta teorike dhe praktike në sistemin medial, kurse individit dhe shoqëria t'i ekzaminoj dëshirat dhe vullnetet, duke qenë më afër pushtetit dhe eventualisht duke pasur qasje të drejtpërdrejtë-kontrolluese. Në fund të fundit, është e rëndësishme të kuptohet se si këto relacione duhet të funksionojnë për t'u arritur një bazë që e trajton pjesëmarrjen në politikë të rëndësishme dhe të domosdoshme sot.

VII.1.1.3. Funksioni i mediave në zhvillimin e Demokracisë

Mediat sot kanë një rol shumë të rëndësishëm në demokraci. Ato kanë funksionin kyç, i cili lidhet me shumë procese, të cilat ndodhin brenda vet një demokracie. Nëqoftëse nuk do të ekzistonin mediat, edhe ekzistimi i demokracisë nuk do të kishte kuptim. Edhe në kohën e antikës, kryesisht në polisët greke, ekzistonte një demokraci e asaj kohë me disa elemente të saj, po ashtu kanë ekzistuar edhe mediat por jo në kuptimin çfarë i shohim sot, por në një mënyrë më të thjeshtë, por në rrethana të kohës.

Mediat si një element shumë i rëndësishëm dhe me ndikim të madh të qytetareve, ka zënë një vend të veçantë në demokraci. Ndikimi i medias në demokraci ushtrohet përmes disa funksioneve:

1. përcakton shkallën e demokracisë së një vendi,
2. funksioni i zhvillimit të interaksionit ndërmjet qytetarëve dhe pushtetit,

3. qeverisja e hapur dhe

4. ndikimi i mediave (konkretisht masmediat) në krijimin e opinioneve.

Përcaktimi i shkallës së demokracisë të një vendi nënkupton disa përmasa të veçanta, me të cilat korrespondojnë mbi hapësirën vepruese të qytetarëve dhe medias në një anë të veçantë me realizimin e disa proceseve të mira për shoqërinë, që sot njihet me emrin demokraci. Ekzistojnë shumë mendime të ndryshme dhe të arsyeshme, kur mendohet në rolin e medias që luajnë në demokraci. Roli i medias në demokraci është shumë i madh dhe ka një ndërlidhje të ngushtë në mes të demokracisë në njërën anë dhe medias në anën tjetër. Disa nga autoret e ndryshëm demokracinë e kuptojnë dhe e interpretojnë në forma të ndryshme, madje nganjëherë duke i parë si sinonime. Mund të themi që shpeshëherë mediat kanë qenë ato të cilat kanë bartur barrën e rëndë për shumë procese politike që janë zhvilluar në konsolidimin e demokracisë, madje duke përcaktuar nivelin e saj.²¹⁴

Zhvillimi i interaksionit në mes të qytetarëve dhe pushtetit, një nga funksionet më të rëndësishme ku një interaksion i tillë realizohet përmes mediave, i cili paraqet edhe esencën e demokracisë si veprim i saj. Kështu krijohet një urë lidhëse në mes qytetarëve në njërën anë, që dërgojnë mesazhe përmes të cilave shpreh kërkesat e veta, dhe pushtetit në anën tjetër, i cili merr apo pranon këto mesazhe të qytetarëve. Kjo lidhje ka pasur, ende ka si dhe do të ketë edhe në të ardhmen një rol shumë të rëndësishëm. Çdo qeveri supozohet të veprojë sipas interesave të qytetarëve të saj. Kur politikat alternative ushtrojnë ndikim të ndryshëm mbi grupe të ndryshme, atëherë qeveria vepron në atë mënyrë duke llogaritur në atë se kush humb dhe kush përfiton prej këtyre programeve

²¹⁴ George Zanchini, Teledemokracia , E drejta për të treguar rolin e mas medias në zhvillimin ekonomik. 2001 Tiranë 2001 , faqe 45.

alternative, të cilat realizohen në kuptimin e definimit nga mediat. Kurrësi nuk mund të mendohet që një qeveri ta përdorë pushtetin e saj të jashtëzakonshëm për t'u krijuar privilegj drejtuesve të vet ose t'u shërbej interesave speciale të individëve të veçantë mbi kurriz të publikut të përgjithshëm, nëse mediat kanë një rol aktiv në këtë proces. Sikur votuesit të dinin që qeveritarët e kanë shkelur besimin e tyre, atëherë ata do të votonin që t'i largonin nga pushteti.

Qeverisja e hapur. Sekretit u jep atyre që qeverisin një kontroll ekskluziv mbi disa fusha të dijes, çka për rrjedhojë, i veshë ata me më tepër pushtet. Kështu, nuk është asgjë për t'u habitur që çështja e sekretit lidhur me problemet në pronësi publike ka qenë prej kohësh dhe mbetet në qendër të vëmendjes së opinionit publik. Argumentet e hedhura kundër sekretit shkojnë me argumentet kundër ushtrimit të censurës dhe në favor të fjalës së lirë. Por, do të ishte James Medison , arkitekti i Amandamentit të Parë të Kushtetutës së SHBA-së, që garanton të drejtën e fjalës së lirë, i cili do të prekte thelbin e çështjes : “Një popull që synon të jetë zot i fateve të veta lypset të vetëarmatohet me pushtetin që i jep dija . Nuk mund të ketë një qeverisje popullore pa popull të informuar ose mjetet që realizojnë në këtë gjë, përndryshe do të kemi prologun e një farse ose të një tragjedie “. ²¹⁵

Në anën tjetër, Jeremy Bentham e bazonte sistemin e vet konstitucional mbi motivin e interesit vetjak, të korrigjuar nga publiku më i gjërë që mund të jetë i mundur në demokraci. Publikun e shihte si mjet kryesor të kontrollës kundër çdo keqqeverisje. Në esenë e vet të titulluar “Rreth Lirisë “. ²¹⁶ John Stuart Milli ia nënshtronte argumentet vëzhgimit të opinioneve publike përmes mediave,

²¹⁵ Samuel Stumpf , Filozofia , Toena ,Tiranë , faqe 343.

²¹⁶ Samuel Stumpf ,Filozofia Toena, Tiranë, faqe 349-350.

ishte i pakushtëzuar dhe përbënte rrugën më të sigurtë të mbivendosjes së argumenteve të mira ndaj atyre të këqija .²¹⁷

Pra, në thelb, nuk mund të ketë një pjesëmarrje reale e kuptimplotë në proceset demokratike, pa pjesëmarrje të ditur dhe të informuar. Mbrojtja e të dhënave sekrete pakëson informacionin në dispozicion të qytetarëve, çka e zbeh aftësinë e njerëzve për një pjesëmarrje sa më të gjallë e të përnjëmendtë. Ndokush mund të thotë se një shoqëri që ka shtyp të lirë dhe institucione të lira, nuk humb ndonjë gjë të madhe nga një qeveri që i mban sekretet vetëm për vete, tek e fundit ka edhe burime të tjera prej nga mund të vilen shumë informacione. Për faktin se njohja e çmuar e rëndësisë së një informimi për një qeverisje sa më efektive, shoqëritë demokratike moderne bëjnë çmos për të ruajtur imazhin e tyre .

Ndikimi i mas-mediave në krijimin e opinioneve. Cilësia është diçka e vështirë për ta vlerësuar, madje edhe përshtatur. Media të cilësisë së lartë mundohen të depërtojnë dhe të tregojnë aftësinë për të vepruar objektivisht lidhur me krijimin e opinioneve dhe realizimin e tyre në publik. Ajo çka është e rëndësishme për të gjitha proceset politike të një vendi është shprehja e lirë e opinioneve, të cilat mund të jenë si opinione të dy taksistëve, të cilët kanë mendimet e veta që shprehin qëndrimet rreth politikës së bërë nga shteti apo opinionet e një grupi të sportistëve, etj.

Liria e mendimit apo e shprehjes janë elemente bazë të cilat i dhanë kuptim demokracisë. Këto të drejta lidhen ngusht me njeriun dhe u dedikohen njerëzve, të cilët sot nuk janë të mbrojtur vetëm nga shtetet nacionale, por me formimin e OKB-së (1945) e cila me 10 dhjetor 1948 nga ana e Asamblesë së Përgjithshme të Kombeve të Bashkuara ka aprovuar Deklaratën e të Drejtave të

²¹⁷ Kushtetuta e SHBA-ve, <http://constitutionus.com/>. E qasur: Maj 2018.

njeriut në mbarë botën, konkretisht neni 18 – përcakton të drejtën dhe lirinë e mendimit, bindjes dhe besimit, kurse neni 19 – shprehja e lirë e mendimit.²¹⁸

Kryesisht, nga kjo deklaratë e të drejtave për një varg çështjesh, të cilat paraqiten për lirinë e veprimit, nënkupton edhe atë mediatik. Kjo nuk do të thotë se nuk kemi edhe akte tjera ndërkombëtare, të cilat rregullojnë shumë çështje që lidhen me funksionimin e medias dhe rolin e saj që luan në demokraci.

VII.1.1.4 Roli i Mediave në konsolidimin e Demokracisë në Kosovë

Duke filluar nga Kushtetuta, Republika e Kosovës ka një bazë ligjore, e cila e mbrohet prodhimin dhe shpërndarjen e medias në përgjithësi nga çfarëdo ndërhyrje, qoftë ajo shtetërore apo ndonjë aktori tjetër, e sidomos ndaj atyre që do t'i parandalonin ata që të përmbushnin misionin e tyre publik.

Në të njëjtën kohë, mediat krijojnë një lidhje mes njerëzve dhe përfaqësuesve të tyre të zgjedhur: jo pak nga mediat, parlamentarët dhe qeveria mësojnë atë që njerëzit mendojnë dhe duan, dhe njerëzit mësojnë atë që parlamenti dhe qeveria planifikojnë dhe bëjnë. Në fund të fundit, mediat ushtrojnë kontroll mbi pushtetarët, duke shpërndarë gjithashtu informacionin që ata do të donin të mbanin sekret dhe duke komentuar në mënyrë kritike mbi këtë informacion. Për shkak të këtij funksioni të

²¹⁸ Zejnullah Gruda, E Drejta Ndërkombëtare Publik Prishtinë 2003, faqe 371.

kontrollit, mediat gjithashtu referohen si "mbikëqyrëse" të demokracisë (watchdogs) ose si "pushteti i katërt."²¹⁹

Siç thamë më lartë, roli i mediave sot kudo në botë ka një rendësi të pazëvendësueshme. Informimi është një fenomen pa të cilin bota nuk mund të imagjinohet. Në anën tjetër, politika vazhdon të dominojë jetën tonë të përgjithshme si dhe specifikat e saj. Pjesëmarrja në politikë përmes mediave, është e padiskutueshme nga pikëpamja e qeverisjes dhe sistemit demokratik. Është e pakontestueshme edhe për shkak të dobisë qytetare, si dhe për nga nevoja e zhvillimit të dyanshëm. Mediat përçojnë në mënyrë të efektshme segmentet politike, modelet qeverisëse, strukturat dhe mekanizmat e ndryshëm qeverisës etj. Politika distribuohet në mënyrë të efektshme përmes "Industrië mediale". Media me të drejtë quhet "pushtet i katërt" në sistemin e konsoliduar të një shteti demokratik.²²⁰ Informimi konsiderohet si oksigjen për shtetet demokratike. Informimi i drejtë dhe korrekt arrihet vetëm në sajë të mediave të lira. Liria e mediave është një ndër shtyllat kryesore për funksionimin e një shoqërie demokratike.

Edhe në Kosovë mediat kanë luajtur dhe luajnë një rol të rëndësishëm në të gjitha sferat e jetës publike.²²¹ Për ta trajtuar rolin e mediave në konsolidimin e demokracisë në Kosovë konsideroj që së pari duhet përmendur disa nga parimet kryesore të zhvillimit të mediave në shtetet demokratike, e pastaj të shikohet se si qëndron Kosova karshi atyre parimeve. Siç e përmendëm edhe më lartë, së pari konsolidimi demokratik i një shteti matet edhe me lirinë e shtypit. Në demokraci, mediat janë

²¹⁹ Shiko ne: <http://www.bpb.de/izpb/7492/warum-medien-wichtig-sind-funktionen-in-der-demokratie>. E qasur: Nëntor 2018.

²²⁰ USA Today: <https://usatoday30.usatoday.com/educate/elections/elect5.htm>. E qasur: Maj 2018.

²²¹ Freedom of Expression, Media and Information in Kosovo An Assessment Based on Council of Europe Indicators for Media in a Democracy: http://safejournalists.net/wp-content/uploads/2016/10/Freedom_of_Expression_Media_and_Information_in_Kosovo_529396.pdf. E qasur: Maj 2018.

zëri i qytetarit, për dallim nga diktatura ku mediat janë në shërbim të pushtetit dhe diktaturës. Mediat janë të pavarura dhe të lira për aq sa respektojnë etiken dhe profesionalizmin, e këtë pavarësi e garanton edhe kushtetuta dhe legjislacioni në fuqi. Qëllimi i mediave është që të jenë afër informacionit të saktë dhe të besueshëm dhe që të njëjtin ta shpërndajnë sa më shpejtë që është e mundur. Pra, për të qenë një media e besueshme, duhet t'i posedojë burimet e informacionit, që janë të besueshme dhe që mos të jenë të njëanshme. Shtetet me konsolidim të lartë të demokracisë nuk mbyllen përballë mediave, përkundrazi u lejojnë gazetarëve të bëjnë hulumtimet e duhura dhe që në mënyrë profesionale dhe të sigurtë të kryejnë punën e tyre.

Por, a respektohen të gjitha këto parime dhe kritere në Kosovë?

Shpeshherë jemi dëshmitarë se mediat tona janë të kufizuara të pasqyrojnë gjendjen reale, e kjo ndodh për shkak të presioneve që vijnë nga ana e politikës dhe tendencës që të kenë një kontroll të konsiderueshëm mbi to. Kontrolli i mjeteve të informimit është sinonim i kontrollit të vendimmarrjes në demokraci, prandaj liria e mediave ka rëndësi vitale për funksionimin e një shoqërie demokratike. Hapi i parë që zakonisht e ndërmarrin qeveritë që synojnë kontrollin ndaj medias është shkurtimi apo persekutimi i lirisë së të shprehurit, e që në rastin e Kosovës ka ndodhur shpesh, ku kanë ardhur në pyetje çështjet që kanë pasur të bëjnë me pushtetin dhe informacionet e harxhimit të parasë publike për dijeninë e qytetarëve. Liria e të shprehurit është një ndër të drejtat themelore të njeriut për realizimin dhe funksionimin e demokracisë. Sot konsiderohet që liria e një shoqërie përcaktohet nga liria e shtypit dhe e mediave të lira në përgjithësi. Prandaj, është e natyrshme që mediat kanë një rol qendror në demokraci, i cili rol është informimi i publikut për çështje që ndodhin në shoqëri në të gjitha sferat e jetës.

Funksion tjetër i mediave është edhe mbikëqyrja e punës së qeverisë dhe institucioneve tjera të publike dhe jopublike të një shteti demokratik. Për media është e zakonshme të kenë çasje kritike ndaj pushtetit, mirëpo vetëm përmes fakteve dhe argumenteve e asnjëherë duke qene të njëanshëm. E drejta e kërkimit, marrjes dhe dhënies së informacionit konsiderohet si e drejtë e pamohueshme politike dhe civile.

Është po ashtu e drejtë e çdo qytetari dhe mediumi që të kritikoj udhëheqësinë e vendit dhe çasja e mediave në një rrjedhë të lirë të informatave është një element mjaft i rëndësishëm për një shoqëri të hapur dhe pluraliste. Në shumë vende të botës me demokraci të avancuar, janë mediat ato që u paraprinë zbulimit të shumë dukurive, siç janë: krimi i organizuar, korrupsioni, nepotizmi në institucionet publike dhe shtetërore etj. Zakonisht kjo ndodh në vendet me demokraci të zhvilluar, ku mediat kanë liri të kërkimit, marrjes dhe dhënies së informacionit.

Sidoqoftë, në Kosove mediat janë nën presionin e qeverisë dhe nuk janë të lira të informojnë opinionin objektivisht.²²² Kjo e bën të vështirë lirinë e veprimit të mediave në Kosovë, edhe pse ligji ua garanton funksionimin e tyre të pavarur.

Tregu mediatik i Kosovës është i mbushur me numër të madh të mediave të shkruara dhe elektronike, ndërsa mediat janë subjekt i presionit politik dhe ekonomik. Është ky një ndër përfundimet e raportit që analizon gjendjen në Kosovë të Organizatës së Evropës Juglindore për Media (SEEMO). Raporti vë në pah se presionet vijnë nga burime të ndryshme, si nga Qeveria apo partitë politike, por edhe prej biznesit dhe përfaqësuesve ndërkombëtarë.

²²² SEEMO: Presioni Politik e ekonomik mbi mediat kosovare: <https://www.evropaelire.org/a/24560213.html>. E qasur: Maj 2018.

“Frikësimi, fyerja verbale, pengimi i mbulimit të ndonjë ngjarjeje të caktuar dhe sulmet fizike janë pjesë e jetës së përditshme të gazetarëve. Njerëzit frikësohen të dalin para kamerave dhe të shprehin atë që mendojnë”, thuhet ndër të tjera në raport, ndërsa citohen gazetarët kosovarë të kenë thënë se problem më vete është edhe vetëcensura.²²³

Kërcënimet dhe presionet, sipas raporti të SEEMO-s, vijnë nga institucione të ndryshme: Qeveria, përfshirë ministrinë, partinë politike, organizatat ndërkombëtare, biznesi, gjykatësit dhe Akademia. Radio Televizioni i Kosovës është një shembull konkret. Pra, Radio Televizioni i Kosovës është medium publik, i cili financohet nga qeveria, ndërsa vetëm tek vendet që synojnë të kenë një kontroll të plotë mbi mediat ndodh që mediumet e tyre publike të financohet drejtpërdrejt nga qeveria. Pra, shtrohet pyetja se çfarë çasje kritike mund të ketë ky medium publik ndaj qeverisë e cila vetë e financon?

Natyrisht se kjo ndikon negativisht në informimin e qytetarëve dhe në kredibilitetin e informacioneve që jep ky medium, për shkak se gazetarët nuk kanë guxim të trajtojnë çështje delikate që kanë të bëjnë me punën e Qeverisë, që është një e drejtë e pamohueshme e çdo mediumi.²²⁴

Sipas raportit të “Reporterëve pa kufij”, Kosova është renditur në mesin e vendeve me media pjesërisht të lira. Duke iu referuar mediave kosovare, organizata vlerëson se mediat në Kosovë, mes tjerash vuajnë nga ndikimet direkte politike.²²⁵ Pra, “mediat në Kosovë vuajnë nga ndikimet direkte

²²³ SEEMO: Presioni Politik e ekonomik mbi mediat kosovare: <https://www.evropaelire.org/a/24560213.html>. E qasur: Maj 2018.

²²⁴ Kapja e shtetit vazhdon me politizimin e Bordeve: <http://kallxo.com/gjnk/kapja-e-shtetit-vazhdoi-me-politizimin-e-bordeve/>. E qasur: Maj 2018.

²²⁵ Reporters without borders: <https://rsf.org/en/kosovo>. E qasur: Maj 2018.

dhe indirekte politike, presion financiar si dhe varësi nga pronarët”, thuhet në raport. “Reporterët pa kufij”, në veçanti përmendin rastin kur kryetari i AAK-së, Ramush Haradinaj erdhi në pushtet duke marrë drejtimin e Qeverisë dhe ku ai i quajti të pashkolluar gazetarët. Raporti i vitit 2018 përmend edhe sulmin ndaj dy gazetarëve hulumtues, për të cilët thotë se u sulmuan pasi kishin bërë raportime kritikuese për Qeverinë dhe aleatët e tyre. Kur i referohet Qeverisë, raporti thotë se qeveria aktuale duket më e gatshme të flasë me gazetarët dhe mediat në tërësi, për dallim prej dy qeverive të mëparshme, të cilat ishin shumë më pak të hapura për dialog. Pra në përgjithësi në renditjen botërore Kosova renditet në vendin 78-të në listë.²²⁶ Te gjitha këto argumente konfirmojnë se mediat në Republikën e Kosovës gjatë ushtrimit të profesionit të tyre vazhdojnë t’iu ekspozohen ndikimeve/ndërrhyrjeve të ndryshme, qofshin ato direkte apo indirekte. Duke marrë për bazë rolin e mediave në zhvillimin dhe forcimin e demokracisë, mund të themi se ndikimi në punën e mediave në Kosovë është në disfavor të konsolidimit të demokracisë.

Zekrija Shabani, ish-kryetar i Asociacionit të Gazetarëve të Kosovës (AGK) për “Zërin” ka thënë po ashtu se gazetarët dhe mediat në përgjithësi në Kosovë kanë presion nga interesi politik, e po ashtu edhe biznesi.²²⁷

“Raporti tregon se të bërit gazetar në Kosovë, nuk është aspak i lehtë dhe ne nuk jemi plotësisht të lirë në punën tonë. Kjo për shumë arsye, duke filluar nga gjendja e rëndë financiare, me të cilën

²²⁶ Po aty.

²²⁷ Mediat në Kosovë kane probleme financiare e presion politik: dhe <http://zeri.info/aktuale/196364/mediat-ne-kosove-kane-probleme-financiare-e-presion-politik/>.
E qasur: Maj 2018.

përballen mediat në vend, mungesa e funksionimit të rendit dhe ligjit, si dhe presionet e grupeve të interesit nga politika e biznesi”, deklaroi Shabani.²²⁸

Pra, siç u tha edhe më lartë, mund të konkludojmë se një shoqëri demokratike nuk mund të funksionoj pa ekzistimin e mediave të lira, të cilat do të pasqyronin gjendjen reale, dhe të cilat mund të kenë një qasje kritike ndaj organeve qeverisëse. Prandaj, me të drejtë në kohët e sotme demokracia e një vendi identifikohet me demokracinë mediale dhe shoqëritë e sotme demokratike quhen shoqëri mediale. Në rastin e Kosovës, nuk mund të mohohet fakti që mediat kanë luajtur dhe luajnë një rol të rëndësishëm në konsolidimin demokratik të shtetit të Kosovës, por sa kanë qenë këto media të lira të ushtrojnë funksionin e tyre, tregojnë raportet ndërkombëtare, të cilat fatkeqësisht Kosovën e vendosin gjithnjë keq sa i përket lirisë së veprimit të tyre.²²⁹ Shpeshherë, liria e mediave në Kosovë është cilësuar edhe më e keqja në Ballkan, por në përgjithësi është ranguar në pozicione shumë të dobëta shkakut i rasteve të shumta të kërcënimit të gazetarëve dhe raportimeve të ndryshme.²³⁰

Në përgjithësi, kur të flasim për rolin dhe rëndësinë e ndikimit të shoqërisë civile dhe mediave në konsolidimin e demokracisë në Kosovë, mund të konkludojmë që këto dy institucione që së bashku përbejnë shoqërinë civile, kanë bërë përpjekje të pamohueshme në zhvillimin e mirëfilltë të zhvillimit të shtetit demokratik në Kosovë. Organizatat e shoqërisë civile kanë avokuar në

²²⁸ Mediat në Kosovë kane probleme financiare e presion politik: dhe <http://zeri.info/aktuale/196364/mediat-ne-kosove-kane-probleme-financiare-e-presion-politik/>. E qasur: Maj 2018.

²²⁹ In Freedom of the Press at least, Kosovo is the worst of the Balkans: <https://www.foreignpolicyjournal.com/2016/05/06/in-freedom-of-the-press-at-least-kosovo-is-the-worst-of-the-balkans/>. E qasur: Maj 2018.

²³⁰ Kosovo: Indicators for the level of media freedom and journalists' safety: <https://www.rcmediafreedom.eu/Publications/Reports/Kosovo-Indicators-for-the-level-of-media-freedom-and-journalists-safety>. E qasur: Maj 2018.

vazhdimësi përmes projekteve të ndryshme tema të rëndësishme, sidomos ato që kanë të bëjnë me luftën kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar, janë përpjekur të kontrollojnë punën e Qeverisë. Parlamentit, gjyqësorit etj. Mediat kanë qenë gjithmonë të gatshme për raportime të sakta dhe të paanshme. Sidoqoftë, në fund të ditës kjo nuk mjafton, sepse më e rëndësishmja është të konstatojmë se sa të lira kanë qenë ato për të kryer punën e tyre me sukses, sa janë penguar ato në kryerjen e veprimtarive të tyre. Pra, raportet ndërkombëtare dhe vendore që merren ekskluzivisht me lirinë e mediave dhe shoqërisë civile në Kosovë deri më tani kanë raportuar për përpjekjet e shoqërisë civile në masën e duhur, për t'i raportuar dhe avokuar temat me rëndësi në Kosovë, mirëpo gjithmonë duke u ballafaquar edhe me pengesa të mëdha nga ana e politikës²³¹.

Si përfundim nga ky kapitull mund të themi se Shoqëria Civile me të vërtetë luan një rol tepër të rëndësishëm në konsolidimin e përgjithshëm të demokracisë dhe institucioneve demokratike të një vendi. Sidoqoftë, shoqëria civile e Kosovës ka pasur dhe ka ende ndikim të kufizuar në çështjet që janë brenga kryesore e qytetarëve, siç janë zhvillimi ekonomik dhe sundimi i ligjit.

Problemi kryesor me të cilin ballafaqohet shoqëria civile në Kosovë është të vepruarit në një ambient të pafavorshëm.

Polarizimi i spektrit politik të vendit ka bllokuar punën e Kuvendit të Kosovës për një pjesë të madhe gjatë dy viteve të fundit. Ndërsa edhe besimi i qytetarëve ndaj institucioneve kryesore në Kosovë është gjithnjë në rënie. Pra të kuptuarit publik i rolit të shoqërisë civile mbetet i ulët, ndërsa është po ashtu brengosëse që shoqëria civile i nënshtrohet presioneve politike dhe kërcënimeve nëse

²³¹ Political pressures taking toll on Kosovo Journalists: Report
<http://www.balkaninsight.com/en/article/political-pressures-taking-toll-on-kosovo-journalists-report-11-21-2017>. E qasur: Maj 2018.

aktivitetet e saj nuk përputhen me qëndrimet e autoriteteve. Nga ana tjetër, ka edhe mungesa të njohurive të qytetarëve për rolin të cilin e ka një shoqëri civile në demokraci, që bënë që angazhimi qytetar në Kosovë të jetë në nivel të ulët. Prandaj, organizatat e shoqërisë civile nuk duhet vetëm të thirren në emër të qytetarëve, por duhet të jenë edhe më afër tyre, duke i përfaqësuar denjësisht interesat e tyre qytetare.

Sa i përket rolit të mediave, në këtë kapitull janë sjellë fakte dhe argumente se mediat në Republikën e Kosovës janë të kufizuara të pasqyrojnë gjendjen reale, e kjo ndodh për shkak të presioneve që vijnë nga ana e politikës dhe tendencës që të kenë një kontroll të konsiderueshëm mbi to. Kontrolli i mjeteve të informimit është sinonim i kontrollit të vendimmarrjes në demokraci, prandaj liria e mediave ka rëndësi vitale për funksionimin e një shoqërie demokratike. Hapi i parë që zakonisht e ndërmarrin qeveritë që synojnë kontrollin ndaj medias është shkurtimi apo persekutimi i lirisë së të shprehurit, e që në rastin e Kosovës ka ndodhur shpesh ku ka ardhur në pyetje çështjet që kanë pasur të bëjnë me pushtetin dhe informacionet e harxhimit të parasë publike për dijeninë e qytetarëve. Pra, siç edhe përmendet disa herë radhazi në kapitullin që ka trajtuar rolin e medias në Kosovë, mediat janë nën presionin e qeverisë dhe nuk janë të lira të informojnë opinionin objektivisht. Tregu mediatik i Kosovës është i mbushur me numër të madh të mediave të shkruara dhe elektronike, ndërsa mediat janë subjekt i presionit politik dhe ekonomik. Është ky, pra, një ndër përfundimet e raportit, që analizon gjendjen në Kosovë të Organizatës së Evropës Juglindore për Media (SEEMO). Raporti vë në pah se presionet vijnë nga burime të ndryshme, si nga Qeveria apo partitë politike, por edhe prej biznesit dhe përfaqësuesve ndërkombëtarë. Edhe sipas raportit të “Reporterëve pa kufij” Kosova është renditur në mesin e vendeve me media pjesërisht të lira. Duke

iu referuar mediave kosovare, organizata vlerëson se mediat në Kosovë, mes tjerash, vuajnë nga ndikimet direkte politike.

Sidoqoftë, siç e kemi përmendur disa herë në këtë kapitull, mund të konkludojmë se një shoqëri demokratike nuk mund të funksionoj pa ekzistimin e mediave të lira, të cilat do të pasqyronin gjendjen reale, dhe të cilat mund të kenë një qasje kritike ndaj organeve qeverisëse. Në rastin e Kosovës, nuk mund të mohohet fakti që mediat kanë luajtur dhe luajnë një rol të rëndësishëm në konsolidimin demokratik të shtetit të Kosovës, por sa kanë qenë këto media të lira të ushtrojnë funksionin e tyre tregojnë raportet ndërkombëtare, të cilat fatkeqësisht Kosovën e vendosin gjithnjë keq sa i përket lirisë së veprimit të tyre. Prandaj, në mënyrë që të kemi një zhvillim më të madh të rolit të shoqërisë civile dhe medias, në përgjithësi kërkohet gjithashtu një avancim më i madh i rolit të tyre në promovimin dhe konsolidimin e shtetit të së drejtës. Shoqëria civile dhe mediat duhet të rrisin presionin e tyre karshi Qeverisë dhe qeverisjes në mënyrë që t'i realizojnë detyrat dhe përgjegjësitë e tyre në mënyrë të papenguar.

Rekomandimet

- Mekanizmat ndërkombëtar, në veçanti Bashkimi Evropian duhet të kenë një qasje të prerë lidhur me strukturat paralele, të cilat jo vetëm që hezitojnë të integrohen në institucionet e Republikës së Kosovës, por edhe bëjnë veprime destruktive duke mos përjashtuar edhe ato kriminale.
- Duhet të krijohet një balancë e vërtetë ndërmjet tri pushteteve në Kosovë pra legjislativit, ekzekutivit dhe gjyqësorit, sepse funksionimi i pavarur i këtyre tri pushteteve është çelës i funksionimit të një shteti demokratik;
- Legjislativi duhet të kryej funksionin e tij kryesor, miratimin e ligjeve, sepse Kuvendi i Kosovës në të gjitha legjislaturat më shumë ka debatuar për tema që shpesh here kanë qene jorelevante dhe jashtë rendit të ditës sesa miratimi i ligjeve;
- Niveli i efikasitetit i mbikëqyrjes së Qeverisë nga ana e Kuvendit të Kosovës vë në pikëpyetje kompetencat e këtij institucioni si dhe humb besimin tek qytetarët e Republikës së Kosovës të cilët edhe i japin mandatin, prandaj forcimi i mbikëqyrjes do ta bënte Qeverinë me përgjegjëse si dhe do e forconte besimin në mes kuvendit e qytetarëve, i cili është zbehur shumë, sidomos viteteve të fundit. .
- Pushteti ekzekutiv në Kosovë në vazhdimësi ka ndikuar gjyqësorin, ku si rezultat i kësaj këtë shtyllë të pushtetit tejte të rëndësishme, e ka sjellë deri në atë nivel sa që kredibilitetit dhe besimi në vendimmarrje pothuajse më nuk ekziston. Varësia e tij nga fryma politike poashtu e ka dhe është duke e penguar konsolidimin e demokracisë si dhe integrimin e Kosovës në mekanizmat ndërkombëtar. Prandaj, influenca e Qeverisë apo ajo partiake ndaj

gjyqësorit duhet të eliminohet nëse është nevoja edhe me mbështetjen e ndonjë mekanizmi të jashtëm.

- Demokracia e brendshme partiake, si njëra nga parimet kryesore të zhvillimit normal të një partie politike në demokraci ka munguara dhe vazhdon të mungoj sepse partitë në Kosovë vazhdojnë të udhëhiqen nga persona të zgjedhur, pa ju nënshtruar një gare transparente dhe demokratike, pra nga të fuqishmit. Si rezultat i kësaj, është më se i nevojshëm forcimi demokratik i proceseve zgjedhore brenda partive si dhe ulja e fuqisë së liderit brenda partive politike në Kosovë;
- Partitë në Republikën e Kosovës akoma kanë burime të dyshimta të financimit të tyre, gjë që bie ndesh me parimet demokratike, prandaj transparenca në deklarimin e financave të partive politike në Kosovë duhet të realizohet sipas ligjeve në fuqi.
- Shoqëria civile luan rolin e mbikëqyrësit në sistemet demokratike si dhe mund të ndikoj tek institucionet që nga bërja e politikave e deri të zbatimi i tyre. Në Kosovë, ky mekanizëm akoma nuk është zhvilluar sa duhet dhe shpesh edhe influencohet nga ngjyrat politike. Pra, shoqëria civile duhet të zhvillohet në profesionalizëm me qëllim që gjatë përfshirjes në politikëbërje apo monitorimin e politikave, të ketë një qasje të pavarur profesionale dhe konstruktive.

Përfundimi

Përmes temave të trajtuara në kapitujt e këtij punimi doktoral kanë marrë përgjigje disa pyetje të rëndësishme në lidhje me konsolidimin e demokracisë në Kosovë.

Në kapitujt e më sipërm, me kujdes janë paraqitur dhe pastaj elaboruar institucione dhe mekanizma shtetëror dhe joshetëror në lidhje me rolin e tyre në konsolidimin e demokracisë në Republikën e Kosovës.

Një kapitull i veçantë i është kushtuar ndarjes së pushteteve, ku të tri pushtetet veç e veç janë trajtuar në këtë punim, me të vetmin qëllim që të verifikohet edhe në aspektin akademik se cilët faktorë në kuadër të tri pushteteve: legjislativit, ekzekutivit dhe gjyqësorit, po e ngadalësojnë konsolidimin e demokracisë në Kosovë.

Kompetencat e rezervuara në kuadër të UNMIK-ut ngadalësuan konsolidimin e demokracisë për shkak se ishte instanca e fundit e normave juridike të dala nga institucionet e Kosovës. Pra, fuqia ekzekutive e Përfaqësuesit të Lartë nuk buronte nga institucionet përfaqësuese të popullit. Po ashtu, misioni i EULEX-it ishte i ngarkuar që ta asistojë Kosovën në fushën e gjyqësorit, policisë, ndërtimit të sistemit të pavarur multietnik të drejtësisë dhe një polici dhe administratë shumëetnike. Pra, edhe në rastin e EULEX-it kishim të bënim me dhënien e kompetencave të këtij mekanizmi që ishte në kundërshtim me parimet e demokracisë dhe konsolidimin e saj. Për më tepër, edhe brenda këtij mekanizmi janë identifikuar raste të korrupsionit dhe ndërhyrjeve të ndryshme në sistemin e drejtësisë, edhe pse ky mekanizëm ishte i thirrur për ta forcuar shtetin ligjor.

Faktori tjetër që ka penguar dhe vazhdon të pengojë konsolidimin e demokracisë në Kosovë është edhe refuzimi i pakicës serbe që të integrohet në sistemin institucional dhe shoqëror të shtetit të Kosovës. Politizimi dhe institucionalizim nga ana e Serbisë i serbeve të Kosovës ka ndihmuar

forcimin e strukturave paralele brenda Kosovës, aktivitetet e të cilave nuk janë penguar nga bashkësia ndërkombëtare. Sfidë e radhës që mund të jetë problem serioz, është edhe krijimi i Asociacionit të Komunave serbe me kompetenca të zgjeruara dhe nëse kjo ndodh, do të vijë në pikëpyetje konsolidimi i demokracisë në Kosovë.

Sa i përket Legjislativit u pa shumë qartë që Kuvendi i Kosovës që nga viti 2008 vlerësohet për një performancë shumë të dobët, e që vazhdon edhe në ditët e sotme të jetë i tillë. Kuvendi i Kosovës ne vazhdimësi iu ka ekspozuar ndikimeve të drejtpërdrejta nga pushteti ekzekutiv, i cili ia ka bere të pa mundur që të veproj në kuadër te kompetencave te tij ashtu siç janë te garantuar me Kushtetutë. Ndërsa edhe e ashtuquajtura “kontrolla dhe balanca” ndërmjet këtyre dy pushteteve ka lënë shumë për tu dëshiruar. Kuvendi i Kosovës në shumë raste ka shkuar në zgjedhje të parakohshme, gjë e cila tregon jo-stabilitet institucional. Pastaj, edhe konstituimi i Kuvendit të ri pas zgjedhjeve ka qenë gjithmonë sfidues dhe i zgjatur me disa muaj, gjë që ka bërë që Kuvendi i Kosovës, si organ i lartë shtetëror, shpesh e ka pasur të pamundur funksionimin e tij apo kryerjen e detyrave të tij me sukses. Konstituimin e Kuvendit çdo herë e ka vështirësuar ne disa raste edhe e ka bere te ta pamundur rivalitetit destruktiv dhe tendencioz i partive politike, te cilat akoma nuk janë ne gjendje për ta ndare interesin e ngushtë nga ai nacional.

Kuvendi i Kosovës, ndër të tjera njihet edhe si organ i cili ka miratuar jashtëzakonisht pak ligje sidomos në legjislaturën e fundit te tij. Rrjedhimisht, disa nga defektet që e kanë përcjellë legjislativin në Kosovë ndër vite janë: miratimi i pakët i ligjeve, fërkimet e ashpra të partive politike parlamentare për tema të nxehta, mos gatishmërinë e qeverisë që te qenë pjesëmarrës në seancat e Kuvendit, në interpelanca dhe debate të rëndësishme shtetërore. Në përgjithësi mund të vijmë në përfundim që Kuvendi i Republikës se Kosovës nuk ka arritur t’i përmbushë obligimet e tij që i

takojnë me Kushtetutën e Kosovës e sidomos funksionin e tij kryesor, e që është miratimi i ligjeve. Mos funksionimi efikas i punës së Kuvendit të Kosovës vë në pikëpyetje njërin nga elementet kryesore të konsolidimit demokratik të një shteti. Kuvendi buron nga populli përmes zgjedhjeve të lira dhe demokratike. Sidoqoftë, pushteti legjislativ në Kosovë ka qenë aq jo efikas ndër vite, sa që shpeshëherë ka vënë në pikëpyetje edhe ekzistencën e vet shtetit, e lëre më kryerjen e detyrave të tij, përmes të cilave do ta përmirësonte edhe imazhin shtetëror dhe konsolidimin e mirëfilltë të demokracisë.

Bazuar në analizën e këtij disertacioni me siguri të lartë mund të themi se dy pushtetet: legjislativi dhe ekzekutivi ende nuk e kanë kaluar provimin e mosndikimit në punët e njëri-tjetrit. Presionet e vazhdueshme që ia bëjnë njëra-tjetrës në vazhdimësi kanë krijuar kriza të përsëritura dhe kanë vënë në dyshim serioz konstatimin që shteti i Kosovës është ende në fazën e hershme të konsolidimit të demokracisë. Për më keq, shpeshëherë pa ndërhyrjen ndërkombëtare si në rastin e tentimit të shfuqizimit të Gjykatës Speciale, Kosova brenda një nate mund ta humbiste krejt çka kishte arritur për shumë vite, ndërsa për konsolidim stabil të institucioneve demokratike as që mund të bëhet fjalë.

Nuk ka dyshim që konsolidimi i mirëfilltë demokratik i një shteti kërkon maturi sa i përket marrjes së vendimeve. Marrëveshjet ndërkombëtare duhet respektuar, sidomos pasi ato janë miratuar njëherë në Kuvend.

Sa i përket rolit të pushtetit ekzekutiv në konsolidimin e demokracisë në Kosovë janë dy probleme që në vazhdimësi e preokupojnë skenën politike në Kosovë. Problemi i parë lidhet me punën e ekzekutivit dhe dobësitë e legjislativit në mbikëqyrjen e ekzekutivit. Rrjedhimisht, ekziston një nivel shumë i ulët i mbikëqyrjes së qeverisë nga ana e Kuvendit të Kosovës. Kjo tregohet edhe me

mospjesëmarrjen e anëtarëve të Qeverisë ende nuk arrijnë të marrin pjesë në seancat plenare parlamentare apo mbledhjet përkatëse të komisioneve parlamentare.

Një nga problemet ishte edhe koalicionet qeverisëse mjaft të mëdha, që në vazhdimësi kanë zbehur fuqinë dhe mekanizmat e mbikëqyrjes parlamentare ndaj qeverisë nga ana e Kuvendit të Kosovës.

Edhe vlerësimet ndërkombëtare përmes raporteve të tyre kanë konstatuar se mbikëqyrja e degës ekzekutive nga Kuvendi duhet përforcuar. Ndikimi i fuqishëm nga ekzekutivi i vendit për ta shndërruar Kuvendin e Kosovës në legjitimues të vendimeve të tij si dhe, kontrolli i dobët parlamentar nga ana tjetër me çdo kusht, ka bërë që Kuvendi i Kosovës edhe pas përfundimit të mbikëqyrjes ndërkombëtare të pavarësisë, të mos arrijë të fuqizohet bazuar në kompetencat kushtetuese. Ndikimi i qeverisë në punën e Kuvendit ka qenë evident, shkak i numrave të deputetëve të koalicionit të pushtetit. Edhe në rastet kur Kuvendi ka votuar diçka që Qeveria e ka vlerësuar si jo të përshtatshme, ka pasur raste kur Qeveria ka ndikuar tek deputetët dhe ata kanë ndryshuar qëndrimin përkitazi me kërkesën e Qeverisë. Kjo ka bërë që në vend se Kuvendi ta kontrollonte Qeverinë, në Kosovë ka ndodhë e kundërta.

Edhe sa i përket pushtetit ekzekutiv dhe pushtetit gjyqësor ka shumë probleme dhe mangësi. Pra pushteti ekzekutiv në Kosovë vazhdimisht ka ndërhyrë në punën e gjyqësorit si dhe ka cenuar funksionimin e pavarur të tij. Zhvillimi i këtij pushtetit e sidomos zbatimi i reformave ende kanë mbetur peng i politikës. Si pasojë e kësaj, sistemi gjyqësor vazhdon të përballet me numrin e vogël të gjyqtarëve, çka edhe shkakton mos efikasitet në punë dhe grumbullim të lëndëve të cilat nuk po zgjidhen. Pushteti ekzekutiv dhe legjislativ asnjëherë nuk ka treguar vullnet të krijojë kushte për punë të pavarur të gjyqësorit. Ekzekutivi, pushtetin gjyqësor me qellim e ka lënë në gjendje të keqe, në mënyrë që të mbetet i varur nga politika. Si përfundim, mund të themi që pushteti ekzekutiv në

Kosovë është më i fuqishëm sesa parashihet të jetë në një shtet normal demokratik. Për më tepër, ky pushtet përveç që ka mbikëqyrje të kufizuar nga legjislativi, ai përkundrazi e kontrollon punën e tij dhe gjithashtu ndikon punën e pavarur të gjyqësorit. Prandaj, mos ushtrimi i kompetencave në mënyrë të pavarur i legjislativit, ekzekutivit dhe gjyqësorit ka ndikuar në ngadalësimin e procesit të konsolidimit të demokracisë në Kosovë.

Sa i përket pozitës së Presidentit, gjatë analizës vijmë në përfundim se pozita e Presidentit në Republikën e Kosovës që nga themelimi i saj iu është ekspozuara sfidave dhe parregullsive të ndryshme ku si pasojë është vënë në pikëpyetje kredibiliteti i kësaj pozite. Mënyra se si janë zgjedhur presidentët deri më tani ka qenë jo në frymën e demokracisë, sepse ata ose janë votuar me vështirësi nga Kuvendi ose janë zgjedhur në mënyrë jo të rregullt, duke përjashtuar çdo normë demokratike dhe kushtetuese, siç është rasti i ish-Presidentes znj. Jahjaga.

Faktori tjetër që ka nxitur debat lidhur me shkeljet kushtetuese nga ana e presidentëve është edhe përfshirja apo të qenit nën petkun e partive, pjesë e të cilave kanë qenë apo edhe vazhdojnë të jenë. Po ashtu, veprimet jashtë kushtetuese të pozitës së Presidentit, siç e kemi rastin e dialogut me Serbinë, e ka bërë edhe më të komplikuar dhe tejet të debatueshëm pozicionin e Presidentit karshi dialogut, sepse presidenti nuk është mandatuar nga kuvendi për të negociuar me Serbinë. Një vet emërim/mandatim në krye të dialogut del përtej kompetencave presidenciale, të cilat i thotë shprehimisht Kushtetuta e Republikës së Kosovës.

Me vet faktin që Republika e Kosovës nuk është vend/sistem presidencial por parlamentar, është në mandatin e Kuvendit të Kosovës që të mandatoj subjektin, i cili do të dialogonte me Serbinë.

Të gjitha këto janë argumente që mënyra se si janë zgjedhur presidentët e Republikës së Kosovës, si dhe mënyra se si udhëheqin me këtë pozitë, e kanë penguar dhe mund të vazhdojnë ta pengojnë konsolidimin e demokracisë. Pra, Presidenti aktual me veprimet e fundit karshi dialogut me Serbinë, ka tejkaluar kompetencat e tij, duke venë në pikëpyetje kushtetutshmërinë dhe mandatin kushtetutës që ka pozita e presidentit.

Prandaj, marrë për bazë këto fakte mund të konkludojmë se përmbushja e kriterëve për **nivelin e parë të konsolidimit të demokracisë** sipas Merkel, vazhdon të përcillet nga defekte të mëdha. Ky nivel i konsolidimit sipas Merkel, është niveli i parë dhe niveli bazë (niveli makro), prandaj defektet që e përcjellin atë, pa dyshim që do të kenë direkt ndikim edhe në nivele të tjera të konsolidimit, si në konsolidimin reprezentativ (nivel mezo), ku përfshihen partitë politike si dhe dy nivelet tjera (nivelet mezo), si konsolidimi në sjellje dhe konsolidimi i kulturës qytetare.

Te **niveli i dytë i konsolidimit të demokracisë**, pra niveli reprezentativ ku sipas Merkel përfshihen partitë politike u potencua në punim se partitë politike në Kosovë vazhdojnë të manifestojnë një demokraci të brishtë brenda tyre. Mostransparenca e burimeve financiare vazhdon të jetë njëra ndër problemet në këtë fushë. Shumica e partive politike në Kosovë nuk e bëjnë publik raportin e financimit.

Bazuar në të gjeturat, mund të thuhet me përgjegjësi të lartë se partitë politike në Kosovë ende përballen me probleme të theksuara sa i përket konsolidimit të demokracisë së brendshme, e që është njëra nga parimet kryesore të zhvillimit normal të një partie politike në demokraci. Mostransparenca e deklarimit të financave të tyre, mungesa e kulturës së lejimit të debatit të brendshëm, fuqia e madhe që ka lideri, zgjedhjet e brendshme jodemokratike dhe regjionalizmi janë

vetëm disa nga problemet që janë identifikuar në këtë punim si dhe me të cilat përballen sot partitë politike në Kosovë, e që si pasojë vejnë në dyshim rolin e tyre në konsolidimin e demokracisë në Kosovë.

Sa i përket zgjedhjeve të lira, te cilat përbëjnë shtyllën kryesore të demokracisë, ato kanë pasur shumë parregullësi dhe probleme. Procesi zgjedhor në Kosovë në fillimet e tij është përcjellë në vazhdimësi me parregullësi të shumta, që ishin: vjedhja dhe manipulimi i votave, shkelja e privatësisë së votës, votimi familjar, presioni dhe frikësimi i vëzhguesve vendor. Te gjitha këto kanë bërë që qytetari i Kosovës ta humb besimin ndaj zgjedhjeve të lira dhe demokratike si dhe ndaj institucioneve që dalin nga këto zgjedhje, saqë është rënë edhe numri i qytetarëve të cilët dalin për të votuar. Humbja e besimit ndaj institucioneve është një ndër indikatorët më të rrezikshëm që mund ta godas konsolidimin e demokracisë.

Në **nivelin e tretë të konsolidimit të demokracisë**, sipas Merkel, niveli i sjelljes së akterëve politik brenda rregullave demokratike, pamë që Kosova sfidohet çdo ditë. Ndikimin më të madh për mospërmbushje të këtij kriteri padyshim e ka edhe mosintegrimi i pakicës serbe në mënyrë të kënaqshme në jetën institucionale të shtetit të Kosovës. Ende në Kosovë funksionojnë institucione paralele brenda territorit të saj, madje të mirë organizuara dhe në sfera të ndryshme, si arsim, shëndetësi etj., të cilat po shkelin rendin kushtetues të Kosovës. Këto struktura paralele po vazhdojnë të mbështeten nga shteti fqinj Serbia. Sado marrëveshjeve të arritura në vitin 2013 ndërmjet Kosovës dhe Serbisë për zhbërjen e këtyre institucioneve paralele, në terren ende nuk po shohim një vendosshmëri të palës serbe. Në anën tjetër, edhe vetë serbët e integruar në Institucionet e Kosovës kanë vazhduar të bllokojnë procese të rëndësishme, për shkak të fuqisë përfaqësuese që u mundëson Kushtetuta e Republikës së Kosovës, e cila përveç garantimit të 20 ulëseve për pakicat

në Parlamentin e Kosovës, ajo parasheh që edhe në vendime të mëdha, si psh., krijimi i ushtrisë si temë aktuale, do të duhej të merrte miratimin e dy të tretave të deputetëve të përgjithshëm, por edhe dy të tretat e votave të deputetëve të pakicave në Kosovë.

Në këtë punim është analizuar edhe roli dhe aktivitetet e bashkësisë ndërkombëtare dhe mekanizmave ndërkombëtar në Kosovë, të cilat kanë luajtur një rol shumë të rëndësishëm në ndërtimin e institucioneve të para demokratike në Kosovë që nga viti 1999 e deri më sot. Por, përgjatë analizës së kapitullit që ka trajtuar këta mekanizma, vërehet se ata edhe kanë bërë gabime përgjatë procesit të ndërtimit të institucioneve, e në veçanti në integrimin e pakicës serbe në shoqërinë kosovare, respektivisht tolerimin e forcimit të strukturave paralele serbe në Kosovë, si dhe lejimin e Serbisë që nëpërmjet këtyre strukturave me veprime destruktive të pengojë konsolidimin e demokracisë në Republikën e Kosovës.

Veç kësaj, mekanizmat ndërkombëtarë, edhe pse kanë pasur kompetenca ekzekutive, duke filluar nga UNMIK deri të EULEX nuk kanë arritur që të luftojnë krimin e organizuar dhe korrupsionin, sidomos atë të nivelit të lartë, të cilat bëjnë pjesë ndër dukuritë kryesore që pengojnë funksionimin e një shteti normal.

Niveli i katërt i konsolidimit të demokracisë, sipas Merkel ishte konsolidimi shoqëror. Ky nivel përfshin kulturën e ngulitur demokratike të qytetarëve në shtet.

Në nënkapitullin rreth (mos) besimit të qytetarëve në institucionet shtetërore u argumentua qartë se shumica e qytetarëve nuk besojnë në institucione, madje një pjesë e madhe e tyre braktisjen e vendit e shohin si alternativë, dhe kjo u vërtetua edhe në fundvitin 2014 dhe fillimvitin 2015, ku kishte një ikje masive dhe që si argument i tyre për këtë migrim masiv e kishin dhënë mosbesimin në institucione të Republikës së Kosovës.

Në kapitullin që ka pasur në fokus shoqërinë civile, e cila edhe e luan rolin e të ashtuquajturit “pushtetit të katërt” apo mbikëqyrësit, vërejmë që edhe në këtë shtyllë vazhdimisht ka ngecje në zhvillimin e një kulture profesionale. Sidoqoftë, shumë organizata joqeveritare në Kosovë, kanë ngritur zërin lidhur me shumë çështje si: korrupsionin, nepotizmin, krimin e organizuar, llogaridhënien e politikanëve para qytetarëve, presionin e politikës ndaj medias e shumë çështje tjera të rëndësishme. Po ashtu, në këtë kapitull është parë se edhe përkundër vështirësive me të cilat janë ballafaquar dhe vazhdojnë të ballafaqohen, shoqëria civile vazhdon të kontribuon në bërjen e politikave, si dhe të jetë pjesë e monitorimit përgjatë zbatimit të tyre.

Ky fakt, në realitet, tregon se roli i shoqërisë civile ka qenë i konsiderueshëm, por edhe konstruktiv në rrjedhën e gjërave në vend prandaj shoqëria civile vazhdon të mbetet faktor kyç në ndërtimin e shtetit dhe kapaciteteve shtetërore.

Prapë se prapë, shoqëria civile e Kosovës ka pasur dhe ka ndikim të kufizuar në çështjet që janë brenga kryesore të qytetarëve, siç janë zhvillimi ekonomik dhe sundimi i ligjit. Të kuptuarit publik i rolit të shoqërisë civile mbetet i ulët, ndërsa është poashtu brengosëse që shoqëria civile i nënshtrohet presioneve politike dhe kërcënimeve nëse aktivitetet e saj nuk përputhen me qëndrimet e autoriteteve.

Sidoqoftë, përparimet që ka Kosova dhe roli i shoqërisë civile në vendin tonë, vërejmë se mbeten ende të dobëta përballë rëndësisë së madhe që ka kjo shoqëri për plotësimin e hapësirave mes politikës, qeverisë dhe qytetarëve të saj.

Dhe krejt në fund është roli i mediave që sot kudo në botë kanë një rëndësi të pazëvendësueshme. Informimi është një fenomen pa të cilin bota nuk mund të imagjinohet. Në anën tjetër, politika vazhdon të dominojë jetën e përgjithshme të qytetarëve në çdo fushë të jetës.

Mediat në Kosovë përballën me kufizime të pasqyrojnë gjendjen reale, kjo ndodh për shkak të presioneve që vijnë nga ana e politikës dhe tendencës që të kenë një kontrollë të konsiderueshme mbi to. Një tentim që të influencohen apo kontrollohen mjetet e informimit është në shpërputhje me parimet demokratike, si dhe mund të themi se është poashtu një tentim për të kontrolluar vendimmarrjen në demokraci. Si rezultat i kësaj, mediat vazhdojnë t'i nënshtrohen presionit të Qeverisë dhe aktorëve tjerë, duke mos qenë të lira të informojnë opinionin objektivisht. Prandaj, kjo ka bërë që Kosova të renditet në mesin e vendeve me media pjesërisht të lira.

Si përfundim, nuk mund të mohohet fakti që mediat kanë luajtur dhe luajnë një rol të rëndësishëm në konsolidimin demokratik të shtetit të Kosovës, por sa kanë qenë këto media të lira të ushtrojnë funksionin e tyre, tregojnë raportet ndërkombëtare, të cilat fatkeqësisht Kosovën e vendosin gjithnjë keq sa i përket lirisë së veprimit të tyre.

Bibliografia

Albert Krasniqi & Krenar Shala, Fuqizimi i shtetësisë së Kosovës nëpërmjet demokratizimit të partive politike. Prishtinë, 2012.

Alexis de Tocqueville, Demokracia në Amerikë, Nju Jork: Westvaco, 1999.

Annegret Bendiek, Der Konflikt im ehemaligen Jugoslawien und die Europäische Integration, Wiesbaden, 2004.

Arsim Bajrami, Seanca mësimore nga kursi Shteti Ligjor”, Prishtinë, 2006.

Arsim Bajrami, Draftimi i Kushtetutës. Manual për hartuesit e Kushtetutës dhe ligjeve. Prishtinë, 2007.

Arsim Bajrami, “Demokracia Parlamentare” (aspekte krahasuese) botim i katërt Prishtinë, 2005.

Arsim Bajrami, Teoria dhe Praktika Parlamentare. Shkup: Flaka, 2002.

Bekim Podrimçaku: Die Westbalkanländer auf dem Weg in die EU, Hamburg 2013.

Bernhard Stahl: Nationalismus und Demokratie: Wohingehet das Kosovo? në:Olaf Leiß, Martin Roth, Christian Gesellmann (Hrsg.). NOMOS, 2013.

David Held, Modelet e demokracisë. Prishtinë, 2011.

Diamond, Larry / Plattner, Marc F. / Chu, Yun-han / Tien, Hungmao: “Consolidating the Third Wave Democracies – Themes and Perspectives” (Konsolidimi në valën e tretë të demokracisë – tema dhe perspektiva), Baltimore dhe London, 1997.

Diamond, Larry: “Introduction: In Search of Consolidation” (Hyrje: Në kërkim të konsolidimit), 1997

Dugolli, Malazogu “Voting trends and electoral behavior in Kosovo 2000-2004. KIPRED. Prishtinë, 2006.

Ellen Bos, (1996): „Die Rolle von Eliten und kollektiven Akteuren in
Ernest Gellner, Konditat e Lirisë: shoqëria civile dhe rivalet e saj. Pejë: Dukagjini, 2002.

Georg Jellinek, "Allgemeine Staatslehre" (Teoria e përgjithshme e shtetit), 1900. E cituar nga Jens Kersten në "Georg Jellinek und die klassische Staatslehre" (Georg Jellinek dhe teoria e përgjithshme klasike mbi shtetin). Shtëpia botuese: Mohr Siebeck.

Geoffrey Pridham, Securing Democracy Political Parties and Democratic Consolidation in Southern Europe, Routledge Sigurimi i Demokracisë Partitë Politike dhe Konsolidimi Demokratik në Evropën Jugore), New York, 2003.

Geoffrey Pridham, *On the cup between democratic transition and consolidation in East-Central Europe*. University of Bristol, UK. Institute for Public Affairs, Bratislava, 12 October 2000.

Giovanni Sartori, Ç'është demokracia. Milano 1993, Ribotimi i fundit 2010.

Guillermo O'Donnell, "Illusions about Consolidation" (Iluzionet rreth konsolidimit), 1997.

John D. Clark, (2003) *Worlds Apart: Civil Society and the Battle for Ethical Globalization*. USA: Kumarian Press.

Iain Mc Lean, Fjalori Politik i Oxfordit, Oxford University Press, 1996.

Ines Lietzke, *Konflikt Regelung durch Europäisierung*, Wiesbaden, 2016.

Juan Linz, / Alfred Stepan, "Problems of democratic transition and consolidation: Southern Europe, South America, and post-communist Europe" (Problemet e tranzicionit demokratik dhe konsolidimit: Europën Juglindore, Amerikën Jugore, si dhe në Europën post komuniste), Baltimore 1996.

Juan J. Linz and Alfred Stepan. 1996. *Problems of Democratic Transition and Consolidation* (Problemet e tranzicionit demokratik dhe konsolidimit). Baltimore: John Hopkins University Press, 1996. Chapter 1. Linz/ Stephan, 1996.

Kramer Helmut und Džihic: die Kosovo-Bilanz, Wien 2005.

Larry Diamond, *Civil Society and the Development of Democracy*. Estudio/Working Paper, 1997.

Lawrence C. Mayer, Politikat Krahase " , SOROS dhe Ora, Tiranë, 2003.

Leonardo Morlino, *Democratic Consolidation* (Konsolidimi Demokratik), Oxford University Press, 1998.

Llambro Filo dhe Haxhi Ferati. Socialdemokracia Europiane dhe Rruga e Tretë-Vështrim historik. Tiranë, 2004.

Llambro Filo dhe Juliana Marko. Historia e Kohëve moderne-Për Shkencat Politike dhe Sociale. Tiranë: UFO, 2006.

Lidija Hristova, Democratic Consolidation of Divided Societies. New Balkans Politics.Journal of Politics. Volume 9. Skopje, Macedonia. 2005.

Manfred Schmidt, G.: “Teoritë e demokracisë” (Teoritë e demokracisë). VS Shtëpia Botuese për shkencat sociale. Wiesbaden, 2010.

Powell Bingham, Contemporary Democracies: Participation, Stability and Violence (Demokraci Bashkëkohore: Stabilitet dhe Dhunë), Cambridge, Mass., Harvard University Press, 1982.

Putnam, Robert D., Robert Leonardi dhe Raffaella Nanetti, Vënia e demokracisë në veprim: Traditat qytetare në Italinë moderne (Princeton, NJ: shtypi i universitetit Princeton, 1993).

Putnam, Robert D., Bowling Alone: Kolapsi dhe ringjallja e komunitetit amerikan (Nju Jork: Simon & Schuster, 2000).

Rafael Biermann,: “Lehrjahre im Kosovo, das Scheitern der Internationalen Kriesenprävention vor Kriegausbruch“ (Vitet e mësimit në Kosovë, dështimi ndërkombëtar i parandalimit të krizës dhe shpërthimi i krizës), Paderborn 2006.

Robert A. Dahl, “Poliarkia: Pjesëmarrja dhe Opozita”, Pegi, Tiranë, 2005.

Robert A. Dahl, “Poliarkia: Pjesëmarrja dhe Opozita”, Pegi, Tiranë, 2005

Samuel P. Huntington, “Vala e tretë – Demokracia në fund të shekullit të njëzetë” AIIS, Tiranë, 2011.

Rustow, Dankward, “Transitions to Democracy Towards a Dynamic Model”, Columbia University Press, 1970.

Samuel Stumpf, Filozofia, Toena,Tiranë, 2010.

Xhezair Zaganjori, Demokracia dhe Shteti i së Drejtës. Tiranë, Luarasi, 2002.

Wolfgang Merkel, “Systemwechsel 1 – Theorien, Ansätze und Konzepte der Systemwechselforschung” (Sistemi i ndryshimit 1 – teorie, qasje dhe koncepte të shkencës mbi ndërrimin e sistemeve), Opladen, 1996

Wolfgang Merkel, / Hans-Jürgen Puhle, / Aurel Croissant, / Claudia Eicher, / Peter Thiery, : “Defekte Demokratie – Band 1: Theorie” (Demokracitë defektive – botimi 1: Teoritë), Opladen 2003

Zenullah Gruda, E Drejta Ndërkombëtare Publik2, Prishtinë 2003.

Burime online dhe gazeta

O’Donnell dhe Schmitter: „Der theoretische Rahmen: Demokratie, Transition und Parteieninstitutionalisierung“ (Korniza teorike: demokracia, tranzicioni dhe institucionalizimi i partive). Springer 2016. Për më shumë:
<http://www.springer.com/gp/book/9783531185606>.

Wolfgang Merkel, „Gegen alle Theorie? Die Konsolidierung der Demokratie in Ostmitteleuropa“ (Kundër gjithë teorisë? Konsolidimi i demokracisë në Evropën e Mesme dhe të Lindjes). WZB Berlin Social Science Center. Berlin 2007. Faqe 416. Për më shumë:
https://wzb.eu/sites/default/files/personen/merkel.wolfgang.289/merkel_pvs_3_48.pdf.

Kofi Annan, Fjalimi në Kombet e Bashkuara rreth Kosovës “No government has the right to hide behind national sovereignty in order to violate human rights” (Asnjë qeveri nuk ka të drejtë të fshihet prapa sovranitetit të saj për të ushtruar dhunë mbi të drejtat e njeriut), 07.04.1999. Për më shumë: <http://www.un.org/press/en/1999/19990407.sgsm6949.html>.

Transition from Authoritarian Rule: Tentative Conclusions about Uncertain Democracies (Tranzicioni nga rregullat autoritare: konkludim tentativ rreth demokracive të pasigurta). Për më shumë:
http://isites.harvard.edu/fs/docs/icb.topic925740.files/Week%206/ODonnell_Transitions.pdf.

Qëndrimi i shteteve të Kuintit në formimin e Qeverisë, në:
<http://fax.al/read/news/10811429/15390764/quinti-te-zgjedhurit-e-popullit-pergjegjes-per-krijimin-e-qeverise>.

QUINT-i kategorik kundër shfuqizimit të Gjykatës Speciale, në: <http://www.dw.com/sq/quint-i-kategorik-kund%C3%ABr-shfuqizimit-t%C3%AB-gjykat%C3%ABs-speciale/a-42035399>.

Anthony Giddens, / Sociology / Shtëpia botuese Qabëj Tiranë 1997 faq. 421.

Giorgio Zanchini, Teledemokracia (Botim i Institutit Shqiptar të Medias) .

Dukagjin Gorani , intervistë nëpërmjet pyetësorit, Maj 2018

Grup autoresh, Privatizimi dhe post-privatizimi në Kosovë “Një gotë gjysmëbosh apo gjysmë e plotë” Raport studimor Shtator 2008.

<http://www.riinvestinstitute.org/uploads/files/2016/October/17/shqip1476702103.pdf>.

O'Donnel dhe Schmitter: „Der theoretische Rahmen: Demokratie, Transition und Parteieninstitutionalisierung“ (Kornizateorike: demokracia, tranzicioni dhe institucionalizimi i partive). Springer 2016. <http://www.springer.com/gp/book/9783531185606>.

Bashkimi Evropian, Misioni për vëzhgimin e zgjedhjeve- Raporti përfundimtar –Zgjedhjet parlamentare në Kosovë 2017.

https://eeas.europa.eu/sites/eeas/files/final_report_eom_kosovo_june_2017_albanian.pdf.

Performanca e Prokurorive. Raport analitik trevjeçar (2013 – 2014 – 2015). Për më shumë:

http://www.psh-ks.net/repository/docs/PERFORMANCA_E_PROKURORIVE_2013,_2014,_2015.pdf

In Freedom of the Press at least, Kosovo is the worst of the Balkans:

<https://www.foreignpolicyjournal.com/2016/05/06/in-freedom-of-the-press-at-least-kosovo-is-the-worst-of-the-balkans/>.

Joshua S. Goldstein, /Marrëdhëniet Ndërkombëtare /Kapitulli 10 Integrimi / Fuqia e Informacionit.

Ligji për Këshillin Gjyqësor të Kosovës. Për më shumë: <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2713>.

Ligji për Këshillin Prokurorial. Për më shumë:

<http://www.kuvendikosoves.org/common/docs/ligjet/2010-224-alb.pdf>.

Ligji për Prokurorinë e Shtetit. Për më shumë:

<http://www.kuvendikosoves.org/common/docs/ligjet/2010-225-alb.pdf>.

Luan Omari, „ Shteti i së Drejtës”, Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Tiranë.

Mandatit i OSBE-së, në: <https://www.osce.org/sq/mission-in-kosovo/mandate>.

Iain Mc Lean,. 2001. Fjalor Politik-Oxford. Tiranë: Shtëpia e librit & Komunikimit.

Mediat në Kosovë kanë probleme financiare e presion politik: dhe
<http://zeri.info/aktuale/196364/mediat-ne-kosove-kane-probleme-financiare-e-presion-politik/>.

Kapja e shtetit vazhdon me Politizimin e Bordeve: <http://kallxo.com/gjnk/kapja-e-shtetit-vazhdoi-me-politizimin-e-bordeve/> .

Këshilli Gjyqësor i Kosovës, për më shumë: <http://www.gjyqesori-rks.org/sq/kjc/report/list/1>.

Këshilli i Bashkimit Evropian, çasur në web-faqen:
https://www.parlament.gv.at/PAKT/EU/XXV/EU/14/61/EU_146145/imfname_10726021.pdf.

Koha Ditore i datës 14. Janar.2017 me titull “Këshilli Prokurorial paraqiti raportin e punës së prokurorive për periudhën janar-shtator 2016”.

Komisioni i Pavarur për Media, <http://www.kpm-ks.org/?faqe=90&gjuha=1>.

Korniza Kushtetuese për Vetëqeverisje të Përkohshme të Kosovës,
https://www.kuvendikosoves.org/common/docs/FrameworkPocket_ALB_Dec2002.pdf.

Kosovo: Indicators for the level of media freedom and journalists’ safety:
<https://www.rcmediafreedom.eu/Publications/Reports/Kosovo-Indicators-for-the-level-of-media-freedom-and-journalists-safety>.

Kosovo-Regierung um Dezentralisierung bemüht, në: <http://www.dw.com/de/kosovo-regierung-um-dezentralisierung-bem%C3%Bcht/a-4059074>.

Kriteret për liberalizimin e vizave. Për më shumë:
<https://mapl.rks-gov.net/getattachment/f07e2b7f-7607-4bf2-9b16-25297ac8a310/Udhezues-per-Liberalizimin-e-vizave.aspx>.

Kushtetuta e Republikës së Kosovës Kapitulli IV, <https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=3702>.

Kushtetuta e SHBA-ve, <http://constitutionus.com/>.

NEW MANDATE, NEW OPPORTUNITIES Evaluation of the work of the Assembly of Kosovo and recommendations for further development. Botuar me 2008.

https://www.kuvendikosoves.org/common/docs/Assessment_Report_English.pdf.

Grup Autoresh, Sistemi zgjedhor dhe partiak në Kosovë – Perspektiva e zhvillimit të demokracisë brendapartiake 2012 http://www.rrpp-westernbalkans.net/en/research/Projects-and-Networks-of-Excellence-completed/Governance/Balkan-Electoral-Comparative-Study/mainColumnParagraphs/00/text_files/file2/Kosovo_Nacionalna_studija_ALB.pdfhttp://www.rrpp-westernbalkans.net/en/research/Projects-and-Networks-of-Excellence-completed/Governance/Balkan-Electoral-Comparative-Study/mainColumnParagraphs/00/text_files/file2/Kosovo_Nacionalna_studija_ALB.pdf.

Gjykata supreme; historiku i sistemit gjyqësor në Kosovë; për më shumë: <http://www.gjyqesori-rks.org/sq/courts/page/index/56>.

Shkelzen Hasani, Die Rolle der EU im Friedenskonsolidierungsprozess im Kosovo, 2011, https://eeas.europa.eu/delegations/kosovo_sq/7641/Kosova%20dhe%20BE-ja, *Marrëdhëniet Politike*.

European Neighbourhood Policy And Enlargement Negotiations, NR. EG1085/2006 në: https://ec.europa.eu/neighbourhood-enlargement/instruments/funding-by-country/kosovo_en.

Vedran Džihic und Helmut Kramer: Der Kosovo nach der Unabhängigkeit, në: <http://library.fes.de/pdf-files/id/ipa/05695.pdf>.

Michael Ehrke: Serbien: Zwischen Kosovo und der EU, në: <http://library.fes.de/pdf-files/id-moe/08918.pdf>.

BTI 2016, Raporti i Shtetit: Kosovë, faqe 11: https://www.bti-project.org/fileadmin/files/BTI/Downloads/Reports/2016/pdf/BTI_2016_Kosovo.pdf.

Bahri Cani, Souverän genug für die Unabhängigkeit? në: <http://www.dw.com/de/souver%C3%A4n-genug-f%C3%BCr-die-unabh%C3%A4ngigkeit/a-16229639>.

Civil Society International, Çka është shoqëria civile? www.civilsoc.org, e qasur me 31.03.2018 <http://www.un.org/reform/civilsociety/panel.shtml>.

Commission Staff Working document, Kosovo 2018 Report, Strasbourg, 17.4.2018 SWD(2018) 156 final Stabilisierungs- und Assoziierungsabkommen (SAA) zwischen der Europäischen Union und dem Kosovo unterzeichnet, ne: <http://www.consilium.europa.eu/de/press/press-releases/2015/10/27/kosovo-eu-stabilisation-association-agreement/>.

Der Kosovo erlangt volle Souveränität, ne: <https://derstandard.at/1339639540031/Lenkungsrat-Der-Kosovo-erlangt-voellige-Souveraenitaet>.

Die wichtigsten Etappen des Aufbaus der Europäischen Union, ne: <http://de.strasbourg-europe.eu/die-wichtigsten-etappen-des-aufbaus-der-europaischen-union,3375,de.html>.

Andreas Ernst : In Kosovo spielen Fakten keine Rolle mehr, ne: <https://www.nzz.ch/international/sturz-der-regierung-in-pristina-kosovo-droht-sich-international-zu-isolieren-ld.1292506>.

Andreas Ernst: EU versagt in Kosovo, ne: <https://www.nzz.ch/international/europa/die-eu-mission-in-kosovo-auf-verlorenem-posten-1.18519077>.

Andreas Ernst: Neue Sheriffs für Kosovos wilden Norden, <https://www.nzz.ch/international/kopie-von-neue-sheriffs-fuer-kosovos-wilden-norden-ld.1354978>. qasur me 16.02.2018

Freedom of Expression, Media and Information in Kosovo An Assessment Based on Council of Europe Indicators for Media in a Democracy: http://safejournalists.net/wp-content/uploads/2016/10/Freedom_of_Expression_Media_and_Information_in_Kosovo_529396.pdf.

Gazeta elektronike “Gazeta Zeri” <http://www.arbresh.info/lajmet/kuvendi-performance-te-dobet/>.

Gazeta elektronike “Koha jone” <http://www.kohajone.com/2018/01/05/quint-i-kategorik-kunder-shfuqizimit-te-gjykates-speciale/>.

Gazeta elektronike “Telegrafi” <https://telegrafi.com/kush-financon-partite-fiton-tender/>.

Gazeta elektronike “Telegrafi” <https://telegrafi.com/parregullsite-ne-zgjedhje-demtuan-demokracine-kosove/>.

Gazeta elektronike “Telegrafi” <https://telegrafi.com/qeveria-kontrollon-kuvendin/>.

Gazeta elektronike Bota Sot, <http://www.botasot.info/aktuale-lajme/813291/kuvendi-sarriti-ta-permbush-rolin-e-tij/>.

Hashim Thaçi: "Katër komuna serbe në veri do të kenë asociacionin e tyre"
<http://www.dw.com/sq/tha%C3%A7i-kat%C3%ABr-komuna-serbe-n%C3%AB-veri-do-t%C3%AB-ken%C3%AB-asociacionin-e-tyre/a-16629207>.

Hon Dean Wells, Current challenges for the Doctrine of the Separation of Powers – The Ghost in the Machinery of Government <file:///C:/Users/Kujtim.bytyqi/Downloads/195-1-380-1-10-20120622.pdf> .

Taulant Hoxha, INDEX-I Kosovar i shoqërisë civile 2016, KCSF:
file:///Shoqeria%20Civile/05_11_2016_3646225_Indexi_Kosovar_i_Shoqerise_Civile_2016_KCSF.PDF.

Raport vjetor i Policisë së Kosovës 2016. Për më shumë:
http://www.kosovopolice.com/repository/docs/Raporti_vjetor_i_pun%C3%ABs_s%C3%AB_Polici_s%C3%AB_s%C3%AB_Kosov%C3%ABs_2016_-SHQIP.pdf.

Political pressures taking toll on Kosovo Journalists: Report
<http://www.balkaninsight.com/en/article/political-pressures-taking-toll-on-kosovo-journalists-report-11-21-2017>.

Polkowski Andreas: Die mittel- und osteuropäischen Länder auf dem Weg in die EU, në:
<file:///C:/Users/bekim.podrimqaku/Downloads/111-116-Polkowski.pdf>.

Raporti i Institutit Demokratik të Kosovës: “RETORIKA NË LUFTIMIN E KORRUPSIONIT
Raport i monitorimit të trajtimit të rasteve të korrupsionit në sistemin e drejtësisë në Kosovë”.
Për më shumë: <http://kli-ks.org/wp-content/uploads/2016/10/1.-Retorika-ne-luftimin-e-korrupsionit-27.10.2016.pdf> .

Raporti i Progresit i KE për Kosovën 2011, faqe 17. Shih:
http://www.eeas.europa.eu/delegations/kosovo/documents/eu_kosovo/20111018_progress_report_s_q.pdf.

Raporti i Progresit i Komisionit Evropian 2011, gjendet në linkun e mëposhtëm:
http://www.eeas.europa.eu/delegations/kosovo/documents/eu_kosovo/20111018_progress_report_s_q.pdf.

Raporti statistikor i gjykatave 2016. Për më shumë: <http://www.gjyqesori-rks.org/sq/kjc/report/list/1>. .

Raporti statistikor i gjykatave 2016. Për më shumë: <http://www.gjyqesori-rks.org/sq/kjc/report/list/1>.

Për një Kuvend që s'hesht, në: <https://www.evropaelire.org/a/2316232.html>.

Picciano Nicasia: The European Union State-Building in Kosovo, në: <https://www.verlagdrkovac.de/978-3-8300-8664-2.htm>.

Reporters Without Borders: <https://rsf.org/en/kosovo>.

Rezoluta 1244, RESOLUTION 1244 (1999) Adopted by the Security Council at its 4011th meeting, on 10 June 1999.
<https://www.un.org/press/en/1999/19990610.SC6686.html>.

Bruno Schoch, Demokratisierung im ungeklärten Staat? Das UN-Protektorat im Kosovo – eine Bilanz, në: https://www.hsfk.de/fileadmin/HSFK/hsfk_downloads/reoport1310.pdf.

SEEMO: Presioni Politik e ekonomik mbi mediat Kosovare:
<https://www.evropaelire.org/a/24560213.html>.

Indeksi i Transformacionit sipas Fondacionit Bertelsmann (BTI) 2016. Për më shumë: <https://www.bti-project.org/en/index/methodology/> .

Freedom House. Metodologjia për “Vendet në Tranzicion”. 2016. Për më shumë: <https://freedomhouse.org/report/nations-transit-methodology>.

Raportin e Progresit të bashkimit Evropian për Kosovën 2016. Faqe 3. Për më shumë: http://www.mei-ks.net/repository/docs/raporti_i_progresit_2016_shqip.pdf.

Gjykata Supreme; historiku i sistemit gjyqësor në Kosovë. Për më shumë: <http://www.gjyqesori-rks.org/sq/courts/page/index/56>.

Raporti statistikor i gjykatave 2016. Për më shumë: <http://www.gjyqesori-rks.org/>.
Raporti statistikor i gjykatave 2016. Për më shumë: <http://www.gjyqesori-rks.org/sq/kjc/report/list/1>.

Raport vjetor i Policisë së Kosovës 2016. Për më shumë:

http://www.kosovopolicice.com/repository/docs/%20Raporti_vjetor_i_pun%C3%ABs_s%C3%AB%20Policis%C3%AB_s%C3%AB_%20Kosov%C3%ABs_2016_-_SHQIP.pdf.

Performanca e Prokurorive. Raport analitik tre vjeçar (2013 – 2014 – 2015). Për më shumë:

http://www.psh-ks.net/repository/docs/PERFORMANCA_E_PROKURORIVE_2013,_2014,_%202015.pdf.

USAID, Civil Society Groups and Political Parties: Supporting Constructive Relationships, Office of Democracy and Governance Occasional Papers Series no. PN-ACU-631 (Washington, DC: USAID, 2004).

Raport i Institutit Demokratik të Kosovës: “RETORIKA NË LUFTIMIN E KORRUPSIONIT. Raport i monitorimit të trajtimit të rasteve të korrupsionit në sistemin e drejtësisë në Kosovë”. Për më shumë: <http://kli-ks.org/wp-content/uploads/2016/10/1.-Retorika-ne-luftimin-e-%20korrupsionit-27.10.2016.pdf>.

Stabilisierungs- und Assoziierungsabkommen zwischen der Europäischen Union und der Europäischen Atomgemeinschaft einerseits und dem Kosovo* andererseits, Brüssel, den 2. Oktober 2015.

https://eur-lex.europa.eu/legal-content/DE/TXT/?uri=uriserv:OJ.L_.2016.071.01.0001.01.DEU&toc=OJ:L:2016:071:TOC.

Transition from Authoritarian Rule: Tentative Conclusions about Uncertain Democracies (Tranzicioni nga rregullat autoritare: konkludim tentativ rreth demokracive të pasigurta). Për më shumë: http://isites.harvard.edu/fs/docs/icb.topic925740.files/Week%206/ODonnell_Transitions.pdf.

Stephan Osvath: Serbische Parallelwelt im Kosovo, në: http://www.deutschlandfunk.de/serbische-parallelwelt-im-kosovo.795.de.html?dram:article_id=245002.

Markus Wagner, Das erste Jahr der UNMIK, in:

http://www.dgyn.de/fileadmin/publications/PDFs/Zeitschrift_VN/VN_2000/Heft_4_2000/04_Beitr_ag_Wagner_VN_4-00.pdf.

The Washington Post: https://www.washingtonpost.com/news/the-fix/wp/2018/04/03/a-new-study-suggests-fake-news-might-have-won-donald-trump-the-2016-election/?noredirect=on&utm_term=.d24f5653fcd7.

Themelimi i Komunave të reja në Kosovë, analizë politikash, në:
http://www.institutigap.org/documents/24767_KomunateReja.pdf.

Web faqja e Ministrisë së Administratës Publike: <https://map.rks-gov.net/Departments/DOJQ.aspx>.
Web faqja www.dadalos.org/ rubrika Demokracia.

USA Today: <https://usatoday30.usatoday.com/educate/elections/elect5.htm>.

Westbalkan: Die Zukunft der EU-Erweiterung, në:
<http://www.europarl.europa.eu/news/de/headlines/world/20180126STO94113/westbalkan-die-zukunft-der-eu-erweiterung>.

Wolfgang Merkel, Konsolidimi i demokracisë në Evropën e Mesme dhe të Lindjes. WZB Berlin Social Science Center. Berlin 2007. Faqe 416. Për më shumë:
https://wzb.eu/sites/default/files/personen/merkel.wolfgang.289/merkel_pvs_3_48.pdf.

Ziel und Aufgaben der Eulex-Mission, në: <https://derstandard.at/3227911/Ziel-und-Aufgaben-der-EULEX-Mission>.

Lista e Tabelave

Tabela. 1. Paraqitja e fazave të tranzicionit bazuar në definimin e O'Donnel dhe Schmitter.....	21
Tabela. 2. Fazat e tranzicionit, përfshirë edhe fazën përmbyllëse.....	30
Tabela. 3. Niveli I: Konsolidimi kushtetues sipas W. Merkel për vendet e Evropës së Mesme dhe Lindore	32
Tabela. 4. Niveli II: Konsolidimi reprezentativ sipas W. Merkel për vendet e Evropës së Mesme dhe Lindore	33
Tabela. 5. Niveli III: Konsolidimi i sjelljes sipas W. Merkel për vendet e Evropës së Mesme dhe Lindore.....	33
Tabela. 6. Niveli IV: Konsolidimi qytetar sipas W. Merkel për vendet e Evropës së Mesme dhe Lindore.....	34
Tabela. 7. Funksionimi i Ndarjes së Pushteteve.....	60
Tabela. 8. Ndarja e Pushteteve.	63
Tabela. 9. Organogrami i Gjykatave në Kosovë.....	99
Tabela. 10. Vërtetimi nga Avokati për ligjshmërinë e publikimit të kallëzimeve penale dhe denoncimeve në Polici	

Anekset



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Gjykata Kushtetuese / Ustavni sud / Constitutional Court

Parandori Jushtinjan p.n., Prishtinë, Kosovë
Tel: +381 (0)38 220 114/5; Fax: +381 (0)38 220 112; www.gjk-ks.org

Prishtinë, më 28 shtator 2010
Nr. ref.: AGJ 43/10

Aktgjykim

Lënda Nr. KI 47/10

**Naim Rrustemi dhe 31 deputetë të tjerë të Kuvendit të
Republikës së Kosovës**

Vs.

**Shkëlqesisë së tij, Fatmir Sejdiu,
President i Republikës së Kosovës**

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

E përbërë prej

Enver Hasani, Kryetar
Kadri Kryeziu, Zëvendëskryetar
Robert Carolan, Gjyqtar
Altay Suroy, Gjyqtar
Almiro Rodrigues, Gjyqtar
Snezhana Botusharova, Gjyqtare
Ivan Čukalović, Gjyqtar
Gjyljeta Mushkolaj, Gjyqtare dhe
Iliriana Islami, Gjyqtare

Parashtruesit e Kërkesës

1. Parashtruesit e kërkesës janë Naim Rrustemi dhe 31 deputetë të tjerë të Kuvendit të Kosovës (shih shtojcën A).

Pala kundërshtare

2. Pala kundërshtare është Shkëlqesia e Tij, z. Fatmir Sejdiu, President i Republikës së Kosovës.

Baza juridike

3. Neni 113 (6) i Kushtetutës së Republikës së Kosovës (më tej si: "Kushtetuta"; Neni 44 i Ligjit No. 03/L-121 për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës i 16 dhjetorit 2008 (më tej si: "Ligji"); si dhe Neni 54(a) i Rregullores së Punës së Gjykatës Kushtetuese (më tej si: "Rregullorja e Punës").

Procedura para Gjykatës Kushtetuese

4. Më 25 qershor 2010, Naim Rustemi dhe 31 deputetë të tjerë (shihni shtojcën A) të Kuvendit të Kosovës parashtruan një kërkesë pranë Gjykatës Kushtetuese. Paraqitësit pretendojnë se Presidenti ka shkelur Nenin 88 (2) dhe sfidojnë kushtetutshmërinë e veprimit të Presidentit Sejdiu që të mbajë postin e Kryetarit të Lidhjes Demokratike të Kosovës, por ta pezullojë ushtrimin e atij funksioni.
5. Në pajtim me Rregulloren e Punës dhe me anë të një letre, më 29 qershor 2010, Gjykata i dërgoi Presidentit Kërkesën në të cilën kërkohej përgjigja e tij.
6. Në pajtim me Rregulloren e Punës, Kryetari emëroi si Gjyqtar Raportues, Gjyqtarin Robert Carolan, si dhe caktoi gjyqtarët në vijim si anëtarë të Kolegjit Shqyrtues: Gjyqtarja Snezhana Botusharova (Kryesuese), Kadri Kryeziu (Zëvendëskryetar) dhe Gjyljeta Mushkolaj.
7. Teksti në vijim është rendi i korrespondencës që ka marrë Gjykata nga një numër i deputetëve të Kosovës, të cilët kanë qenë nënshkrues të kësaj kërkesë.
 - i. 29 qershor 2010: Deputetët, Dragisa Miriç, Mihailo Sčepanoviç dhe Vladimir Todoroviç nënshkruajnë informacion dërguar në Gjykatë, ku tërheqin nënshkrimet e tyre nga ky peticion. Ky dokument përmban dhe një hapësirë për një emër të katërt, Numan Baliç, por dokumenti nuk përmban nënshkrimin e tij.
 - ii. 2 korrik 2010: Një deputet tjetër, Berat Luzha, dorëzon një deklaratë në Gjykatën Kushtetuese në të cilën tërheq nënshkrimin e tij nga peticioni i deputetëve. Ai deklaron se është në dijeni dhe i bindur për shkeljen e Kushtetutës nga Presidenti por ai kërkon të tërhiqet nga peticioni për të shmangur krijimin e krizave politike.
 - iii. 5 korrik 2010: Gjykata Kushtetuese merr një letër nga Muzejene Selmani, e cila e njofton Gjykatën se ajo ka "tërhequr nënshkrimin" nga peticioni.
8. Gjykata ka marrë përgjigjen nga Këshilltari Ligjor i Zyrës së Presidentit më 15 korrik 2010.
9. Gjykata i ka dërguar një letër Komisionit Qendror Zgjedhor (KQZ-së) më 7 korrik 2010 dhe KQZ-ja i është përgjigjur Gjykatës më 22 korrik 2010.
10. Gjykata në përbërje të plotë dhe në seance të fshehtë, ka marrë vendimin lidhur me Kërkesën më 22 shtator 2010.

Përmbledhje e çështjeve para Gjykatës

11. Neni 113.6 i Kushtetutës siguron siç vijon:

Tridhjetë (30) a më shumë deputetë të Kuvendit të Kosovës, janë të autorizuar të ngrenë çështjen nëse Presidenti i Republikës së Kosovës ka kryer shkelje serioze të Kushtetutës

12. 32 deputetë të Kuvendit të Kosovës kanë nënshkruar Kërkesën. Ata pretendojnë se Presidenti i Republikës së Kosovës ka shkelur dhe vazhdon të shkelë Nenin 88.2 të Kushtetutës, i cili ndalon Presidentin nga kryerja e ushtrimit të detyrës të çfarëdo funksioni në parti politike. Ata, gjithashtu pretendojnë se një shkelje e tillë është shkelje serioze e Kushtetutës.

13. Neni 88, në tërësinë e tij, siguron siç vijon:

1. *Presidenti nuk mund të ushtrojë asnjë funksion tjetër publik.*
2. *Pas zgjedhjes, Presidenti nuk mund të ushtrojë asnjë funksion në parti politike.*

Argumentet parashtruar nga Parashtruesit e Kërkesës

14. Kërkesa pohon se në zgjedhjet lokale të 17 nëntorit 2009, LDK-ja mori pjesë si parti e regjistruar. Kërkesa deklaron se sipas Ligjit mbi Zgjedhjet Lokale, duke zbatuar Ligjin mbi Zgjedhjet e Përgjithshme Nr. 03/L-073, *mutatis mutandis*, regjistrimi i një partie politike duhet të përfshijë pozicionin e Kryetarit dhe çfarëdo ndryshimi lidhur me Kryetarin e partisë politike duhet të raportohet në Komisionin Qendror Zgjedhor.

15. Kërkesa, cek gjithashtu dhe Rregulloren e UNMIK-ut 2004/11, Nenin 12 si dhe nene të tjera të paspecifikuara, ku kërkohet që një parti politike duhet të ketë një kryetar. Kjo Rregullore u shfuqizua në mënyrë efektive por u ri-fuqizua sipas Ligjit mbi Zgjedhjet e Përgjithshme të 5 qershorit 2008.

16. Në kërkesë thuhet se fakti i mos prezantimit të asnjë personi tjetër si Kryetar i LDK-së i bën deputetët të arrijnë në konkluzionin se partia ka pasur Kryetar të zgjedhur, z. Fatmir Sejdiu, Presidentin e Republikës së Kosovës, që më 9 tetor 2007.

Përgjigja e Presidentit

17. Përgjigja e Presidentit ngriti tri (3) argumente ligjore mbrojtëse lidhur me Kërkesën:

- i. Deputetët nuk e plotësuan kriterin për të qenë palë e autorizuar në pajtueshmëri me Nenin 113.6 të Kushtetutës;
- ii. Kërkesa nuk u dorëzua brenda afatit kohor, siç përcaktohet nga Neni 45 i Ligjit mbi Gjykatën Kushtetuese, Ligji Nr. 03/L-121;
- iii. Presidenti nuk ka ushtruar asnjë funksion në një parti politike, prandaj, ai nuk ka kryer shkelje të rëndë/serioze të Nenit 88.2 të Kushtetutës.

18. Lidhur me argumentin se parashtruesit e kërkesës nuk kanë pasur të drejtën ligjore për të parashtruar kërkesën para Gjykatës Kushtetuese, Presidenti argumentoi se tërheqja e deputetëve, e cila referohet më lart në paragrafin 7, ka zvogëluar numrin e kërkuar prej 30 (tridhjetë) deputetëve në një numër më të vogël se 30, prandaj nuk ka pasur një numër të mjaftueshëm për pjesën e mbetur të grupit të deputetëve që të konsiderohen si palë e autorizuar siç kërkohet në Nenin 113.6 të Kushtetutës.

19. Neni 45 i Ligjit siguron si vijon:

Neni 45
Afatet

Kërkesa duhet të parashtrohet brenda afatit prej tridhjetë (30) ditëve që nga dita kur shkelja e pretenduar kushtetuese nga ana e Presidentit është bërë publike

20. Lidhur me argumentin nëse kërkesa është parashtruar brenda afatit kohor prej 30 ditësh siç përcaktohet në Nenin 45 të Ligjit, Presidenti argumentoi: "Kërkesa duhet të parashtrohet brenda afatit prej tridhjetë (30) ditëve që nga dita kur shkelja e pretenduar kushtetuese nga ana e Presidentit është bërë publike". Pavarësisht nga fakti se a është veprim i njëhershëm apo i vazhdueshëm. Ai argumenton se secili nga aktet e tij të cilat janë bërë publike më herët se 26 maji 2010, duke qenë 30 (tridhjetë) ditë përpara parashtrimit të kërkesës pranë Gjykatës Kushtetuese, nuk mund të sfidohen më.
21. Presidenti pohon se ai i ka shkruar Këshillit të LDK-së që nga 28 dhjetori 2006, në vijim të zgjedhjes së tij nga Kuvendi i Kosovës si Presidenti i Republikës së Kosovës, duke e njoftuar Këshillin lidhur me Vendimin e tij që të "ngrijë ushtrimin nga funksioni i tij si Kryetar i LDK-së". Këto zgjedhje u zhvilluan 10 (dhjetë) muaj më herët, më 10 shkurt 2006, në një kohë kur Kushtetuta e Kosovës nuk kishte hyrë ende në fuqi.
22. Ai deklaron se pas hyrjes në fuqi të Kushtetutës, më 15 qershor 2008, ai përsëri e bëri publik vendimin e tij për të ngrirë "ushtrimin e funksionit të Kryetarit të LDK-së" me anë të një letre dërguar Këshillit të LDK-së më 16 qershor 2008. Prandaj, ai deklaron se akti që supozohet të jetë antikushtetues u bë publik përmes datave të këtyre dy letrave.
23. Në mënyrë alternative, ai pohon se nëse pretendimi i shkeljes është bazuar në datën e zgjedhjeve lokale, më 17 nëntor 2009, vendimi i tij për të mbajtur pozicionin e Kryetarit të LDK-së, por të "ngrijë ushtrimin" e funksionit, është bërë publike në atë kohë dhe afati kohor për të parashtruar kërkesën ishte data 17 dhjetor 2009, tridhjetë ditë pas zgjedhjeve të nëntorit 2009.
24. Lidhur me çështjen thelbësore, Presidenti kërkon që të argumentojë se një prezantim më i mirë i çështjes para Gjykatës do të ishte "nëse ngrirja e ushtrimit të një funksioni politik, por mbajtja e të njëjtit nga Presidenti i Republikës përbën shkelje të rëndësishme të Kushtetutës së Republikës së Kosovës". Ai argumentoi se ngrirja e ushtrimit të funksionit të partisë politike, pa marrë parasysh mbajtjen e të njëjtit funksion, nënkupton evitimin e shkeljes së rëndë të Kushtetutës.
25. Ai argumenton se Neni 88.2 kërkon që Presidenti nuk mund të ushtrojë (ai thekson) asnjë funksion në parti politike, por nuk i kërkon Presidentit, që pas zgjedhjes së tij, të mos mbajë (ai thekson) asnjë funksion partiak. Ai theksoi më tepër ndryshimin e rëndësishëm midis "mbajtjes" dhe "ngrirjes" së funksionit. Ai krahasoi rolin e një prej zëvendëskryetarëve të Kuvendit të Kosovës, i cili mund të shërbejë si Kryetar i Kuvendit nëse Presidenti mungon ose është i paaftë të ushtronte funksionin e Kryetarit të Kuvendit. Ai, gjithashtu, citoi edhe rolin "zëvendësues" të Kryetarit të Kuvendit nëse Presidenti i Republikës nuk kishte mundësi të përmbushte përgjegjësitë e tij/saj. Ai gjithashtu shtoi se Kryetari i Gjykatës Kushtetuese mund t'i delegojë Zëvendëskryetarit një numër detyrash me qëllim që të mbështesë Kryetarin në kryerjen e detyrave të tij/saj.
26. Në lidhje me ushtrimin e funksionit në një parti politike, siç ndalohej në Nenin 88.2, Presidenti nguli këmbë se nuk kishte asnjë lloj evidence që ai kishte ndërmarrë ndonjë akt jo-kushtetues.

27. Ai insiston se fjala "ushtrim" në kontekstin juridik përkufizohet si, "futja në përdorim" apo "futja në veprim". Për të mbështetur këtë të fundit, ai citoi fjalorin juridik - Black's Law Dictionary (Edicioni i 8-online). Prandaj, ai argumenton se për të ushtruar një funksion, përveç mbajtjes së këtij funksioni, duhet që të ketë edhe veprim.
28. Lidhur me dorëzimin e dokumentacionit të partisë nga LDK-ja në Komisionin Qendror Zgjedhor, Presidenti thekson se ky ishte një akt i cili u krye nga LDK-ja dhe jo nga ai. Ai thotë se dorëzimi i këtyre dokumenteve ka qenë një akt i zbatuar nga LDK-ja dhe nuk është atributi i tij. Ai thekson se është e pakonceptueshme të kuptosh se si mund të mbash përgjegjësi për veprimet e dikujt tjetër, në këtë rast LDK-së, kur testi për kushtetutshmërinë për shkarkimin sipas Nenit 91.3¹ të Kushtetutës ka të bëjë me Aktet e Presidentit kur "ai/ajo (ai thekson) ka shkelur rëndë Kushtetutën.
29. Presidenti argumenton më tej se meqenëse shprehja "shkelje e rëndë" nuk është e përkufizuar në Kushtetutë, duhet të konsiderohen veprime në kundërshtim ose mosveprime që kanë të bëjnë me kompetencat e Presidentit, siç përcaktohen në Nenin 84 të Kushtetutës (cekur më poshtë). Prandaj, Presidenti thekson se ngrirja e ushtrimit të pozicionit të Kryetarit/Presidentit të LDK-së nuk është shkelje e nenit kushtetues dhe nuk përbën shkelje të rëndë/serioze të Kushtetutës.

Vlerësimi mbi pranueshmërinë e Kërkesës

Afati kohor

30. Pyetja që duhet të konsiderohet është nëse kalimi i tridhjetë ditëve nga bërja publike e vendimit të tij për të mbajtur postin e Kryetarit të LDK-së, por " të ngrijë ushtrimin e funksionit", është një pengesë e plotë për të parashtruar kërkesën. Me qëllim që Gjykata të konsiderojë nëse mbajtja e postit si Kryetar i LDK-së është një situatë e vazhdueshme, që vazhdon dhe përbën shkelje të Kushtetutës, çdo ditë që Presidenti mban të dyja postet dhe funksionet zyrtare ose nëse është rast i izoluar. Nëse konsiderohet si rast i izoluar, deputetëve të Kuvendit do t'ju ishte duhur të parashtronin kërkesën para datës 17 dhjetor 2009, tridhjetë ditë pas mbajtjes së zgjedhjeve lokale ose letrës së Presidentit të datës 16 qershor 2008.
31. Kryerja e një shkelje serioze të Kushtetutës, nga secilido President, është paraparë në **Nenin 88.2**, dhe një mekanizëm i veçantë është krijuar që të sigurojë që këto shkelje të shqyrtohen në nivelin më të lartë, domethënë para Gjykatës Kushtetuese (shih **nenet 91.1 dhe 113.6 të Kushtetutës**). Asnjë bartës tjetër i zyrës kushtetuese nuk gëzon këtë lloj mbikëqyrje. Janë vetëm veprimet e Presidentit që mund të referohen për këtë lloj konsiderimi. Kjo, me sa duket, do të jetë reflektimi i rëndësisë së postit të Presidentit brenda kornizës kushtetuese dhe nevoja që ky rol të ushtrohet në mënyrë të rregullt.
32. Në rastin e Presidentit Sejdiu, është e nevojshme që të shohim situatën faktike për të parë nëse mbajtja e funksionit të Kryetarit të LDK-së, por "ngrirja e atij pozicioni", ishte një rast i vetëm, i cili ndodhi një herë të vetme ose nëse përbën një situatë që vazhdon çdo ditë. Nëse është kjo e fundit, atëherë nuk ekziston afat kohor me të cilin deputetet duhet të parashtrojnë një kërkesë pranë Gjykatës në lidhje me shkeljen e supozuar. Për më tepër, fakti i "mbajtjes dhe ngrirjes" së pozicionit, duket se

¹ Kushtetuta e Kosovës, Neni 91.3. "Nëse Presidenti i Republikës së Kosovës është dënuar për ndonjë krim të rëndë ose nëse Kuvendi, në pajtim me këtë nen, konstaton që Presidenti nuk është i aftë të ushtrojë përgjegjësitë e tij/saj për shkak të sëmundjes së rëndë ose nëse Gjykata Kushtetuese konstaton se ajo/ai ka bërë shkelje të rëndë të Kushtetutës, Kuvendi mund të shkarkojë Presidentin me dy të tretat (2/3) e votave të të gjithë deputetëve të tij.

implikon se ngrirja e këtij pozicioni mbetet në fuqi gjatë gjithë kohës. Presidenti pranon se ai ka vazhduar të jetë Kryetari i LDK-së dhe Presidenti i Republikës çdo ditë që nga zgjedhja e tij në 2006.

33. Nëse rasti është ky, pasojat e ngrirjes së pozicionit vazhdojnë dhe kështu ekziston një situatë e vazhdueshme, e cila vazhdon çdo ditë. Nëse arrijmë në një përfundim tjetër, mund të rezultojë në një situatë, ku Presidenti i Kosovës mund të ndalohej nga kryerja e mbajtjes së funksionit të Zyrës së Presidentit për shkak të një shkeljeje kushtetuese por të lejohet të qëndrojë në postin e tij, vetëm pse kërkesa e parashtruar në Gjykatën Kushtetuese nuk është dorëzuar në kohën e duhur. Nuk ekziston asnjë autoritet në Kushtetutë për një rezultat kaq irracional. Edhe Neni 45 i Ligjit mbi Gjykatën Kushtetuese nuk parasheh një rezultat të tillë kaq irracional.
34. Gjykata konsideron se afati kohor prej tridhjetë ditëve i përcaktuar nga Neni 45 i Ligjit mbi Gjykatën Kushtetuese lidhur me kërkesat për shkelje serioze pranë Gjykatës Kushtetuese, të cilat kanë ndodhur vetëm një herë ose që kanë qenë shkelje të vazhdueshme që kanë përfunduar dhe nuk ndodhin më. Afati kohor nuk mund të aplikohet në një shkelje serioze që vazhdon. Megjithatë, nëse shkelja vazhdon, afati kohor prej 30 ditësh nuk mund të fillojë pasi shkelja ende nuk ka përfunduar. Nëse Presidenti kishte dhënë dorëheqjen gjatë presidencës së tij nga posti si Kryetar/President i LDK-së, atëherë afati kohor për të parashtruar kërkesën në Gjykatën Kushtetuese, çfarë do të ishte në atë kohë, shkelje e kaluar, do të skadonte pas kalimit prej 30 ditësh duke filluar nga data e asaj dorëheqjeje. Në të kundërtën, akti i thjeshtë i deklarimit publik se ai e kishte ngrirë pozicionin e tij si Kryetar i LDK-së në një moment të caktuar, dhe si rrjedhojë, në të ardhmen nuk mund të kuronte më natyrën e vazhdueshme të kësaj shkeljeje.
35. Realiteti është se pozicioni qëndron "i mbajtur dhe i ngrirë", siç përmendet në përgjigjen e Presidentit. Gjykata arrin në konkluzionin se situata e vazhdueshme vazhdon ende edhe sot, dhe prandaj afati kohor prej 30 ditësh, siç përcaktohet nga Neni 45 i Ligjit, nuk është i aplikueshëm në këtë rast.

Palë e autorizuar

36. Neni 113.6, cituar më lartë në paragrafin 11, kërkon medoemos 30 ose më shumë deputetë të Kuvendit për të parashtruar pyetjen nëse Presidenti ka kryer një shkelje serioze. Kemi të regjistruar që 32 deputetë janë bashkuar bashkë dhe kanë paraqitur Kërkesën në këtë Gjykatë. Prandaj, është e qartë se Gjykata ka marrë një kërkesë të vlefshme më 25 qershor 2010.
37. Gjykata, gjithashtu ka përcaktuar më lartë mënyrën dhe datat e tërheqjeve të supozuara të disa prej deputetëve nga kërkesa. Gjykata nuk do të spekulojë për sa i përket motiveve sepse deputetët vendosën të nënshkruajnë kërkesën fillestare ose se pse kanë vendosur të tërheqin nënshkrimet e tyre nga kërkesa.
38. Gjykata është në dijeni se parashtrimi i një kërkesë është me rëndësi të madhe kushtetuese dhe politike. Deputetët, të cilët kanë nënshkruar kërkesën fillestare kanë qenë në dijeni të kësaj rëndësie. Përseri, ata kanë qenë të vetëdijshëm rreth natyrës kolektive të kësaj kërkesë, ku duhet të bëhej bashkimi kolektiv me një minimum prej 30 (tridhjetë) deputetëve. Më 25 qershor 2010, 32 deputetët fillestarë (iniciatorët) kanë qenë të mendimit se kjo pyetje e rëndësishme duhet të referohet në Gjykatën Kushtetuese. Ndoshta, ka pasur dhe të tjerë deputetë që e kanë nënshkruar, por mbase dhe jo. Çështja kryesore është se kërkesa e parashtruar, ka pasur numrin e duhur të nënshkrimeve dhe ka qenë në procedim nga Gjykata që nga ajo datë.

39. Neni 23 i Ligjit mbi Gjykatën Kushtetuese përcakton:

Gjykata Kushtetuese do të vendosë për çështjet që iu janë referuar në mënyrë ligjore nga ana e palëve të autorizuar pavarësisht tërheqjes së palës nga procedura.

Në kuptimin e zakonshëm, ky nen e obligon Gjykatën që të marrë vendim lidhur me çështje të cilat parashtrohen në mënyrë ligjore. Kjo theksohet nga përdorimi i fjalës "do të".

40. Rregullorja e Punës e Gjykatës Kushtetuese shtjellon lidhur me çështjen e tërheqjes siç vijon më poshtë:

Neni 32

Tërheqja e Kërkesës

(1) Pala e cila ka parashtuar kërkesën mund ta tërheqë atë në çfarëdo kohe para fillimit të seancës dëgjimore për atë kërkesë.

(2) Pavarësisht tërheqjes në pajtim me paragrafin (1), Gjykata mund të zgjedhë të vendos në lidhje me atë kërkesë. Në rast të tillë, Gjykata vendos pa seancë dëgjimore, duke u bazuar vetëm në kërkesë dhe përgjigje, në rast se përgjigja është parashtuar, dhe çfarëdo dokumentesh të bashkangjitura asaj.

(3) Sekretariati njofton të gjitha palët me shkrim për tërheqjen e palës dhe përcaktimin e Gjykatës për të vendosur në bazë të kërkesës, pavarësisht tërheqjes së saj.

41. Ky Nen pranon se pala mund të tërheqë kërkesën në çfarëdo momenti para fillimit të seancës dëgjimore, por i jep Gjykatës liri veprimi për të marrë vendim mbi kërkesën. Neni është i heshtur lidhur me rrethanat të cilat mund të kenë influencë nëse mund ta ushtrojnë këtë liri veprimi ose jo.

42. Në rastin konkret, Presidenti argumenton se tërheqja e supozuar e nënshkrimeve të disa deputetëve nga kërkesa, në masën që numri i mbështetësve bie nën numrin 30, do të thotë se grupi nuk mund të konsiderohet si palë e autorizuar siç parashihet në Nenin 113.6 të Kushtetutës. Përgjigja e Presidentit nuk e adreson obligimin e Gjykatës sipas Nenit 23 të Ligjit mbi Gjykatën Kushtetuese që të vendosë mbi çështje që referohen në mënyrë ligjore, si dhe përgjigja e tij nuk adreson Nenin 32 të Rregullores.

43. Kjo kërkesë ndryshon nga kërkesa e cila parashtrohet nga një person fizik ose person juridik. Është e nevojshme që të bëhet së paku prej 30 deputetësh. Asnjë deputet ose edhe disa prej tyre, nuk mund të kenë kompetenca që të flasin në emër të të gjithëve deputetëve, të cilët kanë iniciuar fillimisht kërkesën. Vetëm deputetët si grup, me 30 deputetë si minimum për të parashtuar një kërkesë, mund të jetë palë e autorizuar që mund të parashtrojë kërkesën. Në mënyrë të ngjashme, vetëm të gjithë ata deputetë, të cilët kanë nënshkruar kërkesën që në fillim, mund të parashtrojnë një kërkesë për të tërhequr kërkesën pasi është parashtuar në Gjykatë. Mund të ndodhë që disa nga deputetët të kërkonin të tërhiqnin nënshkrimet e tyre nga kërkesa, duke e ditur këtë, dhe në të njëjtën kohë, deputetë të tjerë të kërkonin që të shtonin nënshkrimet e tyre si zëvendësim. A do të shkaktonte mbledhja e nënshkrimeve të tjera një kurë lehtësimi për tërheqjen e nënshkrimeve të tjera? A do të ishte e nevojshme që të parashtrohej një kërkesë e re në tërësi apo kërkesa e vjetër do të mbetej pezull derisa të shtoheshin nënshkrime të reja? Natyra e pakënaqshme e një shtate të tillë ceket përkatësisht në Nenin 23 të Ligjit mbi Gjykatën Kushtetuese, që e

lejon Gjykatën të procedojë me kërkesën, e cila është parashtruar në mënyrën e duhur, derisa, Gjykata të marrë vendim lidhur me kërkesën.

44. Pretendimi i kryerjes së shkeljes së Kushtetutës nga Presidenti i Republikës është rast i rëndë dhe Gjykata mund të marrë një vërejtje gjyqësore se deputetët që kanë nënshkruar kërkesën, e kanë menduar këtë kur kanë bashkangjitur nënshkrimet e tyre. Në mënyrë të ngjashme, ata nuk duhet të lejohen të tërheqin nënshkrimet e tyre duke mos dhënë arsye të qarta, serioze dhe substanciale.
45. Të gjithë deputetët, të cilët kanë parashtruar kërkesën fillestare, kanë vepruar së bashku në një bashkësi kolektive, e cila u bë e plotë kur u parashtrua para Gjykatës më 25 qershor 2010. Dëshirat individuale të një, dy ose tre deputetëve, të cilët dëshirojnë të tërheqin nënshkrimet e tyre, nuk kanë asnjë efekt juridik mbi ligjshmërinë e kërkesës së parashtruar.
46. Gjykata konkludon se më 25 qershor 2010, ky rast është referuar në mënyrë të rregullt pranë Gjykatës Kushtetuese. Gjykata e ka pranuar këtë kërkesë në atë datë dhe qëndron në këtë Gjykatë deri sa të jepet Aktgjykim.
47. Prandaj, Gjykata konkludon se rasti është i pranueshëm.

Merit

48. Substanca e kërkesës i referohet Nenit 88.2, i cituar më lart, nëse Presidenti, pas zgjedhjes, ka ushtruar ndonjë funksion në parti politike. Me qëllim që të arrijmë në një konkluzion, është e nevojshme që të ekzaminojmë rolin e Presidentit në tërësi brenda kornizës kushtetuese. Kushtetuta duhet të lexohet në mënyrë holistike dhe Gjykata duhet të interpretojë dispozitat e saj duke pasur parasysh natyrën e ndërruarur të dispozitave të saj të larmishme.

Roli i Presidentit

49. Neni 83 i Kushtetutës i referohet statusit të Presidentit si kreu i shtetit. Ky nen siguron:

Presidenti është kreu i shtetit dhe përfaqëson unitetin e popullit të Republikës së Kosovës.

50. Neni 4 e përshkruan më tepër kur përcakton formën e qeverisë së Republikës dhe deklaron:

1. Kosova është Republikë demokratike e bazuar në parimin e ndarjes së pushteteve dhe kontrollit e balancimit në mes tyre, sikurse është përcaktuar me këtë Kushtetutë.

- (2) garanton funksionimin kushtetues të institucioneve të përcaktuara me këtë Kushtetutë;
- (3) shpall zgjedhjet për Kuvendin e Kosovës dhe thërret mbledhjen e parë të tij;
- (4) nxjerr dekrete në pajtim me këtë Kushtetutë;
- (5) shpall ligjet e miratuara nga Kuvendi i Republikës së Kosovës;
- (6) ka të drejtën e kthimit për rishqyrtim të ligjeve të miratuara, nëse konsideron se janë të dëmshme për interesat legjitime të Republikës së Kosovës ose të një a më shumë komuniteteve të saj. Të drejtën e rikthimit të një ligji mund ta shfrytëzojë vetëm një herë;
- (7) nënshkruan marrëveshjet ndërkombëtare në pajtim me këtë Kushtetutë;
- (8) propozon amendamente për këtë Kushtetutë;
- (9) mund të referojë çështje kushtetuese në Gjykatën Kushtetuese;
- (10) udhëheq politikën e jashtme të vendit;
- (11) pranon letrat kredenciale të shefave të misioneve diplomatike të akredituar në Republikën e Kosovës;
- (12) është Komandant Suprem i Forcave të Sigurisë të Kosovës;
- (13) udhëheq Këshillin Konsultativ për Komunitete;
- (14) cakton mandatarin për formimin e Qeverisë, pas propozimit të partisë politike ose të koalicionit, që përbën shumicën e Kuvendit;
- (15) emëron dhe shkarkon Kryetarin e Gjykatës Supreme të Kosovës me propozimin e Këshillit Gjyqësor të Kosovës;
- (16) emëron dhe shkarkon gjyqtarët e Republikës së Kosovës me propozimin e Këshillit Gjyqësor të Kosovës;
- (17) emëron dhe shkarkon Kryeprokurorin e Shtetit të Republikës së Kosovës, me propozimin e Këshillit Prokurorial të Kosovës;
- (18) emëron dhe shkarkon prokurorët e Republikës së Kosovës, me propozimin të Këshillit Prokurorial të Kosovës;
- (19) emëron gjyqtarët për Gjykatën Kushtetuese, me propozimin e Kuvendit;
- (20) emëron Komandantin e Forcave të Sigurisë të Kosovës, pas rekomandimit të Kryeministrit;
- (21) së bashku me Kryeministrin, emëron Drejtorin, Zëvendës-drejtorin dhe Inspektorin e Përgjithshëm të Agjencisë së Kosovës për Intelejgencë;
- (22) vendos për shpalljen e Gjendjes së Jashtëzakonshme, në konsultim me Kryeministrin;
- (23) mund të kërkojë mbledhje të Këshillit të Sigurisë të Kosovës dhe i kryeson ato në kohën e Gjendjes së Jashtëzakonshme;
- (24) vendos për formimin e misioneve diplomatike e konsullare të Republikës së Kosovës, në bazë të konsultimit me Kryeministrin;
- (25) emëron dhe shkarkon shefat e misioneve diplomatike të Republikës së Kosovës, me propozimin e Qeverisë;
- (26) emëron Kryetarin e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve;
- (27) emëron Guvernatorin e Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës i cili shërben edhe si Drejtor Menaxhues dhe emëron anëtarët e tjerë të Bordit të Bankës;
- (28) jep medalje, mirënjohje dhe çmime, në pajtim me ligjin;
- (29) shpall falje individuale, në pajtim me ligjin;
- (30) së paku një herë në vit i drejtohet Kuvendit të Kosovës përkitazi me fushëveprimtarinë e tij/saj.
52. Përveç kompetencave të Nenit 84, ekziston edhe një numër i madh referencash për Presidentin në Kushtetutë. Pushteti, funksionet, detyrat dhe kompetencat janë të përcaktuara në nene të tjera. Këto nene janë: 4, 18, 60, 66, 69, 79, 80, 82, 93, 94, 95, 104, 109, 113, 114, 118, 126, 127, 129, 131, 136, 139, 144, 150 dhe 158. Disa prej këtyre neneve merren më detajisht me kompetencat e përmendura në Nenin 84, nene të tjera i japin kompetenca Presidentit, të cilat nuk përmenden. Për shembull, Neni 84.1 dhe 84.2 përsërisin në mënyrë substanciale çfarë përmban Neni 4.3. Megjithatë, Neni 79, në të cilën Presidentit i jepet pushteti për të iniciuar legjislationin, nuk përmendet aspak në Nenin 84.
53. Disa nga kompetencat e Presidentit janë të kufizuara, si për shembull, Presidenti nuk mund të ushtrojë një funksion të veçantë në bazë të iniciativës së tij. Shembuj të tillë janë:

- i. Sipas Nenit **84 (15)** dhe **(16)** ku Presidenti emëron dhe shkarkon Kryetarin e Gjykatës Supreme dhe gjyqtarët e tjerë në bazë të propozimit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës;
- ii. Sipas **Nenit 84 (17) dhe (18)** ku Presidenti emëron dhe shkarkon Kryeprokurorin dhe prokurorë në bazë të propozimit të Këshillit Prokurorial të Kosovës;
- iii. Sipas Nenit **93.8**, Presidenti duhet të veprojë mbi rekomandimin e Qeverisë në emërimin dhe shkarkimin e krerëve të misioneve diplomatike; dhe
- iv. Sipas Nenit **158**, Presidenti emëron Guvernatorin e Bankës Qendrore, duke marrë miratimin e Përfaqësuesit Civil Ndërkombëtar, në pritje të përfundimit të mbikëqyrjes ndërkombëtare të implementimit të Propozimit Gjithëpërfshirës për Zgjidhjen e Statusit të Kosovës, më 26 mars 2007.

54. Megjithatë, ekzistojnë shumë shembuj, ku Presidenti luan një rol independent dhe ku ai mund të veprojë sipas iniciativës së tij, pa pikë referimi nga zyra kushtetuese ose zyrtarë ligjorë. Disa shembuj të kësaj janë sipas Nenit 69.4, ku Presidenti duhet të ndërhyjë me një takim të jashtëzakonshëm të Kuvendit të Kosovës ose ku Presidenti emëron Kryesuesin e Komisionit Qendror Zgjedhor nga gjyqtarët e Gjykatës Supreme sipas Nenit 139.

55. Disa nga kompetencat më të rëndësishme të Presidentit cekin shumë ngushtë mbi jetën politike të shtetit. Sipas Nenit 95.1, Presidenti "i propozon Kuvendit një kandidat për Kryeministër, në konsultim me partinë politike ose koalicionin që ka fituar shumicën e nevojshme të votave në Kuvend, të mjaftueshme për të formuar Qeverinë".

56. Neni 95.4 përcakton:

"Nëse përbërja e propozuar e Qeverisë nuk merr shumicën e votave të nevojshme, Presidenti i Republikës së Kosovës, brenda dhjetë (10) ditësh emëron kandidatin tjetër sipas së njëjtës procedurë. Nëse as herën e dytë nuk zgjidhet Qeveria, atëherë Presidenti i Kosovës i shpall zgjedhjet, të cilat duhet të mbahen jo më vonë se dyzet (40) ditë nga dita e shpalljes së tyre".

57. Në mënyrë të ngjashme, nëse Kryeministri jep dorëheqjen ose nëse Zyra gjendet e lirë për çfarëdo arsye, Neni 95.5 siguron se Presidenti "emëron një kandidat të ri në konsultim me partinë e shumicës ose koalicionin, i cili ka fituar shumicën e votave në Kuvend për të krijuar Qeverinë".

58. Sipas Nenit 60, Këshilli Konsultativ për Komunitete vepron nën kompetencat e Presidentit.

Ligji për Presidentin

59. Ligji për Presidentin e Republikës së Kosovës, Ligji Nr. 03/L-094 u miratua më 19 dhjetor 2008 dhe u publikua në Gazetën Zyrtare më 25 janar 2009.

60. Neni 1 i Ligjit siguron se Presidenti është kreu i shtetit dhe përfaqëson unitetin e popullit të Republikës së Kosovës

61. Neni 5 përcakton llojin e betimit që Presidenti jep para Kuvendit. Teksti i betimit është si më poshtë:

"Betohe se tërë fuqinë time do t'ia kushtoj ruajtjes së pavarësisë, sovranitetit dhe integritetit territorial të Republikës së Kosovës, sigurimit të lirive dhe të të drejtave njerëzore e qytetare, respektimit dhe mbrojtjes së Kushtetutës dhe ligjeve, ruajtjes së paqes dhe mirëqenies së të

gjithë qytetarëve të Republikës së Kosovës dhe me ndërgjegje e përgjegjësi do t'i kryej të gjitha detyrimet e mia."

62. Neni 7 i Ligjit, i cituar më poshtë, reflekton dispozitat e Nenit 88 të Kushtetutës.

Papaftueshmëria

1. Presidenti nuk mund të ushtrojë asnjë funksion tjetër publik.

2. Pas zgjedhjes, Presidenti nuk mund të ushtrojë asnjë funksion në parti politike.

Analiza e pozicionit të Presidentit

63. LDK-ja është e përfaqësuar mjaftueshëm në Kuvendin e Kosovës. Ajo mori pjesë në mënyrë aktive në zgjedhjet lokale, që u mbajtën në Kosovë më 17 nëntor 2009. Anëtarët e saj janë të angazhuar në ligjërata politike, biseda dhe konteste në baza ditore. Partia ka qëllimet e saj politike dhe ka të drejtë të aspirojë për poste politike për të avancuar këto qëllime. Në një demokraci, si kjo në Kosovë, ligji u jep partive politike njohje dhe vlerësim të veçantë. Ata kanë të drejtë të apelojnë tek qytetarët që të marrin votat e tyre dhe kandidatët e zgjedhur prej tyre gjatë kohës së zgjedhjeve. Ata kanë të drejtë të negociojnë koalicionë në nivel kombëtar, në Kuvendin e Kosovës dhe në Komunat e gjithë vendit.

64. Partitë politike jo vetëm që avancojnë qëllimet e tyre, duke qenë aktivë në arenën politike, por gjithashtu duke mbështetur kandidatë, të cilët aspirojnë për poste/funksione politike. Një nga mënyrat për ta bindur elektoratin për të votuar për ta është duke publikuar qëllimet dhe programet e partisë së tyre. Ato veprojnë kështu edhe për të zgjedhur kandidatët për zgjedhje dhe duke zgjedhur për poste politike, ata persona që do të influencojnë elektoratin për të votuar kandidatët e tyre dhe listat e tyre.

65. Nëse dikush arrin në përfundimin se pozicioni publik i deklaruar i Presidentit është i saktë, në atë që ka "ngrirë" ushtrimin e funksionit të Kryesisë/Presidencës të partisë së tij, atëherë Gjykata duhet të konsiderojë se ku qëndron realiteti i kësaj "ngrirje". Nuk është e njëjta, si për shembull, një shërbyes civil i ndonjë ministrie, të marrë lejen e pushimit nga pozicioni teknik i shërbyesit civil i saj/ose i tij, për të ndjekur karrierë politike, sikurse nëse Presidenti i Republikës do të përpiqej të merrte "leje për mungesë/pushim" nga pozicioni i tij si Kryetar i një partie politike kryesore, në të njëjtën kohë që mbante titullin zyrtar të Kryetarit të asaj partie politike.

66. Partitë politike kanë si funksion dhe dëshirë themelore të fitojnë mbështetjen e qytetarëve dhe të influencojnë njerëzit në lidhje me çështjet politike dhe të fitojnë zgjedhjet. Një nga mënyrat themelore për të fituar zemrat dhe mendjet e njerëzve, që do të votojnë në kohën e zgjedhjes, është aftësia e një partie politike që të nxis ata

68. Në realitet, që të dy, edhe LDK edhe Presidenti mund të përfitojnë nga asociimi me njëra tjetrën. Presidenti mund të jetë në gjendje të "shngrijë", ushtrimin e tij të detyrave vetëm nëse dhe kur largohet nga detyra e Presidentit të Kosovës. Partia mund të kërkojë avancim politik duke pasur lidhje me një oficer/zyrtar të fuqishëm kushtetues, Presidentin e Republikës së Kosovës. Marrëdhënia simbiotike qëndron midis Presidentit dhe partisë së tij edhe sot e kësaj dite. Kështu pra, ata "përdorin" ose "shfrytëzojnë" njëri tjetrin duke lejuar këtë lidhje asociimi publik që të vazhdojë. Ky term " të përdorim ose shfrytëzojmë", është një nga përkufizimet për "ushtrim/ushtroj", që Presidenti ofron në përgjigjen e tij.

69. Me qëllim që të konsiderojmë nëse kjo është vetëm një shkelje teknike e Kushtetutës ose shkelje serioze, Gjykata duhet të vlerësojë ndikimin e vendimit të Presidentit mbi besueshmërinë e publikut në zyrën e Presidentit të Republikës së Kosovës. Duke pasur parasysh kompetencat e konsiderueshme të dhëna në bazë të Kushtetutës, është e arsyeshme që publiku të presupozojë se Presidenti i tyre, që "përfaqëson unitetin e popullit" dhe jo një fragment ose interes politik partiak, do të përfaqësojë të gjithë ata. Çdo qytetar i Republikës gëzon të drejtën që të sigurohet nga paanshmëria, integriteti dhe pavarësia e Presidentit. Kjo për më tepër, kur ai ushtron zgjedhje politike si kur zgjedh kandidatë konkurrentë nga koalicionet të mundshme për t'u zgjedhur Kryeministër.

70. Opinioni i Gjykatës është se kjo nuk mund të ndodhë kur Presidenti ende mban post shumë të lartë në një nga partitë politike më të njohura në vend dhe arrin në përfundimin se Presidenti ka kryer shkelje serioze të Kushtetutës sipas Nenit 88.2 të Kushtetutës duke vazhduar të lejojë vetveten të figurojë i regjistruar si Kryetar i LDK-së.

PËR KËTO ARSYE, GJYKATA VENDOS ME SHUMICË VOTASH SI VIJON

- I. Kërkesa është e pranueshme.
- II. Ka shkelje serioze të Kushtetutës së Kosovës, respektivisht të Nenit 88.2 të Kushtetutës, nga Shkëlqesia e Tij, z. Fatmir Sejdiu, duke mbajtur njëkohësisht postin e Presidentit të Republikës së Kosovës si dhe postin e Kryetarit të Partisë Politike - Lidhja Demokratike e Kosovës, LDK-së.
- III. Ky Vendim do t'ju komunikohet Palëve dhe do të publikohet në Gazetën Zyrtare në pajtueshmëri me Nenin 20.4 të Ligjit.
- IV. Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë dhe mund t'i bëhet rishikim editorial.


Veç kësaj, gjyqtari Almiro Rodrigues dhe gjyqtarja Snezhana Botusharova deklaruan se do të lëshojnë opinione mospajtuese, të cilat do të publikohen nga Gjykata në kohën e duhur.

Gjyqtar Raportues


Robert Carolan



Kryetar i Gjykatës Kushtetuese


Prof. Dr. Enver Hasani

Përkthyer nga përkthyes zyrtarë të certifikuar të Gjykatës, si përkthim i saktë dhe i tërësishëm i versionit anglisht të Aktgjykimit.



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO

**GJYKATA KUSHTETUESE
УСТАВНИ СУД
CONSTITUTIONAL COURT**

Prishtinë, më 30 mars 2011

Nr. ref.: AGJ 107/11

AKTGJYKIM

në

Rastin Nr. KO 29/11

Parashtruesit

Sabri Hamiti dhe deputetë të tjerë

Vlerësimi i kushtetutshmërisë të Vendimit të Kuvendit të Republikës së Kosovës, Nr. 04-V-04, lidhur me zgjedhjen e Presidentit të Republikës së Kosovës, i datës 22 shkurt 2011.

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Enver Hasani, Kryetar
Kadri Kryeziu, Zëvendëskryetar
Robert Carolan, gjyqtar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare
Ivan Čukalović, gjyqtar
Gjyljeta Mushkolaj, gjyqtare dhe
Iliriana Islami, gjyqtare

Parashtruesit e kërkesës

1. Parashtruesit e kërkesës janë 25 (njëzet e pesë) deputetë nga Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK) dhe 9 (nëntë) deputetë nga Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës, (AAK) (shih Shtojcën A), përfaqësuar nga Mr. sc. Vjosa Osmani.

Vendimi i sfiduar

2. Vendimi i sfiduar nga parashtruesit është Vendimi i Kuvendit të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Kuvendi), Nr. 04-V-04, lidhur me zgjedhjen e Presidentit të Republikës së Kosovës, z. Behgjet Pacolli, në seancën e jashtëzakonshme të Kuvendit, më 22 shkurt 2011.

Objekti i çështjes

3. Objekti i çështjes i kësaj kërkesë është vlerësimi i kushtetutshmërisë nga Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata) të vendimit të Kuvendit, me të cilin, z. Behgjet Pacolli u zgjodh President i Republikës së Kosovës.
4. Parashtruesit kontestojnë kushtetutshmërinë e procedurës së zgjedhjes së Presidentit të Republikës së Kosovës, e aplikuar në seancën e jashtëzakonshme të Kuvendit, mbajtur më 22 shkurt 2011, duke pohuar shkelje të nenit 86 të Kushtetutës [Zgjedhja e Presidentit] së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Kushtetuta).
5. Parashtruesit, në veçanti pohojnë se neni 86, paragrafët (4), (5), dhe (6) të Kushtetutës janë shkelur duke mos pasur kuorumin e nevojshëm gjatë votimit, me mungesën e një kundër-kandidati dhe me ndërprerjen e votimit gjatë procedurës së zgjedhjes.

Baza juridike

6. Neni 113.5 i Kushtetutës, neni 42 i Ligjit Nr. 03/L-121 mbi Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, i datës 16 dhjetor 2008 (në tekstin e mëtejme: Ligji) dhe rregulli 56 (1) i Rregullores së punës së Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatë

7. Më 1 mars 2011, parashtruesit paraqitën kërkesën në Gjykatë.
8. Më 2 mars 2011, sipas rregullit 8 dhe 33 të Rregullores së punës, Kryetari, me Urdhër Nr. GJR. 29/11 të datës 2 mars 2011, emëroi gjyqtaren Iliriana Islami si Gjyqtare Raportuese. Në të njëjtën datë, sipas rregullit 9 të Rregullores së punës, Zëvendëskryetari i Gjykatës, me Urdhër Nr. KSH. 29/11, emëroi Kolegjin Shqyrtues, të përbërë prej gjyqtarës Snezhana Botusharova (Kryesuese), Ivan Čukalović dhe Enver Hasani.
9. Më 3 mars 2011, kërkesa ju komunikua Kryetarit të Kuvendit, duke kërkuar përgjigjen e tij. Në të njëjtën datë, sipas Rregullores së punës, kërkesa ju komunikua edhe Presidentit të Republikës së Kosovës dhe Zyrës Civile Ndërkombëtare (ICO), si palë të interesuara në këtë çështje.
10. Më 8 mars 2011, Gjykata kërkoi nga parashtruesit të paraqesin dokumentacion shtesë, sipas rregullit 35 (2) të Rregullores së punës.
11. Më 10 mars 2011, Kryetari i Republikës së Kosovës, z. Behgjet Pacolli, dorëzoi përgjigjen e tij lidhur me kërkesën e parashtruesve.
12. Më 11 mars 2011, Kryetari i Kuvendit të Republikës së Kosovës, z. Jakup Krasniqi, dorëzoi vetëm Vendimin mbi zgjedhjen e Presidentit, procesverbalin dhe Transkriptin nga zgjedhja e Presidentit dhe Qeverisë mbajtur në seancën e jashtëzakonshme të datës 22 shkurt 2011.

13. Më 17 mars 2011, Kolegji Shqyrtues pas këshillimit mbi Raportin e Gjyqtarës Raportuese, i rekomandoi Gjykatës për pranueshmërinë e kërkesës.
14. Më 28 mars 2011, Gjykata shqyrtoi dhe votoi lidhur me kërkesën.

Përmbledhja e fakteve

15. Më 21 shkurt 2011, Kryetari i Kuvendit ftoi deputetët për të mbajtur një seancë të jashtëzakonshme më 22 shkurt 2011. Në rendin e ditës për këtë seancë të jashtëzakonshme, midis çështjeve të tjera, u paraqit dhe zgjedhja e Presidentit të Republikës së Kosovës.
16. I vetmi kandidat i propozuar për t'u zgjedhur si President i Republikës së Kosovës ishte z. Behgjet Pacolli.
17. Gjatë votimit, nuk morën pjesë partitë opozitare: LDK, AAK dhe Vetëvendosja. Si pasojë, të pranishëm ishin vetëm 67 (gjashtëdhjetë e shtatë) deputetë.
18. Pas raundit të parë të votimit, Kryetari i Kuvendit deklaroi se 67 (gjashtëdhjetë e shtatë) deputetë ishin të pranishëm, dhe nga këta 67 deputetë, vetëm 54 (pesëdhjetë e katër) deputetë kishin votuar PËR.
19. Kuvendi, atëherë, mbajti edhe një raund të dytë, pas të cilit, Kryetari i Kuvendit deklaroi se nga 67 deputetë, 58 deputetë votuan PËR.
20. Pastaj, Kryetari i Kuvendit shpalli edhe një raund tjetër të votimit. Megjithatë, PDK (Partia Demokratike e Kosovës) kërkoi një pushim, i cili fillimisht u refuzua nga Kryetari i Kuvendit.
21. Pas pushimit, u mbajt raundi i tretë i votimit, në të cilin Kryetari i Kuvendit deklaroi se nga 65 (gjashtëdhjetë e pesë) deputetë, 62 (gjashtëdhjetë e dy) votuan PËR. Megjithatë, Komisioni, i cili udhëhoqi procedurën e zgjedhjes, deklaroi se nga 67 (gjashtëdhjetë e shtatë) fletëvotime në kutinë e votimit, 62 ishin PËR, 4 KUNDËR dhe 1 votë e pavlefshme.
22. Pas raundit të tretë të votimit, Kryetari i Kuvendit, z. Jakup Krasniqi, konkludoi se z. Behgjet Pacolli zgjidhet President i Republikës së Kosovës.

Argumentet e parashtruesve të kërkesës

i. Mungesa e kuorumit që mundësonte zgjedhjen e Presidentit

23. Parashtruesit pohojnë se sipas nenit 86(4) të Kushtetutës i cili siguron se: "Zgjedhja e Presidentit bëhet me dy të tretat (2/3) e votave të të gjithë deputetëve të Kuvendit", 2/3-at e shumicës të 120 (njëqind e njëzetë) deputetëve është 80 deputetë, i cili është kuorumi i nevojshëm që nevojitet për të proceduar me zgjedhjen e Presidentit. Megjithatë, gjatë seancës të jashtëzakonshme të Kuvendit, gjatë raundit të parë të votimit, ishin të pranishëm vetëm 67 deputetë, që do të thotë se kuorumi i nevojshëm nuk u arrit më qëllim që të zbatohet procedura e votimit për President. Pavarësisht kësaj, votimi u zhvillua pa kuorum.
24. Sipas parashtruesve, mungesa e kuorumit ishte evidente edhe në raundin e dytë të votimit, ku vetëm 67 (gjashtëdhjetë e shtatë) deputetë u deklaruan të pranishëm.

25. Në raundin e tretë të votimit, vetëm 65 (gjashtëdhjetë e pesë) deputetë u deklaruan të pranishëm dhe Kryetari i Kuvendit konkludoi se z. Behgjet Pacolli, i cili kishte marrë 62 (gjashtëdhjetë e dy) vota, u zgjodh President i Republikës së Kosovës.
26. Në përgjithësi, sipas opinionit të parashtruesve, gjatë gjithë procedurës së votimit për zgjedhjen e Presidentit, kuorumi i nevojshëm i 2/3-ve nuk u plotësua kurrë ose të ishte në pajtim me të, e cila përbën shkelje të nenit 86.4 të Kushtetutës.
27. Për më tepër, parashtruesit pohojnë se procedura është në kundërshtim me mënyrën se si Presidenti i Republikës së Kosovës është zgjedhur më parë.
28. Për më tepër, ata argumentojnë se neni 51 i Rregullores së punës së Kuvendit specifikon qartësisht: "Kuvendi ka kuorum kur janë të pranishëm më shumë se gjysma e deputetëve të Kuvendit" dhe se "Vendimet e mbledhjeve të Kuvendit janë të vlefshme, në qoftë se në kohën kur ato janë marrë, në sallë kanë qenë më shumë se gjysma e deputetëve të Kuvendit". Për më tepër, Rregullorja e punës së Kuvendit siguron se: "Ligjet, vendimet dhe akte të tjera të Kuvendit konsiderohen si të miratuara, nëse shumica e deputetëve janë të pranishëm dhe votojnë". Megjithatë, Rregullorja siguron gjithashtu se: "Përgjithësisht bëhet në rastet kur Kushtetuta e Republikës së Kosovës parashih ndryshe". Sipas parashtruesve, është e qartë se lidhur me kuorumin e nevojshëm në rastin e zgjedhjes së Presidentit të Kosovës, Kushtetuta parashih ndryshe, duke kërkuar 2/3-at e të gjithë deputetëve të Kuvendit.
29. Parashtruesit, gjithashtu, cekin se çështjet për të cilat me Rregulloren e punës së Kuvendit, kërkohet vendim-marrja me 2/3-at, janë: ratifikimi i marrëveshjeve ndërkombëtare, shkarkimi i Avokatit të Popullit, zgjatja e Gjendjes së Jashtëzakonshme për më shumë se 150 ditë, miratimi i Rregullores së Punës së Kuvendit, etj. Parashtruesit pohojnë se kur Kuvendi duhet të vendos për ndonjë nga çështjet e sipërpërmendura, votimi nuk duhet të ndodh, derisa të ketë kuorum të konfirmuar prej 2/3-ve e të gjithë deputetëve të pranishëm. Si shembull, parashtruesit deklaruan se në seancën e Kuvendit të datës 6 shtator 2010, pasi Kryetari i Kuvendit konfirmoi se 72 (shtatëdhjetë e dy) deputetë ishin të pranishëm, ai vazhdoi me rendin e ditës, që përmbante në pikën 4, ratifikimin e Marrëveshjes mes Qeverisë së Kosovës dhe Bankës Botërore. Sipas nenit 18.1 (3) të Kushtetutës, ratifikimi i marrëveshjeve ndërkombëtare duhet të behet me 2/3-at e të gjithë deputetëve të Kuvendit. Duke respektuar këtë procedurë, në seancën e 6 shtatorit 2010, Kryetari i Kuvendit, pasi deklaroi se nuk kishte kuorum, e shtyu atë për seancën e ardhshme plenare. Ngjashmërisht, në një seancë në 2009, Kuvendi procedoi me ratifikimin e një marrëveshjeje për përvetësimin e një kredie mes Qeverisë së Kosovës dhe IBRD, Bankës Ndërkombëtare për Rikonstruktiv dhe Zhvillim, si dhe Memorandumin e Misionit të Thesarit të Bankës Botërore, vetëm pasi u konfirmua se 81 deputetë ishin të pranishëm, domethënë, më shumë se 2/3-at ishin të nevojshëm për ratifikimin e kësaj marrëveshjeje. Gjithashtu, në seancën e datës 13 dhe 17 maj 2010, pika 7 në rendin e ditës, ishte rishqyrtimi i propozimit të Qeverisë së Kosovës për të ndryshuar Marrëveshjen me Fondin Monetar Ndërkombëtar, FMN-në. Para rishqyrtimit të kësaj çështjeje, Kryetari i Kuvendit deklaroi se votimi për këtë procedurë nuk mund të fillojë pa kuorumin e përbërë nga 2/3-at e të gjithë deputetëve të Kuvendit.
30. Parashtruesit, më tej argumentojnë se zgjedhja e Presidentit të Republikës së Kosovës në 2008 u bazua në Kornizën Kushtetuese për Vetëqeverisje të Përkohshme në Kosovë, e cila parashikonte një procedurë identike (lidhur me numrin e nevojshëm të votave) për zgjedhjen e Presidentit. Neni 9.2.8 i kësaj Kornize siguron se: "Kuvendi zgjedh Presidentin e Kosovës me shumicën e 2/3-ve të votave të të gjithë deputetëve të Kuvendit. Nëse pas dy raundeve të votimit, nuk mund të arrihet shumica e 2/3-ve, në raundin pasues, kërkohet shumica e votave të gjithë deputetëve". Edhe në atë rast, votimi u mbajt pas konfirmimit se kuorumi prej 2/3-ve i të gjithë deputetëve ishte i pranishëm.

Në fakt, 119 deputetë ishin të pranishëm dhe pasi ky numër u konfirmua, Kryetari/Udhëheqësi, deklaroi se: "të gjitha kushtet/kriteret janë plotësuar me qëllim që të vazhdojmë me rendin e ditës, e cila përfshinte edhe zgjedhjen e Presidentit". Parashtruesit, duke përdorur parimin e analogjisë, pohojnë se kushti i kuoromit prej 2/3-ve duhet të ishte i vlefshëm për zgjedhjen e Presidentit, sipas Kushtetutës.

31. Parashtruesit insistojnë që është evidente se, praktikat e mëparshme të Kuvendit konfirmojnë, edhe nëse nuk është e shprehur në mënyrë specifike, që para se të fillojë votimi, nevojitet kuorumi prej 2/3-ve, sipas Rregullores së punës të Kuvendit dhe Kushtetutës. Kjo mbështetet në praktikën parlamentare të Kuvendit. Prandaj, duke mos respektuar këtë procedurë, është shkelur neni 86 i Kushtetutës dhe çfarëdo vendimi i marrë gjatë një procedure të tillë është jo-kushtetues.

ii. Mungesa e ndonjë kundër-kandidati gjatë procedurës së votimit të Presidentit

32. Lidhur me këtë, parashtruesit pohojnë se zgjedhja e Presidentit të Republikës së Kosovës duhet të kishte ndodhur pas nominimit të më shumë se një kandidati, sipas nenit 86.5, i cili siguron se: "Nëse asnjëri kandidat nuk merr shumicën prej dy të tretave (2/3) në dy votimet e para, organizohet votimi i tretë në mes të dy kandidatëve të cilët kanë marrë numrin më të lartë të votave në votimin e dytë dhe kandidati që merr shumicën e votave të të gjithë deputetëve, zgjidhet President i Republikës së Kosovës". Për më tepër, neni 86.6 i Kushtetutës siguron: "Nëse asnjëri kandidat nuk zgjidhet President i Republikës së Kosovës, shpërndahet Kuvendi...".
33. Parashtruesit pohojnë se neni 86 i Kushtetutës kërkon kandidimin e të paktën dy (2) kandidatëve, pasi në të dyja citimet, numri i kandidatëve është i përmendur në shumës. Megjithatë, gjatë votimit më 22 shkurt 2011, ishte vetëm një kandidat i cili garonte për postin e Presidentit, e që është jo-kushtetuese, sipas nenit 86.5 dhe nenit 86.6 të Kushtetutës.
34. Së fundmi, parashtruesit pohojnë se në dy zgjedhjet e mëparshme për President të Republikës së Kosovës, ka pasur gjithmonë dy kandidatë që garonin për President të Kosovës. Në fakt, Korniza Kushtetuese nuk përcakton ndonjë kundër-kandidat, dhe është e qartë se qëllimi i hartuesve të Kushtetutës ishte, kur përfshinë kriterin në Kushtetutën e Republikës së Kosovës, të mos ketë vetëm një kandidat në rastin e zgjedhjes së Presidentit, por të ketë edhe një kundër-kandidat. Prandaj, sipas parashtruesve, qëllimi i hartuesve të Kushtetutës ishte të ndryshohej kjo pjesë procedurale e zgjedhjes së Presidentit, duke pasur parasysh një pozicion më demokratik duke i shtuar parimin e garimit/konkurrencës.

iii. Ndërprerja e votimit në kundërshtim me Rregulloren e punës të Kuvendit të Republikës së Kosovës

35. Lidhur me ndërprerjen e votimit, në momentin kur u kërkua një pushim, parashtruesit pohojnë se kjo ishte shkelje e Rregullores së punës të Kuvendit të Kosovës dhe të Kushtetutës, bazuar në konkluzionin e Kryetarit të Kuvendit, si interpretuesi përfundimtar i Rregullores së punës. Meqenëse, Rregullorja e punës nuk ka specifikuar, nëse që në fillim të fazës së votimit për zgjedhjen e Presidentit, ndërprerjet ose pushimet mund të lejohen në mes të procedurës së votimit, është e qartë se Kryetari i Kuvendit, sipas nenit 17.1 të rregullores së punës, jep interpretimin përfundimtar të Rregullores së punës gjatë seancave plenare. Kjo është saktësisht se çfarë bëri z. Jakup Krasniqi në seancën e 22 shkurtit 2011, kur ai deklaroi se ndërprerja e votimit përbënte shkelje të Rregullores së punës.

36. Parashtruesit, për më tepër, pohojnë se në mes të raundit të dytë dhe të tretë lidhur me zgjedhjen e Presidentit, PDK kërkoi një pushim, i cili fillimisht u refuzua nga Kryetari Jakup Krasniqi, por edhe pasi ai e lejoi këtë pushim, ai deklaroi se kjo përbënte shkelje të Rregullores së punës dhe shkelje të Kushtetutës.
37. Në parashtrësën e tyre, pas një pushimi prej rreth një ore, gjatë raundit të tretë të votimit, z. Behgjet Pacolli u zgjodh President i Republikës së Kosovës, përkundër paralajmërimit të mëhershëm të Kryetarit të Kuvendit, z. Jakup Krasniqi, se një pushim i tillë ishte jo-kushtetues dhe në kundërshtim me Rregulloren e punës së Kuvendit të Kosovës. Pasi pushimi përfundoi, Kryetari i Kuvendit deklaroi edhe një herë se ndërprerja në mes të procedurës së votimit është në kundërshtim me Rregulloren e punës dhe do të ketë pasoja pasi është ushtruar presion mbi deputetët.
38. Parashtruesit konkludojnë se, bazuar në faktin që Kryetari i Kuvendit është interpretues i përfundimtar i Rregullores së punës, ndërprerja e procedurës së votimit i shkeli këto rregulla.

Përgjigja nga Presidenti i Kuvendit të Republikës së Kosovës

39. Kryetari i Kuvendit të Republikës së Kosovës, z. Jakup Krasniqi, nuk paraqiti asnjë koment lidhur me kërkesën e parashtruesve, por paraqiti para Gjykatës Vendimin mbi zgjedhjen e Presidentit të Republikës së Kosovës, z. Behgjet Pacolli, procesverbalin dhe transkriptin mbi zgjedhjen e Presidentit dhe Qeverisë së Kosovës mbajtur më 22 shkurt 2011.
40. Kryetari i Kuvendit hapi seancën e jashtëzakonshme, më 22 shkurt 2011, me 81 deputetë të pranishëm, dhe sipas procesverbalit dhe transkriptit, në rendin e ditës ishin 2 (dy) çështje: 1) Zgjedhja e Presidentit të Republikës së Kosovës, dhe 2) Zgjedhja e Qeverisë të Republikës së Kosovës.
41. Prandaj, Komisioni i përkohshëm për verifikimin e kuorumit dhe mandatave paraqiti një raport për verifikimin e plotësimit të kriterëve nga kandidati i nominuar për President, z. Behgjet Pacolli, i cili konkludonte se ai i plotësonte kushtet që parashihen në Kushtetutë dhe Ligjin Nr. 03/L-094 mbi Presidentin e Republikës së Kosovës.
42. Pasi u prezantua ky raport nga komisioni, Kryetari i Kuvendit deklaroi se të pranishëm ishin 93 deputetë.
43. Para se të fillonte raundi i parë i votimit, LDK, AAK dhe Vetëvendosja u larguan nga seanca dhe nuk morën pjesë. Si rezultat, të pranishëm ishin vetëm 67 (gjashtëdhjetë e shtatë) deputetë.
44. Pas raundit të parë të votimit, Kryetari i Kuvendit deklaroi se ishin të pranishëm 67 deputetë, dhe se nga këta 67 (gjashtëdhjetë e shtatë), 54 deputetë votuan PËR, 11 votuan KUNDËR dhe 2 vota ishin të pavlefshme.
45. Kuvendi, pastaj mbajti raundin e dytë, ku Kryetari i Kuvendit deklaroi se nga 67 (gjashtëdhjetë e shtatë) deputetë të pranishëm, 58 (pesëdhjetë e tetë) deputetë votuan PËR, 7 (shtatë) votuan KUNDËR dhe 2 (dy) vota ishin të pavlefshme.
46. Pastaj, Kryetari i Kuvendit hapi raundin e tretë të votimit, i cili u mbajt pas pushimit me 65 (gjashtëdhjetë e pesë) deputetë të pranishëm. Kryetari i Kuvendit deklaroi se nga 65 (gjashtëdhjetë e pesë) deputetë të pranishëm, 62 (gjashtëdhjetë e dy) deputetë votuan PËR, 4 (katër) votuan KUNDËR dhe 1 (një) votë ishte e pavlefshme. Megjithatë, Komisioni, i cili udhëhoqi procedurën e votimit, deklaroi se nga 67 (gjashtëdhjetë e

shtatë) fletëvotime në kutinë e votimit, 62 (gjashtëdhjetë e dy) ishin PËR, 4 (katër) ishin KUNDËR dhe 1 (një) votë ishte e pavlefshme.

47. Pas raundit të tretë të votimit, Kryetari i Kuvendit, z. Krasniqi, konkludoi se z. Behgjet Pacolli zgjidhet President i Republikës së Kosovës.

Përgjigja nga Presidenti i Republikës së Kosovës

48. Presidenti i Republikës së Kosovës, z. Behgjet Pacolli (në tekstin e mëtejme: Pala e Interesuar), pohon se ai u nominua si kandidat për postin e Presidentit të Republikës së Kosovës në pajtim me nenin 86.3 të Kushtetutës. Pala e Interesuar pohon se në pajtim me nenin 86.1 dhe 86.5 të Kushtetutës, në raundin e tretë të votimit, 62 deputetë votuan PËR zgjedhjen e z. Behgjet Pacolli si President i Republikës së Kosovës.
49. Lidhur me mungesën e kuorumit, Pala e Interesuar argumenton se sipas nenit 69 [Orari i Seancave dhe Kuorumi] të Kushtetutës, dhe më specifikisht nenit 69.3 të Kushtetutës, siguron se Kuvendi ka kuorum kur më shumë së (1/2) gjysma e deputetëve janë të pranishëm. Në fillim të seancës së jashtëzakonshme, të pranishëm ishin 117 deputetë, sipas Palës së Interesuar. Fakti që LDK, AAK dhe Vetëvendosje u larguan nga seanca, duhet të konsiderohet si votë kundër kandidatit, z. Behgjet Pacolli, për postin e Presidentit të Republikës së Kosovës, dhe deputetët që ishin të pranishëm dhe votuan për z. Pacolli, duhet të konsiderohen si përmbushje të kushteve procedurale të nenit 86 të Kushtetutës dhe se dëshira e Kuvendit u shpreh në dy raundet e para të votimit.
50. Për më tepër, Pala e Interesuar argumenton se kur filloi raundi i parë i votimit në seancë ishin të pranishëm 67 deputetë, domethënë, Kuvendi kishte kuorum në pajtim me nenin 69.3 të Kushtetutës dhe nenin 51.1 dhe nenin 51.3 të Rregullores së punës të Kuvendit. Prania e 67 deputetëve u konfirmua, gjithashtu, edhe nga Kryetari i Kuvendit. Për më tepër, as neni 86 i Kushtetutës, dhe as Rregullorja e punës së Kuvendit nuk siguron se 2/3-at e deputetëve nevojiten që të fillojë votimi.
51. Për më tepër, Pala e Interesuar argumenton se Kushtetuta, në mënyrë të drejtpërdrejtë, nuk parashihet obligimin që deputetët të jenë të pranishëm. Megjithatë, në frymën e Kushtetutës dhe në përfaqësimin dinjitoz të elektoratit të tyre, ata kanë obligim (të paktën, obligim etik) të jenë të pranishëm në seancë. Prandaj, me qëllim që të shmanget bllokimi për zgjedhjen e Presidentit në Kuvend, hartuesit e Kushtetutës, dhe në veçanti neni 86 i Kushtetutës, ka paraparë tri raunde të votimit dhe në raundin e tretë, z. Behgjet Pacolli u zgjodh President i Republikës së Kosovës.
52. Lidhur me numrin e kandidatëve, Pala e Interesuar argumenton që neni 86.3 i Kushtetutës nuk e kërkon shprehimisht numrin e tillë dhe nuk i obligon deputetët të nominojnë më shumë se një kandidat për President.
53. Për më tepër, Pala e Interesuar pohon se neni 86 i Kushtetutës duhet të ri-lexohet dhe të interpretohet në tërësi, dhe neni 86.5 dhe neni 86.6 i Kushtetutës i referohet vetëm "situatës speciale" kur ka më shumë se një kandidat për postin e Presidentit.
54. Lidhur me pushimin, Pala e Interesuar argumenton se as Kushtetuta, e as Rregullorja e Punës nuk e ndalon të drejtën e një grupi parlamentar të kërkojë një pushim.
55. Për më tepër, Pala e Interesuar pohon se sipas nenit 17.1 të Rregullores së punës, interpretuesi përfundimtar i Rregullores së punës së Kuvendit është Kryetari i Kuvendit. Prandaj, Kryetari i Kuvendit, si interpretuesi përfundimtar i Rregullores së punës së Kuvendit e aprovoi kërkesën për një pushim. Prandaj, pushimi ishte në pajtim me Rregulloren e punës së Kuvendit dhe Kushtetutës.

56. Pala e Interesuar gjithashtu ceku, *inter alia*, se “kërkohet një amendament shtesë në Kushtetutë në pajtim me parimet universale të së drejtës”.

Vlerësimi mbi pranueshmërinë e kërkesës

57. Lidhur me pohimin e parashtruesve se neni 86 [Zgjedhja e Presidentit] i Kushtetutës është shkelur, Gjykata vlerëson se me qëllim që të gjykojë ankesën e parashtruesve, është e nevojshme që së pari të ekzaminojë nëse ata kanë plotësuar kushtet e pranueshmërisë që përcaktohen në Kushtetutë dhe siç specifikohen më tej në Ligj dhe Rregulloren e punës.
58. Gjykata, së pari duhet të ekzaminojë nëse parashtruesit mund të konsiderohen si palë e autorizuar, sipas nenit 113.5 të Kushtetutës, që thotë: “Dhjetë (10) a më shumë deputetë të Kuvendit të Kosovës, brenda një afati prej tetë (8) ditësh nga dita e miratimit, kanë të drejtë të kontestojnë kushtetutshmërinë e çfarëdo ligji ose vendimi të miratuar nga Kuvendi, si për përmbajtjen, ashtu edhe për procedurën e ndjekur”. Në Kërkesën konkrete, 34 (tridhjetë e katër) deputetë nga LDK dhe AAK kontestojnë kushtetutshmërinë e ndonjë vendimi ose ligji miratuar nga Kuvendi, për të zgjedhur z. Behgjet Pacolli si Kryetar i Republikës së Kosovës. Prandaj, parashtruesit janë palë e autorizuar dhe kanë të drejtë ta referojnë këtë çështje në Gjykatë, në lidhje me nenin 113.5 të Kushtetutës.
59. Për më tepër, lidhur me kushtin e mëtejme të nenit 113.5 të Kushtetutës, se parashtruesit duhet ta kishin paraqitur kërkesën “brenda 8 (tetë) ditëve nga data e miratimit” të ndonjë vendimi nga Kuvendi, Gjykata përcakton se Kuvendi e miratoi vendimin e tij më 22 shkurt 2011, kurse parashtruesit dorëzuan kërkesën në Gjykatë më 1 mars 2011. Prandaj, parashtruesit kanë plotësuar afatin kohor ligjor të nevojshëm për të paraqitur një parashtrësë në Gjykatë, siç përcaktohet në nenin 113.5 të Kushtetutës.
60. Gjykata gjithashtu, arrin në përfundimin se parashtruesit kanë plotësuar nenin 42 të Ligjit, duke parashikuar se:
- “Në kërkesën e ngritur në pajtim me nenin 113, paragrafi 5 të Kushtetutës, ndër të tjera, paraqiten informatat e mëposhtme, inter alia:*
- 1.1. emrat dhe nënshkrimet e të gjithë deputetëve të Kuvendit që kontestojnë kushtetutshmërinë e ligjit apo vendimit të nxjerrë nga ana e Kuvendit të Republikës së Kosovës;*
- 1.2. dispozitat e Kushtetutës apo të ndonjë akti apo ligji që ka të bëjë me këtë kërkesë; dhe*
- 1.3. paraqitja e provave mbi të cila mbështetet kontesti”.*
61. Meqë parashtruesit janë palë e autorizuar, kanë plotësuar afatin e nevojshëm për të paraqitur një kërkesë në Gjykatë dhe kanë përshkruar në mënyrë të saktë shkeljen e supozuar të Kushtetutës, duke përfshirë edhe vendimin e sfiduar të Kuvendit, Gjykata konkludon se parashtruesit kanë përmbushur të gjitha kriteret e pranueshmërisë.
62. Meqë parashtruesit kanë përmbushur kushtet procedurale lidhur me pranueshmërinë, Gjykata tani, ka nevojë që të ekzaminojë meritën e ankesave të parashtruesve.

Vlerësimi ligjor i kërkesës

Lidhur me procedurën për zgjedhjen e Presidentit të Republikës së Kosovës

1. Lidhur me numrin e kandidatëve

63. Parashtruesit ankohen se procedura për zgjedhjen e Presidentit të Republikës së Kosovës vetëm me një kandidat përbën shkelje të nenit 86.5 dhe nenit 86.6 të Kushtetutës.
64. Lidhur me këtë, Gjykata i referohet nenit 86.3 të Kushtetutës, i cili parasheh: *"Secili shtetas i Republikës së Kosovës mund të nominohet si kandidat për President të Republikës së Kosovës, nëse ajo/ai siguron nënshkrimet e të paktën tridhjetë (30) deputetëve të Kuvendit të Kosovës. Deputetët e Kuvendit mund të nënshkruajnë vetëm për një kandidat për President të Republikës së Kosovës"*.
65. Lidhur me rastin konkret, Gjykata vëren se z. Behgjet Pacolli, si kandidat për president i Republikës së Kosovës, paraqiti nënshkrimet e 64 deputetëve. Është e qartë se grupet parlamentare që e lëshuan dhe nuk morën pjesë në seancën e jashtëzakonshme të mbajtur më 22 shkurt 2011, nuk e shfrytëzuan mundësinë Kushtetuese për të nominuar një kandidat tjetër për President të Republikës së Kosovës.
66. Neni 86.5 i Kushtetutës siguron se: *"Nëse asnjëri kandidat nuk merr shumicën prej dy të tretave (2/3) në dy votimet e para, organizohet votimi i tretë në mes të dy kandidatëve të cilët kanë marrë numrin më të lartë të votave në votimin e dytë dhe kandidati që merr shumicën e votave të të gjithë deputetëve, zgjidhet President i Republikës së Kosovës"*.
67. Neni 86.6 i Kushtetutës siguron se: *"Nëse në votimin e tretë, asnjëri kandidat nuk zgjidhet President i Republikës së Kosovës, shpërndahet Kuvendi dhe shpallen zgjedhjet e reja, të cilat duhet të mbahen brenda dyzet e pesë (45) ditësh"*.
68. Gjykata është e mendimit se formulimi i nenit 86 [Zgjedhja e Presidentit] të Kushtetutës duhet të ekzaminohet në tërësi. Interpretimi i nenit mund të jetë vetëm se duhet të ketë më shumë se një kandidat për zgjedhjen e Presidentit të republikës së Kosovës, me qëllim që procedura e votimit të vihet në lëvizje. Në veçanti, në paragrafin 5 të tij, në mënyrë eksplicite përcaktohet se, nëse 2/3-at e shumicës nuk është arritur nga asnjë kandidat në raundin e parë të votimit, atëherë, zhvillohet edhe një raund i tretë i votimit midis *"dy kandidatëve të cilët kanë marrë numrin më të madh të votave gjatë raundit të dytë"*. Për më tepër, neni 86.6 i Kushtetutës, gjithashtu shprehet për më shumë se një kandidat: *"Nëse asnjë nga **kandidatët** nuk zgjidhet"*. Neni 27 (4) dhe (5) i Rregullores së punës së Kuvendit përmban dispozita të ngjashme.
69. Në lidhje me këtë, Gjykata i referohet Kornizës Kushtetuese për Vetëqeverisje të Përkohshme në Kosovë, që në Kaptinën 9.2.8 përmban: *"Presidenti i Kosovës do të zgjidhet nga Kuvendi me votë të fshehtë. Nominimi për postin e Presidentit do të kërkojë mbështetjen e partisë, e cila ka numrin më të madh të vendeve në Kuvend ose të paktën 25 anëtarë. Kuvendi do të zgjedhë Presidentin e Kosovës me 2/3-at e shumicës të anëtarëve të Kuvendit. Nëse pas dy raundeve të votimit, 2/3-at e shumicës nuk janë arritur, në raundin pasues, kërkohet shumica e votave të të gjithë anëtarëve të Kuvendit për zgjedhje"*.
70. Gjykata vëren se, sipas Kornizës Kushtetuese, zgjedhja e parë e Presidentit të Kosovës u mbajt në 2002, në të cilën, ishte vetëm një kandidat që garonte për President të Kosovës, domethënë, z. Ibrahim Rugova nga LDK. Në zgjedhjet presidenciale të 2004-s, ishin dy kandidatë që garonin për President, Ibrahim Rugova nga LDK, dhe Ramë Buja nga PDK.

Më tej, në zgjedhjet e 2006-ës, ishte vetëm një kandidat që garonte për President, Fatmir Sejdiu nga LDK. Megjithatë, në zgjedhjet e 2008-s, ende nën Kornizën Kushtetuese, ishin dy kandidatë që garonin për President, Fatmir Sejdiu nga LDK dhe Naim Maloku nga AAK. Në zgjedhjet e fundit presidenciale të 22 shkurtit 2011, mbajtur sipas nenit 86 të Kushtetutës të Republikës së Kosovës, ishte vetëm një kandidat që garonte për postin e Presidentit të Republikës së Kosovës.

71. Për më tepër, Gjykata vëren se Korniza Kushtetuese qëndron e heshtur lidhur me numrin e kandidatëve për zgjedhjen e Presidentit të Kosovës. Megjithatë, ndryshe nga Korniza Kushtetuese, neni 86 i Kushtetutës së Republikës së Kosovës përmend në mënyrë të qartë (jo-ambiguoze) se duhet të ketë më shumë se një kandidat në raundin e parë dhe të dytë, si dhe në raundin e tretë. Është e qartë se hartuesit e Kushtetutës kanë zgjedhur formulimin e fjalëve të nenit 86 të Kushtetutës me qëllim që të devijojnë nga sistemi i paraparë në Kornizën Kushtetuese, duke përfshirë kështu një sistem më demokratik ku më shumë se një kandidat nevojitet para se të vihet në lëvizje procedura për zgjedhjen e Presidentit të Republikës së Kosovës. Procedura e zgjedhjes është krijuar me qëllim që të sigurojë, që më shumë se një kandidat i nominuar për t'u zgjedhur si President, ai, që mori shumicën e votave do të zgjidhet si përfaqësues i popullit të Kosovës. Nëse qëllimi i hartuesve të Kushtetutës do të kishte qenë që të paraqisnin një procedurë alternative për zgjedhje, vetëm me një kandidat të nominuar, Kushtetuta, shprehimisht do e kishte parashikuar një procedurë të tillë.
72. Lidhur me këtë, Gjykata i referohet si shembull Kushtetutës së Shqipërisë, e cila, në nenin e saj 87.5 lejon shprehimisht që të ketë vetëm një kandidat që të garojë për postin e Presidentit:

“Kur ka më shumë se dy kandidatë dhe asnjëri prej tyre nuk ka marrë shumicën e kërkuar, brenda 7 ditëve bëhet një votim i katërt ndërmjet dy kandidatëve që kanë marrë numrin më të madh të votave”.

73. Kushtetuta e Hungarisë, në të kundërtën, parasheh një sistem të ngjashëm që parashihet në Kushtetutën e Kosovës, në nenin 29 B:

“.....

(2) Parlamenti do të zgjedhë Presidentin e Republikës me votë të fshehtë. Votimi mund të ri-përsëritet nëse është e nevojshme. Kandidati, i cili merr shumicën e 2/3-ve të votave të anëtarëve të Parlamentit në raundin e parë të votimit zgjidhet President i Republikës.

(3) Nëse asnjë kandidat nuk merr këtë shumicë në raundin e parë të votimit, procesi i votimit mund të përsëritet, në pajtim me paragrafin (1). Shumica prej 2/3-ve të votave të anëtarëve të Parlamentit nevojitet për t'u zgjedhur në raundin e dytë të votimit.

(4) Nëse asnjë kandidat nuk fiton shumicën e nevojshme në raundin e dytë, do të mbahet një raund i tretë. Në raundin e tretë, vetëm dy kandidatë që kanë marrë numrin më të madh të votave gjatë raundit të dytë të votimit, mund të vazhdojnë me zgjedhjen. Kandidati i cili fiton shumicën e votave - pavarësisht numrin e votimeve - në raundin e tretë zgjidhet President i Republikës.

“.....”

74. Në fakt, procedura e zgjedhjes presidenciale rrjedh nga periudha e tranzicionit pas Luftës së Ftohtë, kur ish-shtetet Komuniste kishin zgjedhur që të zgjidhnin presidentët e tyre nga Kuvendet/Parlamentet nëpërmjet një procedure të ngjashme siç parashihet edhe në Kushtetutën e Hungarisë dhe Kosovës. Ndërkohë, shumica e vendeve ish-Komuniste ndryshuan procedurën e zgjedhjes së Presidentëve dhe vendosën për zgjedhje të

drejtpërdrejtë me votë të përgjithshme. Kjo zgjidhje u motivua nga nevoja për të shprehur dhe reflektuar vullnetin e popullit dhe, përmes votimit të drejtpërdrejtë, të zgjedhet Presidenti i cili është Kreu i Shtetit dhe përfaqëson unitetin e popullit.

75. Lidhur me procedurën e zgjedhjes së Presidentit, siç parashihet në nenin 86. 6 të Kushtetutës, Gjykata thekson se nëse deputetët paraqesin vetëm një kandidat për zgjedhjen e Presidentit të Kosovës, kushtet formale për të vënë në lëvizje procedurën e zgjedhjes nuk janë plotësuar. Në një situatë të tillë, çdo procedurë e cila u pasua me vetëm një kandidat për t'u zgjedhur President i Republikës së Kosovës, ka qenë kështu shkelje e nenit 86 të Kushtetutës.
76. Gjykata thekson se në seancën e jashtëzakonshme të Kuvendit, mbajtur më 22 shkurt 2011, deputetët paraqitën z. Pacolli si kandidat të vetëm për t'u zgjedhur President i Republikës së Kosovës. Në të njëjtën seancë, procedura e zgjedhjes e udhëhequr nga Kryetari i Kuvendit rezultoi që i vetmi kandidat të zgjidhej President i Kosovës, edhe pse sipas opinionit të Gjykatës, nuk ishte në pajtueshmëri me kriteret e nenit 86 të Kushtetutës.
77. Në këto rrethana, Gjykata konkludon se procedura për zgjedhjen e z. Behgjet Pacolli si President i Republikës së Kosovës, mbajtur në seancën e jashtëzakonshme të Kuvendit, më 22 shkurt 2011, përbën shkelje të nenit 86 të Kushtetutës dhe prandaj, është kundër-kushtetuese.

2. Lidhur me votimin në Kuvend

78. Gjykata, së pari thekson se, meqë sapo konkludoi se procedura e zgjedhjes me vetëm një kandidat që garon për postin e Presidentit ishte jo-kushtetuese, nuk do të jetë e nevojshme që të cekim pohimet e shkeljeve të supozuara shtesë të Kushtetutës lidhur me procedurën e zgjedhjes gjatë seancës së 22 shkurtit 2011. Megjithatë, edhe suke supozuar se Kushtetuta do të lejonte që një kandidat të garonte për postin e Presidentit, pjesëmarrja e më pak se numri i deputetëve siç kërkohet me nenin 86 të Kushtetutës, gjithashtu rezultoi në procedurën e votimit si të pavlefshëm.
79. Lidhur me këtë, Gjykata i referohet nenit 70 [Mandatet e Deputetëve] të Kushtetutës, i cili përcakton se "Deputetët e Kuvendit janë përfaqësues të popullit..". Për më tepër, lidhur me obligimin e tyre si deputetë, neni 74 [Ushtrimi i funksionit] i Kushtetutës siguron: "deputetët e Kuvendit të Kosovës do të ushtrojnë funksionin e tyre në interesin më të mirë të Republikës së Kosovës dhe sipas Kushtetutës, ligjeve dhe Rregullores së punës së Kuvendit".
80. Për më tepër, Ligji Nr. 03/L-111 mbi të Drejtat dhe Përgjegjësitë e Deputetit (në tekstin e mëtejshëm: Ligji për deputetët) dhe neni 3 dhe 21 të Rregullores së punës së Kuvendit, miratuar më 29 prill 2010, theksojnë edhe më shumë se deputetët e Kuvendit janë përfaqësuesit e Popullit dhe do të kenë të drejta të barabarta dhe obligim që të marrin pjesë plotësisht në procedurat e Kuvendit dhe do t'i ndjekin detyrat si përfaqësues të njerëzve të Kosovës në pajtim me Kushtetutën, Ligjin dhe Rregulloren e punës së Kuvendit. Kjo do të thotë, duke marrë votën e qytetarëve, deputetët kanë obligime ndaj atyre, inter alia, siç përcaktohet në nenin 40 [Obligimet] të Ligjit për deputetë, duke qenë të obliguar të marrin pjesë në seancat plenare ose në takimet e organeve ndihmëse të Kuvendit, në të cilat, ata janë anëtarë. Nëse deputeti nuk mundet të marrë pjesë në seancat e Kuvendit ose në takimet e organeve ndihmëse të Kuvendit, atëherë, ai/ajo duhet të informojë Kryetarin e Kuvendit, respektivisht, Kryetarin ose Zëvendëskryetarin e atij organi, duke paraqitur arsyet për mungesën e tij/saj, siç kërkohet nga neni 40.3 i Ligjit për deputetë.

81. Obligimi i deputetëve reflektohet edhe më shumë në betimin që anëtarët e Kuvendit duhet të bëjnë pas verifikimit të mandateve të tyre, sipas nenit 10 të Rregullores së punës së Kuvendit, që përmban:

"Unë, deputet i Kuvendit të Republikës së Kosovës, betohem se me nder e me përkushtim do ta kryej detyrën time dhe do ta përfaqësoj me dinjitet popullin, do të punoj në interes të Kosovës dhe të gjithë qytetarëve të saj, do të angazhohem për mbrojtjen dhe për respektimin e kushtetutshmërisë dhe të ligjshmërisë, për mbrojtjen e tërësisë territoriale dhe të integritetit institucional të Kosovës, për garantimin e lirive dhe të drejtave të njeriut, në përputhje me ligjet e vendit dhe me standardet evropiane. Betohem!"

82. Për më tepër, Gjykata thekson se sipas nenit 27 të Rregullores së punës së Kuvendit, anëtarët e Kuvendit do të pajtohen me Kodin e sjelljes, i cili është i bashkangjitur me Rregulloren. Kodi i sjelljes siguron qartësisht se anëtarët e Kuvendit kanë detyrë që të respektojnë ligjin dhe të veprojnë në çdo rast në pajtim me besimin që publiku iu ka dhënë atyre.
83. Në këto rrethana, të gjithë 120 deputetët e Kuvendit duhet të ndjehen të obliguar sipas Kushtetutës, Ligjit për deputetët, Rregullores së punës së Kuvendit dhe Kodit të sjelljes të marrin pjesë në seancat plenare të Kuvendit dhe të përkrahin procedurat që parashihen aty, por mbi të gjitha, një obligim vis-a-vis për njerëzit e Kosovës që i zgjedhën ata.
84. Zgjedhja e Presidentit të Kosovës, i cili sipas nenit 83 [Statusi i Presidentit] është Kreu i Shtetit dhe përfaqëson unitetin e njerëzve të Republikës së Kosovës, është e një rëndësie kaq të madhe, sa që të gjithë deputetët, si përfaqësues të popullit të Kosovës, duhet ta konsiderojnë si detyrë kushtetuese të tyre, përveç nëse ju lejohet nga Presidenti i Kuvendit, të marrin pjesë në procedurën për zgjedhjen e Presidentit siç përcaktohet në nenin 86 [Zgjedhja e Presidentit] të Kushtetutës.
85. Lidhur me këtë, Gjykata vëren se lidhur me numrin e votave që kërkohet për zgjedhjen e Presidentit të Republikës së Kosovës, neni 86.4 i Kushtetutës siguron se Presidenti i Republikës së Kosovës do të zgjidhet me dy të tretat(2/3-at) e **"votave të të gjithë deputetëve"** të Kuvendit, që do të thotë se të gjithë 120 deputetët duhet të votojnë, minus ata deputetë të cilët kanë marrë leje nga Kryetari i Kuvendit, dhe kandidati i cili merr 80 ose më shumë vota nga votat e të gjithë deputetëve (në raundin e parë dhe të dytë) do të zgjidhet. Vetëm nëse nuk arrihen dy të tretat e shumicës, mbahet raundi i tretë. Neni 27 i Ligjit për deputetë dhe neni 27.4 i Rregullores së punës së Kuvendit, përmban formulim identik të fjalëve: "dy të tretat(2/3) e **votave të të gjithë deputetëve të Kuvendit**".
86. Nga procesverbali i seancës së jashtëzakonshme, mbajtur më 22 shkurt 2011. shihet se para se të fillonte votimi, fillimisht ishin të pranishëm 81 deputetë. Megjithatë, kur votimi filloi, vetëm 67 deputetë ishin të pranishëm dhe morën pjesë në votim, ndërsa deputetët e tjerë ishin larguar nga salla e Kuvendit. Kushti i nenit 86, që të gjithë deputetët duhet të votojnë, megjithatë nuk u plotësua. Për më tepër, raundi i dytë i votimit ndodhi në rrethana të njëjta, ndërsa në raundin e tretë, z. Behgjet Pacolli, kandidati i vetëm i nominuar, u zgjodh President i Kosovës me 62 vota nga 67 vota.
87. Gjykata konkludon se, meqë vetëm 67 deputetë morën pjesë në procedurën për zgjedhjen e Presidentit të Kosovës, në seancën e jashtëzakonshme të Kuvendit, mbajtur më 22 shkurt 2011, neni 86 i Kushtetutës u shkel.

3. Lidhur me pushimin e mbajtur gjatë procedurës së zgjedhjes të Presidentit të Republikës së Kosovës


88. Lidhur me pohimin e parashtruesve se pushimi që u lejua nga Presidenti i Kuvendit, para raundit të tretë, përben shkelje të nenit 27 të Rregullores së punës së Kuvendit, Gjykata vëren se neni 86 i Kushtetutës, si dhe neni 27 i Rregullores së punës qëndrojnë të heshturalidhur me këtë çështje.
89. Për më tepër, Gjykata thekson detyrën e saj për të shqyrtuar vetëm shkeljet e supozuara të Kushtetutës. Ankesa e parashtruesve se u mbajt një pushim para se të mbahej raundi i tretë i votimit, sipas mendimit të Gjykatës, nuk përbën çështje kushtetuese, e cila mund të ngrihet sipas nenit 86 [Zgjedhja e Presidentit] të Kushtetutës. Megjithatë, nëse Kuvendi do të kishte vendosur që të mos e lejonte atë pushim, ose nëse Kryetari i Kuvendit, si interpretuesi përfundimtar i Rregullores së punës, të kishte informuar deputetët që gjatë votimit nuk do të lejohen pushime me qëllim që të shmanget presioni i ushtruar mbi deputetë, atëherë pushimi para raundit të tretë do të kishte përbërë shkelje të atij vendimi.
90. Prandaj, lidhur me ankesën e parashtruesve se ka shkelje të nenit 86 [Zgjedhja e Presidentit] të Kushtetutës, kur u lejua dhënia e pushimit para raundit të tretë, Gjykata konkludon se parashtruesit nuk kanë paraqitur dëshmi, pse një shkelje e atij neni duhej të kishte ngjarë.

PËR KËTO ARSYE


GJYKATA, në seancën e mbajtur më 28 mars 2011,

- I. SHPALL, njëzëri, se Kërkesa është e PRANUESHME.
- II. SHPALL, me shtatë vota për dhe dy kundër, se Vendimi i Kuvendit të Republikës së Kosovës, Nr. 04-V-04, lidhur me zgjedhjen e Presidentit të Republikës së Kosovës, më 22 shkurt 2011, është jo-kushtetues – dhe nuk do të jetë në fuqi nga data e publikimit të tij në përputhshmëri me nenin 116.3 të Kushtetutës – meqenëse është në kundërshtim me kërkesat e nenit 86 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe parimet demokratike të mishëruara aty.
- III. Ky Aktgjykim do t'u njoftohet palëve dhe do të publikohet në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20(4) të Ligjit.
- IV. Ky Aktgjykim do të ketë efekt të menjëhershëm.

Gjyqtarja Raportuese


Dr. Iliriana Islami

Kryetari i Gjykatës Kushtetuese


Prof. Dr. Enver Hasani

Shtojca A

LDK

1. Sabri Hamiti
2. Ismet Beqiri
3. Teuta Sahatqija
4. Arben Gashi
5. Lutfi Haziri
6. Skender Hyseni
7. Salih Morina
8. Eqrem Kryeziu
9. Anton Quni
10. Imri Ahmeti
11. Vjosa Osmani
12. Hashim Deshishku
13. Ali Sadriu
14. Sadri Ferati
15. Sali Asllanaj
16. Naser Osmani
17. Armend Zemaj
18. Bahri Thaçi
19. Afërdita Berisha-Shaqiri
20. Hykmete Bajrami
21. Vjollca Krasniqi
22. Lirije Kajtazi
23. Haki Demolli
24. Nazane Breca
25. Lutfi Zharku

AAK

1. Ardian Gjini
2. Daut Haradinaj
3. Ahmet Isufi
4. Time Kadriaj
5. Burim Ramadani
6. Bali Muharremaj
7. Kymete Bajraktari
8. Teuta Haxhiu
9. Xhevdet Neziraj

Pyetësor për përfaqësues nga Parlamenti i Republikës së Kosovës dhe nga Shoqëria Civile në Kosovë për disertacionin e Xhavit Drenorit me temën: “Konsolidimi i demokracisë në Kosovë”

1. Sa e ka penguar apo vazhdon ta pengoj konsolidimin e demokracisë mosfeksionimi në mënyrë të pavarur dhe të mirëfilltë i tri pushteteve (Ekzekutivi/Legjislativi/Gjyqësori)?

2. Legjislativi, a është duke funksionuar sipas mandatit që i është dhënë (me ligj)?
Nëse jo, cekni disa nga pengesat ju lutem!

3. A kemi kulturë politike në komunikimin mes grupeve parlamentare në Kuvend?

4. Prezenca e influencës së Serbisë ndaj partive politike serbe në Kosovë, a është duke e penguar konsolidimin e demokracisë?

5. Mosgatishmëria e pakicës serbe që të integrohen në shoqërinë dhe institucionet kosovare, a është duke e penguar konsolidimin e demokracisë?

6. Cilët faktor tjerë kanë ndikuar në pengimin e konsolidimit të demokracisë në Kosovë?

7. A keni edhe diçka të shtoni në lidhje me temën e konsolidimit të demokracisë në Kosovë?

Faleminderit shumë!